monumentet



DO NOT COPY

2/1984

DO NOT COPY

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURES
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURES
TIRANE

DO NOT COPY

monumentet

2 / 1984 (28)

REDAKSIA

SOTIR KOSTA (KRYEREDAKTOR)
APOLLON BAÇE (ZËV. KRYEREDAKTOR)
ALEKSANDËR MEKSI, ALI MUKA, EMIN RIZA, GJERAK KARAISKAJ,
HASAN NALLBANI

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7

Tirazhi 1200 Formati 70x100/12 Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik. Shtypshkronja «Mihal Duri» – Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

A. Baçe

– Vështrim mbi besimin dhe arkitekturën e kultit tek ilirët 5

B. Dautaj

– Shëtitoret e Dimales 33

L. Lazimi

– Përkujtimorja e Skënderbeut 57

E. Riza

– Në shembull i zhvillimit i banesës gjirokastrite 77

R. Ballauri

– Arkitektura, restaurimi dhe mjedisi urban i një monumenti historik. 95

I. Sukaj–H. Isufi

– Vështrim mbi arkitekturën dhe veçoritë funksionale të haneve në qytetet Durrës dhe Kavajë 113

MATERIALE

N. Ceka–M. Zeqo

– Kërkime nënujore në vijën bregdetare dhe ujrat e brendshme të vendit tonë 127

H. Myrto

– Të dhëna mbi shtrirjen e Dyrrahut në pjesën jugperëndimore të Kënetës 141

BIBLIOGRAFI

A. Baçe

– Antike Welt, Albanien im Altertum 159

N. Ceka

– Butrinti dhe fortifikimet e tij 163

DO NOT COPY

TABLE DE MATIERES

Page

ARTICLES

A. Baçe

– Aperçu sur la foi et l'architecture de culte chez les illyriens 29

B. Dautaj

– Les stoas de Dimale 54

L. Lazimi

– Le monument commémoratif de Skanderbeg à Lezha 75

E. Riza

– Un exemple évolué de l'habitation de Gjirokastër (L'habitation des «Skëndulaj») 91

R. Ballauri

– L'architecture, la restauration et le milieu urbain d'un monument historique 111

I. Sukaj, H. Isufi

– Aperçu sur l'architecture et les particularités fonctionnelles des aubèrges dans les villes de Durrës et Kavajë (fin du XIX^{e}sc – début du XX^{e}sc) 124

MATERIELLES

N. Ceka, M. Zeqo

– Fouilles soumarines le long de la côte et dans les eaux interieures de notre pays. 137

H. Myrto

– Données sur l' l'étendue de Durrachium dans la partie sud-occidentales du «Marais» 156

BIBLIOGRAPHIE

A. Baçe

– Antike Welt, 1983. Albanien im Altertum. 161

N. Ceka

– Butrint et ses fortifications – Gj. Karaiskaj Maison d'édition «8 Novembre», Tirana 1984, 182 p. 166

DO NOT COPY

Nr. 2 1984

monumentet

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

VËSHTRIM MBI BESIMIN DHE ARKITEKTURËN E KULTIT TEK ILIRËT

Tempulli në qytetet e mirfilltë ilirë lindi krahasimisht vonë, nga fillimi i shek. III p.e.sonë, e shumta nga fundi i shek. IV p.e.sonë. Në vështrim të parë duket sikur këtu kemi të bëjmë me një prapambetje në fushën e arkitekturës, por ndërtimi që në shek. e V p.e.sonë i mureve rrethues të qyteteve ilirë me blloqe të mëdhenj e të latuar guri, sipas teknikës dhe skemave më të përparuara bashkëkohëse (Amantia, Nikae, Buthrot etj), tregon se arsyeja e kësaj vonese nuk duhet kërkuar kursesi në prapambetjen teknike. Krahas kësaj ndërsa theatrot, shëtitoret dhe ndërtimet e tjera shoqërore të qyteteve të mirfilltë ilirë të shek. IV-III p.e.sonë, për nga përkujdesja dhe përmasat nuk shkëputen nga ndërtimet e këtyre gjinive në qytetet bashkëkohës helenë, tempujt, në të kundërt me ç'do pritej, nuk i fitojnë kurrë përmasat e tempujve helenë. Ata trajtohen si tempuj të vegjël (naiskose), më tepër vende blatimi se tempuj të mirfilltë. Këto dukuri të përbashkëta për tërë Ilirinë dhe Epirin, e gjejnë shpjegimin tek rituali ilir i adhurimit të shfaqjeve të natyrës, fillimisht të papërfiguruara ikonografikisht, pikërisht në natyrë. Për ta kuptuar këtë dukuri, të përbashkëtën brenda arealit ilir dhe dasitë me vendet fqinjë, së pari do parashtrojmë shkurtimisht besimin dhe ritualin tek ilirët. Ky vështrim i bashkërenduar me dëshmitë e kulturës materiale hedh dritë dhe në sqarimin e unitetit shpirtëror të popullsisë ilire, si një shprehje e qartë e bashkësisë së tij etnike.

Besimi Në periudhën e bronxit, hekurit të parë e madje edhe mjaft më vonë ilirët besonin dhe nderonin forcat dhe elementët e natyrës. Ndërmjet këtyre forcave dhe elementëve një vend kryesor zinte dielli përreth të cilit shtjellohej dhe shumica e më se 60 simboleve ilirë. Përfaqësuesit më të mirëfilltë të kësaj simbolike, svastika, kryqi helikë dhe rrathët bashkëqendrorë[1] gjenden thuajse kudo, që nga fibulat e deri tek qëndismat, që nga prehistorija e deri në ditët tona. Kjo simbolikë dhe nderim i kultit të diellit, ndiqet qartë edhe në arkitekturë. Në vendbanimin prehistorik të Gajtanit, muret e fortifikimit «mbrohesin» prej rrathësh bashkëqendrorë të përvizuar me gurë[2], të cilët simbolizonin pikërisht diellin. Anët e vatrave të banesave Japode të fillimeve të periudhës së dytë të hekurit, në Rifnik dhe Donja Dolina, qenë të zbukuruara me rrathë të bashkëqendërt, svastika dhe meandra.[3] (fig. 1). Kjo dhe trajtimi tepër i kujdesur i këtyre vatrave i tregon ato alltarë të diellit dhe ngrohtësisë së vatrës familjare. Si simbol të diellit jemi të prirur që të shohim dhe një sferë të vogël guri të gdhendur në shkëmb, në murin e pasëm të një banese në Çukën e Ajtoit. Një dëshmi krejt të qartë të simbolikës së diellit në arkitekturë, madje mjaft të vonë, të gjysmës së dytë të shek. II të e.sonë,

---

1) R. Petazzoni, **Antichi culti solari nella peninsola balcanica,** «Revista d'Albania», 2, Roma, 1942, 2, fq. 109, 114, A. Stipčević, **Kukasti Križ kod starih ilira,** «Gjurmime albanologjikë», 9 (3), Prishtinë; 1970, 1-2, 109-128; A. Stipçeviç **Ilirët,** Prishtinë, 1980, fq. 188.

2) B. Jubani, **Kultura ilire në shekujt 12-5 p.e.sonë,** «Lëndët Shoqërore në Shkollë», 1972, Nr. 7, fq. 215.

3) C. Truhelka, **Die Vorgeschichtliche Pfahlbau im Savabet bei Donja Dolina,** Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und Herzegovina, Wien, XIV, 1909.

na sjell Maksimi i Tirit, sipas të cilit ilirët Paionë e «adhurojnë diellin në formën e një disku të vogël të ngritur në majën e një kollone të lartë[4]». Simboli i diellit mbijetoj në trajtën e rrathëve bashkëqëndrorë në edikolat e stelave në antikitetin e vonë (fig. 2), edhe kur ideologjija e krishterë u kthye në ideologji zyrtare. Krahas kësaj nderimin e kultit të diellit, si presion i besimit vendas, e gjejmë dhe në qytetet koloni.[5]

Kulti tjetër më i përhapur në Iliri ishte ai i dragoit (dracoi, draccena) — gjarpërit me të cilin mitologjia lidh dhe emrin e ilirëve.[6] I papranuar nga simbolika greke ai haset rëndom që nga periudha e bronxit e deri në ditët tona. Dragoin e shohim të ngadhënjojë bashkë me luftëtarët ilirë fitoren mbi armikun, gjarpërin e gjejmë në monedhat e Amanties dhe Bylisit[7]. Simbol i ripërtëritjes së vetë jetës ai lidhet me tokën, duke qenë në bestytninë popullore



Fig. 1



Fig. 2

edhe të shekullit tonë «Zot i truallit të shtëpisë dhe njëkohësisht zot i tokës»[8] . Si i tillë ai është simbol i kultit të lashtë të perëndive të tokës. Për shkak të këtij parapëlqimi krishtërimi u mundua ta shrrënjosë këtë besim dhe simbolikën e tij: Sipas Hieronimit në v. 365 në Epidaur erdhi Shën Hilarioni i cili mundi dhe vrau «dragoin e madh që njerëzit e quanin Boa»[9]

4) **Maxim,** Tyr., II, 8, 6.

5) Simbas Herodotit (IX, 93) diellit në Apolloni në shek. e V p.e.sonë i ishin kushtuar grigja të mëdha bagëtije të cilat ruheshin nga njerëzit më në zë «si për nga pasuria ashtu dhe fisi». Dënimi i tyre me verbim kur cënoheshin këto grigja tregon adhurimin e veçantë të hyut-diell.

6) Apolod, Bib. III 39. Mbishkrimi me emrat dracoi, draccena gjetur në Bllacë të Shkupit (A. Stipçeviç, **Ilirët,** fq. 196).

7) Ky simbol paraqitet në një numër të pafund zbukurimesh, veçanërisht metalike. Më qartë ai del në paftat e praruara të gjetura në Selcë të rr. Pogradecit (N. Ceka, **Gërmimet në qytetin ilir të Selcës së Poshtme**, «Buletin arkeologjik», Tiranë 1971) dhe Gostilje në veri të liqenit të Shkodrës (D. Basler, **Nekropola u veliim ledinima u Gostilju** «Glasnik zemoljskog muzeja» Bosne i Hercegovine, Sarajevo 1969). Monedhat e Amanties (268-168 p.e. sonë) paraqesin në faqe Zeusin e Dionën dhe në shpinë një gjarpër të mbledhur kulaç, të Bylisit (260-148 p.e.sonë) Zeusin dhe një gjarpër rreth bririt të bollëkut (H. Ceka, **Probleme të numismatikës ilire,** Tiranë, 1965, fq. 78, 84). Në monedhat e kolonive të bregdetit dalmat gjarpëri, si simbol i ilirëve, paraqitet i sulmuar nga shqiponja ose kaprolli, simbol i kolonistëve (J. Brunschmied, **Die inschriften und Münzen der Griechischen städte Dalmatiens,** Wien, 1898). Më tej me pajtimin e tyre në monedhat u la vetëm simboli i kolonistëve.

8) M. Tirtja, **Mbi zanafillën e disa motiveve në gurgdhendjet në shtëpitë fshatare shqiptare**, «Monumentet» 2, 1982, fq. 123.

9) Hieronym, **opera,** III ep. 2.

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

Por paradoksalisht dëshmitë e këtij kulti në arkitekturë fillimisht i hasim në kishat paleokristiane, në Paleokastër, ku simbol kryesor është gjarpëri (fig. 3), dhe në Antigone (fig. 4) ku simbole kryesore janë dragoi dhe gjarpëri.[10]. Paraqitja e këtij simboli vazhdoi pa ndërprerje deri në ditët tona (fig. 5,6).

Besimi i parë ilir drejtpërdrejt në forcat elementët dhe qëniet e natyrës[11] të papërfiguruara ikonografikisht, bëri që faltoret e para të jenë në natyrë, burimeve, shpellave, lisave shekullorë. Një ndër ta ishte dhe «lisi i gjatë fallxhor... në Dodonën pelazgjike», orakulli më i vjetër në Ballkan.[12] Orakulli

DO NOT COPY

10) A. Baçe, **Kështjella e Paleokastrës,** «Iliria», 2, Tiranë, 1981, fq. 210. Për pllakat e varreve të shek. XVI. S. Bešlagiç, **(Stari Malisorski nadgrobni spomenici u Vuksan Lekiču,** «Glasnik Muzeja Kosova» X, 1970, fq. 363-383). Për ata të mëvonshmit në Këlmend e Koplik dhe harqet e dyerve të banesave të shek. XIX-fillimit të shek. XX (Përmet, Labëri, Çermenikë, Malësi të Madhe, Malësi të Tiranës, Mat, Mirditë, Dukagjin, Kosovë) M. Tirtja **(vep. cit,** fq. 122-123) kjo dukuri e fundit dëshmon atë një kult të fortë totemik, tradicional.

11) Kjo e fundit kuptohet dhe nga simbolika totemike e ndërvartësisë së fisit nga ndonjë kafshë si ulcin (ujk), Delmin (dele), Taulant (Dallandyshe), Enkelej (ngjalë) (A. Mayer, **Die sprache der alten illyrier,** Wien, 1957, II, fq. 120-138, 38, 112, 45-48).

12) Homer, Iliad; XVI 233, 325, **Odis** XIV 327, XIX, 296, Herodoti (II, 52) e tregon atë orakullin më të vjetër të Greqisë. Simbas Kern-it (s.v. **Dodona,** «Pauly – Wissowa, Real Enzyclopädie, Sttutgart 1905, V), lisi është pema e çdo kryezoti indoeuropian.

Orakulli i Dodonës u lokalizua së pari nga Ismail Qemali në vitet 60 të shek. XIX. Në ditarin e tij (Ismail Qemali Vlora, **Kujtime,** Toronto, 1968, fq. 18, 19) ai shkruan «E lashë Janinën me keqardhje sepse ky vend kish një interes të dyfishtë për zemrën time. Janina ish qyteti ku unë kreva studimet e mija dhe nga ana tjetër ish një vend ku në çdo hap gjejshim shenjat e qytetërimit prehelenik ose Pellazgjik që rraca shqiptare kish çdo të drejtë ta quajë të sajën, dhe ish për më tepër gurra prej nga rrodhi qytetërimi i mëvonshëm Helenik. Midis kujtimeve që mbaj mend në këtë kohë qe vizita që i bëra një vendi që më vonë u provua se qe orakulli i Dodonës. Dihet se orakulli i parë i kohëve të vjetra, ay i Dodonës, kishte pasë qenë në këtë vend megjithëse asnjë nuk kish ide se ku ndodhesh pikërisht. Gjatë një shëtitje me një mik që bëmë së bashku në pronën e tij në fshatin Melingus, më ranë në sy disa gërmadha me rëndësi të posaçme, që duke i shqyrtuar me vërejtje më dhanë përshtypjen dhe më kujtuan pozicionin dhe përshkrimin e Dodonës. Mali i Tmarusit, që dominonte këto gërmadha, lisat shekullorë, dhe një pus që ishte ndërtuar në kohë shumë të vjetra, më bënë të mendoj që në të vërtetë ndodheshim midis gërmadhave të Dodonës. Dhjetë vjetë më vonë kur ndodhesha në Vlorë, bashkë me mikun tim të fëminis Z. Kostandin Karapanon, misjoni frëng që kish bërë gërmime në këtë vend deklaroi se çdo mendim se në këtë vend ka pasë qenë Dodona është mendim i gabuar dhe ahere i përsërita Karapanos përshtypjet e vizitës sime. Karapanua që ishte njeri gjithmonë me inisiativë, menjëherë nisi gërmimet e tij, qiti në dritë jo vetëm orakullin e famshëm po dhe një sasi objektesh arkeologjike të një vlere shumë të madhe». Në të vërtetë gërmimet e Karapanos, në vitin 1875 përputhen mjaft mirë me këto të dhëna. Botimi i parë i këtij lokalizimi nga Cht. Wordsworth **(where was Dodona** «J.H.S.» 2, 1882 fq. 228v) është mjaft më i vonë edhe nga gërmimet e Karapanos.



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7

shërbehej prej Selëve «që nuk lajnë këmbët dhe flejnë për tokë». Ky ritual, pa asnjë shëmbëlltyrë në ritualin Helen[13] e dëshmon atë të lidhur me kultin e tokës, së cilës priftërinjtë e tempullit, edhe në shek. e II të e. sonë, i këndonin «Toka na sjell bereqetin, këndojani pra lavdet tokës mëmë[14]). Një ndryshim tjetër thelbësor me ritualin helen qëndron në faktin se «banesë» e Zeusit dhe Dionës, perëndive të mëtejshme të orakullit, nuk ishte naosi i tempullit, si në tërë tempujt ose dhe orakujt e tjerë të Helladës, por «degët e lisit të shenjtë»: Burimet e shkruara tregojnë se deri nga fundi i shek. IV p.e. përreth lisit nuk kishte asnjë ndërtim përveç një unaze trekëmbëshash që mbartnin mbi vete kazanë kumbues[15] bronxi (fig. 7). Kjo vërtetohet dhe nga gërmimet arkeologjike, gjatë të cilëve u zbuluan pjesë të këtyre trekëmbëshave të shek. VIII p.e.sonë[16], të zbukuruar me motive të repertorit iliro-epirot. Këto veçanti: rituali i selëve, «banimi» i perëndive në pemë e jo në naosin e tempullit dhe mungesa e tempullit, deri në shek. e III p.e.s. dëshmojnë qartë se orakulli i Dodonës nuk kishte të bënte fare me religjionin helen dhe se i përkiste një sfere tjetër shpirtërore, asaj ilire[17]. Për më tepër trekëmbësha të tillë me një enë gjysmë sferike sipër

DO NOT COPY

13) Homer, **Iliad,** XVI, 233-235. Kern **(Po aty)** thekson se ky ritual nuk ka asnjë paralele në religjionin grek. Ky zakon s'ka të bëjë aspak me ruajtjen e virgjërisë nga priftëreshat e Artemisit në Orhomenos siç mendon Dakaris **(Dodona,** bot. angl. fq. 93).

14) Paus, 10, 12, 10.

15) Demon, **F.H.G,** I, 381. Në se prekej njeri prej Kazanëve dridhjet i transmetoheshin kazanëve të tjerë dhe kumbimi vazhdonte thuajse pa mbarim, Nga ky tingull priftërinjtë e orakullit parashikonin ngjarjet.

16) S. Dakaris, **vep. cit,** p1-21.

17) S. Dakaris, **vep. cit,** e quan orakullin e Dodonës Grek dhe e sheh zhvillimin e tij në kohë, të njëjtë me atë të orakujve të tjerë. Argumentat e mësipërm, veçanërisht mungesa e tempullit të paktën deri nga fundi shek. IV p.e.sonë, dëshmojnë të kundërtën. Po kështu argumentat linguistikë të Dakarisit fitojnë forcën e bumerangut. Së pari emrat kryesorë Tomor dhe Dodonë nuk janë grekë dhe Tomori e ka homonimin e tij në Shqipëri, çka e tregon atë emër të arealit iliro-epirot. Kalimi Selloi-helloi – hellas që ai mundohet ta vërtetojë, nuk dëshmohet as nga burimet dhe as pranohet gjuhësisht. Dakaris e kërkon shpjegimin e rrënjës **di** të Gjinores së Zeusit në Eudios (gr. ditë me kohë të mirë). Kur kjo rrënjë përqaset me shqipen ditë. Po kështu emri i lisit **drus** tek autorët antikë mund të lidhet shumë mirë me shqipen **dru.** Së fundi autorët antikë e quajnë Dodonën barbare e jo greke.



Fig. 8



Fig. 9

(fig. 8), janë gjetur dhe në Novo-Mesto[18] çka dëshmon për një orakull tjetër të njëjtë dhe në ilirinë veriore.

Nderimin e një fuqie të natyrës, po nëpërmjet një objekti të natyrës, e hasim dhe në Buthrot. Këtu objekt adhurimi ishte një burim, gjasisht me ujë mineral me veti shëruese, pasi më tej ai ju kushtua hyut të mjeksisë. Me kohë burimi u mbulua pjesërisht me bllloqe guri të punuar vrazhdët[19], me një përkujdesje për mos t'ju larguar natyrës (fig. 9). Rëndësija e tij kuptohet dhe nga zhvillimi i qendrës së qytetit pikërisht rreth boshtit të këtij burimi.

Një shfaqje e tillë haset dhe në liqenin e Seferajt, 2 km në jugperëndim të qytetit ilir të Belshit, ku në afërsi të bregut u zbulua një numër i madh terrakotash, enësh dhe kockash kafshësh, të hedhura në ujë gjatë zhvillimit të ceremonive të kultit. Terakotat tregojnë se kjo ceremoni e shek. III-II p.e.sonë i kushtohej një hyjneshe ilire të njësuar me Afërditën[20] dhe dëshmojnë qartë se ajo nuk kryhej brenda ndonjë tempulli, por në natyrë, në ujrat e liqenit. Nderimi dhe adhurimi i burimeve dëshmohet dhe në tokat e Japodëve, në Bihaç, dhe të Liburnëve, në Flanonë[21].

Panteoni ilir. Thellimi i diferencimit shoqëror në iliri në shekujt e pasëm të periudhës së parë të hekurit, shtroj kërkesën e përligjies së këtij diferencimi. Dora-dorës shfaqjet dhe fenomenet e natyrës nisën të fitojnë atribute njerëzorë dhe të përfaqësohen prej një hierarqie të diferencuar, e vetkuptueshme kjo pasi një shoqëri me klasa kërkonte bazën e saj ideologjike. Por emrat e perëndive dhe gjysmëperëndive ilire nuk u njësuan kurrë me emrat e perëndive greke ose romake. Qëndresa që u bëri panteoni ilir këtyre dy panteonëve të fuqishëm, tregon se ai lindi si pasojë logjike e zhvillimit të brendshëm dhe diferencimit të shoqërisë ilire.

Më herët nga perënditë ilire, njohim Redonin, i cili lidhet mirë me lundrimin. Emrin e tij e gjejmë në monedhat e v. 168 p.e.s të Lisit dhe të Labiatëve,[22]

18) A. Stipçeviç, **Ilirët,** fq. 132. Ky trekëmbësh është krejt i njëjtë me atë të një unaze të shek. VIII p.e.sonë të gjetur në Dodonë (Dakaris Dodona p1-21).

19) L.M. Ugolini, **L'acropoli di Butrinto,** Roma-Milano, 1942, fq. 98.

20) N. Ceka-M. Zeqo, **Kërkime nënujore në vijën bregdetare dhe ujrat e brendshme të vendit tonë,** «Monumentet», 2, 1984.

21) C. Patsch, **Iapodi,** «Glasnik Zemaljskog muzeja», Sarajevo, 10, 1898, fq. 335. 345., R. Katiçiç: **Drei altbalkanische Nomina Sacra,** «Godisnjak» Centar za Balkanoška ispitivanja, Sarajevo, 7, 1972, fq. 126-127, A. Stipçeviç, **Ilirët,** fq. 194.

22) N. Ceka **(Bust i mbretit Gent apo figurë e mitologjisë ilire,** «Iliria», VI, f. 242). Shkruan se «Emri mbi faqe të monedhës së Lisit do të afronte më në fund me një toponim të sotëm gjeografik Rodon... Do të mendonim se tek teponimi Kepi i Rodonit, i cili na përmendet në dy dokumente mesjetarë të vitit 1324 në trajtat Redonum e Rhedones (L. Thalloczy, C. Jireček, E. Šufflay, **Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatia illu-**

DO NOT COPY



Fig. 10

Redon quhej një skelë ilire dhe emrin e tij e hasim në një mbishkrim në Itali (Grota Porcinaria), ku bëhet fjalë për ekuipazhet e anijeve Medaur dhe Redon.[23] Me lundrimin dhe ujrat lidhet shumica e perëndive të tjerë të ilirisë veriperëndimore, perëndija e detrave Bindi-Neptuni i Japodëve, Ika-Jutosika, perëndesha e burimeve tek Liburnët, Boria, perëndia e erërave tek Istrët.[24]

Në se në Ilirinë veriperëndimore, ku si zeje kryesore ishte lundrimi dhe përfitimi i të mirave të detit, vendin e parë e zinin perënditë e ujrave, në Ilirinë e Jugut dhe Epir, të lidhura më tepër me bujqësinë, blegtorinë dhe gjuetinë, më të përhapur qenë hyjnitë e lashta, të tokës dhe grigjave, kryesisht Thana (fig. 10), simotra ilire e Artemisit dhe Dianës.[25]. Prania në Kandavi e stacionit rrugor «Ad Dianam» dhe mbishkrimi në veri të liqenit të Shkodrës «Diana Candavensis» [26] tregon përhapjen e gjërë të kultit të kësaj perëndeshe ilire të cilën e njohim vetëm nga «interpretatio romana». Për më tepër, si pasojë e presionit të besimit vendas, ajo zuri vend të dorës së parë dhe në panteonin e qyteteve-koloni, ku u njësua mirë me Artemisin.[27] Relievet e kësaj hyjneshe me shpurën e sajë, e cila i qëndroi gjatë shekujve presionit të krishtërimit duke arritur në ditët tona me emrin e zanave, i gjejmë si në jugë ashtu dhe në veri.[28] (fig. 11).

Përqëndrimi i pushtetit, krijimi i njësive politike gjithnjë e më të mëdha, lindja e shtetit ilir dhe epi-



Fig. 11

rot, e kërkoi dhe e gje
shëmbëlltyrën dhe në reli
gjion. Njëri prej perëndiv
u shkëput dhe u ngrit n
një piedestal më të lart
se të tjerët. Këta ishin Re

---

strantia, I. Vindobonae, Nr. 694, 798) na është ruajtur një emër i lashtë, një toponim i trashëguar nga fondi gjuhësor ilir. Nuk do të ishte një guxim i tepruar... të shihnim tek busti me Kausia, të emërtuar vetëm tek monedhat e Lisit, hyun ilir të detit». Gjetja e skelës ilire në Kepin e Rodonit (N. Ceka – M. Zeqo, **vep. cit)** e vërteton plotësisht këtë.

23) C. Pagliara, **Gli iscrizioni di Grota Porcineria,** «Leuca», Leece, 1980.

24) Në Bihaç, në burimin e Privalicës, janë gjetur altarët dhe tre mbishkrime, njeri nga të cilët i prepozitit të Japodëve, i kushtohet «Bindo-Neptuno Sacrum»-it (R. Katičić, **Drei altbalkanische Nomina Sacra** fq. 126-127). Në Flanona Ikës, Jutosikës, i ishte kushtuar një përmendore. Burimi në këtë vend njihet dhe sot e kësaj dite me emrin e saj. (A. Stipçeviç, **Ilirët,** f. 194). Emri i Borias përmendet së bashku me një varg perëndish të tjera: Eia, Melesocus; Iria, (A. Degrassi, **Culti dell istria preromana e romana»,** Adriatica praehistorica et antiqua, Miscellana, G. Novak dicata» Zagreb 1970, f. 615-623). Mendojmë se ky emër vazhdoi më tej paksa i shndërruar në Bora, era e ftohët e Veriut.

25) E. Çabej, **Kult und Fortleben der Göttin Diana auf dem Balkan,** «Leipziger Vierteljahresschrieft für Sudosteuropa», 5, 1941, No 3-4, f. 229-341. Në mbishkrimet në tokat e Dalmatëve Thana del gjithnjë e shoqëruar me Vidasusin. A. Mayer, **(Die illyrischen Götter Vidasus und Thana,** «Glota», 31, f. 235-243) sheh në të hyjninë e burimeve, kullotave dhe pyjeve.

26) Stacioni Ad Dianam tek N. Ceka-L. Papajani, **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike,** «Monumentet», 1971, f. 1. Mbishkrimi i Dioklesë nga C. Prashniker-A. Schober, **Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien, 1919, f. 2.

27) Përhapjen e gjërë të kultit të Artemisit në qytetet koloni e dëshmojnë statuetat e shumta të saja në Epidamn (C. Praschniker-A. Schober, **vep. cit,** f. 42). dhe relievet dhe mbishkrimet e gjetura në Apolloni (C. Praschniker, A. Schober, **vep. cit,** fq. 75, C. Praschniker, **Muzakhia und Malakastra,** Wien, 1920, f. 38; C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien,** Wien, 1904, f. 186). Kësaj perëndije i kushtohej tempulli më i vjetër e më i madh i Korkyrës dhe një tempull në Apolloni (i vetmi i identifikuar) Piknisja e rrugës së Kandavisë nga Dyrrahu ishte pikërisht një tempull i Artemisit (Appian, **Bell – civ,** I, 60-CILIII-602).

28) Relievet e gjetura në Amantie, Pogradec dhe Elbasan tek S. Anamali **(Amantia,** «Iliria», 2, Tiranë, 1972, fq. 95). Ato të Epidamnit jepen nga C. Praschniker-A. Schober, **(vep.cit,** fq. 41, 42), të Bihaçit dhe Sinjit nga A. Stipçeviç, **(Ilirët** tabelat pas f. 160).

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13

doni i Ardiejve, zot i detrave, Medauri luftëtar «Zot dhe lar publik i Rizonit dhe tërë Dalmatëve... që e shilonte kalin me ushtë në dorë»,[29] Jupiteri i Parthinëve që e njohim vetëm nga «interpretatio romana»[30]. Njësimi i këtij hyu me Jupiterin që forcën e kishte në rrufetë, e afron atë me zotin Shurdh, që të shurdhon, me perëndinë e vetëtimave dhe bubullimave, kujtimi i të cilit ruhet ende sot[31]. Përveç tyre njihen dhe një sërë perëndish të tjera.[32] (fig. 12).

Të tëra këto tregojnë se në drejtim të panteonit ilir kemi të bëjmë me parapëlqime, me një intesitet të ndryshëm të njerës ose tjetrës shfaqje, por jo me një dasi e cila do ta cënonte unitetin shpirtëror dhe kultural. Në të kundërt këtë dasi, shfaqje më e qartë e e së cilës është vetë rituali, e shohim në raportin me religjionin Helen. Mjaft mirë këtë e dëshmojnë dhe tiparet arkitekturorë të tempujve në qytetet e mirfilltë ilirë. Krahas tyre do trajtojmë dhe tempujt e hershëm të qyteteve – koloni, të kohës kur lidhjet metropol – apoike ishin ende të forta. Për këtë trajtim nisemi nga fakti se ato janë pjesë e repertorit arkitekturor të truallit të ilirisë dhe nga ana tjetër ato shërbejnë si pika më të afërta e më të qarta referimi për nxjerrjen në pah të dasive midis tempullit Helen dhe tempullit Ilir.

Tempujt e qyteteve koloni. Disa antefikse qeramike me luanë dhe koka gorgonash dëshmojnë pra-

29) Medaurit i kushtohet mbishkrimi me vargje në tempullin e Eskulapit në Lambezie të Numidisë, nga Konsulli dhe legati i atjeshëm i cili origjinën e kish nga Rizoni (CIL III, 285). Emrin e tij e rigjejmë dhe në mbishkrimin e Grotta Porcinarias (C. Pagliara, Po aty).

30) C. Patsch, **Der Jupiter Parthinus,** «Klio», XXXI, 1938, f. 439-443.

31) Emri i tij ruhet ende në malësinë e Shkodrës. Me të lidhet gjasisht emri i qytetit mesjetar të Shurdhahut dhe ndoshta Sardës antike (shih për këtë Steph **s.v. Sarda** dhe shpjegimin e tij).

32) H. Ceka, (**Probleme...**, f. 84) shkruan «se brini me gjarpën nuk hyn në rradhën e atributeve të Zeusit pra nuk ka asnjë lidhje me këtë hyjni. Kryet e Zeusit e ndeshim në monetat e Epirit, t'Amanties, t'Olympes, të Dyrrahut, të Skodrës dhe në një rast të vetëm bile dhe t'Apolonisë. Kjo do të thotë se kemi të bëjmë me një hyjni që adhurohej në krejt territorin ilir... duhet të shtronim qoftë në formë hipoteze pyetjen në se në rastin tonë nuk kemi para nesh një perëndi ilire të unifikuar me Zeusin».

A. Stipçevic, **(Ilirët, f. 194-195)** na bën të ditur për një sërë perëndish të tjerë Eia, Melesocus, Iria ose me perëndi të tjera si «Armatusi, Liberni, Terminusi, të njohur vetëm nga «interpretatio romana».



Fig. 14



Fig. 15

ninë në Korkyrë të tre tempujve të drunjtë njëri i fundit të shek. VII p.e.sonë dhe dy të fillimit të shek. VII p.e.sonë.[33] Korkyrës i përket dhe një nga shembujt më të hershëm të tempujve me elemente të gurtë, ai i Artemisit, tempulli më i madh i njohur i arkitekturës arkaike[34] (fig. 13). Koha e ndërtimit të tij. (v. 620-580) përkon me një periudhë gjatë së cilës tradita ndërtimore e Korinthit u përpunua në mënyra vehtiake dhe influencoi deri edhe arkitekturën e «Magnia Grecias», veçanërisht të Pestumit dhe Selinuntit.[35]

Stilobati i tempullit të Artemisit (22.4 x 47.6 m) qarkohej prej 8 kollonash në ballet e ngushtë dhe nga 17 në anët.[36] Në mesin e tij gjendet kthina e shenjtë (naosi) shumë e përzgjatur dhe e ngushtë me vendin e blatimeve nga pas (opistodomin) dhe një parakthinë, (pronaos), të thellë në ballë. Tempulli qarkohej nga hajati i mbuluar (peristazisi), mjaft më i gjerë se në tempujt e tjerë (5m). Naosin e ndriçuar fare dobët vetëm nga hapsira e derës e ndanin në tre anijata dy sërë prej 10 kollonash dykatëshe. Anijata e mesit tepër e ngushtë dhe e gjatë (2.5 x 22m) të çonte drejt shtatores së perëndeshës. Në kollonat e tempullit vërehet kalimi përfundimtar nga proporcionet e kollonave të drunjta, të holla e të gjata, në proporcionet e kollonave të gurta, të ngjeshura mirë[37] Mbi kreun e tyre vjen kapiteli me ekinin të shtrirë si pjatë, çka tradhëton shembëlltyrën origjinale të ka-

33) G. Gruben, **«Die tempel der Griechen,** München, 1966, f. 103.

34) Tempull tjetër i madh është Heraioni i Olimpit vërtet më i gjatë por me ballë më të ngushtë (18,75 x 50 m).

35) G. Gruben (**vep. cit,** f. 105, 231). Sipas tij kjo influencë vërehet përpara së gjithash në peristasin 2 module të thellë dhe përpunimin e kollonave. Mjaft të ngjashëm me tempullin e Korkyrës për nga zgjidhja planimetrike, konceptet dhe proporcionet, por të ndryshëm për nga përmasat janë tempulli i II i Herës së Pestum, i shek. V p.e.sonë, dhe tempulli G në Selinunt, i v. 520 p.e.sonë. Ky i fundit përkon me tempullin e Korkyrës dhe nga numri i kollonave (8 x 17). Prostazisi i gjërë, si në Korinth vërehet dhe në tempujt X,F,G në Selinunt (Krahasimi sipas planimetrive të H. Kahler, **Der Grieschische Tempel, das Wesen und Gestalt,** Berlin, 1964).

36) G. Gruben, **vep.cit,** f. 104.

37) Në tempullin e Artemisit hasim një nga shembujt më të parë të këtij kalimi. Kështu në Delf në tempullin e Athinës I, të vitit 600 p.e.sonë kollona e gurtë ruan proporcionet e kollonës së drunjtë. 1:6,5 dhe kollonada e njëkohëshme e Heraionit në Olymp është në raportin 1:5,3. Në tempullin e Artemisit në Korkyrë raporti midis diametrit të poshtëm të kollonës dhe lartësisë së saj është 1 : 4,75 (1,32 : 6,30 m). Raporti diametër kollonë-interkolumn 1 : 1,25 është shumë më i vogël nga raporti 1 : 2,7 në tempullin e Herës në Olymp dhe 1 : 3,4 në tempullin e Herës në Argos.

DO NOT COPY



Fig. 16



Fig. 17

pitelit, prej druri të lakueshëm. I tërë balli i tempullit është i gjërë dhe i ngjeshur[38] ç'ka solli dhe një fronton të ngritur dhe një lartësi 14,5 m të tërë tempullit (fig. 14). Zbukurimin më të pasur në fronton e ka sima prej qeramike të ngjyrosur, si në tempullin e Artemisit në Apolloni (fig. 15). Mesin e timpanit të saj e ze Gorgona me një ikonografi arkaike (fig. 14).

Po i shek. VI p.e.sonë, por i gjysmës së dytë, është tempulli, në kodrën më të lartë të Apollonisë, prej ku vështrimit i hapet një panoramë e gjërë mbi tërë fushën përreth, Aosin (Vjosën) dhe Adriatikun. Këtij tempulli i përkasin disa themele, një fragment reliefi (fig. 16) dhe dy copa tënjë mbishkrimi arkaik në dorishte ARTAM (IS) dhe GAIA[39], në dialektin e Korinthit prej nga erdhën kolonët e parë. Përmendja në të e Artemisit dhe e Gaiës, perëndeshës së tokës, pak të njohur dhe pak të nderuar në Greqi, dëshmon për respektin e kultit vendas që nderonte para së tërash perënditë ktonike.

Një tempull i ndërtuar nga një koloni e Korinthasve, për më tepër në shek. e VI, s'mund të ishte veçse i orderit dorik. Por përmasat e relievit tregojnë se ai nuk ishte, siç do pritej, pjesë e një metopi të këtij orderi por pjesë e një frizi.[40] që i sillej tempu-



Fig. 18

38) Deri në fillimet e frontonit, raporti lartësi, gjërësi i ballit të tempullit është 1 : 2,6, mjaft më pak se në tempujt e mëvonshëm ku luhatej rreth 1 : 1.5.

39) Bazamentët e tempullit dolën gjatë gërmimit të banesës së misionit arkeologjik francez. Për to dhe gjetjen e mbishkrimeve na bën të ditur H. Ceka **(Mbi historikun e kërkimeve dhe gërmimeve arkeologjike në Apolloni.** Buletini i Universitetit Shtetëror, ser. shke. shoq. nr=4, Tiranë 1958, f. 217). Nga këto bazamente ruhet një mur me dy sërë blloqesh kuadratikë, dhe një mur tjetër që e takon përpendikularisht diku nga mesi (Skica tek. S. Anamali. **Gërmimi në anën Verilindore të qytetit të Apollonisë**, «Studime Historike» I; Tiranë, 1964, fig. 1). Relievi jepet nga L. Rey **(Fouilles de la Mission Française d'Apollonie d'Illyrie (1931-1933) Decouverte faite sur le sommet sud,** «Albania» 5, Paris, 1935, f. 47-48).

40) Metopat dorikë kanë një raport gjatësi-gjërësi rreth 1:1 kurse relievi i mësipërmë është të paktën 1.64 m i gjatë dhe rreth 0,60 m i gjërë (sot ai ruhet deri në gjysëm, në 0,33m lartësi).

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 19

llit rreth e përqark si në tempujt e orderit jonik; veçori kjo e panjohur për kohën në shqyrtim. Frizi prej guri gëlqeror të nxjerrë prej kodrave të Mallakastrës[41] është punuar në reliev të lartë dhe ka qenë i piktuar me ngjyra të forta. Në të paraqiten tre luftëtarë që po ndeshen me amazonat, simbol ky i luftës mes grekërve dhe të huajve (fig. 17). Të tre luftëtarët të shveshur deri në gjoks e muskulozë, me dorën e majtë mbajnë nga një mburojë të madhe të rrumbullakët, ndërsa në të djathtën ushtat. Prej tyre luftëtari i ballit, i përkulur mirë për të zbutur goditjen e kundështarës, mban në krye një përkrenare Korinthike, të qytetit mëmë. Punimi i luftëtarëve me konture të thatë, me bustin ballazi dhe kokën anash si dhe ngjashmëria ikonografike me luftëtarët e thesaurosit të Sifnosit në Delos, i ndërtuar para v. 525 p.e.sonë, e daton frizin dhe tempullin përreth kësaj kohe[42]. Punimi i frizit me gur lokal dëshmon se Apollonia e kishte nisur herët rrugën e prodhimtarisë artistike, pa importuar nga qyteti mëmë dekorin skulptural. Ashtu si edhe Korkyra, korniza e frontonit të tempullit të Apollonisë zbukurohej me një veshje terakote ku shiritët e purpurtë këmbeheshin me vargje astragalësh dhe breza palmetash të këmbyera me lule lotosi[43]

Përveç tempullit të mësipërm në sipërfaqen afro njëhektarëshe të kodrës ndodheshin dhe tempuj të tjerë, ç'ka e dëshmon kodrën temenos, areal të shenjtë. Nga fundi i shek. IV fillimi i shek. III p.e.sonë, ky areal duket se u qarkua plotësisht. Nga lindja ai kufizohej prej murit rrethues të qytetit, nga perëndimi përvizohej prej portikut, ndërsa në jugë prej një muri rreth 4 m të lartë, të ndërtuar në shek. IV dhe të rindërtuar në shek. e III p.e.sonë.[44] Ky mur shërbente dhe si mur tarracimi për sheshin para, ku gjendej simboli i qytetit, obelisku (fig. 18). Drejt sheshit, hapej hyrja e temenosit e mbuluar me hark të rremë, të mbrehët, me dy kamaret e mbishkrimeve anash. Një korridor i ngushtë dhe i shkalluar të çonte nga hyrja në temenos.

Përveç tempujve në brendi të qytetit në Apolloni kishte dhe një tempull jashtë mureve rrethues, 800 m në jugë të tyre, afër fshatit Shtyllas. Dikur në këtë vend Aosi brylëzohej dhe i afrohej më tepër se kudo qytetit. Po këtu në një skelë lumore ndalonin dhe anijet që vinin nga larg, nga deti. Tempulli ndodhej fare afër skelës, në një kodër që lartësohej 60 m mbi lumin. Prej majës së saj gëzohej një fushëshikim i bukur e i largët dhe po aq mirë e po aq nga larg tempulli mund të shikohej nga detarët dhe udhëtarët që vinin nga deti. Sot prej tij ruhet në këmbë vetëm një shtyllë (fig. 19), e cila falë përmasave të mëdha ka pagëzuar

41) H. Ceka, **Po aty.**

42) Ky friz ka shumë ngjashmëri me frizin, ndonëse më të përkujdesur, të thesaurosit të Syfnosit në Olimp. Herodoti na bën të ditur se ishulli i tyre u shkatërrua në v. 525 p.e.sonë (III 57) pra thesaurosi ka qenë ndërtuar para kësaj date.

43) Fragmentet tek S. Anamali, **Po aty.**

44) Në këtë kodër C. Praschniker, gjen një bazament të shekullit VI p.e.sonë (2 x 2m) që e supozon altar (**vep.cit** fq. 36-77). Po këtu ai zbulon dhe një sërë kollonash, një mbishkrim «ex voto» kushtuar Asklepit nga toksarku dhe një ndërtim me blloqe të latuar (**vep.cit.** fq. 38.).

Muri është ndërtuar me blloqe kuadratikë me faqe të rrafshta. Një pjesë e tyre janë paijsur me kornizë brenda së cilës faqja e çukitur mbart monogramin e Damosias që e daton në shek. III: p.e.s. Pjesa tjetër e blloqeve nuk e ka kornizën.

fshatin e afërm. Por në fillimin e shekullit të kaluar edhe mund të arrihej në një rikonstruksion ideal të tempullit (fig. 20)[45]. Sipas këtij rikonstruksioni tempulli lartësohej mbi një stilobat me përmasa (23 x x 40 m). Përreth e qark tij vijonin kollonat dorike të peristilit, nga 6 në anët e ngushta (heksastil) dhe 11 në anët e gjëra. Mesin e platformës e zinte naosi (rreth 10.5 x 22 m). Ndërmjet mureve të saja dhe kollonadës krijohej peristazisi, rreth 2 m i gjërë. Naosi ndriçohej dobët nga hyrja në ballin e ngushtë duke e lënë mjedisin e brendshëm në gjysmëerrësirë. Kjo anë pararendej prej pronaosit të kufizuar anash nga zgjatja e mureve anësorë (antet) dhe në ballë nga 4 kollona. Njera prej tyre është pikërisht dhe kollona që ruhet sot, e ngjeshur me diametër të poshtëm 1.36 m dhe lartësi 6.85 m (raporti diametër lartësi 1 : 5). Por kollonat që qarkonin stilobatin si zakonisht duhet të kenë pasur një diametër më të madh. Rrjedhimisht raporti diametër-lartësi ka qenë edhe më i ngjeshur (rreth 1 : 4,50)[46], raport ky karakteristik për tempujt e gjysmës së dytë të shek. VI p.e.sonë – gjysmës së parë të shek. V p.e.sonë[47]. Në këtë datë, më tepër nga mesi i gjysmës së dytë të shek. V p.e.sonë, të çon edhe forma e ekinit, elastik me buzë të rrumbullakosura në takimin me abakun (fig. 21). Në tempujt e gjysmës së parë të shek. VI p.e.sonë ai është shtrirë, ndërsa në gjysmën e dytë të shek. V nis e zvogëlohet tepër[48]. Duke u nisur nga raporti i mësipërm dhe forma e ekinit kollona e Apollonisë i përket diapazonit midis gjysmës së dytë të shek. VI – fillimit të gjysmës së dytë të shek. V p.e.sonë. Nga ana tjetër parakthina e tempullit nuk kufizohet vetëm anash nga antet, por pararendet edhe prej 4 kollonash (prostil, tetrastil), veçori kjo që haset vetëm në tempujt e shek. VI-gjysmës së parë të shek. V p.e.so-



Fig. 20

POOR COPY

45) L. Heuzej – H. Daumet **(Mission archéologique de Macédoine,** Paris 1876) gjetën ende të pambuluara hendeqet e themeleve të grabitura, çka i lejon ata të arrijnë në një rikonstruksion ideal të besueshëm. Të dhënat metrike i kemi nxjerrë nga skica e tij. G. Pani **(Një tempull antik në Apolloni.** Monumentet historike në vendin tonë», Tiranë, 1975, f. 142-147) shtyhet si shumë kur mundohet tja nënshtrojë tempullin një rikonstruksioni tepër të imtë. I pa bazuar është edhe mendimi i tij për ndonjë «farë ndikimi lokal» dhe se «elementi vendas ushtroi sigurisht ndikimin e vet me anë të traditës qoftë dhe me normat e tij estetike» **(Po aty,** f. 146). C. Praschniker **(vep. cit.** f. 141) kryen në këtë vend sondazhe, por pa rezultat. Vetëm në skajin veriperëndimor të platformës ai gjen gjurmat e një ndërtese me blloqe të latuar, ku supozon shtëpinë e priftit të tempullit.

46) Diametri i kollonave të jashtme ka qenë rreth 10-15% më i madh se i kollonave të parakthinës, rreth 150-155 cm dhe lartësia 7.03 (nëse lartësisë së kollonës së pronaosit 6.85 m do t'i shtonim 18 cm e këmbës së shkallës, me të cilin paisej zakonisht parakthina. Rrjedhimisht ky raport do të ketë qenë 1 : 4.66 (për diametrin 1.50 m dhe lartësinë e kollonës 7,03 m) dhe 1 : 4,5 (për diametrin 1.55 m dhe lartësinë 6.85 m, sa kollona e pronaosit).

47) Nga periudha arkaike (tempulli i Athinës-Delf v. 600 p.e.s.) e deri në v. 570 (tempulli Apollonit në Sirakuzë). Ky raport zbret nga 1 : 6,5 në 1 : 4. Më tej nga v. 550 p.e.sonë (tempulli C në Selinunt) dhe deri në v. 450 (tempulli D në Agrixhent) luhatet në raportin 1:4,15 (tempulli Apollonit në Korinth v. 540 p.e.sonë) deri 1 : 4,84 (tempulli



Fig. 21



Fig. 22

DO NOT COPY

në[49]. Këto veçori: raporti dhe forma e kollonës dhe kollonat në ballë të parakthinës, e datojnë tempullin e Shtyllasit nga fillimi i shek. V p.e.sonë.

Mbi kollonadën e jashtme, nga balli i ngushtë, vijonte dhe frontoni që, si zakonisht në tempujt e këtij orderi, duhet të kenë qenë sa 2/3 e lartësisë së kollonës. Kështu i tërë tempulli ka pasur një lartësi rreth 11.50 m. Në se rikonstruksioni i Hezej – Domjesë është i rregullt zgjidhja planimetrike e tempullit të Shtyllasit është krejt e veçantë: Raportit gjërësi-gjatësi të tempullit të Shtyllasit (1 : 1,73), i afrohet vetëm një tempull i vonë, i shek. III p.e.sonë, ndërsa në tërë rastet e njohur nga periudha klasike ai nuk zbret nën 1 : 2,1.[50] Pjesë që i përkasin një tempulli arkaik, të

A. Agrixhent) (përjashtuar tempullin F në Selinunt dhe atë të Athinës në Egine me datime jo shumë të sigurta), me një parapëlqim të atij 1 : 4,5. Mbas v. 447 raporti ngrihet menjëherë mbi 1 : 5,48, i influencuar nga arkitektura e Parthenonit, ndërsa nga v. 400 ai e kalon raportin 1 : 6. (sipas një tabele krahasuese të hartuar nga të dhënat e G. Gruben **vep. cit.** dhe H. Kahler **vep. cit).**

48) Më tepër ngjashmëri ajo ka qoftë si raport e qoftë si profil ekini me fazën e I të tempullit G. në Selinunt, të v. 470 p.e.s.

49) Këta tempuj janë Parthenoni (v. 477, p.e.sonë), tempulli G në Selinunt (v. 510 p.e.sonë), tempulli i Apollonit në Sirakuzë (v. 570-560 p.e.sonë).

50) H. Kahler, (**vep. cit**, f. 24) vë në dukje se «tërë pjesët e planimetrisë së tempujve dorikë janë në raport dinamik dhe çdo pjesë ka veçoritë e saja». Por mendojmë se në vija të përgjithshme mund të ndiqet një farë ligjësije. Në shek. e VI-V p.e.sonë raporti gjërësi-gjatësi luhatet kryesisht nga 1 : 2,1 – 1 : 2,5. Rasti i vetëm ku ky raport arrin në 1 : 1,17 është tempulli i Athinës në Pergam. Por kollonat e tija kanë një raport diametër-lartësi 1 : 7 dhe tempulli datoi vonë, në shek. III p.e.sonë.

shek. VI p.e. sonë, janë zbuluar dhe në Durrës. Këto pjesë prej terrakote të pikturuar janë kreu i një «finksi», një antefiks dhe një fragment kornizë (fig. 22). Kryet e Korës me përmasa pak më të mëdha se natyralja (35 x 24 cm), i ka flokët, vetullat dhe rrathët e syve të pikturuara me ngjyrë të zezë ndërsa buzët me të kuqe. Antefiksi paraqet kryet e meduzës me një ikonografi të afërt me atë të tempullit të Artemisit në Korkyrë. Së fundi fragmenti i Kornizës paraqet një kombinim motivesh gjeometrike[51].

Tempujt e qyteteve iliro epirotë. Ndryshe nga qytetet-koloni ku tempujt e njohur janë tepër të mëdhenj, të orderit dorik dhe të hapur, me kollona rreth e qarkë (peripterë) në qytetet e mirëfilltë të Ilirisë dhe Epirit tempujt janë të vegjël, të paqarkuar me kollona (me ante ose prostilë). Këta tempuj të vegjël (naiskose) janë më tepër vende për depozitimin e blatimeve se tempuj të mirëfilltë[52]. Ndërtimi i tyre vetëm në fillim të shek. III p.e.sonë tregon gjithashtu se, në Iliri dhe Epir ata u futën mjaft vonë, nëpërmjet ndikimit të asaj rryme niveluese kulturale, të njohur me emrin kulturë helenistike.

Më i vjetër ndër këta ndërtime është tempulli në Orakullin e Dodonës. Këtu nga shek. IV p.e.sonë, lisi i shenjtë u qarkua nga një mur avllije me blloqe lartësi të njëjtë, i cili krijonte një oborr të vogël. Në skajin perëndimor të oborrit u ngrit një ndërtesë, e mbyllur (4 x 6.50 m)., vetëm me një portë në anën e ngushtë, me kthinë dhe parakthinë. Ky ndërtim nuk rinte i lirë në brendi të oborrit, si çdo tempull grek, por ndërthurej me murin e tij, duke qëndruar më tepër jashtë se brenda. Kjo e dëshmon atë, vend për blatimin e dhuratave ose dhe banesë për sellët falxhorë[53].

Pirroja i Epirit i cili pa në Dodonë një qendër polarizimi politik e rindërtoi sërishmi orakullin në fi-



Fig. 23



Fig. 24

DO NOT COPY

51) M. Zeqo, **Dëshmi të artit arkaik në Durrës,** Materiale të Sesionit arkeologjik Durrës, 1983 (dispencë), f. 23-24.

52) Ata ngjasojnë kryesisht me thesauroset e Olimpit ku vendoseshin dhuratat e pjesmarsve në lojrat olimpike. (shih. G. Gruben **vep. cit,** f. 57-61 dhe përshkrimin e Pausanias për to).

53) Materialin grafik e përshkrimor e kemi marrë nga S. Dakaris, **(vep. cit)** S. Dakaris e daton thesaurosin në fund të shek. V p.e.sonë (**vep. cit.** f. 40). Për këtë ai bazohet vetëm në disa antefikse me palmeta, sipas tij të gjysmës së dytë të shek. V p.e.sonë. Përveç faktit se ky tip palmete haset rëndom në tërë aktivitetin, kjo është në kundërshtim me të dhënën e Demonit (P.H.G.I, 381), që në shek. e IV p.e.sonë këtu nuk kish asnjë ndërtim. Dakaris fillimisht e quan atë tempull e më tej vend për ruajtjen e blatimeve pra thesauros. Në shek. e IV rrethi i trekëndëshave dhe kazanëve të bronxët u zëvëndësua nga Halkeioni i blatuar nga Korkyrasit; një djalosh prej bronxi me kamxhik në një dorë dhe një enë në tjetrën. Tingullin këtë herë e krijonte kamxhiku, që lëvizte nga era dhe godiste enën prej bronxi.

Ilim të shek. III p.e.sonë. Në këtë kohë vendin e oborrit të vjetër e zuri oborri i ri, më i madh (20,8 x x 19.2 m). Nga tre anë ai rrethohej prej një portiku me kollonadë jonike[54] (fig. 23), e cila risillte frymën që mbizotëronte në këtë kohë në arkitekturën ilire dhe Epiriote, në shetitoret, theatrot dhe banesat, synimin për krijimin e portikëve dhe oborreve peristilë. Oborri peristil këtu qarkohet nga tre anë prej një portiku duke lënë të lirë vetëm anën nga orakulli, nga lisi i shenjtë (fig. 24). Në këtë mënyrë, vështrimet nga ky portik gjysëm i ndriçuar fokusoheshin tek lisi i ndriçuar nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Me pushtimin e papritur të Dodonës nga Etolët (v. 219 p.e.sonë)



Fig. 25



Fig. 26

u rënua i tërë kompleksi i orakullit. Por në vitin 218 p.e.s. mbas fitores të papritur mbi etolët dhe kapjes së një plaçke të mirë lufte, kompleksi u rimëkëmb[55]. U ngrit kollonada, në vend të thesaurosit u ndërtua një tempull i mirëfilltë, më i madh, në bosht të oborrit të hyrjes. Vetë hyrja u trajtua monumentale si propile (fig. 25). Tashmë stilobati i saj (5.2 x 3.2 m) i qarkuar nga tre shkallë mbartëse 6 kollona jonike, 4 nga balli (tetrastil) dhe nga dy në anët. Mbi to vijonte antablementi i kurorëzuar nga frontoni dhe çatija. Tempulli i ngritur mbi një platformë po tre shkallëshe (2.5 x 13.5 m) përbëhej prej naosit të cekët, pronaosit dhe një hajati të hapët (exonarteksi) krejt të njëjtë me atë të hyrjes, propilese, po me 4 kollona në ballë (fig. 26). Kështu tempulli u barasvlerësua me orakullin, lisin e shenjtë, në mos po fitoj një mbipeshë ndaj tij. Kjo ndoshta dëshmon për largimin në këtë kohë nga besimi i parë kur nderohej vetëm pema, simboli dhe zëdhënësi i perëndive të lashta. Nga ana kompozicionale ky trajtim, disi i rënduar, ja hoqi oborrit frymëmarrjen e lirë. Në të shihet njëkohësisht synimi bashkëkohës për efekte që arrihej nëpërmjet këmbimit të sipërfaqes transparente të kollonadës me sipërfaqen e plotë të murit

54) Në portik Pirroja varte si shenja të fitoreve ushtarake mburojat e kapura në luftë. Në to ruheshin gjithashtu paktet politike të Epirotëve. Në të janë gjetur një mburojë romake me mbishkrimin «Basileu Pirro dhe Epirotët dhe Tarantinët, prej romakëve dhe aleatëve të tyre, naiosit të Zeusit» dhe një mburojë masedone ku lexohet vetëm Ba(sileus), (S. Dakaris, vep. cit. f. 46).

55) Polibi na bën të ditur se «etolët zgjodhën për strateg të tyrin Dorimahun. Ky kur arriti në faltoren e Dodonës dogji portikët e tempullit, prishi një pjesë të madhe të kushtimeve dhe rrëzoi dhe muret e faltores (Polyb IV, 67). Në vitin 218 p.e.sonë Filipi V dhe Epirotët pushtuan Kryeqendrën Etole Thermonin dhe u përkujdesën për një rindërtim rrënjësor në Dodonë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 27a



Fig. 27b



Fig. 28a



Fig. 28b

anësor, tërheqjes në brendi të murit të plotë, që sillte një kontrast më të madh ndërmjet kollonave të ndriçuara dhe ballit të fshehur thellë, dhe rritjes në vertikalitet, duke arritur një lartësi pak më të madhe se gjerësija. Në këtë drejtim formën e hajatit me kollona jo vetëm në ballë por edhe anash[56], mund ta shohim dhe si pararendëse të tempujve të mëvonshëm romakë, të shekujve të erës sonë. Në vitin 107 p.e.sonë temenosi u shkatërrua nga romakët, por mesa kuptohet ai u rindërtua shpejt. Shkatërrimi përfundimtar ndodhi në fund të shek. IV të e.sonë. Kri-

56) Me aq sa njohim trajtimi me kollona anash ngjet me trajtimin e propileve të temenosit të Athina Lindias në Rodos, të fillimit të shek. III, p.e.sonë. Por ndërtuesit këtu janë kufizuar vetëm në propiletë ndërsa në vetë tempullin e Athinës kemi një zgjatim të mureve ansorë; në formë gjysmë antesh (Planimetritë e temenosit dhe rikonstruksioni i tempullit tek G. Gruben, **vep. cit,** fq. 387).



Fig. 29



Fig. 30

shtërimi dhe ithtarët e tij që shihnin në orakullin e Dodonës një armik të rrezikshëm që e pengonte përhapjen e fesë së re, jo vetëm prishën tempullin, por prenë dhe lisin e shenjtë.

Orakullin dhe tempullin e Dodonës e qarkonin në formë theatri, tempuj të tjerë të mbyllur, që duket se u kushtoheshin perëndive të lashta ktonike: Dionës, Themisit, Afërditës.[57] (fig. 27). Më i hershmi prej tyre duket se është tempulli i «Afërditës» një tempull i vogël, naiskos (4.7 x 8.5 m) me dy kollona tetëkëndëshe midis anteve (fig. 28). Pikërisht këto kollona tetëkëndëshe, të njëjta me ato të gjetura në Butrint, Foinike, Shtetitoren e II të Apollonisë dhe kryesorja të njëjta me kollonat e shetitores së theatrit të Dodonës, e datojnë tempullin në të njëjtën kohë me shetitoren e theatrit, në vitin 297-272 p.e.sonë.[58]

57) Nëse ndërtimi në verilindje të orakullit ka qenë tempull ose jo kjo nuk mund të thuhet me aq siguri. Ndërtimi ka një trajtë krejt të panjohur e madje të pajustifikuar për arkitekturën e tempujve, katrore (9.8 x 9.4 m), me dy ambiente të shtrirë së gjëri e jo së gjati, me një derë të ngushtë në mes, me mure prej qerpiçi. Veç kësaj orientimi i tempullit të «Dionës», i shek. III p.e.sonë, nuk përkon fare me drejtimin e këtij ndërtimi. Nga ana tjetër tempujt si rregull orientoheshin nga lindja e diellit në ditën e festës. Nëse të dy ndërtimet do paraqisnin tempujt të njëpasnjëshëm në kohë, kushtuar së njëjtës perëndi ata do kishin orientim të njëjtë. Rrjedhimisht mendimi i S. Dakaris (**vep. cit.** f. 50) se ky ndërtim ishte një tempull i vjetër i Dionës, i shek. të IV p.e.sonë ose fillimit të shek. III p.e.sonë, nuk na duket shumë bindës.

58) S. Dakaris, **(Po aty),** duke u nisur nga disa gjetje dhe mënyra e punimit me gurë të vegjël e daton tempullin në shek. e IV – fillimin e shek. III p.e.s. Atij i shket dukuria se kollonat e shëtitores së theatrit, të fazës së tij të parë, janë krejt të njëjta me ato të tempullit.

DO NOT COPY



Fig. 31



Fig. 32

Rreth kësaj kohe shpella e shenjtë dhe në Buthrot u kthye gjithashtu në një tempull[59] (fig. 29). Mbishkrimi kushtimor i theatrit «u ndërtua me të ardhurat e hyut (Asklep)» tregon se tempulli ishte ngritur para theatrit, para gjysmës së dytë të shek. III p.e.sonë. Kjo kuptohet dhe nga deformimi i planimetrisë së theatrit për të respektuar konturet e tempullit e për tu lidhur sa më mirë me të (fig. 30).

Të dy këta tempuj ndahen në kthinën e shenjtë dhe parakthinën e kufizuar anash nga zgjatimi i mureve të kthinës (antet) në ballin e së cilës, midis anteve, gjenden dy kollona tetëkëndëshe (fig. 28, 30). Në këtë drejtim ata dallojnë nga thesaurosi klasik grek me ante që i përmbahet kryesisht orderit jonik, duke ju afruar më tepër orderit dorik, por të përpunuar në mënyrë vehtjake, karakteristike vetëm në arealin iliro-epirot. Dyshemeja e këtyre tempujve është në nivelin e truallit të jashtëm. Në Buthrot ku ruhet e paprekur, dyshemeja është e shtruar me pllaka të mëdha guri gëlqeror, të prera mirë (fig. 31). Të dy kthinat e tempujve lidhen me një derë të vogël nga e cila mund të vështrohej shtatorja e hyut. Prej tyre njohim një shtatore të gjetur në brendi të tempullit të Asklepit në Buthrot, e shek. II p.e.sonë (fig. 32). Kjo shtatore e mermertë, e një burri të veshur me tunikë dhe mantel ka madhësi pak më të madhe se natyralja.[60]



Fig. 33

Para tempullit të Butrintit, nga ana e tij e majtë, ndodhet temenosi, ai është i kufizuar prej një ndejtëseje të zbukuruar me putra luani, nga muri rrethues i qytetit dhe një ndërtim me oborr qendror, me funksion të paqartë. Duke e ditur se theatrot i kushtoheshin një hyu, dhe se theatri i Buthrotit është i bashkëlidhur me tempullin e Asklepit, mund të thuhet se temenosi përfshinte tërë qëndrën shoqërore të qytetit. Në temenos, duke u nisur nga forma e sajë vehtiake dhe shembujt e njohur, duket se përfshihej dhe shetitorja e cila ka mjaft mundësi të ketë qenë një portik kurimi (eukomeiterion, abaton) (fig. 30).

59) Rikonstruksioni i tij tek L. Ugolini, **vep. cit,** fq. 108.

60) L. Ugolini (**vep. cit** f. 109) Shtatores i mungon koka dhe dora që do të lejonin identifikimin ose jo me Asklepin. Por nëse ajo nuk i përket Asklepit do ketë qenë futur më vonë në tempull, kur ai humbi destinimin e tij. Mendimi i Ugolinit se kjo është shtatorja e kryepriftit është krejt i pabazë, në kundërshtim me çdo ritual fetar.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 34



Fig. 36



Fig. 35



Fig. 37



Fig. 38



Fig. 40



Fig. 39



Fig. 41

DO NOT COPY



Fig. 42



Fig. 43



Fig. 44

Raporti gjerësi-gjatësi[61] i tempullit me ante në Dodonë, është 1 : 1,6. Po i tillë është dhe raporti i tempullit të Butrintit, në se në gjatësinë e tij përfshimë dhe shpellën, në rolin e opistodomit. Nga të dy tempujt e mësipërm ai i Butrintit dëshmohet plotësisht si i Asklepit[62] (fig. 33) ndërsa ai i Dodonës ka një farë mundësije të qe i Afërditës.[63].

Dy tempujt e tjerë të Dodonës, ai i Dionës dhe ai i Thetisit, i perëndive të lashta të tokës[64], janë të së njëjtës gjeneratë me fazën e III-të tempullit të Zeusit në Dodonë dhe me tempullin mbi theatër në Butrint. Këta tempuj të orderit jonik, ashtu si dhe tempulli i Zeusit kanë 4 kollona në ballë (prostilë, tetrastilë). Prej tyre tempulli i «Dionës» ndodhet në të djathtë të orakullit (fig. 34,35), ndërsa ai i «Thetisit» në të majtë të tij (fig. 36). Të dy këta tempuj ngrihen në një terren të sheshtë. Në të kundërt tempulli i Butrintit, ai mbi theatër, ndodhet në një platformë të vogël, në mes të shkëmbit të lartë të thiktë (fig. 37). Të dy tempujt e Dodonës që ruhen me planimetri të plotë janë krejt të ngjashëm me njëri tjetrin. Me sa duket i tillë duhet të ketë qenë dhe ai

61) Nga këta tempuj jashtë territorit ilir dhe epirot, njohim tempullin e Asklepit në ishullin Kos, i fillimit të shek. III p.e.s (0,78 x 10.75 m) dhe atë të Demetrës në Pergam i shek. II p.e.s (6,45 x 12,7 m) (G. Gruben, **vep. cit.** f. 380, 414).

62) Në Celën e tempullit janë gjetur dy fragmente shkopi të mermertë dhe një kolonetë me gjarpërinj të mbështjellë rreth tyre, një kollonetë me paraqitjen e një Kantari dhe të gjarpërinjve me mjekër ku shkruhet Antimahu-Asklepit, fragmenti i një shtatoreje të vogël të Asklepit me një mbishkrim dedikues po asklepit. 5 mbishkrime votive të Asklepit si dhe një dekret lëshimi skllevërish që i konsakrohen Asklepit.
L. Ugolini, **vep. cit,** f. 112, 124, 118, 120, 121, 124, 116, 117.

63) S. Dakaris, (**vep. cit** f. 55). Duke u nisur nga disa figurina terakote të gjetura në afërsi të tempullit që paraqesin një grua me një pëllumb në gji mendon se tempulli i takon kësaj perëndeshe.

64) S. Dakaris (**vep. cit** f. 51, 52), për këtë bazohet në tabelat votive të gjetura në buleutorion. .

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 45a



Fig. 45b



Fig. 45c



Fig. 46a



Fig. 46b

i Butrintit[65] (fig. 38). Në të vërtetë përmasat e të tre tempujve janë të njëjta (Diona 6,35 x 9,85, Themisi 6,25 x 10.3, Tempulli i Butrintit 6,3 dhe rreth 10 m i gjatë). Tempujt përbëhen prej kthinës së shenjtë, me planimetri katrore dhe parakthinës. Një derë e ngushtë, midis kthinës dhe parakthinës, lejonte të vështrohej shtatorja e perëndisë në kthinën e shenjtë, paksa e tërhequr nga balli. Muret anësorë, me blloqe të vendosura brinjas (orthostate) lartësohen drejt e mbi truall (Dodonë) ose mbi një stereobat treshkallësh (Butrint) (fig. 39). Blloqet e mureve dhe kollonave të punuara prej një materiali pak më estetik se stereobati kanë qenë të patinuara.[66] Në tempujt e Dodonës, mbi stilobatin e parakthinës zgjaten lehtë antet, ndërsa në ballë gjenden katër kollona jonike që mbartin mbi vete antablementin dhe frontonin. Në këtë parakthinë, një këmbë shkallë më të lartë se terreni, kalohej si nga tre hapsirat mes kollonave të ballit ashtu dhe nga anët. Nga alltarët e këtyre tempujve njohim vetëm ato të tempullit të Themisit 1.5 m më në ballë të hyrjes (fig. 36). Ky alltar (4,2 x 3,3 m) ndodhej në bosht të tempullit, i përçarë mespërmes nga hyrja për në tempull. Të dy tempujt e Dodonës datojnë rreth vitit 218 p.e.sonë mbas fitores mbi Etolët.[67] Afërsisht i kësaj kohe është dhe tempulli i Butrintit, i ndërtuar pas theatrit, pas gjysmës së dytë të shek. III p.e.sonë. Shtrimi i dyshemesë së tempullit të Butrin-

65) Tempulli mbi theatër (A. Baçe – **Arkitektura e ndërtimeve shoqërore,** shek. V – I p.e.sonë në «Historia e arkitekturës shqiptare» deri në vitin 1912 maket) ruhet mirë vetëm në pjesën e pasme. Balli i përparshëm, me sa duket i pambuluar nga dherat, është grabitur. Prej tij ruhet vetëm një pjesë e bazamentit që lejon matjen e gjatësisë rreth 10 metrave, por jo rikonstruksionin. Por duke u nisur nga përmasat dhe një farë zgjerimi i bazamentit, ka tepër gjasë që ai të zhvillohej si tempujt e Dodonës.

66) Në Butrint ku guri është ranor muret e tempullit janë suvatuar me shtresë bazë grunti, me gëlqere me kashtë dhe patinuar me një shtresë të hollë llaçi gëlqereje. Në Dodonë kollonat janë patinuar me llaç me pluhur mermeri.

67) S. Dakaris, **vep. cit** f. 51-52 e daton tempullin e Dionës pak mbas v. 219 p.e.sonë. Tempullin e Themisit ai e daton në diapazonin 330-232 p.e.sonë, duke u nisur vetëm nga përdorimi në të i gurit ranor. Ky gur fare mirë mund të jetë i ripërdorur .Çka është kryesorja të dy tempujt janë krejt të njëjtë, si pasojë ato janë të njëkohëshëm.

DO NOT COPY



Fig. 47

tit në shek. e I të e.sonë me një mozaik bardhë e z
me motive gjeometrike tregon se tempulli u përdo
dhe në shekujt e erës sonë.

Disi i ndryshëm prej tyre është tempulli i Hera-
kliut, gjasisht i fillimit të shek. III p.e.sonë[68], i ri-
ndërtuar pas shembjes në v. 219 p.e.sonë. Tempull
(15.6 x 11.2 m) përbëhet nga kthina e shenjtë (9,1
x 10 m) parakthina e thellë (5,6 m) dhe nga një shtro
je përpara me pllaka të prera mirë. Mbi këtë shtroj
vijonin kollonat e orderit dorik. Tempulli duket se ki
shte vetëm 4 kollona në ballë (prostil, tetrastil).[69]
(fig. 40).

Një tempull tjetër ndodhet në Amantie, 150 r
në jugperëndim të murit rrethues, afër hyrjes së kësa
ane. Tempulli ngrihet në mesin e një platforme oval



Fig. 49



Fig. 48



Fig. 50

68) S. Dakaris, **(vep. cit** f. 53) e quan këtë tempull të Herakliut duke u nisur nga një metop që paraqet luftën e tij me hidrën e Lernës. Ai e sheh atë si të ndërtuar nga Pirroja për nder të heroit.

69) S. Dakaris, **(Po aty)** mendon për 4-6 kollona, por për 6 kollona vendi është shumë i ngushtë.

(rreth 30 x 30 m) të përgatitur enkas për këtë qëllim (fig. 41)[70]. Nga para, nga ana e pjerrsisë, mbushja prej dheu e platformës mbahet prej një muri të lartë, të përforcuar me kontraforte. Punimi i blloqeve të këtij muri është me gurë konglomeratë, brekçe shpati, me faqe të rrafshta dhe lartësi të njëjtë. Tempulli i Amanties[71] (fig. 42), është një tempull dorik, me mur të rrafshtë nga anët e gjata dhe me nga 4 kollona në anët e ngushta (amfiprostil, tetrastil). I tërë tempulli ngrihej mbi një stilobat të stërzgjatur 18,36 x 6.70 m, raporti (1 : 2,75 m) të qarkuar nga stereobati tre shkallësh. Në anën lindore, pas kollonave të ballit me diametër 0,80 m[72], ndodhej një hajat (peristazisi) dhe pas tij parakthina (pronaosi) e kufizuar anash nga antet (fig. 43). Po këtë pamje ka edhe ana tjetër e ngushtë perëndimore. Por këtu mbas ambientit të kufizuar nga antet ndodhet muri i rrafshët. (fig. 44). Në se ky ambient shërbente për vendosjen e blatimeve (opistodom) ose si një tempull i vogël, i ndërvarur, kjo nuk dihet. Në anën lindore midis anteve ndodheshin dhe dy kollona të tjera. Një derë të çonte prej këtej në naos. Kjo kthinë dhe kështu e vogël (4,94 x 5,94 m) duket se ngushtohej edhe më tepër nga dy sërë kollonash të vogla, gjasisht dykatëshe.[73] Por ky ngushtim nëpërmjet ndriçimit të dobët të kollonave dhe erësimit të mëtejshëm të faqeve të kthinës sillte me vete iluzionin optik se kthina e shenjtë ishte mjaft e gjërë.

Ky tempull kishte një arkitekturë mjaft të kujdesur, pllakat e dyshemesë, panelet e xokolit, kollonat, antablementat, skulpturat, deri dhe tjegullat, solene dhe kalipterë janë të mermerta (fig. 45). Detajet i përmbahen dy orderëve, jonik dhe dorik. Dyshemeja e kishës paleokristiane është e mbuluar thuajse e tëra me pllaka mermeri të bardhë kristalin (55,5-74 x 153 x 5 cm). Panelat (88 x 181 cm) me një kornizë 12 cm anash (fig. 46) janë ripërdorur në ndërtimet sepulkrale. Kollonat e gjetura dorike, me 20 kanelyra kanë diametër të poshtëm 38,5 cm dhe po kaq është dhe gjurma e gjetur mbi bllokun e ripërdorur në kishë. Nga antablementi dorik është gjetur një pjesë triglifi me kanale të gdhendur me kënd, ndërsa nga antablementi jonik epistili, dhe 4 frize. (fig. 47,48). Solenët kanë profil të sheshtë dhe buzë të kthyera në kënd të drejtë, ndërsa kalipteret i afrohen si profile kalipteреve korinthikë. Në se detajet jonikë nuk janë sjellë nga diku tjetër, ka mjaft mundësi që ti përkasin rikonstruksionit të tempullit.

Tempulli fillimisht duket se ka qenë i orderit dorik, me kollonadë të zgjatur, mbi të cilën vazhdonte një antablement jo dhe aq i lartë dhe mbi të, në ballë frontoni. Prej skulpturave që zbukuronin timpanonin e tij ruhet vetëm ajo e skajit të majtë (fig. 49).[74], e punuar prej një mermeri të bardhë e kristalin, të njëjtë me detajet e orderit dorik. Në të paraqitet një grua e re që i mban të dy gjinjtë me dorë, kati për t'i dhënë për të pirë fëmijës që e ka përqafuar. Skulptura shquan për nivelin e lartë artistik të punimit. Megjithëse i mungon koka ajo e rijep tërësisht elasticitetin e trupit të një gruaje të re, të bukur dhe energjike. Ndjesimin e trupit të saj nuk e pengojnë edhe palat e robës së hollë të cilat e lejojnë të tejduket e tërë forma e tij. Duke u nisur nga punimi i hollësishëm, veçanërisht, i dorës kuptohet se ajo i përket kohës së hershme perandorake.

---

70) S. Anamali, **Amantia,** f. 89, Muri ka gjërësi 2,40 m dhe përbëhet prej 6 rradhë blloqesh me lartësi të njëjtë (0.54 m) aq sa muret e fazës së II të fortifikimit. Muri përforcohet nga kontrafortet me përmasa 0.9 x 0.65 m. Tre rreshtat e fundit të tija dhëmbëzohen brenda.

71) Tempulli është gërmuar nga S. Anamali (**Amantia,** f. 89-90). Tempulli i Amanties është zhveshur thuajse deri në rrafshin e tokës për ndërtimin e një kishe paleokristiane. Për këtë qëllim janë marrë jo vetëm pjesët e mermerta, pllakat e dyshemesë dhe detajet arkitektonike por deri dhe blloqet e mureve. Megjithkëtë planimetria e tij është e kapshme dhe rikonstruksioni i mundshëm.

72) Një kollonë e tillë është gjetur prej S. Anamalit; **(Po aty)** Balli 7m i gjërë mund të mbajë vetëm 4 kollona 0.80 metërsha, me një interkolumn 1,25 m. dhe raport diametër — interkolumn 1 : 1,5.

73) Veç gjetjes së trungjeve të kollonave dorike me diametrin e poshtëm 38,5 cm, me 20 kanelyra, në një nga pllakat e mermerta të dyshemesë së kishës (69 x 42 x 23,5 cm), të marra nga tempulli, shihet shenja e një kollone po me diametër të tillë. Si kollonë balli ajo është shumë e vogël. Nga ana tjetër brenda kthinës shihen, gjurmët e një muri me blloqe të punuar keq rreth 30 cm larg paretit, 40 cm mbi nivelin e dyshemesë. Pranija e tij shpjegohet vetëm me mbajtjen e diçkaje dhe tregon se ky mur ka qenë i veshur.

74) L. Papajani, **Një skulpturë nga tempulli i Amanties,** «Monumentet historike në vendin tonë», fq. 56. Gjatësija e saj është 84 cm dhe lartësija 28 cm. Autori sheh në të Afërditën dhe Erosin.

POROSOFY

Një mbishkrim i gjetur në Amantie i shek. I-II p.e.sonë tregon se «në kohën e prytanit Menem, birit të Drimakut, u krye rindërtimi nga themelet i tempullit të Afërditës dhe vetë Menemi u kujdes për punimet». Duket se me këtë rindërtim lidhet shtresa e mozaikut në dysheme dhe disa fragmente gjethesh akanthi, geizipodesh (dhëmbëzimesh), astragalesh[75] dhe mundet detajet e orderit jonik të gjetur në kishë. Jeta e tempullit zgjati deri nga shek. IV, kur pas shembjes me pjesët e tija u ndërtua bazilika paleokristiane. Tempujt e këtij tipi, amfiprostilë, janë mjaft të rrallë.[76] Tepër i ngjashëm me tempullin e Amanties është vetëm ai i Athina-Lindias në ishullin e Rodosit, po dorik dhe me 4 kollona (tetrastil) në të dy ballet (amfiprostil). Me të janë të njëjta dhe raportet gjërësi-gjatësi (1 : 2,75 ndaj 1 : 2.8)., të veçantë jo vetëm për këtë kohë, por edhe për kohët më të hershme. Datimi i tempullit të Athina-Lindias në v. 300 p.e.sonë ridëshmon datimin e tempullit të Artemisit në Amantie në fillim të shek. III p.e.sonë.

Gjurmë tempujsh të tjerë janë gjetur në Foinike, Symizë dhe Gurzezë.[76]. Në Foinike është zbuluar një kthinë e vogël, me sa duket pjesë e një tempulli ende të pagjurmuar plotësisht (fig. 50). Muret e kthinës janë punuar me kujdes me arthastatë të latuar. Anash sajë vijon dhe një shkallare, gjasisht pjesë e temenosit. Në Gradishtën e Symizës është zbuluar një stilobat me gjurmë kollonash dhe para tij terrakota, me sa duket blatime të pastruara nga tempulli. Së fundi në Gurzezë është gjetur një tjegull me mbishkrimin Διός Νάου (tempullit të Zeusit) e cila dëshmon praninë e një tempulli të Zeusit.

Konkluzione. Në përfundim të kësaj sprove të parë për një vështrim të bashkërenduar të besimit dhe dëshmive të kulturës materiale për mbarë ilirinë dhe epirin, vemë në dukje se:

1) Besimi tek ilirët pati një karakter të ndryshëm nga ai helen. Ai u mbështet më gjërësisht në elementë autoktonë indoeuropjanë. Në thelb të besimit ilir qëndronte adhurimi i objekteve dhe shfaqjeve të natyrës, me rrjedhojë zhvillimin e ritualit pranë këtyre objekteve.

2) Ky ritual i njëjtë si në Iliri ashtu dhe në Epir, qëndronte larg ritualit helen. Kjo dëshmon për një botë të përbashkët shpirtërore të tyren si shfaqje e qartë e së njëjtës bazë etnike.

3) Presioni i besimit ilir u ndje dhe në qytetet koloni ku u parapëlqyen hyjnitë e lashta ktonike dhe objektet e natyrës.

4) Panteoni ilir mori trajta antropomorfike dhe u diferencua si rezultat i zhvillimit të brendshëm ekonomik dhe thellimit të ndarjes në klasa. Si i tillë ai ndonse u afrua me panteonin helen e më tej romak, nuk u unjisua kurrë me të.

5) Tempujt në Iliri dhe Epir lindën në kuadrin e formimit të arkitekturës qytetare. Këta tempuj kanë karakteristika të ndryshme nga tempulli helen. Të tërë ata janë të vegjël naiskose, çka i tregon kryesisht vende-ruajtje blatimesh, dhe jo «banesa» të perëndive. Tipi i mbyllur me ante i lidh ata kryesisht me perënditë e lashta ktonike.

6. Shfaqja e tyre krahasimisht e vonë në Iliri dhe Epir dhe përmasat e vogla nuk shpjegohen kursesi me shkaqe teknike, por me dasitë rituale.

DOKTORATURA

75) Mbishkrimi, shtresa e mozaikut dhe gjetjet tek S. Anamali (**Amantia.** f. 92, 90).

76) Tempulli fillimisht i kushtohej Lindias, perëndeshës lokale të natyrës që më tej u njësua me Athinanë (G. Gruben, vep. cit, f. 90). Tempulli tetrastil amfiprostil, ka përmasa 7,7 x 21,65 m që afrojnë tepër me ato të Amanties (6,75 x 18,36 m). Tempuj të tjerë të tillë janë ai i Demetrës e Kores në Ilisos, i shek. V p.e.sonë, tempulli dorik i Artemisit, në Tege dhe amfiprostili në temenosin e Herës në Pestum, i shek. IV p.e.sonë (sipas G. Gruben, **vep. cit,** f. 134, 235).

76) L. Ugolini, **L'acropoli di Fenice,** Roma – Milano, 1932. P. Lera, **Rezultatet e gërmimeve në Gradishtën e Symizës gjatë vitit 1973,** «Buletin Arkeologjik» Tiranë 1974,

APOLLON BAÇE

DO NOT COPY

APERÇU SUR LA FOI ET L'ARCHITECTURE DE CULTE CHEZ LES ILLYRIENS

RESUME

Dans les villes authentiques illyriennes le temple a vu le jour au début du IIIe sc. av.n.e. ou à la fin du IVe sc. av.n.e. Mais la construction, dès le Vè sc. av.n.e. des enceintes des villes illyriennes avec de grands blocs de pierres équarries selon la technique et les schémas évolués contemporains, montre qu'il ne faut pas du tout chercher la raison de ce retard dans la technique arriérée. De même, alors que les autres constructions sociales (stoas, théâtres, etc.) des villes authentiques illyriennes du IVe-IIIe sc. av.n.e., du point de vue du traitement et des dimensions ne s'écartent pas des autres constructions de même genre dans des villes helléniques contemporaines, les temples n'atteignent jamais les dimensions des temples helléniques, ils sont traités comme de petits temples (naiskos). Ces phénomènes communs pour toute l'Illyrie et l'Epire, s'expliquent par le rituel illyrien de l'adoration des phénomènes de la nature.

La foi. *A l'âge du bronze, à celui du fer et plus tard les illyriens croyaient et honoraient les forces et les éléments de la nature. Entre ces forces et éléments une place importante est réservée au Soleil, dont l'adoration du culte se trace nettement en architecture. Dans la fortification préhistorique de Gajtan, les enceintes étaient «protégés» par des cercles concentriques, délinées de pierres qui cymbolisaient le Soleil. Les foyers des habitations iapodes du début de la deuxième période de fer, à Rifnik et Donja Dolina, étaient ornés de cercles concentriques, de svastika et de méandres qui les témoignent d'autels du Soleil, et de la chaleur du foyer familial. Un autre témoignage du symbole du soleil en architecture, nous est donné pendant la deuxième moitié du IIe sc. par Maxime de Tir, d'après lequel les illyriens Païones adorent le Soleil, symbolisé par un petit disque élevé au bout d'une haute colonne.*

L'autre culte plus répandu en Illyrie était celui du dragon-serpent auquel la mythologie relie le nom des illyriens. En tant que symbole du renouvellement de la vie, il est lié à la terre, tout en étant, à la superstition populaire de notre siècle, le maître du sol de la maison et en même temps le maître de la terre. En tant que tel, il est le symbole de l'ancien culte des dieux de la terre. Le christianisme a essayé d'effacer cette croyance et son symbole. Mais paradoxalement les témoignages de ce culte, se rencontrent en architecture, premièrement dans les églises paléochrétiennes. Ce symbole se rencontre en architecture jusqu'à nos jours. (fig. 3-6).

La première foi des illyriens envers les forces et les éléments de la nature a fait que les premiers facteurs soient en nature. L'un d'eux était «le haut chêne devin... à la Dodone pélasgique», le plus ancien oracle des Balkans. L'oracle était servi par les Sellois «qui ne se lavent pas les pieds et couchent par terre». Ce rituel, qui ne ressemble en rien à celui hellénique, témoigne qu'il était lié au culte de la terre. Ce qui le diffère aussi du rituel hellénique c'est le fait important que «l'habitation» de Zeus et Dioné, les dieux ultérieurs de l'oracle, n'était pas le naos du temple, comme dans tous les autres temples ou oracles, mais «les branches du chêne devin». D'après les recherches, jusqu'à la fin du IVe sc. autour du chêne il n'y avait aucune autre construction, à part un anneau de trépieds qui portaient en dessus des chaudières en bronze. Toutes ces particularités: «le rituel des Sellois, l'habitation des Dieux dans les branches d'un arbre» et l'absence du temple jusqu'au IIIe sc. av.n.e. témoignent que l'oracle de Dodone n'avait rien à faire avec la religion hellène, il appartenait à une autre sphère spirituelle, à celle illyrienne. Un plus grand nombre de tels trépieds surmontés d'un récipient en forme de demi-sphère (fig. 8), ont été trouvés à Novo-Mesto, ce qui temoigne d'un pareil oracle à l'Illyrie du Nord. L'honneur envers une puissance de la nature, au moyen d'un objet de la nature, se rencontre même à Buthrot. Cet objet était une source, probablement d'eau minérale aux qualités curatives (fig. 9). La construction du centre de la ville, tout autour de cette source, est une preuve de son importance. Le même phénomène se rencontre au lac de Seferaj, au sud-ouest de la ville illyrienne de Belsh, où l'on a découvert un grand nombre de terres cuites du IIIe-IIe sc. av.n.e., de récipients et d'os d'animaux, jetés dans l'eau pendant les cérémonies de culte. Cela montre clairement que la cérémonie ne se passait pas dans un temple mais en nature, dans l'eau du lac.

Le panthéon illyrien. *L'approfondissement de la différenciation sociale en Illyrie pendant les derniers siècles de la première période de feu a exigé la base idéologique qui argumente cette différenciation. Peu à peu on a donné aux*

phénomènes de la nature des attributs humains représentant une hiérarchie différenciée. Les noms des Dieux et semi-dieux illyriens n'ont pas été unifiés à ceux des grecs et romains. La résistance du panthéon illyrien envers ces deux puissants panthéons montre qu'il est né comme conséquence logique du développement intérieur et de différenciation de la société illyrienne.

Le premier Dieu illyrien connu c'est Redon, le Dieu de la navigation. Nous retrouvons son nom sur les monaies, sur une inscription mentionnant les équipages des bateaux «Medaur et Redon», Redon s'appelait aussi un quai illyrien. A la navigation et aux eaux est relié aussi la plupart des autres Dieux de l'Illyrie du nord-ouest. (Bindi-Neptune, Ika, Boria etc.).

En Illyrie du Sud et en Epire, les plus répandues étaient les déesses liées à la terre et à l'élevage avant tout Thana, conseur illyrienne d'Artémis et Dioné. Les reliefs de cette déesse et de sa suite qui a fait face pendant des siècles à la pression du christianisme connues à nos jours sous le nom des «Zana» (fées), se trouvent au nord et au sud de ce territoire. (fig. 10, 11).

La naissance de l'état d'Illyrie et d'Epire a cherché et trouvé son image même à la religion. L'un des Dieux s'écarte et s'élève à un plus haut piédestal que les autres. C'étaient Redon «le Dieu des mers», Medaur le combattant, «Dieu et laurier publique de Rizon et de toute la Dalmatie», «Jupiter parthinus» qui est connu seulement par «interprétation» romaine. L'unification de ce Dieu avec Jupiter, le Dieu de la foudre et du Tonnerre, l'approche avec le Dieu «Shurdh» qui rend sourd avec la déesse de la Foudre et du Tonnerre, dont le souvenir reste encore de nos jours.

Tout ceci démontre que sur le territoire de Illyrie et d'Epire, le panthéon est unique, bien que les préférences et l'intensité puissent changer d'une région à l'autre. Au contraire, la diversité, dont le rituel même en est l'expression, est nette par rapport à la religion hellénique.

Les temples des villes colonies. L'un des plus anciens exemples des temples à éléments de pierre, celui d'Artémis, le plus grand connu de larchitecture archaïque, se trouve à Corfou. Le temps de sa construction (VIIe-VIe siècles av. n.e.) correspond à une période, pendant laquelle la tradition de construction de Corinthe a été élaborée d'une manière particulière, en influant même sur l'architecture de «Magnia Graeciae», surtout de Paestum et de Sélinonte.

Du VIe sc. av. n. e., mais de la deuxième moitié, est aussi le temple de la plus haute colline d'Apollonie, d'où s'étale un vaste panorama de toute la plaine, d'Aos (Vjosë) et d'Adriatique. A ce temple appartiennent quelques fragments de fondation un fragment de relief (fig. 16, 17) et deux morceaux d'une inscription archaïque en dorient ARTAM(IS) et GAIA, au dialecte de Corinthe d'où sont arrivés les premiers colons. La mention ici d'Artémis et de Gaia, la déesse de la terre, peu connue et peu honorée en Grèce, témoigne du respect du culte aborigène qui honorait les Dieux chthoniens. Un temple construit par les colons de Corinthe, surtout au VIe sc., ne pourrait être que d'ordre dorique. Mais les dimensions du relief montrent qu'il n'était pas un fragment du métope de cet ordre mais un fragment d'une frise qui entourait le temple comme dans les temples de l'ordre ionique, une particularité inconnue pour l'époque en question. La frise en pierre calcaire, trouvée dans le voisinage, représente trois combattants qui attaquent les amazones, le symbole de la guerre entre les grecs et les étrangers. Leur ressemblance iconographique avec les combattants du trésor de Syfnos à Délos, construit avant l'année 525 av. n. e., date la frise du temple à peu près de cette époque. Le fait que la frise était travaillée avec la pierre de la région montre qu'Apollonie n'importait pas de la ville mère le décor sculpturel.

A part le temple mentionné, sur une superficie d'environ 1 ha de la colline, il y avait aussi d'autres temples. A la fin du IVe sc. et au début du IIIe sc. av. n. e. cette zone a été complétement entourée d'enceinte. (fig. 18).

A part les temples à l'interieur de la ville d'Apollonie, il y en avait un autre au dehors de l'enceinte, à 800 m au sud de cette ville, tout près du quai d'Aos, sur une colline de 60 m de hauteur au-dessus du fleuve. D'après la réconstruction de Heuzej-Daumet, le temple s'élevait sur un stylobate (23 x 40 m). Il était entouré des colonnes doriques (fig. 19, 20, 21), de six aux faces étroites (hexastyle) et de onze aux faces larges. Au milieu du plate-forme se trouvait le naos précédé du pronaos qui des deux côtés était limité par l'allongement des antes et au front par quatre colonnes. La colonne conservée est d'un diamètre inférieur de 1,36 m et d'une hauteur de 6,85 m, mais les colonnes qui entouraient le stylobate comme d'habitude ont dû avoir un plus grand diamètre. Par conséquence, le rapport diamètre-hauteur a été encore plus ramassé (environ 1:4,50), ce qui est caractéristique pour les temples de la deuxième moitié du VIe sc. av. n.è.

Un autre appui pour la datation c'est le traitement de l'échine: Dans les temples de la première moitié du VIe sc. av n. e., elle est étendue tandis que pendant la deuxième moitié du Ve sc. elle commence à se rétrécir. D'après le rapport mentionné et la forme de l'échine, la colonne d'Apollonie appartient au diapason entre la deuxième moitié du VIe sc. et le début du Ve sc. av. n. e. D'autre part le pronaos du temple n'est pas limité seulement par les antes il est précédé de quatre colonnes, ce qui se rencontre seulement dans les temples du VIe et de la première moitié du Ve sc. av. n. e. Ces particularités datent le temple de Shtyllas du début du Ve sc. av. n. e. Si la reconstruction de Hauzej-Daumet est exacte, la solution de planimétrie du temple de Shtyllas est tout à fait particulière le rapport largeur-longueur du temple de Shtyllas est 1 : 1,7 tandis que dans les cas connus de la période classique, il n'est pas moins de 1:2,1.

Des fragments, appartenant au temple archaïque du VIe sc. av. n. e., sont découverts à Durrës aussi. Ce sont des fragments de terres cuites peintes comme: une antéfixe représentant une méduse, un fragment de corniche du fronton et la tête d'un sphinx (fig. 22).

DOKTORI

DOWNLOAD

Les temples des villes d'Illyrie et d'Epire contrairement aux villes colonies où les temples connus sont assez grands, aux villes de l'Illyrie et d'Epire, ils sont petits, à antes ou à prostyles. Le plus ancien d'eux, c'est le temple de l'oracle de Dodone. D'après les données de S. Dakaris, au IVe sc. av. n. e. le «chêne devin» a été entouré d'une petite cour A. son côté ouest, il y a eu une construction (4 x 6,50 m) qui s'entrecroisait avec le mur de la cour, plutôt à l'extérieur qu'à l'intérieur. C'était l'endroit où on faisait des offrandes aux déesses, ou une habitation des «Sellois» Pirrus d'Epire qui a vu à Dodone un centre de polarisation politique, a reconstruit l'oracle au début du IIIe sc. av. n. e. En ce temps-là, la nouvelle cour entourée d'un portique à colonnade ionique, a substitué l'ancien. Avec l'occupation inattendue de Dodone par les «Etoles» (219 av. n. e.) le complexe de l'oracle a été complètement ruiné, mais en 218 av. n. e. quand les Etoles sont vaincus, le complexe a été reconstruit. On a élevé la colonnade et à l'endroit du trésor on a construit un vrai temple avec une entrée monumentale (fig. 25, 26). Ainsi le temple a été apprécié autant que l'oracle et le chêne divin. Cela fait preuve de l'éloignement, en ce temps-là, de la première foi, quand on honorait seulement l'arbre, le symbole et le porteparole des anciens Dieux. Du point de vue compositionnel, ce traitement un peu surchargé a enlevé à la cour son espace libre. Ainsi le porche muni de colonnes non seulement dans la partie frontale, mais des deux côtés aussi, peut être vu comme une forme précédente des temples ultérieurs romains, des siècles de notre ère.

L'oracle et le temple de Dodone étaient entourés, par d'autres temples fermés, qui parait-il, se consacraient aux anciens dieux chthonies. Le plus ancien d'entre eux c'est celui d'«Aphrodite», un petit temple à deux colonnes octagonales entre les antes (fig. 27). Ces colonnes octagonales, pareilles à celles trouvées à Buthrote, Foinike, à la deuxième Stoa d'Apollonie, et ce qui est important, pareilles aux colonnes de la stoa du théâtre de Dodone, datent le temple de la même époque que la stoa du théâtre, de l'année 297-272 av. n. e. A cette époque la «grotte sacreé», même à Buthrot a été convertie en temple. L'inscription dédiée au théâtre: «construit avec les revenus du dieu [Asclépios]» dénote que le temple appartenant à ce Dieu était construit avant le théâtre, avant la deuxième moitié du IIIe sc. av. n. e. Cela se voit même par la déformation de la planimétrie du théâtre. (fig. 28-32). Les deux temples sont composés du naos et du pronaos limité des deux côtés par les antes faisant saillies du mur du naos, etre lesquelles se trouvent deux colonnes octagonales. De ce point de vue ils diffèrent du lieu du trésor grecque avec antes, qui tient principalement à l'ordre ionique, s'approchant plutôt de l'ordre dorique, mais traité de façon particulière, caractéristique pour l'Illyrie et l'Epire Le plancher de ces temples est au-dessous du niveau du terrain à l'extérieur. Son naos et pronaos sont liés au moyen d'une petite porte d'où on pouvait contempler la statue du Dieu. Nous connaissons une statue trouvée à l'intérieur du temple d'Asclépios à Buthrot, du IIe sc. av. n. e. Devant le temple, de Buthrot, à sa gauche, se trouve le temenos limité par un siège décoré de pattes de lion et du mur d'enceinte de la ville.

Les temples du type à antes de cette époque ont un rapport longueur-largeur de 1:1,6. C'est le rapport du temple de Dodone aussi et de celui de Buthrot, si sa longueur englobe la grotte aussi, dans le rôle de l'opisthodome.

Les deux autres temples de Dodone, celui de Dioné et de Thétis les plus anciens dieux de la terre, sont de la même génération que la troisième phase du temple de Zeus à Dodone et du temple au-dessus du théâtre de Buthrot. (fig. 34-39). Ces deux temples d'ordre ionique, ainsi que le temple de Zeus, sont dotés de quatre colonnes à la partie frontale. Les deux temples de Dodone, qui se conservent avec une planimétrie complète, sont pareils. Il parait que même celui de Buthrot leur ressemble. En fait les dimensions des trois temples sont pareilles. (Dioné 6,35 x 9,85, Thémis 6,25 x 10,3. Le Temple de Buthrot 6,3 x environ 10). Les temples sont composés du naos à planimétrie carrée et du pronaos. Les murs latéraux s'élèvent directement sur le terrain (à Dodone) où sur un stéréobate à trois rampes (à Buthrot). A Buthrot, les blocs des murs et des colonnes, travaillés par un matériel moins esthétique que le stéréobate, ont été patinés. Au temple de Dodone, sur le stylobate du pronaos s'allongent légèrement les antes, tandis que dans la partie frontale il y a quatre colonnes ioniques. Les deux temples de Dodone datent vers l'années 218 av. n. e., après la victoire sur les Etoliens. A peu près à la même époque appartient aussi le temple de Buthrot, construit après le théâtre, pendant la deuxième moitié du IIIe sc. av. n.e. Un autre temple se trouve à Amantie, 150 m au sud-ouest de l'enceinte au milieu d'une plate-forme ovale. Le temple se dresse au-dessus d'un stylobate allongé (18,36 x 6,70 m) à un rapport 1:2,75 m, entouré d'un stéréobate à trois rampes. A l'Est, derrière les colonnes de la façade d'un diamètre de 0,80 m, se trouvait le peristasis suivi du pronaos limité des deux côtés par les antes. La même vue appartient à l'autre côté étroit à l'Ouest. A l'Est, une porte donnait accès au naos. Ce petit naos (4,94 x 4,94 m) devenait encore plus étroit par deux rangs de petites colonnes, paraît-il à deux étages. Au début, il parait que le temple a été d'ordre dorique, à colonnade allongée au-dessus de laquelle s'élevait un entablement peu élevé surmonté du fronton. Des sculptures qui ornaient son tympan on conserve seulement celle du coin gauche travaillé en marbe blanc cristalisé. Elle représente une jeune femme prête à allaiter son enfant qui l'a embrassée. Bien que la tête manque, le reste donne entièrement l'élasticité du corps d'une jeune femme, svelte et belle. Le traitement montre qu'elle appartient à la haute période impériale (fig. 42, 49).

Une inscription trouvée à Amantie, du I-II sc. av. n. e. dénote que «Au temps du Prytane Menem, fils de Drimak, a été entammé la restauration du temple d'Aphrodite depuis ses fondations, et Menem lui-même s'est intéressé à ces travaux». Il parait qu'à cette reconstruction se rapportent le mosaïque du plancher, et peut-être les éléments de l'ordre ionique, trouvés dans l'église. La vie au temple a continué jusqu'au IVe siècle,

quant, après sa démolition, ces fragments sont utilisés pour la construction de la basilique paléochrétienne. Les temples de ce type amphiprostyle sont assez rares. Seulement le temple d'Athènes Lindias à l'ile de Rodos ressemble beaucoup au temple d'Amantia.

Des traces d'autres temples ont été trouvées à Foinike, Symize et Gurzeze. A. Foinike, on a découvert un petit naos, qui semble être une partie d'un temple partiellement découvert. Les murs du naos sont traités soigneusement avec des orthostates équarris. Il est entouré d'une échelle qui a du être une partie du lieu sacré. A Symize, on a découvert un stylobate avec des traces de colonnes et devant lui des terres cuites. A Gurzeze on a Découvert une tuile portant l'inscription Διοζ Ναιου qui témoigne de l'existence d'un temple de Zeus.

Conclusions. A la fin de cette première épreuve d'un aperçu coordonné de la foi et des témoignages de la culture matérielle de toute l'Illyrie et de l'Epire, nous remarquons que:

1) La foi chez les illyriens a eu un caractère différent de celles chez les hellènes. Elle a été largement appuyée sur les éléments authoctones indo-européens. La foi chez les illyriens se caractérisait par une adoration des objets et des phénomènes de la nature avec pour conséquence le développement du rituel auprès de ces objets.

2) Ce rituel, le même pour l'Illyrie et l'Epire témoigne d'une vie spirituelle commune en tant que le reflet de la même base ethnique.

3) La pression de la foi illyrienne a été sentie aussi dans les villes colonnies où l'on a préféré les anciens dieux chthoniens et les objets de la nature.

4) Le pantheon illyrien a été vêtu de traits antropomorphes et a été différencié à cause du développement intérieur de l'économie et de l'approfondissement de la division en classes. En tant que tel, malgré son approchement avec le panthéon hellénique et plus tard celui romain il n'a jamais été unifié à lui. Les temples d'Illyrie et d'Epire ont vu le jour dans le cadre de la formation de l'architecture urbaine. Leurs traits diffèrent à ceux du temple hellénique. Ils sont tous petits (naiskos) ce qui montre qu'ils ont été principalement des lieux de sauvegarde des offrandes et non des habitations» des Dieux. Le type fermé à antes les lie principalement avec les anciens dieux chthoniens.

6) Leur apparition relativement tardive en Illyrie et en Epire et les petites dimensions n'ont rien à faire avec les causes techniques, mais avec les diversités rituelles et avec la religion hellénique.

PHOTOCOPY

Nr. 2 1984

monumentet

DO NOT COPY

Burhan DAUTAJ

SHËTITORET E DIMALES[1]

Qyteti ilir i Dimales i lokalizuar në rrënojat antike të kalas së Krotinës në rrethin e Beratit,[2] ka qenë ngritur mbi rrafshet e një kodrine rrëzë faqes perëndimore të malit të Shpiragut. Në antikitet qyteti ishte qëndra më e madhe ekonomike dhe administrative për zonën në jug të Aps-it (lumi Seman) deri në fqinjësi me Koinonin e Bylinëve.[3] Ky teritor kapte si shtrirje zonën e Malësisë së Shpiragut në krah të djathtë të rrjedhjes së Gjanicës deri në Seman.[4] Dimale me një tok vendbanimesh përreth formonte një bashkësi të vetme, që shtrihej në shpinë të Apolonisë dhe fqinjë me fisin ilir të parthinëve[5]. Me këtë mund të shpjegohet dhe të përmendurit në burimet e shkruara antike[6] të Dimales së bashku me parthinët dhe përkrah Apolonisë si një qytet politikisht i rëndësishëm e me pozitë të veçantë strategjike që pat tërhequr vëmëndjen e Romës e të Maqedonisë.[7]

Kodra e qytetit formohet nga dy kreshta të lidhura nëpërmjet një qafe, e gjitha e rrethuar me mure (fig. 1). Kreshtën më të lartë e zinte akropoli (rreth 2 ha), i cili veçohej nga pjesa e poshtme e qytetit prej një muri të brendshëm që qarkonte shpatet jugor e perëndimor deri në takimet me murin rrethues arrin rreth 18 ha.

Interesimi për kalanë e Krotinës ka nisur qysh nga vitet 20-të të këtij shekulli,[8] ndërsa zbulimi dhe studimi i rrënojave të qytetit u bë i mundur vetëm pas çlirimit të vendit. Në pranverën e vitit 1962 gjatë një ekspedite përnjohëse për gjurmimin e rilevimin topografik të këtij vendbanimi ndeshëm në konturet gjysëm rrethore të pesë nikeve, gjurmë të një portiku-

---

1) Mbështetur në të dhënat më të reja mbishkrimore të zbuluara në kalanë e Krotinës, emri i qytetit do të jepet në femëroren Διμαλλη (Διμάλλα) dhe jo siç është transkriptuar deri sot Dimal.

2) Për identifikimin e qytetit me rrënojat antike të kalas së Krotinës shih: B. Dautaj, **Zbulimi i qytetit ilir Dimal,** «Studime Historike» 2 (1965), fq. 93-102, nga i njëjti autor **La cité illyrienne de Dimal,** «Iliria» II (1972), fq. 149-165.

3) Për Koinonin e bylinëve shih: F. Prendi, **Urbanizimi i Ilirisë së Jugut në dritën e të dhënave arkeologjike,** «Studime Historike» 3 (1972), fq. 92 dhe shënimi 30.

4) B. Dautaj, **Dimali në dritën e të dhënave arkeologjike,** «Studime Historike», 2 (1973), fq. 90 e shënimi 20; i njëjti autor: **Dimale à la lumière des données archéologiques,** «Iliria» IV (1976), fq. 385.

5) N. Ceka, **Vendi dhe roli i parthinëve në Ilirinë e Jugut në shek. e III-të p.e.s.,** «Konferenca e II-të e studimeve albanologjike», Tiranë 1968, fq. 347-351, ku përherë të parë caktohet si kufi i parthinëve nga jugu Semani.

6) Polibi, III, 18, 1, 3, dhe VII, 9, 13, Livi, XXIX, 12, 3; 3.

7) Shih: Projekt-marrëveshjen e vitit 215 midis Filipit V maqedon dhe Hanibalit Kartagas (Polibi VII, 9, 13-) si dhe Paqen e Foinikës të vitit 205 p.e.s. (Livi XXIX, 12, 3),

8) I pari që shkeli kalanë e Krotinës ka qenë arkeologu austriak Prashniker në vitin 1916. Në kumtimin e tij shumë të shkurtër autori na jep dhe një skicë të konturevе të kalas (shih. C. Praschniker, **Muzakhia und Malakastra,** «Jahreshefte des Ostereichischen archeologisches Institutes» Bd XXI-XXII/1, Wien 1922, Col 103, fig. 40. Por vlerësimi i plotë i monumentit u bë me gjurmimin dhe rilevimin topografik në vitin 1962, ku planimetria e kalasë së Krotinës pësoi mjaft ndryshime, plotësime e saktësime nga sa kish mundur të shihte Prashnikeri në kohën e tij.



Fig. 1

-shëtitore rëzë shpatit jugor të kreshtës së akropolit
të cilat u bënë shkas për kërkime të mëtejshme ar-
keologjike në kalanë e Krotinës.[9] Një shëtitore e dytë
u zbulua në zonën e akropolit, ndërsa shëtitorja
tretë doli rëzë këmbës lindore të kreshtës (kuotë 405
në pjesën e poshtme të qytetit.

Nëpërmjet trajtimit të shëtitoreve të Dimales, q
është dhe punimi më i plotë për to, do të mundohe
mi, përsa na lejon materiali, të bëjmë dhe ndonjë ko
rigjim e saktësim të asaj ç'ka është botuar për d
nga këto monumente në literaturën tonë shkencore.[10]

Shëtitorja e parë. Gërmimet për zbulimin e këti
monumenti u përqëndruan mbi një brezare të pjerrt
që fillon rrëzë shpatit jugor të akropolit dhe zbre
disa metra poshtë një ledhi mbajtës të formuar ng
blloqet e rrëzuar të nikeve. Nga pesë niket e eviden
tuara në vitin 1962, gjatë gërmimeve, dualën në pa
dhe dy të tjera duke e çuar numrin e tyre në 7, m
shtrirje nga perëndimi në lindje.[11] Përveç nikeve q
formonin sfondin e pasmë arkitektonik të portikut
zbuluan sheshi para tyre së bashku me një trakt t



Fig. 2

9) Kërkimet disa vjeçare (1963-1965, 1971, 73, 74) në kalanë e Krotinës janë ndër-marë nga ish Sektori i Arkeologjisë (sot Qëndra e Kërkimeve Arkeologjike). Gërmimet e para në kala të filluara në verën e vitit 1963 për zbulimin e shëtitores së parë të Dimales u kryen nga arkeologët A. Mano, D. Komata dhe autori i këtij punimi.

10) Në raportin paraprak me karakter informativ mbi **Rezultatet e gërmimeve arkeologjike të vitit 1974 në Dimal**, «Buletin Arkeologjik» 5 (1975) nga autori i këtij punimi dhe, në një artikull përgjithësues të botuar kohët e fundit nga A. Baçe-N. Ceka, **Shëtitoret e periudhës qytetare ilire,** «Monumentet» 2 (1981) fq. 5-42 konstatohen mangësi në ndonjë rast dhe zgjidhje të gabuara për të dy shëtitoret e para të Dimales, të cilat nëpërmjet këtij shkrimi plotësohen dhe saktësohen mbi bazën e të dhënave më të reja nga gërmimet në kalanë e Krotinës.

11) Këtij orientimi ju nënshtrua i gjithë gërmimi, thellësia e të cilit ndryshonte nga perëndimi (0.40m) në lindje (1.50m) në përshtatje me pjerrësinë natyrore të terrenit.

DO NOT COPY

murit terracues që ka shërbyer dhe si themel për stilobatin e kolonadës së jashtme, gjurmët e një hyrje për në akropol në anën lindore të shëtitores si dhe një pjesë e murit të brendshëm që qarkonte shpatin jugor të kreshtës së akropolit (tab. I).

Muri i pasëm përveç funksionit mbajtës nëpërmjet vargëzimit dhe gërshetimit të pandërprerë të nikeve me daljet ballore, luante dhe një rol dekorativ në sfondin e brendshëm të shëtitores (fig. 2). Prej murit është ruajtur vetëm faqja ballore e tij me gjatësi 29.40m. Nuk jemi të sigurtë në se muri kthehej ose jo me ante, por fakti që nga perëndimi terreni paraqitej shkëmbor (ranor) dhe shikimi tretej mbi një horizont më të gjërë të joshur dhe nga freskia e erërave bregdetare të shtyn të mendosh për një portik të hapur edhe nga kjo anë.

Niket paraqiten në gjëndje të dëmtuar, veçanërisht në radhët e sipërme të tyre, të cilat në përgjithësi nuk shkojnë tej rrjeshtit të katërtë. Kështu nga niket 1-4 ruhen thuajse të plotë tre rrjeshtat e parë ndërsa nga i katërti vetëm blloqet e mesit (fig. 3). Diçka më mirë ruhen tre niket e fundit, te të cilat rrjeshti i katërt paraqitet disi më i plotë. Për ngritjen e muraturës janë përdorur blloqe konglomeratë, porozë të vendosur në lidhje të thatë me lartësi rrjeshtash jo gjithëkund të barabartë.[12] Ndeshja nëpër rrjeshta e ndonjë blloku ranor nuk ka të bëjë me fazën fillestare të ngritjes së nikeve por me meremetime të tyre. Numri i blloqeve sipas rrjeshtave alternohet në mënyrë të tillë që radhët çift ndaj atyre tek rriten me një gur më tepër. Kështu rrjeshti i parë gjithëkund është ndërtuar me 5 blloqe, i dyti me 6, i treti me 5 dhe me radhë... Përjashtim bën vetëm nikja Nr. 3 e cila i ka blloqet me përmasa më të vogla se niket e tjera.[13] Ky raport deri në rrjeshtin e katërt është i përbashkët për të gjitha niket dhe bën të mundur që nëpërmjet balleve të realizohet një lidhje konstruktive më e qëndrueshme midis tyre. U zbuluan gjithsej 8 ballë të cilët luajnë rolin edhe të kontraforteve. Ballet, përjashtuar atë të fillimit e të fundit, janë të gjërë rreth 1 m me vija peshimi në skaje. Forma konkave e nikeve është arritur nëpërmjet vendosjes së rrjeshtave sipas një harku përafërsisht sa gjysma e një rrethi me diametër 3 m. Thellësia e nikeve shkon nga 1.44--1.50 m. Zgavrimi i blloqeve nga faqja ballore, veçanërisht trajtimi në vertikalitet i kësaj faqeje në formë të një dhëmbëzimi të lehtë në pjesën e sipërme të



Fig. 3



Fig. 4

gurit tregon se duke filluar nga rrjeshtat e poshtme ka prirje për një mbyllje në trajtë absidale të nikeve. (Tab. II).

Dyshemeja e nikeve gjithëkund është shtruar me 4-6 rasa guri, ndërsa boshllëqet midis tyre janë plotësuar me gurë më të vegjël të vendosur në dhe të rrahur.

12) Përjashtuar dy niket e fillimit ku rrjeshti i parë nëpërmjet një shkallzimi në ballin e nikes Nr. 2 pëson një ulje (rreth 0.10m) në përshtatje me pjerësinë e terrenit te të tjerat ai ruan të njëjtën lartësi (0.70m). Radhët që pasojnë deri në rrjeshtin e katërt variojnë në lartësi nga 0.60 m deri në 0.44 m.

13) Prandaj dhe numri i tyre sipas rradhëve rritet me një gurë më tepër: rrjeshti i parë me 6 blloqe, i dyti me 7, i treti me 6...

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

Para nikes Nr. 3, përbri dhe në një nivel me shtrojën e saj, u ndesh «in situ» një trakt kalldrëmi, ndoshta gjurmë të shtrojës me gurë të shëtitores.

Skajet fundor të murit me nike ndërpriten nga konstruksione më të vona që kanë zëvendësuar ballet. Nga perëndimi puqur me niken Nr. 1 janë vendosur së gjati dy blloqe ranorë, nga të cilët njëri i punuar me fashaturë (rustika). Në anën lindore përbri nikes Nr. 7 është ndërtuar një konstruksion (fig. 4) me gjërësi sa dyfish i ballit dhe lartësi 1.80 m[14]. Të dy këto konstruksione nga teknika e punimit me rustikë dhe materiali nuk kanë asgjë të përbashkët me ballet e vërtetë dhe kronologjikisht mund të lidhen fare mirë me meremetimet e kryera në niket. Megjithatë ngritja e tyre duket ja ka arritur qëllimit që në gjëndjen e dëmtuar rëndë të nikeve të bëhej një rindërtim sa më i shpejtë dhe paraqitës që të harmonizonte me ndërtimet në anën lindore të portikut (fig. 5). I njëkohëshëm me nikët mendohet të jetë një mur, i cili fillon ngjitur me skajin lindor të murit të pasmë dhe ndjek drejtimin paralel me boshtin gjatësor të shëtitores. Muri me gjatësi 9.20 m dhe gjërësi 2 m, i formuar nga dy faqet dhe mbushjes së mesit, mbështetet, ashtu si dhe niket, në shpatin jugor të akropolit. Muratura e ngritur në dy radhë lartësi (1.20 m) është ndërtuar nga blloqe gëlqerore të vendosur mbi një themel me gurë të papunuar (fig. 6).

Midis dy faqeve të murit formohet një platformë e sheshtë (e gjërë 1.40 m), me sa duket, një sheshpushimi i shtruar me kalldrëm guri (fig. 7), e cila të bën të mendosh për praninë nga kjo anë e shëtitores e një hyrje për në akropol. Faqja e brendshme e ngritur një rrjesht blloqesh më lartë se faqja e jashtme e murit (0.15m mbi shtrojen me kalldrëm) duket ka shërbyer si rradhë e parë e shkallares, që i ngjitej përpjetë shpatit për të dalë në brezaren sipër nikeve. Në të mirë të këtij supozimi mund të merren sipërfaqet e fërkuara të blloqeve në pjesët e shkelura të tyre si dhe dalja në pah e një rrjeshti të dytë gurësh në vazhdim

14) Nga 5 blloqet e ballit lindor ruheshin «in situ» tre prej tyre, ndërsa në vendin e dy të tjerëve, ishin murosur blloqe ranor të punuar me rustikë dhe të shkallëzuar. Ngritja e këtij konstruksioni ka të bëjë me ndërtimin përbri tij të një ambienti të njëkohëshëm me të.



Fig. 7



Fig. 8

të radhës së parë, por që u la, si dhe krejt hyrja, të zbulohej në të ardhmen. Lënia pa u trajtuar e faqes së jashtme, jugore të murit mund të shpjegohet ndoshta me fiksimin e rampës të shkallares së poshtme që të çonte për në sheshpushimin e shtruar me kalldrëm.[15] Ndërprerja e kalldrëmit në anën lindore nga një konstruksion (shih. fig. 7) që formon qoshe të rregullt me rrjeshtin e faqes së brendshme të murit, tregon për një mbyllje nga kjo anë të sheshpushimit. Trajtimi me rustikë i blloqeve nga faqja e jashtme (lindore) e tyre[16] paramendon për paraqitjen e shetitores edhe nga kjo anë. Shtrirja e gërmimeve në anën jugore të sheshit para nikeve nxori në pah në largësi 10 m nga ballet (11.5m nga muri i pasmë) një mur mbajtës (fig. 8) që ka shërbyer si themel për stilobatin e kolonadës së jashtme të shëtitores. Ky mur i zbuluar në gjatësi 5 m ndjek drejtimin paralel me murin e pasëm me nike. Në muraturë janë përdorur blloqe ranorë të vendosur në të thatë. Gjërësia e murit është 0.70 m, ndërsa lartësia e barabartë me atë të tre rrjeshtave (0.80 m). Mbi mur në sheshin para tij u ndeshën grumbuj gurësh të hedhur, të një natyre me ato të përdorur për shtroje të shetitores.

Pranë hyrjes me dalje ballore 0.95 m nga faqja e jashtme e konstruksionit mbajtës të shkallëve nis një mur (fig. 9), i cili ndjek rrëzën e shpatit jugor të akropolit. Nga muri, i zbuluar në gjatësi rreth 30 m, ruhet në gjendje të mirë vetëm trakti pranë hyrjes. Për veshjen e xokolaturës janë përdorur blloqe gëlqeror të punuar me rustikë. Midis dy faqeve me gjërësi sa ajo e murit, është shtruar në formë kalldrëmi me rasa të mëdha guri një sipërfaqe e dystë ndoshta për



Fig. 9

15) Zgjatimi i murit prapa ballit të nikes 7 deri në takimin me skajin lindor të murit të pasmë, tregon për qëllimin fillestar të ngritjes së tij, në funksion të hyrjes. Po të gjykojmë nga disniveli i kalldrëmit mbi mur me atë të shtrojes së shëtitores del se ngjitja për në sheshpushim duhet të jetë bërë nëpërmjet 4 – 5 këmbë shkalle.

16) Nga ky konstruksion ruhen vetëm dy blloqet e qoshes ndërsa i treti është zhdukur nga ndërtimi i një ambienti të vonë. Lënia pa u trajtuar e blloqeve nga faqja e brendshme e tyre mund të shpjegohet me përdorimin e ndonjë veshje dekorative për të gjithë hyrjen.

DO NOT COPY

ngritjen mbi të të një murature me tulla. Skaji perëndimor i këtij muri është prekur nga ngritja e një ambienti më të vonë (fig. 10), i cili ka zhdukur dhe çdo gjurmë të ndërtimeve në sheshin para hyrjes për në akropol. Ambienti ka trajtën e një kulle katërkëndëshe (6.5 x 4.5 m) me dalje ballore 8 m nga muri i pasëm me nike. I gjithë ambienti mbështetet në faqen jugore të konstruksionit të shkallëve. Muret e tjerë, përjashtuar qoshen perëndimore të tij, ruhen vetëm në themel, të ndërtuar me gurë ranor.[17] Pranë skajit perëndimor ruhet një trakt i xokolaturës i veshur me blloqe të punuar me rustikë (shih. fig. 4), ndërsa pjesa tjetër e mureve deri në çatinë me konstruksion druri ka qenë e ngritur me muraturë tulle. Këtë tregojnë dy traktet me tulla të plota të ndeshur në skajet lindor e perëndimor të ambientit.[18] Të vetmen hyrje ky ambient e ka pasur nga fasada perëndimore me dalje në sheshin para nikeve[19].



Fig. 10

Gjetjet e pakta arkeologjike brenda ambientit, disa profile amforash, të shek. III-II p.e.sonë dhe përdorimi në konstruksionet mbajtëse i tullave të plota ndihmojnë për një datim të përafërt por jo dhe për qëllimin e përdorimit të tij. Megjithatë një gjë del e qartë se ambienti «kullë» i është shtuar më vonë shetitores dhe mund të lidhet me rindërtimin e portikut dhe restaurimin e nikeve dhe të balleve fundorë me blloqe ranorë të punuar me rustikë.

Nga studimi i këtyre rrënojave sipas trajtimit stilistik dhe materialit të përdorur në konstruksionet mbajtëse mund të veçohen dy periudha ndërtimi.

Periudha e parë (fundi i shek. IV-shek. III p.e.s). Ka të bëjë me fazën fillestare të ngritjes së shetitores të përfaqsuar nga muri me nike, shtroja e sheshit para tyre, muri mbajtës për vendosjen e stilobatit të kolonadës së jashtme dhe hyrja në akropol. Kësaj periudhe i përket dhe ndërtimi i murit të brendshëm që qarkon shpatin jugor të kreshtës së akropolit. Shtresa kulturore e fundit e shek. IV-shek. III p.e.s[20], ndihmon për të përcaktuar afërsisht kohën e këtyre ndërtimeve. Gjetja me shumicë e tjegullave në sheshin para nikeve, mbeturina të çatisë, prej të cilave disa me vulë me emrin e bashkësisë dimalase në gjinditorenΔιμαλλίταν dhe me Ηράων të datuara në shek. III p.e.s — fillimi i shek. II p.e.s[21] mund të shërbejë si «terminus ante quem», për ndërtimin e shetitores I-rë të Dimales.

Dëmtimi i rëndë i shëtitores, që vihet re nëpërmjet meremetimeve me blloqe gëlqerorë në murin e pasmë me nike, duhet kërkuar jo aq në fatkeqësitë natyrore se sa në ngjarjet politike, të cilat tronditën Ilirinë, përfshirë dhe Dimalen në çerekun e fundit të shek. III p.e.sonë.[22]

Periudha e dytë (shek. II-I p.e.s). Përfaqsohet nga ambienti katërkëndësh dhe meremetimeve të kryera në niket dhe në ballet fundore, të cilat tek-

17) Këto konstruksione vijnë të shkallëzuar në përshtatje me pjerrësinë natyrore të terrenit, si rrjedhojë dhe gjërësia e tyre lëviz për muret gjatësorë 1.65 m, ndërsa për jugorin ajo shkon deri në 2 m.

18) Këto trakte 1-2 rradhësh, janë ngritur me tulla të plota 0.44 x 0.44 x 0.08 m të lidhura me llaç të hollë balte. Tulla me këto përmasa janë ndeshur dhe në Apolloni në konstruksione të shek. IV-II p.e.s. (shih. A. Mano, **Të dhëna mbi qeramikën masive të Apolonisë, përdorur si material ndërtimi,** «Studime Historike» 1, 1965, fq. 63, tab. VI.

19) Nga hyrja ishte ruajtur vetëm njëri krah i përfaqsuar nga një bllok i vendosur vertikalisht, i cili nga pjesa më e ngushtë e tij formon një faqe të rrafshtë për inkasimin e derës. Përbri dhe poshtë tij shtrihet horizontalisht një bllok tjetër i punuar dhe ky si i pari me rustikë, por që në pjesën e shkelur të tij ruan gjurmë të një pragu (shih fig. 4 në tekst).

20) Gjetjet arkeologjike si qeramikë me vernik të zi (fragmente kupash, pjatash dhe skyfkosash) dhe disa monedha të Dyrrahut dhe Apolonisë të datuara në shek. IV-III p.e.s. përcaktojnë përmbajtjen e kësaj shtrese.

21) B. Dautaj, **«Dimale në dritën. . . .» vep. cit,** fq. 386.

22) Kemi parasysh luftën e dytë iliro-romake 219-218 p.e.s ku Dimale bëhet objekt i sulmit romak dhe vuan të gjitha pasojat e rënda të këtij pushtimi. (Polibi III, 18,4,5).

BOTIMET

nikisht paraqiten më të dobta dhe dëshmojnë për një rënie në fushën e ndërtimeve shoqërore në krahasim me periudhën pararendëse. Me ndërtimet e reja, shëtitorja i është nënshtruar, me sa duket, dhe një riformulimi që ka ngushtuar shtrirjen nga jugu të saj,[23] ndërsa si kohë ato mund të lidhen me ndërtimet në zonën e akropolit të datuara në shek. II p.e.s.[24]

Një problem me interes që del nga studimi i shëtitores së I-rë të Dimales është ai i formulimit arkitektonik, ndonëse të dhënat e përftuara nga gërmimet janë tepër të varfra për të arritur në një rindërtim sa më të plotë të saj. Shkaku i një varfërie të tillë duhet kërkuar në atë që brezarja prej kohësh ka qenë përdorur si tokë arë, gjë që ka sjellë dhe zhdukjen e pjesëve arkitektonike, veçanërisht të kollonave, antablemantit dhe çatisë së shëtitores.

Projektimi i shëtitores së Dimales përgjatë tarracës, rrëzë shpatit jugor të kreshtës së akropolit tregon për një konceptim të qartë planimetrik dhe urbanistik në përshtatje me kushtet konkrete të vendit. Hapja e saj nga jugu, e mbrojtur mjaft mirë nga erërat e ftohta kontinentale, sigurisht që ka ndikuar në zgjedhjen e vendit.[25] Sistemimi i terrenit ka qenë një çështje tjetër jo më pak e rëndësishme, për deri sa kishte të bënte me ngritjen e strukturave mbajtëse dhe të qëndrueshme siç ishin muri me nike, themeli për vendosjen e stilobatit dhe hyrja në akropol të cilat kërkonin njohuri dhe përvojë. Kuptohet që këto zgjidhje nuk ishin të panjohura po të kemi parasysh shëtitoret e Apolonisë.[26] me të cilat kjo e Dimales ka mjaft elemente të përbashkëta.

Shëtitorja e I-rë e Dimales me shtrirje gjatësore nga perëndimi në lindje rreth 40 m (përfshirë dhe hyrjen) është më e vogël se ato të Apolonisë. Gjërësia e saj prej 11.5 m, me dy rrugë kalimi i afrohet shumë shëtitores së II-të të Apolonisë dhe është thuajse e barabartë me atë të Bylisit.[27] Kjo tregon se shëtitorja e parë e Dimales ka patur dy rrjeshta kollonash. Prej rrjeshtit të jashtëm ruhet vetëm themeli për vendosjen e stilobatit, ndërsa nga i brendëshmi nuk është ruajtur asnjë gjurmë për shkak të shfrytëzimit si tokë arë të brezares para nikeve. Largësia ndërmjet rrjeshtave të kollonadës dhe rrjeshtit të brendshëm e balleve të nikeve, për analogji me shëtitoren e II-të të Apolonisë, mendohet të ketë qenë përkatësisht 5.5 m dhe 4.5 m të mjaftueshme për dy kalime të lirëshme.[28] Shpërndarja e kollonave duhet të jetë bërë në mënyrë të atillë që të mos paraqiste vështirësi konstruktive për mbajtjen e çatisë dhe konkretisht çdo balli dhe mesi nikeje i përgjigjej një kollonë e brendëshme dhe një e jashtme si dhe në shetitoren e Apolonisë. Me këtë shpërndarje të kollonave si për rrjeshtin e brendshëm dhe për të jashtmin përftohet një largësi nga boshti në bosht prej 2.15-2.20 m e barabartë me interkolumnin në të dy shëtitoret e Apolonisë.[29]

Përpjekjet e autorëve A. Baçe-N. Ceka për një zgjidhje planimetrike të njëjtë për nga gjërësia me atë të shëtitores së I-rë të Apolonisë mbështeten në të dhëna jo të sakta.[30] Prej tyre del se nuk janë parë dy nga elementet përbërës të shëtitores së Dimales siç janë muri mbajtës i stilobatit të kolonadës së jashtme dhe hyrja në akropol që lidhen me të dhënat e reja nga gërmimet. Gjithashtu edhe mendimi për një trajtim hapsinor të nikeve të njëjtë me ato të shëtitores së parë të Apolonisë[31] nuk na duket bindës. Në fakt trajtimi i murit të pasëm të shetitores së Dimales nëpërmjet formave të harkuara dhe lidhjes së nikeve me anë të balleve, siç pranohet dhe prej tyre, i përmbahet me rigorozitet rrjeshtimit dhe

23) Me ndërtimin e ambientit katërkëndësh shtrirja nga jugu e shëtitores ngushtohet me rreth 4 m.

24) B. Dautaj, **«Rezultatet e gërmimeve...» vep. cit,** fq. 27.

25) Brezare të sheshta me horizont shikim më të gjerë dhe të përshtatëshme për zhvillimin e qendrës së qytetit ndodhen në perëndim dhe veriperëndim të kodrës së kalasë.

26) L. Rey, **Fouilles de la Mission Française a Apolonie d'Illyrie (1925)** në «Albania» Nr=2 Paris, 1927, dhe **Fouilles de la Mission Française à Apolonie d'Illyrie (1926-1927).**, «Albania» Nr=3, Paris 1928. Një nga portiqet e zbuluara prej tij në Apolloni është ngritur i tëri rrëzë kodrës që zotëron si dhe në Dimale gjithë pjesën e poshtme të qytetit.

27) A. Baçe-N. Ceka, **vep.cit,** fq. 12, tab. I dhe fq. 31, fig. 54.

28) A. Baçe-N. Ceka, **vep.cit,** fq. 13 dhe shënimi 33.

29) A. Baçe-N. Ceka, **vep.cit,** fq. 14.

30) Zgjidhja planimetrike e propozuar nga këta autorë, **(vep.cit** fq. 34) për shtetitoren e I-rë të Dimales me gjatësi 29.40 m e gjërësi 5 m me një rrugë kalimi për mendimin tonë është e gabuar pasi merr si piknisje ambientin katërkëndësh që i përket periudhës së dytë të ndërtimit.

31) A. Baçe-N. Ceka, **vep.cit,** fq. 34 dhe 41. Sipas këtyre autorëve niket në portikun e Dimales kanë ruajtur trajtën cilindrike deri në lartësinë e katit, duke mos vënë re formën harkore të blloqeve dhe prirjen për mbyllje në rrjeshtat e sipërme të nikeve. Kjo dhe trajtimi planimetrik i gabuar i shetitores së Dimales i ka çuar në krahasim me shëtitoren e parë të Apolonisë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

në përgjithësi zgjidhjes planimetrike si dhe në shetitoren e II-të të Apolonisë. Edhe nga teknika e punimit të gurit, materialit të përdorur dhe përmasave niket në shetitoren e Dimales kanë ngjashmëri të plotë me ato të shetitores së II-të dhe ndryshojnë mjaft nga niket në shetitoren e parë të Apolonisë. Forma absidale e nikeve që në të Dimales ruhet deri në rrjeshtin e katërt supozon për një mbyllje nga sipër të tyre, çka do t'i përgjigjej një lartësie kolone 4.20-4.40 m e pranueshme për interkolumne 2.15-2.20 m sa dhe në shetitoren e II të Apolonisë.[32] Megjithatë në trajtimin e formës absidale të nikeve dhe në përgjithësi të shetitores së Dimales mund të mendohet për një zgjidhje pak më të ndryshme nga simotra e saj, shetitorja e II e Apolonisë. Ky ndryshim duhet parë kryesisht në drejtim të mbylljes së nikeve,[33] dhe të komunikimit nëpërmjet hyrjes së shetitores me akropolin, që e pasurojnë me elemente funksionale dhe e dallojnë shetitoren e Dimales nga shetitoret në qendrat e tjera ilire.

Supozimi për një shetitore dy katëshe të mbuluar e motivuar me lartësinë e konsiderueshme të terrenit në pjesën e prapme të saj.[34] do ti përshtatej më mirë mbulimit të hyrjes dhe zgjidhjes së problemit për shkarkimin e prurjeve të rreshjeve nga brezarja sipër nikeve. Sidoqoftë fakti që shetitorja e I-rë e Dimales ka huazuar mjaft elemente nga shetitorja e II-të e Apollonisë tregon se konceptimi dhe projektimi i saj duhet të jetë bërë nga arkitektë të shkollës apoloniate të cilët kanë ditur të krijojnë një tip të kristalizuar mirë që ruan traditat arkitektonike dhe i zhvillon ato më tej me elementë të rinj funksionalë. Për marrëdhënie të ndërsjellta, tepër të ngushta, midis këtyre dy qyteteve dhe jo vetëm në fushën e ndërtimeve, dëshmon e gjithë lënda arkeologjike e zbuluar në Dimal.[35]

Shëtitorja e II-të[36]

Pas zbulimit të shëtitores I në pjesën e poshtme të qytetit vëmëndja e jonë u përqëndrua në zonën e akropolit ku terreni paraqitej disi i sheshtë dhe më pak i prekur nga punimet e ndryshme bujqësore. Gërmimet u shtrinë mbi një tarracë të gjatë e të sheshtë nga brenda murit rrethues, aty ku shpati verior i kreshtës së akropolit pëson një rënie me disa dhjetra metra pjerrësi që përfundon në luginën e ngushtë të përroit të Cukalatit. Si piknisje për fillimin e punimeve u muar një trakt muri që ende dukej mbi kurrizin ku tarraca lartësohej për të kaluar në platformën e një brezareje tjetër më në jug të saj. Orientimit të murit nga perëndimi në lindje ju nënshtrua i gjithë gërmimi i cili jo gjithëkund shkoi deri në taban, pasi pjesa më e madhe e sipërfaqes së gërmuar zihej nga mbeturina ndërtimore me shtrirje kohore nga shek. II p.e.s. – shek. IV e.j.

Ndërtimet më të hershme të zbuluara në këto gërmime përfaqësohen nga mbeturinat e një shetitoreje (e dyta sipas radhës së zbulimit) dhe një rruge që komunikon me pjesën e prapme të saj (Tab. III). Ndërtimi i kësaj shetitoreje mbi një tarracë të gjatë dhe të ngushtë me shtrirje përbri faqes së brendshme të murit rrethues, tregon për një terren jo të fortë të përshtatshëm për ndërtime të këtij lloji. Në këto kushte ndërtuesve sigurisht që u është dashur, si dhe në shetitoren e I-rë të zgjerojnë sheshin nëpërmjet ngrënies në shpinë të terracës dhe sistemimit të terrenit për ndërtimin e konstruksioneve mbajtëse. Por ndërsa në shetitoren e parë i është arritur qëllimit për t'i bërë këto konstruksione sa më të qëndrueshme nëpërmjet thyerjes të murit me anë të nikeve, në të dytin ndërtimi në linjë të drejtë dhe me blloqe të vegjël i murit të pasmë duket nuk i ka bërë dot ballë për një kohë të gjatë presionit të dherave të kodrës.

Përveç murit të pasmë që formonte sfondin arkitektonik të shetitores ishin ruajtur dhe pjesa më e madhe e bazamenteve të kolonadës e hapur e gjitha nga veriu përballë murit rrethues (fig. 11). E ndodhur në afërsi të këtij të fundit shëtitorja e II-të ka pasur nga pas dhe një hyrje të gjerë 3 metërshe, që lidhej drejtpërsëdrejti me rrugën dhe e ndante murin e pasmë në dy krahë të barabartë. Kjo mund të vihet re prej mbylljes në të dy krahët e shetitores nga kthimi i murit në ante.

Krahu lindor i murit të pasmë (fig. 12) me gjatësi 24 m dhe gjerësi 0.52 m të barabartë me atë të një rrjeshti gurësh ruhet në lartësi që ndryshon nga 1.20 – 1.65 m. Muratura është ngritur nga blloqe

32) A. Baçe-N. Ceka, **vep.cit,** fq. 15 dhe shënimi 34.

33) Ka të ngjarë që mbyllja e nikeve nga sipër në shetitoren e I-rë të Dimales të jetë thjeshtuar nëpërmjet përdorimit të një pseudoqemer se sa me kupolë sferike si në shetitoren e dytë të Apolonisë (shih: A. Baçe-N. Ceka, **vep. e cit.,** fq. 16, fig. 19).

34) A. Baçe – N. Ceka, **Vep.cit,** fq. 34.

35) B. Dautaj, **«Aspekte të jetës ekonomike në Dimal»** «Iliria» VI, 1976, fq. 150 e vazhdim.

36) Gërmimet për zbulimin e kësaj shëtitoreje të filluara në vitin 1964 u kryen nga A. Mano dhe autori.

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

të vegjël gëlqerorë dhe gëlqeror ranor të vendosur në të thatë. Për nivelimin e rrjeshtave dhe mbushjen e fugaturave vertikale është përdorur çakëll guri, ndërsa thyerja aty këtu e linjave horizontale ka të bëjë me meremetime të murit. Skaji lindor i ballorit mer në kënd të drejtë një kthesë deri në mbylljen nga ky krah të shetitores, ndërsa në gjatësi 7.80 m bën një kthesë të dytë për t'u lidhur me një mur tarracues që ndjek shpatin verior të kakisë së akropolit.

Në krahun tjetër muri u arrit të gjurmohej deri në gjatësi 23.20 m duke lënë të pazbuluar skajin perëndimor të tij së bashku me traktin që mendohet se mbyllte nga kjo anë shëtitoren. Ky krah në dallim nga ai i anës lindore është rindërtuar në pjesën më të madhe të tij me blloqe të mëdhenj kuadratikë të marrë nga ndonjë godinë më e lashtë. I gjithë ky krah është shfrytëzuar si substruksion për ngritjen e muraturave të banesave më të vona, të cilat shtrihen në krejt sheshin para tij. Te hyrja, të dy krahët e murit të pasmë, formojnë qoshe të rregullta nga gërshetimi me traktet tarracues që shoqërojnë rrugën nga të dy anët e saj. Skajet fundorë (jugor) të trakteve që shoqërojnë rrugën ndërpriten pa u futur në faqe të gërmimit si pasojë e uljes së terrenit deri në nivelin e sheshit të brezares mbi shetitore.

Paralel me murin e pasmë dhe në largësi 8 m nga ky i fundit u zbulua një rrjesht bazamentesh, gjurmë të kolonadës që formonte fasadën veriore të shetitores (fig. 13). Ishin ruajtur gjithsejt 12 bazamente të përbërë nga blloqe (plinta) ranor të vendosur mbi një shtroje gurësh të ngjeshur në dhe të rrahur. Një pjesë e bazamenteve të krahut perëndimor të portikut ishin zhdukur nga ndërtimi i konstruksioneve të vona. Po për të njëjtën arsye në dy nga bazamentet e skajit lindor plintat u gjetën të çvendosura dhe të ripërdorura.

Me interes janë gjurmët rrethore të kollonave prej guri që ruhen mbi sipërfaqe të plintave (Tab. IV, B), të cilat si dhe në stilobatin e shëtitores së Bylisit nuk kanë shënja kunji ndërlidhëse[37]. Kjo tregon se men-



Fig. 13

37) A. Baçe – N. Ceka, **vep. e cit.** fq. 30, fig. 55.

dimi për kollonadë druri në portikun e shëtitores së II-të Dimales[38], që mbështetet kryesisht në mungesën mbi sipërfaqe të plintave të gjurmëve për lidhje metalike, nuk qëndron. Për këtë flet gjetja në sheshin para portikut të disa fragmenteve, kapitel dhe trungje kollonash dorike (Tab. IV, A), të cilat padyshim i përkasin kollonadës së shëtitores. Megjithatë largësia (interkolumni) prej 3 m midis bazamenteve supozon për një antablement druri.

Me njohjen e interkolumnit dhe të shpërndarjes simetrikisht, në të dy krahët e portikut, të kolonave (përfshirë dhe bazamentin në drejtim të boshtit të hyrjes së pasme) përftohet numri i përgjithshëm 17 i tyre. Shetitorja e dytë me gjatësi 51 m dhe gjerësi 8 m duhet të ketë qënë dy katshe dhe e mbuluar. Ngritja e një kati të dytë diktohet, nga njëra anë, prej shtrirjes së saj në afërsi dhe përballë murit rrethues, ndryshe një shetitore një katshe do të humbiste pamjen e peisazhit që ishte dhe një nga kërkesat funksionale të kohës. Nga ana tjetër lartësimi i terrenit (rreth 3 m) në shpinë të shetitores e bënte të papërshtatëshme për çati të ultë.

I njëkohëshëm me shetitoren mendohet të jetë trakti rrugor që nëpërmjet hyrjes komunikon me pjesën e pasme të saj (fig. 14). Rruga u zbulua vetëm në gjatësi 6.30 m me skajin jugor të futur në sheshin e pa gërmuar të brezares mbi shëtitore. Për trase të rrugës me gjërësi 3 m është përdorur zhavorr i imët lumi përzier me dhe të ngjeshur dhe mbeturina qeramike. Drejtimi jugor i boshtit gjatësor të rrugës, në largësi rreth 60 m nga portiku përputhet me atë të hyrjes së akropolit ç'ka tregon për një lidhje të shetitores së parë me të dytën.

Në mesin e rrugës, së gjati, ishte ndërtuar një kanal i ruajtur në gjatësi 13.20 m, i cili në prerje ka formën e shkronjës «U» me gjerësi 0.20 m. Për shtroje të kanalit ishin përdorur tjegulla të plota (solene) të vendosura së gjati në tokë. Paretet anësore ngriheshin nga një rrjesht gurësh të vegjël të lidhur me llaç balte, ndërsa për mbulimin e kanalit ishin përdorur rasa të rëndomta guri. Nga ana veriore kanali duket përshkonte të gjithë sheshin para shetitores deri në derdhjen e tij në murin rrethues të akropolit. Me futjen e skajit jugor të tij në sheshin e pagërmuar tregon se kanali ka qënë ndërtuar në funksion të ndonjë godine ende të pazbuluar. Është e qartë se ndërtimi i këtij kanali i përket një periudhe të vonë kur shëtitorja kishte dalë nga përdorimi dhe sipërfaqja e rrugës ngrihej rreth 0.30 m nga niveli fillestar i saj.



Fig. 14

Dalja në pah e bazamenteve të një kolonade të dytë me shtrirje kryesisht në krahun lindor të portikut paralel dhe në largësi 4.50 m nga ballori i murit të pasmë mendojmë se nuk ka të bëjë me shëtitoren.[39] Këto bazamente i përkasin një kohe relativisht më të vonë se shëtitorja, kur kjo e fundit kishte pushuar së funksionuari dhe krejt trualli i saj është zënë nga ndërtime të cilat kanë përfshirë në strukturat mbajtëse murin e pasmë të meremetuar.

I tillë duket se ka qenë ngritja e një tregu me

38) A. Baçe – N. Ceka, **vep. e cit.** fq. 35.

39) Mendimi i shfaqur nga autorët A. Baçe-N. Ceka **(vep.cit.** fq. 35) për këto bazamente si gjurmë të kolonadës së brendëshme të shetitores do të ishte me interes po qe se mbështetej nga të dhënat më të reja të gërmimeve.

DO NOT COPY



Fig. 15

një tok punishtesh-dyqane[40] dhe i një portiku të përfaqësuar nga bazamentet në fjalë (fig. 15). Dy nga ambientet punishte pranë qoshes lindore dallohen qartë prej shtrojeve të zbuluara për nën çatinë e rrëzuar si pasojë e një zjarri të befasishëm[41]. Në funksion të këtyre ambienteve u ndesh një kanal me konstruksion guri (fig. 16), nga ndërtimi i të cilit ishin dëmtuar dy nga bazamentet e kolonadës së jashtme të shetitores. Kanali ka shërbyer për grumbullimin e ujrave nga ambientet dhe derdhjen e tyre në një basen (gropë) të veshur me tjegulla (kaliptere) të ngulura vertikalisht në tokë. Buzë gropës ishin vendosur dy blloqe të mëdhenj të skuadruar, mbi sipërfaqe të cilëve ruheshin disa thellime gjatësore, ndoshta gjurmë nga rrafja e metalit para temperimit të tij në ujin e basenit.

Para ambienteve në gjithë gjatësinë e krahut lindor të murit mbështetës shtrihej portiku (hajati) i hapur nga veriu në formën e një korridori të gjatë me gjerësi 1.5 m. Kolonada e portikut e vetmja mundësi për mbështetjen e çatisë nga kjo anë, qëndronte mbi 8 bazamente në formë plintash. Këto të fundit përbëheshin nga blloqe të vegjël gëlqerorë, me formë kuadratike (0.50 x 0.50 x 0.20 m) të vendosura drejtpërsëdrejti në tokë. Konturet e lehta rrethore mbi sipërfaqe të bazamenteve, interkolumni prej 3 m dhe mungesa e çdo gjurme të mureve ndarës në ambientet tregojnë për ndërtime me konstruksion druri[42].



Fig. 16

40) Në mbështetje të këtij supozimi mund të merret gjetja në sheshin e gërmuar të një sasie të konsiderueshme zgjyre hekuri, ndërsa brenda kthinave u ndeshën me shumicë peshore balte dhe objekte të ndryshme metalike (dalta të përmasave të ndryshme, çelsa, reze dyersh, etj.) që lidhen me prodhimin zejtar.

41) Me heqjen e çatisë në ambientin e parë (nga lindja) për shtroje ishin përdorur tulla të plota 0.49 x 0.49 x 0.09, ndërsa në tjetrin, përbri tij dyshemeja ishte shtruar me tjegulla të plota (solene) 0.83 x 0.52 x 0.03 m të venosura përmbys. Pranë vatrës së zjarrit të ambientit të parë u zbulua dhe thesari me monedha apoloniate të datuara në fund të shek. I p.e.s. (B. Dautaj, «Raport i gërmimeve... **vep.cit.**)

42) Për muret ndarës të ambienteve nuk përjashtohet edhe mundësia e ndërtimit të tyre me qerpiç, por si pasojë e rënies së zjarrit dhe me kalimin e kohës qerpiçi është njësuar me tokën e cila gjithkund kishte një ngjyrë të kuqërremtë.

DO NOT COPY

Krejt ndryshe paraqitej gjendja në anën perëndimore të gërmimit, ku ndeshëm në mbeturinat e një godine të madhe e cila e projektuar 4.5 m nga muri i pasmë i shetitores, ruan me rigorozitet drejtimin paralel me portikun e tregut, të njëkohëshëm me të. Me daljen jashtë përdorimit të godinës, rrënojat e saj dhe i gjithë krahu perëndimor i murit të pasmë i rindërtuar me blloqe kuadratikë është shfrytëzuar si substruksion për një sërë kthinash me muraturë të dobët. Këto të fundit janë dhe nga ndërtimet më të vona (shek. II – IV e.j.) të ndeshura në gërmimin tonë.

Nga trajtimi i këtyre rrënojave sipas horizonteve të banimit, teknikës dhe materialit të përdorur dallojmë dy periudha ndërtimi.

Periudha e parë (fundi i shek. III – shek. II p.e.s.). Kësaj periudhe i përket ndërtimi i rrugës dhe i shëtitores së II-të. Kjo e fundit me anë të hyrjes nga prapa lidhej nëpërmjet rrugës me shëtitoren e parë. Karakteristike për këtë periudhë është ngritja e muraturave me blloqe të vegjël dhe nivelim rrjeshtash me ashkla guri. Gjetjet arkeologjike si monedha të Apolonisë, qeramika me vernik të zi dhe me breza si dhe mjaft vula mbi tjegulla të ndeshura në shtresë kulturore të shek. III-II p.e.s.[43] ndihmojnë në datimin e kësaj periudhe, e cila përkon fare mirë me periudhën e dytë në shetitoren e I-rë.

Periudha e dytë (shek. I p.e.s. – shek. I e.s.) lidhet me ndërtimin e tregut dhe të godinës së madhe të cilat përfshijnë në konstruksionet mbajtëse të çatisë murin e pasmë pas daljes nga përdorimi të shëtitores. Por ndërsa ndërtimet në anën lindore u ndërprenë aty nga fundi i shek. I p.e.s. si pasojë e rënies së zjarrit, në krahun perëndimor ato vazhduan edhe përtej këtij caku. Rruga vazhdon të shfrytëzohet si dhe në periudhën e parë, por me të vetmin ndryshim që niveli i sipërfaqes kishte pësuar një farë ngritje dhe në boshtin gjatësor të saj është ndërtuar kanali. Tipike për këtë periudhë është përdorimi në muraturë i materialeve të ripërdorura (blloqe të skuadruar guri në disa raste të punuar me fashaturë), ndërsa për nivelimin e rreshtave vendin e çakëllit e zënë fragmentet e tjegullave. Në se shtresa kulturore e shek. II-I p.e.s. daton fillimet e kësaj periudhe[44], thesari me monedha apoloniate i çerekut të fundit të shek. I p.e.s. të ndeshur nën rrënojat e çatisë së tregut[45] dëshmon për ndërprerjen në anën lindore të këtyre ndërtimeve.

Datimi i sigurt i tregut shërben dhe si «terminus ante quem» për shetitoret e qytetit. Para së gjithash ai tregon se shetitorja e dytë duhet të jetë të paktën e shek. II-të p.e.s. ndërsa komunikimi me shëtitoren e I-rë, më saktë me fazën e rindërtuar të saj, e çon datimin e kësaj në fund të shek. III p.e.s. Si rrjedhojë ndërtimi i shëtitores së parë duhet kërkuar të paktën në mesin e këtij shekulli, ç'ka shërben dhe si mbështetje për datimin e shëtitores së II të Apolonisë në gjysmën e parë të shek. III p.e.s.

Shëtitorja e tretë. U zbulua në brezaren rrëzë faqes lindore të kreshtës (kuota 405) në pjesën e poshtme të qytetit[46]. Si shkak për fillimin e gërmimeve shërbeu një trakt muri, për të cilin Prashnikeri mendonte se ishte vazhdim i murit rrethues që veçonte akropolin nga pjesa tjetër e qytetit[47]. Parashikimi Prashnikerit nuk u vërtetua sepse në vend të murit rrethues që pritej dolën në dritë rrënojat e një shetitoreje me nimfe dhe të një baseni në pjesën e prapme të saj. Nga shetitorja ruheshin muri mbajtës, bazamentet e kolonave dhe një kanal për largimin e ujrave të çezmës jashtë ndërtesës. (Tab. V).

Terreni rrëzë kodrës, i kushtëzuar edhe nga prania e vendburimit ujor, ka qenë i përshtatëshëm për ndërtime të karakterit shoqëror. Përveç prerjes së lehtë të faqes lindore të kodrës për ndërtimin e murit mbajtës që formonte sfondin e pasmë arkitektonik të portikut, më pak mbushje dhe sheshime është sistemuar i gjithë trualli për zhvillimin e godinës. Si rrjedhojë pjesa e përparme e shetitores paraqet vazhdimin e brezares së gjërë dhe të sheshtë, prandaj dhe nuk ka dalë nevoja e ndërtimit të ndonjë stilobati.

43) Përveç vulës Ἡραιων, shfaqen në këtë kohë për herë të parë emrat Αθάνιων dhe Νεστωρ dhe mjaft vula më monograme të datuara në shek. III-II p.e.s.

44) Fragmente amforash italike të shoqëruara me monedha të Apolonisë dhe republikane romake formonin fizionominë e kësaj shtrese. Ndeshja në rrënojat e çatisë të tjegullave me vulë AMYNTAS dhe PAPMENOS të shek. III-II p.e.s. mund të merren si «terminus post quem» të ngritjes së tregut.

45) B. Dautaj, **Të dhëna numizmatike nga Dimale»**, punim dorëzuar për botim në Revistën «Iliria» 1/1984.

46) Gërmimet për zbulimin e kësaj shetitoreje u kryen nga arkeologu Dh. Budina dhe autori. Në planimetrinë e dhënë nga A. Baçe, N. Ceka. **Vep.cit,** fq. 34, fig. 62) rrënojat e kësaj shetitoreje gabimisht janë konfonduar me ato të shëtitores së dytë në zonën e akropolit.

47) C: Praschniker, **vep.cit,** po aty. Sipas autorit pjesa e poshtme e qytetit komunikonte me akropolin nëpërmjet një korridori të formuar nga dy mure paralelë që lidheshin me murin perimetral të kodrës.

DO NOT COPY



Fig. 17



Fig. 18

Muri i pasmë me gjatësi 29.25 m. kthehej në të dy krahët me ante duke lënë të hapur me kolonadë fasadën lindore të shetitores, përballë akropolit (fig. 17). I gjithë muri ngrihej mbi një taban të fortë gëlqeror ranor. Në muraturën e tij veçohen qartë dy periudha ndërtimi të ndryshme nga teknika dhe materialit të përdorur në këto konstruksione. Një pjesë e ballorit (rreth 11 m gjatësi) në krahun jugor të murit që mbyllte nga kjo anë shetitoren është ngritur me muraturë izodomike (fig. 18), blloqe gëlqerorë me faqe të rrafshta të vendosura në të thatë[48]. Muret ruheshin në lartësinë e tre rrjeshtave me gjerësi atë të një blloku (0.52 m). Skaji verior i ballorit me muraturë izodomike i është nënshtruar një meremetimi për tu lidhur me pjesën tjetër, shtesë të murit të pasmë. Kjo e fundit është ndërtuar me gurë të vegjël të rëndomtë, përfshirë në muraturë dhe ndonjë bllok të ripërdorur, të lidhur me llaç balte. Si rrjedhojë dhe gjërësia e ballorit në pjesën shtesë të murit të pasmë është më e madhe (rreth 1 m.). Megjithatë si pasojë e presionit të dherave të kodrës muri kishte lakuar në disa vende.

Në largësi 9.60 m nga skaji verior i shetitores, ballorit i mbështetet nga brënda një konstruksion i ndërtuar me të njëjtën teknikë dhe material të përdorur dhe në pjesën shtesë të murit të pasëm. Ky konstruksion me planimetri katërkëndëshe (3 x 0.60 m) dhe lartësi 0.30 m duket ka shërbyer si stol (sofat) për shlodhje.

Krahu verior i murit të pasmë të kthyer në ante në dallim nga ai i anës jugore, jo vetëm që është i plotë por skaji lindor i tij nëpërmjet një kthese paralele në ballorin vazhdon në gjatësi 2.85 m për tu lidhur me kolonat.

Nga kolonada ishte ruajtur vetëm rrjeshti i bazamenteve paralel dhe në largësi 4.20 m nga ballori i murit të pasmë, që përcakton dhe gjërësinë e shetitores. U zbuluan gjithsej 8 bazamente të përbërë nga plinte blloqe) ranorë të vendosur drejtëpërsëdrejti mbi taban. Largësia nga boshti në bosht midis plintave arrinte rreth 3 m, përjashtuar këtu dy bazamentat e fillimit në anën jugore të portikut me interkolumn më të vogël (2.20 m). Në vendin e bazamentit të tretë të anës jugore u ndesh një platformë (1.5 x 0.60 m) e shtruar me një rrjesht gurësh të vegjël, e cila mund të ketë shërbyer si bazament në vënd të plintit që mungon. Këtë e përforcon si largësia prej 2 interkolumne midis bazamentit të dytë dhe të katërtë të kësaj ane, ashtu dhe shtrirja e platformës rreth 0.25 m nën nivelin e sipërfaqes së plintave (Tab. V, prerja B–B).

Pranë dhe në largësi, 5.60 m nga skaji jugor i shëtitores doli në pah kanali për largimin e ujrave të çezmës. Kanali i ndërtuar me tulla të plota (0.38 x x 0.38 x 0.07 m) niste përbri ballorit të murit të pasmë dhe me drejtim përpendikular me këtë të fundit përshkonte së gjëri portikun deri në derdhjen e ujrave jashtë shetitores (fig. 19). Në prerje ai ka formën e një govate me gjërësi fundi 0.77 m dhe gryke 1.37 m. Dy rradhë tullash të ngjeshura mbi taban formonin shtrojen, ndërsa përbri tyre nga të dy krahët e tij ngriheshin paretet anësore me një rrjesht tullash të vendosura në mënyrë oblike.

48) Blloqet kanë këto përmasa: 0.55 x 0.38, 0.72 x 0.98 x 0.39 m.

DO NOT COPY

Mbi kanal ishte ndërtuar një pritë me një rrjesht gurësh të vegjël, ndërsa në mesin e saj ruhej një hapësirë për kalimin e ujrave, që në drejtim të kundërt të rrjedhjes vinte diçka më e gjërë (0.18 m). Është e qartë që kanali ka qenë ndërtuar në funksion të një çezme me dalje në murin ballor, por, si pasojë e dëmtimit të këtij të fundit nga çezma nuk ruheshin gjurmë të saj.

Zbulimi në pjesën e prapme të shëtitores e gjurmëve të një baseni[49], që komunikonte me çezmën, të bën të mendosh për ushqimin me ujë nga ndonjë vendburim rëzë shpatit lindor të kreshtës. Megjithatë sot nuk ndeshet as edhe një gjurmë të rrjedhjeve nga kodra, prandaj nuk përjashtohet mundësia e mbushjes së basenit dhe nëpërmjet rreshjeve nga strehët e çatisë.

Siç del edhe nga trajtimi i lëndës shëtitorja e tretë me përdorim dhe si nymfe ka kaluar nëpër dy periudha ndërtimi.

Periudha e parë (shek. III-fillimi i shek. II p.e.s). Ka të bëjë me fazën fillestare të ndërtimit të një nimfeu me portik me përmasa shumë më të reduktuara (11 x 4.20 m) nga gjendja e trashëguar pas gërmimeve. Prej nymfeut janë ruajtur krahu jugor i murit të pasmë të kthyer në ante me muraturë izodomike, kanali me tulla për largimin e ujrave të çezmës jashtë godinës dhe një trakt i muri nga baseni në pjesën e prapme të portikut. Si gjurmë të kolonadës fazës së parë mund të merren dy bazamentet e ruajtura në skajin jugor të portikut me interkolum 2.20 m[50]. Monumentaliteti i nimfeut duket është dhë në nëpërmjet trajtimit të fasadës ballore (kolonadë dhe antablementit) me konstruksion guri. Gjetja n sheshin para portikut të disa trungjeve dhe kapi tele kolonash dorike (fig. 21) flasin në të mirë të kë tij supozimi. Baseni lidhej me portikun nëpërmje një çezme të hapur në mesin e ballorit, perpendikulo me aksin gjatësor të kanalit me tulla.

Për datimin e këtyre konstruksioneve ndihmojn të dhënat statigrafike të përftuara në shtresë kultu rore të shek. III–II p.e.s.[51].

Periudha e dytë (gjysma e dytë e shek. II – shek I p.e.s.) Përfshin meremetimin e krahut jugor të nim feut dhe nëpërmjet shtesës së bërë në murin e pasme ndërtimin e një shëtitoreje me gjatësi gati sa trefi shi i portikut të parë (28.20 m). Gjatë projektimit du ket është patur parasysh të ruheshin traditat e pla nizimit si në plan volumor dhe në atë ndërtimor. S rrjedhojë shëtitorja me çezmë ka ruajtur po atë gjë rësi dhe lartësi të nimfeut në fazën e parë të ndër timit, një katsh, i mbuluar dhe me një rrugë kalimi Mbyllja e këtij portiku në të dy skajet e fasadës krye



Fig. 19



Fig. 20

49) Nga baseni u arrit të zbulohej vetëm rreshti i sipërm i një muri paralel dhe në largësi 2.5 m nga pjesa e prapme e ballorit. Ky konstruksion me gjatësi 5.60 m është ngritur me blloqe ranor të punuar vetëm nga faqja e brendshme e tyre.

50) Duke gjykuar nga përmasat e nimfeut dhe interkolumni prej 2.20 m, mund të mendohet për një portik me katër kollona ballore.

51) Qeramika me vernik të zi mat dhe monedha të Dyrrahut (Irakli-armë dhe Zeus-trikëmbësh), të Apolonisë (Apolon-obelisk, Artemis-trikëmbësh dhe lyrë-obelisk) formojnë përmbajtjen e kësaj shtrese.

DO NOT COPY

sore me mure paralel me ballorin në gjatësi 2.60 m për të vazhduar me kolonadën është një element i ri funksional që nuk ndeshet në shetitoret e tjera të Dimales. Krijimi i këtyre qosheve të qeta mund të shpjegohet me nevojën e mbrojtjes nga erërat e ftohta kontinentale dhe të korenteve të ajrit që në këtë pjesë të qytetit sigurisht kanë qënë më të ndjishme. Një element tjetër funksional që lidhet me periudhën e dytë të ndërtimit është dhe platforma për mbledhje dhe soditje, e cila, me sa dimë, nuk ndeshet në asnjë nga shëtitoret antike të zbuluara në vendin tonë.

Shëtitorja me çezmë për nga interkolumni prej 3 m, trajtimit të kolonadës me konstruksion druri dhe materialit të përdorur në bazamentet e kolonave i afrohet shëtitores së dytë dhe ka ngjashmëri të plotë me kolonadën e tregut të datuara në shek. II-I p.e.s. Të kësaj kohe janë dhe disa profile amforash me vulë të ndeshura në të dy anët e kanalit, monedha të Apolonisë dhe fragmente tjegullash me vulë Αμυντας dhe me monogram. Me qënë se shëtitorja e dytë dhe tregu janë të datuara mirë nga thesari me denarë apoloniatë, kuptohet që për nimfeun e periudhës së parë duhet kërkuar një kohë më e herëshme të paktën gjysma e dytë të shek. III p.e.s por gjithmonë me përparësi kronologjike shëtitoren e I-rë.

Krahas gërmimeve arkeologjike, nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, u ndërmorën dhe punime përforcuese dhe restauruese në konstruksionet mbajtëse të shëtitoreve të Dimales[52]. Kështu në vitin 1969 u kryen përforcime në murin e pasmë të shëtitores I-rë të dëmtuar nga presioni i dherave si dhe u bënë përpjekje për ringritjen e rrjeshtave të sipërmë me blloqet e rrëshqitur të nikeve (fig. 22). Punime përforcuese u kryen edhe në vitin 1981 në shëtitoren e II-të duke mënjanuar rrezikun për shpërbërjen e muraturave të dobta nga veprimi i agjentëve atmosferikë.

* * *

Zbulimi i shëtitoreve në Dimale dhe qytete të tjera të Ilirisë së Jugut janë një dëshmi tjetër e fuqizimit të këtyre qendrave në kushtet e një shoqërie ilire të zhvilluar skllavropronare në shek. IV-III p.e.s. Shëtitoret, krahas ndërtimeve të tjera të karakterit shoqëror, zinin një vend të rëndësishëm në urbanizimin e qyteteve antike. Si qendra të një veprimtarie të gjërë shoqërore këto godina me përmasa relativisht të mëdha ndërtoheshin në vende të përshtatëshme dhe të mbrojtura. Grumbullimi i njerëzve në këto ambiente plot ajër dhe dritë gjallëronte jetën ekonomike, politike dhe kulturore të qyteteve.

Shëtitorja e I-rë dhe nimfeu i përkasin periudhës së lulëzimit të Dimales dhe organizimit politik të saj sipas shembullit të Apolonisë dhe qyteteve të tjera ilire.[53].

Për këtë dëshmojnë dhe vulat mbi tjegulla, prodhime të punishteve shtetërore, të sigluara me emrin dhe ofiqin e nëpunësit më të lartë dhe eponin të shoqëruar herë me legjendën e qytetit (Δυμάλλας), dhe herë me atë të bashkësisë dimalase (Δυμαλλίταν), me të cilat janë mbuluar çatitë e këtyre godinave.

Ndryshimi i kushteve në Iliri, veçanërisht pas pushtimit romak, pati pasoja të rënda për qytetin ilir, ç'ka shënoi dhe fillimet e rënies së tij. Ndërtimet



Fig. 21

52) Punimet në shetitoren e parë u kryen nga restauratori K. Zheku, ndërsa në shetitoren e dytë nga arkeologu restaurator Ll. Papajani.

53) Mbi organizimin politik dhe administrativ të Apolonisë e disa qyteteve të tjera ilire shih S. Anamali **Të dhënat mbishkrimore në disa qytete të Ilirisë së Jugut**, Iliria VI, 1976 fq. 125-130 dhe A. Mano-B. Dautaj, **«Një mbishkrim në Olympe»** përgatitur për shtyp në revistën «Iliria». Për organizimin shtetëror të Dimales me prytan në krye, dëshmohet nga një mbishkrim të gjetur kohët e fundit në rrënojat antike të Dimales dhe që sot ruhet në Muzeun Historik të qytetit të Beratit.

BOOK COPY



Fig. 22

shoqërore përbëjnë atë fushë ku reflektohen më shumë se kudo pasojat e kësaj krize, sidomos për qytetin e Dimales, i cili qysh nga çereku i fundit i shek. III p.e.s. u përfshi në ngjarjet politike më në zë të kohës[54]. Rindërtimi i shëtitores I-rë me përmasa të reduktuara dhe ndërtimi i shëtitores së II-të dhe të III-të mund të meren si pasqyrim i atyre kushteve ekonomike shoqërore që jeton Dimale dhe në përgjithësi qyteti ilir në shek. II-I p.e.s. Këtë tregon futja në ndërtimet shoqërore të konstruksioneve mbajtëse me muratura të dobëta e lidhje balte si dhe trajtimi i fasadave ballore me kolonadë ose antablement druri, ç'ka nuk i përshtatej karakterit monumental të shëtitoreve. Ato shënojnë në përgjithësi një rënie të vlerave arkitektonike dhe një thjeshtim në trajtimin planimetrik dhe volumor të këtyre ndërtimeve. Megjithatë projektuesit e ndërtuesit dimalas, me këto ndërtime të thjeshta dhe praktike kanë ditur të zgjidhin drejt kërkesat e shijet e qytetarëve me mundësitë dhe kushtet konkrete të vendit. Kështu ndërtimi i një ansambli të ri në akropol duket ka të bëjë me shfrytëzimin e këtij të fundit dhe si qendër banimi e përforcuar nga ngritja e tregut. Po me krijimin e këtyre qendrave të reja ka të bëjë dhe ndërtimi i shëtitores së tretë.

Siç del dhe nga studimi i këtyre shëtitoreve Dimale paraqitet me një jetë të zhvilluar qytetare në atë shkallë dhe me atë shije si dhe në qendrat e tjera ilire.

54) Këtu kemi parasysh marrëveshjen e vitit 215 midis Filipit të V-të maqedonas dhe Hanibalit Kartagas (Polibi VII, 9,13) si dhe Paqen e Foinikes e vitit 205 midis Romës e Maqedonisë (Livi XXIX, 12,3;13).

DO NOT COPY

TAB I

DO NOT COPY



DO NOT COPY





TAB III



DO NOT COPY

DO NOT COPY


41
30
1.5
7
4
2
6
50
27
A
6
12.5
6
10
10
19 KANELYRA
0 10 20 30 cm
8.5
8.6
B
50
35
62
53
55
52
20
40
43
55
95
12
30
55
40
0 20 40 60 cm

TAB V

DO NOT COPY



Burhan DAUTAJ

LES STOAS DE DIMALE

RESUME

La ville illyrienne de Dimale, identifiée par les ruines antiques de la forteresse de Krotine dans la région de Berat, a été après Apollonie, le plus grand centre économique et administratif de la zone s'étendant au sud d'Aps, jusqu'à Koinan des Bylin. Dimale et les habitations fortifiées tout autour, constituaient une seule unité se situant derrière Apollonia, près de la tribu illyrienne des parthins. C'est ce qui explique sa mention avec celle d'Apollonia et des parthins, par les auteurs antiques.

La colline de la forteresse de Krotine, sur laquelle s'étendait la ville de Dimale, est formée de deux crêtes entourées d'enceintes (fig. 1). Sur la plus haute crête se trouvait l'acropole séparé de la partie inférieure de la ville par un mur intérieur. La ville, dans l'enceinte, avait une superficie de 18 ha.

Pour la première fois la forteresse de Krotine est mentionnée par l'archéologue autrichien C. Praschniker, mais les recherches et l'étude des ruines de la ville ont commencé seulement après la libération du pays. Parmi les monuments découverts pendant les fouilles archéologiques. les stoas de la ville tiennent une place importante.

La première stoa a été découverte au pied du versant sud de l'acropole. On en a conservé le mur arrière à sept niches, les fondations, qui tenaient le stylobate de la colonnade extérieure, ainsi que les traces de l'entrée de l'acropole au côté Est de la stoa (tab. I). Du mur de soutènement avec niches, il reste seulement le fronton d'une longueur de 29,40 m qui était en même temps un élément décoratif à l'intérieur de la stoa (fig. 2). Les niches se présentent gravement endommagées surtout dans leurs rangées supérieures (fig. 3). La forme demi-circulaire des niches est réalisée par le creusement de la face extérieure des blocs de conglomérats surtout verticalement, ce qui fait preuve d'une tendence vers la fermeture en forme absidale des niches (tab. II). Les niches sont liées par des frontons qui jouent le rôle des contreforts. L'intérieur des niches est couvert de dalles tandis que la piste est pavée de pierres. Les coins terminaux du mur arrière sont découpés par des constructions ultérieures simultanées aux aménagements effectués dans les niches avec des blocs sableux.

Tout près du coin Est du mur à niche, un mur d'echiffre de l'escalier de l'entrée, suit l'axe longuitudinal de la stoa (fig. 6). Le déblayage pavé de pierre entre les deux parois du mur (fig. 7), servait de palier à l'escalier qui grimpait l versant de l'acropole menant à la terrace au dessus de la stoa

Les fouilles au côté sud ont mis à jour un fragment du mu de soutènement du stylobate de la colonnade extérieure, leque se situait à 10 m des frontons des niches, ce qui précisait l largeur de la stoa.

Près de l'entrée, dont le fronton fait saillie de 0,95 m d paroi extérieur du mur d'échiffre, on a construit un mur de revê tement (fig. 9), qui suit la direction Est, au pied du versant Su de l'acropole. Ce mur formé de deux parois déblayés entre eu se conserve à la hauteur du soubassement. Le coin Ouest de c mur a été altéré par une construction ultérieure (fig. 10) qui effacé les traces des constructions de la place devant l'entré Au nord, la construction quadrangulaire s'appuie au mur d'échi fre. L'entrée de la construction qui se trouvait sur la façad Ouest, donnait accès à la place devant les niches.

Lors de son utilisation, la première stoa a été soumise deux périodes de construction. De la première période (fin d IVe-IIIe siècle av.n.è), on a conservé le mur à niches, les fond tions du stylobate de la colonnade extérieure ainsi que les tr ces de l'entrée à l'acropole. C'est à cette période que remon la construction du mur intérieur qui entoure la crête au sud d l'acropole. Le grand nombre de tuiles et de restes du to trouvés, dont quelques-uns portent le ceau du nom d Dimale (Δμαλλίτων) et le nom de Ηραίων date du IIIe-IIe siècles av.n.è. peuvent servir de «terminus ante quen pour la construction de la première stoa.

Le grave endommagement de la stoa qui se fait rema quer par les aménagements du mur à niche ne doit pas êt cherché tant dans les catastrophes naturelles, que dans l événements politiques (les guerres illyro-romanes) qui ont ébra lé l'Illyrie et Dimal à la fin du IIIe sc. av. n. e.

Pendant la deuxième période (IIe-Ier sc. av.n.è.) la stoa subi des modifications à cause des nouvelles constructions (construction quadrangulaire) qui ont beaucoup restreint sa étendue vers le sud.

Bien que les fouilles nous donnent peu de matériel, l'étud de la première stoa pose un problème intéressant, celui de s reconstruction. L'utilisation de la terre devant les niches à de fins agricoles a causé la perte des éléments architectonique La stoa de la première période, d'une longueur de 40 m

DO NOT COPY

d'une largeur de 11,5 m indique qu'il y a eu deux rangées de colonnes. On pense que la distance entre les rangées des colonnes et la rangée intérieure et les frontons des niches a été de 5,5 m et de 4,5 m, assez large pour deux passages. Les colonnes étaient réparties d'une telle manière qu'lis ne nuisaient pas au soutient du toit. A chaque fronton et à chaque milieu de niche correspondaient une colonne intérieure et une autre extériere, comme dans la deuxième stoa d'Apollonie, à laquelle ressemble celle de Dimale. Cette répartition de colonnes crée un entre-colonnement d'une largeur de 2,10-2,15 m, égal pour les deux rangées de colonnes.

Les efforts effectués autrefois pour une solution de planimétrie de cette stoa et sa comparaison avec la première d'Apollonie, n'aboutissent à rien puisqu'on n'a pas vu ses deux éléments principaux, le mur de soutènement du stylobate et l'entrée de l'acropole. De même, l'idée que le traitement de l'espace des niches est pareil à celui de la première stoa d'Apollonie n'est pas convaincant. En fait le traitement du mur arrière de la stoa de Dimale avec ses formes courbées et ses niches attachées par des frontons, s'en tient rigoureusement au rangement et, en général, à la solution planimétrique de la deuxième stoa d'Apollonie. Même du point de vue du traitement stylistique, de la technique, du matériel et des dimensions les niches de la stoa de Dimale diffèrent de celles de la première stoa et ressemblent beaucoup aux niches de la deuxième stoa d'Apollonie. La forme absidale des niches de Dimale, conservée jusqu'au quatrième rang tend à se fermer au-dessus d'elles ce qui correspond à une hauteur de colonne de 4,20-4,30 m considérable pour un entre-colonnement de 2,10-2,15 m, comme dans la deuxième stoa d'Apollonie. Quand même, le traitement en forme absidale des niches surmontées de fausse-voûtes nous amène à une solution différente de celle de la deuxième stoa d'Apollonie. L'idée d'une stoa à deux étages, motivées par la hauteur du terrain dans sa partie arrière conviendrait mieux à la couverture de l'entrée.

La deuxième stoa. Elle a été découverte dans la partie nord-ouest de l'acropole, près du paroi intérieur de l'enceinte de la colline. A l'heure actuelle, on en conserve le mur de soutènement et le stylobate de la colonnade (fig. 11). Se situant près de l'enceinte, une large entrée de la stoa donnait accès à une route qui divisait le mur, arrière en antes, en deux ailes égales, (fig. 14).

Du mur arrière, construit en ligne droite, on a découvert son côté Est (fig. 12) d'une longueur de 24 m et d'une hauteur de 1,85 m. De l'autre côté, le mur a été découvert à une longueur de 23 m ne touchant pas son coin ouest. Tout le côté ouest du mur arrière a été reconstruit et utilisé comme soubassement des habitations ultérieures. Une rangée de stylobates, composée de 12 blocs, les traces de la colonnade, (fig. 13) se trouvait à une distance de 8 m parallèle au mur arrière, ce qui définie aussi la largeur de la stoa. L'autre partie du stylobate, à l'Ouest de la stoa, a disparu avec les constructions ultérieures. Les faibles contours circulaires sur les stylobates, sans traces de liaison métallique avec les colonnes et l'entre-colonnement de 3 m, témoignent d'un entablement à construction en bois. On pense que la deuxième stoa, d'une longueur de 51 m et d'une largeur de 8 m, a été couverte, à deux étages et à une seule piste. Située en face et tout près de l'enceinte, une stoa à un étage effacerait la vue du paysage, tandis que l'élévation du terrain à son dos serait inconvenable à une basse couverture.

La mise à jour d'une deuxième rangée de stylobates, à l'Est du mur arrière, n'a rien à faire avec la stoa, mais à un portique en fonction d'un marché à plusieurs ateliers. (fig. 15). La découverte d'un trésor de monnaies d'Apollonie, du dernier quart du Ier sc. av.n.e. au-dessous des restes des troits de ces ateliers, témoigne de la construction de la deuxième stoa, au IIe sc. av. n. e., ce qui correspond à la deuxième période de la première stoa. La première phase doit être cherchée au moins au milieu du IIIe sc. av. n.e. Puisque la première stoa de Dimale ressemble à la deuxième stoa d'Apollonie, nous devons accepter sans hésiter que cette dernière date de la première moitié du IIIe sc. av. n. e.

La troisième stoa a été découverte au pied du versant Est de la crête, dans la partie inférieure de la ville. La découverte d'un fragment de mur isodémique, lequel d'après Prachniker était la suite de l'enceinte, qui en forme de corridor, liait l'acropole à la partie inférieure de la ville, a servi d'indice à entreprendre des fouilles. Les hypothèses de Prachniker étaient erronées parce que, au lieu de l'enceinte on a découvert le côté Sud d'une stoa à nymphes.

De cette stoa on a conservé le mur de soutènement en ligne droite, une rangée de stylobates, un canal pavé de briques ainsi, que les traces d'un bassin à la partie arrière du portique (tab. IV). Le mur de soutènement se tournait des deux côtés en antes laissant ouverte et à colonnade la façade Est de la stoa, en face de l'acropole (fig. 17). Dans sa maçonnerie on distingue bien deux périodes de constructions, qui diffèrent par leur technique et les matériaux utilisés. Le côté sud de la stoa (fig. 18) est élevé en maçonnerie isodémique, ce qui le distingue de toute l'autre partie du mur, construite avec de petits cailloux liés en mortier de pisé. Le côté nord du mur arrière tourné en antes qui au moyen d'un détour parallèle au fronton continue sur une longueur de 2,85 m afin de toucher la colonnade, se conserve entièrement. De la colonnade en conserve huit stylobates rangés à une distance de 4,20 m parallèlement au mur, ce qui définit aussi la largeur de la stoa. Au côté sud de la stoa, a été construit un canal pavé de briques (fig. 20) en fonction d'une fontaine du fronton du mur arrière, de laquelle on ne conserve aucune trace.

La troisième stoa a été construite pendant deux périodes. A la première période appartiennent la construction du nymphée à portique aux dimension (11x4,20 m) plus petites que la stoa. En en a conservé le côté sud à maçonnerie isodémique et le canal pavé de briques pour éloigner en dehors de la construction les eaux de la fontaine. La monumentalité du

DO NOT COPY

nymphée nous est donnée par le traitement du portique construit en pierre. Les différents fragments d'architecture trouvés sur la place devant les stylobates, renforcent cette idée (fig. 21). Le long de la deuxième période (IIe-Ier sc. av.n.e.) on a entamé la réparation du côté sud du nymphée et par l'adjonction au mur arrière on a construit la stoa d'une longueur de 28, 20 m. La stoa à un étage couverte a conservé la largeur et la hauteur du nymphée de la première phase de construction. La fermeture de la stoa aux coins frontaux par des murs suivis de la colonnade a eu pour but la construction de coins tranquilles, protégés des vents froids et des courants d'air très sentis dans cette partie de la ville. Un autre élément fonctionnel c'est la plate-forme qui s'appuie au paroi intérieur du fronton du mur arrière, où l'on se repose et l'on admire le paysage (fig. 19). La troisième stoa, par son entre-colonnement de 3 m et le traitement de la façade frontale à construction de bois, ressemble, à la deuxième stoa, daté au IIe sc. av. n. e. Quant à la construction du nymphée il faut remonter au IIIe sc. av. n. e. (avec un avantage chronologique de la première stoa).

*
* *

La découverte de la stoa de Dimale et des autres villes de l'Illyrie du sud est un témoignage matériel de l'épanouissement et de l'affermissement de ces centres dans les conditions d'une société de servage illyrienne développée, au cours du IVe-IIIe sc. av. n. e. Il est certain que la première stoa et le nymphé appartiennent à la période de l'épanouissement et de l'organisation politique et administrative de Dimale, selon l'exemple d'Apollonie, de Bylis et des autres villes illyriennes. Cela est témoigné par des dizaines de tuiles scellées comme des produits des ateliers d'Etat, signés par l'office et le nom des hauts employés et des éponymes de la ville accompagné, quelquefois par le nom de la ville, quelquefois par le nom de la mairie de Dimale. La ressemblance entre la première stoa de Dimale et la deuxième stoa d'Apollonie montre que la conception et le projet de la première ont été faits par des architectes de l'école d'Apollonie, qui ont su créer un type bien cristallisé, conservant les traditions architectoniques enrichies par de nouveaux éléments fonctionnels. D'après le matériau archéologique découvert à Dimale, à part le domaine de construction, entre ces deux villes il y a eu aussi d'autres relations.

Avec la nouvelle situation en Illyrie, surtout après l'occupation romaine, la ville est sur son déclin. Les constructions sociales sont le domaine où se reflètent mieux qu'ailleurs les conséquences de cette crise, surtout à Dimale qui depuis le IIIe sc. av. n. e., s'inclue dans les événements politiques de l'époque. La reconstruction de la première stoa avec des dimensions diminuées et la construction des deux autres stoas, sont le reflet des conditions économiques et sociales de Dimale et de la ville illyrienne, au cours du IIe sc. av. n. e. Cela se voit par l'emploi des faibles constructions de soutènement de maçonnerie et par le traitement des façades frontales de la stoa en construction de bois, ce qui ne convenait pas au caractère monumental de ces constructions. Ils marquent en général un abaissement des valeurs architectoniques et une simplification de leur traitement planimétrique et volumétrique. Malgré, cela, les constructeurs de Dimale, par ces constructions simples mais pratiques, et riches en éléments fonctionnels ont su satisfaire les besoins et les goûts des citadins dans les conditions concrètes du pays.

DO NOT COPY

Nr. 2 1984

monumentet

Latif LAZIMI

DO NOT COPY

PËRKUJTIMORJA E SKËNDERBEUT*)

Marin Barleti humanisti shqiptar i shek. XV na bën të ditur, se heroi ynë kombëtar, Skënderbeu, u varros në katedralen e Shën Kollit të Lezhës. Prej tij mësojmë gjithashtu, se në vitin 1478, mbasi turqit pushtuan Lezhën grabitën varrin, duke marrë eshtrat për t'i përdorur si hajmali dhe dogjën katedralen[1]. Për një kohë të gjatë kjo mbeti si legjendë, por gjurmimet shkencore dhe gërmimet arkeologjike dëshmuan, që varrimi i heroit është bërë pikërisht në këtë katedrale[2]. (fig. 1).



Fig. 1

Nga të dhënat historike, mësojmë se kisha e parë e Shën Kollit, ku u mblodh dhe kuvendi i Lezhës, u rënua nga fundi i viteve 40 të shek. XV. Nga gërmimet arkeologjike të mëparshëm dhe ato të kryera vitet e fundit dolën në pah gjurmët e mureve dhe të absidës të kishës së rënuar (Tab. I, 1). Në vitin 1459 ajo rindërtohet që nga themelet me përmasa më të mëdha duke përfshirë rrënojat e kishës më të hershme dhe në vitin 1468 në të varroset Heroi ynë Kombëtar Skënderbeu. Monumenti pësoi dëmtime nga dy djegje, në vitet 1478 dhe 1506. Në vitet 80 të shek. XV katedralja u shndrrua në xhami, sikurse e dëshmojnë qartë shtesat dhe adaptimet murale, dhe u quajt xhamia Selime. Ajo u braktis

*) Rilevimet të autorit, B. Penxhës, A. Qyshkës, S. Terezit. Vizatimet nga autori dhe A. Qyshka. Fotot të autorit dhe N. Kasapit. Punimet e restaurimit janë kryer nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës së Tiranës gjatë viteve 1978-1981 nën drejtimin e autorit K. Zhekut dhe Th. Karanxhës. Projekti konstruktiv i ndërtimit të ri dhe i përforcimeve të kryera në pjesë të ndryshme të monumentit është bërë nga Inxh. R. Poloska. Projekti i mbulesës nga N. Lako dhe V. Pistoli. Realizimi i ndërtimit të ri u krye nga N.N. Lezhë nën drejtimin e autorit dhe Ark. M. Pepës. Projekti i ndriçimit është realizuar nga Inxh. Kiço Joti. Falenderojmë skulptorin e Popullit Odhise Paskalin, për sygjerimet dhe mendimet e dhëna për ngritjen e kësaj vepre.

1) M. Barleti, **Historia e Skënderbeut** f. 490 Tiranë 1964.

2) F. Prendi, **Vendvarrimi i Skënderbeut** Konferenca e dytë e studimeve Albanologjike, Vëll. I fq. 248, Tiranë 1969. Ku jepen identifikimi i kishës, të dhënat e kërkimeve arkeologjike në monument dhe bibliografia për të.

DO NOT COPY



Fig. 2

rreth viteve 20 të shek. XVII dhe u rindërtua sërishmi në fund të shek. XVIII duke ruajtur të njëjtin funksion (Fig. 2)[3]. Këto faza ndërtimesh dhe rindërtimesh ishin pasqyruar qartë në muret dhe shtresat e dyshemesë së saj. Prej tyre padyshim, faza më e rëndësishme historike është, ajo e v. 1459 (Tab. I, 2), ndërsa shtesat, të cilat nuk lidhen me ngjarje të rëndësishme nuk kanë rëndësi historike, as dhe arkitektonike. Heqja e këtyre shtesave të çon në gjendjen mbas djegjes, që ju bë nga turqit katedrales së Shën Kollit, vendvarrimit të Skënderbeut dhe Selisë ku u mblodh kuvendi i Lezhës (Tab. II).

Duke u nisur nga synimi për ruajtjen e monumentit në fazën më kryesore me vlera të veçanta historike që lidhet me heroin kombëtar, projekti i përkujtimores të Skënderbeut k shte si ide qendrore, përkujdesjen, vënien në pë dhe vlerësimin e vlerave historike, të realizuara n anë të një ndërtimi të ri, të trajtuar me një kollo nadë rreth e rrotull, brenda të cilit do të ruhesh pjesët origjinale të monumentit të shek. XV.[4] Nëpë mjet kësaj zgjidhje largoheshin shtesat e vona, që binin ndeshas, vlerave të vërteta të monumentit dh që nuk e justifikon aspak veten ndaj momentit kry sor historik. Nga ana tjetër rrethimi dhe mbulimi i sa marrja nën mbrojtje nga një ndërtim i ri me arkitek turë monumentale të përkujdesur, por të thjeshtë, tr gon pikërisht vlerësimin dhe respektin e veprës s Skënderbeut nga epoka e jonë. (Fig. 3).

Realizimi i saj përfshinte në vetvehte dy proçes të rëndësishme, atë të restaurimit të monumentit dh të ngritjes së ndërtimit të ri mbrojtës dhe vlerësues.

Qëllimi i punimeve restauruese ishte nxjerrja n pah e gjurmëve origjinale të monumentit të shek. XV Fillimisht u bënë sondazhe në pjesë të ndryshme t dyshemesë së kishës dhe jashtë saj, në afërsi të mu raturës dhe pastaj u krye zhveshja e mureve të monu mentit të transformuar, nga suvatimet e reja. Punime e pastrimit dhe gërmimet nxorrën në dritë planime



Fig. 3

3) **Po aty**, fq. 245.

4) Përpara kësaj ideje ka patur mendime dhe është punuar për një zgjidhje tjetër, e cila mbështetej në një rikonstruksion hipotetik të kishës, për ta kthyer në gjëndjen fillestare. Mbas një diskutimi të gjerë kjo zgjidhje nuk gjeti miratim, sepse rikonstruksioni që do t'i bëhej katedrales ishte jo vetëm i padokumentuar historikisht, por përbën një praktikë që nuk rekomandohet në restaurimet tona.



Fig. 4



Fig. 5

trinë e cila ishte ruajtur e pandryshuar, përjashtuar cepin jugëperëndimor, ku ishte ndërtuar minarja (Tab. I, 1). Në qendër të kishës në thellësi 2.80 m u zbulua një bazament guri me dimensione 2.85 x 1.95 m me dy shkallëzime të ruajtura (Fig. 4). Zhveshja e mureve nga suvatimet nxori dritaret origjinale të murit jugor të mbuluara me hark të mprehtë. Në faqen kryesore të monumentit dolën porta, kamarja gjysëm rrethore mbi të dhe një pjesë e rivendosur e rozetës rrethore (Tab. III).

Duke u nisur nga gjurmët e mësipërme kuptohet se kemi të bëjmë me një kishë një nefshe me absidë rrethore. Krahas rezultateve të gërmimit arkeologjik, që tregojnë ndërtimin e saj në shek. XV ky datim dëshmohet dhe nga stili romanik, i cili gjeti përhapjen më të madhe në zonat e Shqipërisë veriperëndimore. Monumenti i mësipërm, siç e theksuam edhe më lart, gjatë shekujve të pushtimit osman, ju nënshtrua një sërë transformimeve, të cilat e përshtatën kishën në xhami. Ndër këto hynë ndërtimi i minares, hapja e dritareve dhe dyerve të reja të mbuluara me hark gjysëm rrethor, ndërtimi i mihrabit në pjesën e fundme të faqes jugore (Fig. 5, 6). Njëkohësisht kanë humbur një sërë elementesh volumor dhe të interierit të kishës; siç janë frontonet, mbulesa e absidës, çatia e parë dyujse pjesërisht rozeta e faqe ballore etj. (Tab. IV, 2). Duke analizuar në kompleksitet të gjitha të dhënat historike, të gërmimeve arkeologjike, të sondazheve, të zhveshjeve dhe të elementeve që ruhen në monument, mendojmë se ai ka kaluar nëpër tre faza kryesore transformimi. Fazës së parë i përkasin rrënojat e mureve në brendësi të katedrales dhe një fragmenti të ruajtur të absidës, së bashku me pjesën e muraturës që përmban një pjesë afresku (Tab. I, Tab. IV, 1). Nga studimi paraprak rezulton që ky është pikturuar në teknollogji dhe teknikë bizantine me fry-



Fig. 6

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

më romanike[5]. Faza e dytë është katedralja e rindërtuar në shek. XV, nga e cila ruhen muret perimetrale dhe elementet e pamjeve (Tab. IV, 2, Tab. II). Në fazën e tretë kemi shndrimin e katedrales dy herë radhazi në xhami, me elementet e saj karakteristikë si dritaret, minarja dyert, mihrabin etj. (Tab. I, Tab. IV).

Si pasojë monumenti arriti në ditët tona i shndrruar nga gjendja e tij fillestare. Por një sërë elementesh arkitektonikë të ruajtur pjesërisht ose tërësisht na lejojnë që ta kthejmë me vërtetësi në gjendjen mbas djegies që ju bë katedrales.

Gjatë restaurimit kisha u çlirua nga shtesat dhe adaptimet e ndryshme me elementë të arkitekturës islamike dhe u plotësua një pjesë me elementet e saj fillestare të cilët ruheshin pjesërisht ose tërësisht.

Muret perimetrale u restauruan, duke hequr çdo shtesë të re që i ishte bërë katedrales mbas djegies, gjë që lexohej qartë në teknikën e muraturës. Pjesa që mbeti e kishës paraqitej në gjendje të dëmtuar, prandaj u kryen në pjesë të veçanta ndërhyrje konstruktive. Faqja jugore rrezikohej nga gërmimet e bëra në thellësi, më poshtë se fundi i themelit të saj, gjatë zbulimit të bazamentit antik prej guri, prandaj në pjesën e brendshme të saj u ndërtua një mur butobetoni

5) Studimi paraprak dhe konsolidimi i fragmentit të afreskut është kryer nga E. Sopi në vitin 1981. Materiali ndodhet në Arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës.



Fig. 9



Fig. 10

që ju bashkëngjit faqes së brendshme të muraturës, që shkonte më poshtë se thellësia e gërmimit (Tab. V, 1, 2).

Heqja e minares krijoi probleme të vështira konstruktive edhe për faktin se i gjithë muri perëndimor i kishës ishte çvendosur 30 cm nga vertikaliteti. Si shkak për këtë mund të ketë shërbyer prishja e qoshes së djathtë të kishës, për të ndërtuar minaren dhe ulja e themelit nga lëkundjet e herëpasherëshme të tërmeteve që kanë prekur shpesh Lezhën. Me ndërhyrjen që ju bë, kjo faqe u ruajt si e tillë me gjithë çvendosjen e madhe që kishte pësuar (Fig. 7). Fillimisht u krye pajantimi nga ana e drejtimit të çvendosjes së murit dhe u përforcuan themelet me muraturë buto betoni (Tab. V, 1, 3, 4).

Në qoshen e majtë të kësaj faqeje, në të cilën kishte plasaritje në të gjithë lartësinë u bënë qepje të maskuara në thellësi të muraturës me brez beton-arme të derdhur në vend në formë të shkronjës L, sipas konfiguracionit të qoshes së murit (Tab. VI, 1, 2) (Fig. 8). Pastaj u kalua në prishjen e minares dhe plotësimin me muraturë të këtij boshlleku (Fig. 9, 10). Brëndësia e muraturës së re që u ndërtua, u bë prej strukturash beton-armeje. Në të dy skajet e lidhjes së muraturës egzistuese me të renë u ndërtuan kollona beton-armeje, ku u vendosën fitila hekuri që futen në brendësi të dy muraturave. Kollonat u lidhën me breza beton-arme (Tab. VI, 1, 3).

Në pjesën e prapme të katedrales gjatë punimeve të ndërtimit u zbulua një rrugë e antikitetit të vonë, me drejtim veri-jug, e cila kalonte poshtë themeleve të absidës. Për nxjerrjen në pah dhe vlerësimin e saj, muri perimetral i një pjese të absidës mbështetet mbi një konsol beton-armeje i cili u realizua me trarë të parapërgatitur. Ata u mbështetën nga njëra anë mbi dy mure betoni që u ndërtuan në brendësi të hapsirës së absidës pa cënuar strukturën e muraturës së monumentit dhe shërbenin si kontrapeshë e pjesës së absidës të dalur konsol, ndërsa skaji tjetër u fut nën murin e absidës (Tab. VII, 1, 2).

Çveshja e muraturës nga suvatimet e reja, të bëra në kohë të ndryshme gjatë ndryshimit të funksioneve të katedrales, nxorri në dukje teknikën e çregullt të ndërtimit të mureve të saj. U ruajtën vetëm pjesët e suvatuara të mbetura mbas djegjes së kishës, kjo sidomos në faqen e hyrjes kryesore, ku ato duken qartë. Pjesët e reja të muraturës me të cilat u plotësuan boshllëqet e dritareve ose dyerve të xhamisë u trajtuan me po atë teknikë të çrregullt në mënyrë që me një vështrim të përgjithshëm të mos krijohej një copëtim i volumit të kishës, ndërsa po të shihet me vëmëndje nga afër të dallohet muratura e re (Fig. 11).

DO NOT COPY

Elementet arkitektonikë të kishës të ruajtura tërësisht ose pjesërisht u restauruan duke e kryer konsolidimin, pastrimin dhe plotësimin e tyre pa cënuar strukturën dhe pozicionin fillestar. Korniza prej guri e derës kryesore vende-vende e thyer, u pastrua nga bojrat dhe u ngjit me ngjitës guri (Fig. 12). Fragmenti i rozetës, element dekorativ i pamjes kryesore, u hoq, u pastrua, u përforcua dhe u rivendos, po në atë pozicion (Fig. 13).

Plasaritjet në pjesën e kamares sipër derës kryesore u injektuan në brendësi me llaç çimentoje. Dritaret e anës jugore të mbyllura sipër me hark të mprehtë u plotësuan në ato vende që ishin dëmtuar dhe u ruajtën në nivelin e konfiguracionit të gjurmëve që u zbuluan (Fig. 14). Nga gjurmët e rëndësishme të katedrales së fazës së parë u konsoliduan dhe u evidentuan, fragmenti i absidës, së bashku me pjesën e muraturës ku ndodhet afresku (Fig. 15). Pas konsolidimit në të lexohet figura e shenjtorit me veshje peshkopale, e inkuadruar në një bordurë valzuse (Fig. 16).

Me përfundimin e restaurimit të muraturës së katedrales u bë shtrimi i dyshemesë me pllaka guri të daltuara, punim i cili ngjason me shtresën fillestare. Duke qenë një shtresë e re, ajo nuk u takua me muret perimetrale, por u la një boshllëk që varion për shkak të shtrembësisë së tij, për të vlerësuar kështu muraturën e vjetër të saj, tashmë të restauruar. Bazamenti antik i zbuluar afërsisht në qendër të kishës në një thellësi relativisht të madhe, me qëllim që të bëhet i vizitueshëm, u përfshi brënda një am-



Fig. 11



Fig. 12

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14

bjenti të mbyllur, me ndriçim artificial, poshtë dyshemesë së saj. Në të u lanë shkallë druri për të zbritur poshtë në monument. Ambjenti u realizua prej konstruksioni beton armeje dhe u hidroizolua.[6]

Në brendi të përmendores u mendua që të vendosen vepra arti të realizuara me derdhje në bronx, të cilat do të ndihmonin për të plotësuar kuadrin historik të ngjarjeve që kanë lidhje me Heroin[7]. Dera kryesore e hyrjes dy kanatshe me dimensione 1.70x x2.60 m ka të punuar në reliev Shqiponjën e Kastriotëve, përkrenaren dhe eshta e shpata. Në dy faqet e brendëshme të mureve gjatësore janë vendosur 25 mburoja të derdhura në bronx, që simbolizojnë 25 betejat nën udhëheqjen e Skënderbeut me datën, vendin dhe historinë e saj.

Për të simbolizuar varrin e Heroit afër qendrës, mbi një pjesë dyshemeje të shtruar me mermer të zi është vendosur një pllakë e bardhë guri në të cilën janë vendosur kopjet e përkenares dhe shpatës së Skënderbeut sipas origjinaleve që ndodhen në Vjenë. Përballë hyrjes në muze ndodhet busti i Heroit[8] i vendosur në absidë mbi një bazament guri (Fig. 17).

Ndërtimi i ri u trajtua me një kollonadë që mban sipër frizin. Kompozimi volumor dhe trajtimi arkitektonik i këtij ndërtimi ka si qëllim, jo vetëm ruajtjen e monumentit, por dhe vlerësimin e tij, e realizuar kjo nëpërmjet një transparence hapsinore midis kollonave të larta të proporcionuara dhe mbulesës së tejdukshme. Në zgjidhjen arkitektonike u synua që nëpërmjet linjave të arkitekturës klasike, të krijohet një volum sa më monumental me sipërfaqe të pastra, të veshura me mermer pa elemente të shumtë dekorativ, mbasi momenti kryesor është vet monumenti dhe ndërtimi i ri është në funksion të tij. Në harmonizimin e raportit të proporcioneve të volumeve dhe ele-



Fig. 15

6) Për ndërtimin e ambjentit u bë zmontimi dhe montimi i bazamentit me saktësi vetëm me një ndryshim të vogël, duke e vendosur fundin e tij 25 cm, më lart, e detyruar kjo nga ndërtimi i dyshemesë së konstruksionit. Punimet u drejtuan nga L. Papajani.

7) Këto vepra janë realizuar nga skulptorët R. Varfi dhe B. Sadiku.

8) Vepër e skulptorit të Popullit Odise Paskali.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 16



Fig. 17



Fig. 18

menteve jemi mbështetur në arkitekturën e ndërtimeve monumentale, me synimin për t'i dhënë edhe përmbajtjen e arkitekturës bashkëkohore. Trajtimi arkitektonik i pamjeve është i njëjtë si zgjidhje. Ato formulohen nga një rrjesht kollonash të ngritura mbi një xokol një metër, mbi të cilat ndodhet frizi që konturon gjithë volumin.

Përmasat planimetrike të ndërtimit janë 18.5 x x 32.5 m dhe lartësia 11 m. Kollonat kanë seksion 0.40 x 0.40 m dhe lartësia 8 m, ndërsa frizi është 1.5 m. Përmasat dhe lartësia e kollonave, së bashku me hapsirat ndërmjet tyre është parë në raport me

lartësinë e kornizës dhe xokolit me qëllim që ndërtimi i ri të jetë sa më transparent, për ta vështruar monumentin, por njëkohësisht dhe i proporcionuar. (Tab. VIII). Hyrja është realizuar me një ngritje prej disa këmbë shkallësh, të ndara nga një shesh pushim i gjërë, që të çojnë gradualisht në platformën e ndërtimit të ri, në qendër të së cilës ndodhet monumenti.

Realizimi i konstruksionit mbajtës është bërë me elementë beton armeje, ndërsa mbulesa me kapriatë të varur, të mbuluar sipër me material të lehtë, me ondaluks transparent. Në vendin e vendosjes së plintave monolite u kryen gërmime arkeologjike, si pasojë e të cilave u zbulua dhe një rrugë e antikitetit të vonë, e cila u la e pacënuar (Fig. 18). Muret perimetralë mesjetar të rrethimit të dytë të qytetit të Lisit, që kalojnë pranë ndërtimit shërbejnë si sfond i përkujtimores.

Edhe në ndërtimin e ri u vendosën vepra arti të punuara në bronx. Në pamjen kryesore të volumit në qendër të kornizës u vendos përkrenarja e Skënderbeut, ndërsa në fund të platformës u ngrit një panel që paraqet flamurin kombëtar, i realizuar në fushën me mozaik dhe në mes me një shqiponjë prej bronxi. Përmasat e mëdha të flamurit (4 x 5 m), me pamje të dyanëshme e mbyllin hijshëm perspektivën e hapsirës volumore të ndërtimit të ri nga hyrja kryesore.

Në funksion të idesë që ndërtimi i ri vlerësues të jetë në kontrast me vet monumentin, ndihmon dhe ndriçimi artificial i specifikuar për monumentin dhe ndërtimin e ri pa e prishur unitetin arkitektonik të tyre. Përkujtimorja me pozicionin e saj në qendër të një zone me monumente, ka synuar që nga ana kompozicionale dhe estetike të zgjidhte sa më mirë, jo vetëm funksionin për të cilin u ndërtua, por t'i përshtatet dhe mjedisit përreth dhe kohës në të cilën u ndërtua. (Tab. IX).

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Tab. I

Planimetria e kishës së Shën Kollit

2



Planimetria e Xhamisë "Selime"

1







TAB II

Tab II





Pamje Kryesore



PAMJE LINDORE



DO NOT COPY

DO NOT COPY

Tab. III



PAMJE KRYESORE



FAQJA LINDORE (BRENDA)





DO NOT COPY

Tab. IV

FAZA E PARE



FAZA E DYTE



Rikonstruksion i fazës së dytë

FAZA E TRETE



0 2 4 6 8 M

DO NOT COPY

Tab. V

PLANIMETRIA



PAMJE KRYESORE





PAJANTIMI I PAMJES KRYESORE



PERFORCIMI I THEMELEVE



Prerje 1:1

Prerje 2:2

Prerje 3:3

Tab. VI



DO NOT COPY

DO NOT COPY

Tab. VII



Prerja "1-1"

Prerja "2-2"



Vlersimi i rrugës antike

0 2 4 6 M

Tab. VIII



PLANIMETRIA E PERKUJTIMORES



Pamje Kryesore



Pamja Lindore



Prerja Gjatësore



DO NOT COPY

Tab IX

DO NOT COPY









Latif LAZIMI

DO NOT COPY

LE MONUMENT COMMEMORATIF DE SKANDERBEG A LEZHA

RESUME

L'enterrement de notre héros national Skanderbeg dans la Cathédrale «Saint Nicolas» à Lezha est porté à notre connaissance par l'humaniste albanais du XVe siècle, Marin Barleti. Il nous fait connaître aussi, que les turcs, après avoir occupé la ville de Lezha, en 1478, ont fouillé la tombe afin d'utiliser les ossements comme des amulettes et ont mis le feu à la cathédrale. Cela était tenu pendant longtemps pour une légende, mais les fouilles archéologiques et les recherches ont démontré que c'est là qu'on enterré notre héros national.

D'après les données historiques, la première église de Saint-Nicolas, où s'est réunie la Ligue de Lezha, a été ruinée vers les années 40 du XVe sc. En 1459 elle a été reconstruite avec de plus grandes dimensions, englobant même les ruines de l'ancienne église et c'est en 1468 qu'on y a enterré notre héros national Skanderbeg. Le monument a été endommagé lors des deux incendies en 1478 et 1506. D'après les adjonctions dans les années 20 du XVIe sc. cette cathédrale s'est transformée en mosquée, nommée la mosquée de Sélime. Elle a été abandonnée vers les années 20 du XVIIe siècle et a été reconstruite pour remplir la même fonction, vers la fin du XVIIIe siècle. Ces phases de construction et de reconstruction étaient bien reflétées par les murs et les couches de son plancher. Sans doute, la plus importante période historique est celle du XIVe et du XVe siècles, tandis que les adjonctions n'ont pas de valeur historique, ni architectonique. L'enlèvement des adjonctions ultérieures nous a amené à l'état de la cathédrale après être incendiée par les turcs.

Dans le but de conserver le monument de la phase principale avec des valeurs historiques particulières, le projet du tombeau de Skanderbeg avait pour but de restaurer, de mettre en valeur et d'apprécier les valeurs historiques, les réalisant au moyen d'une nouvelle construction, une colonnade qui entourerait les parties originales du monument du XIVe-XVe siècles.

Cette solution éliminait les adjonctions qui se heurtaient aux vraies valeurs du monument. D'autre part, la protection par une nouvelle construction d'une architecture monumentale, soignée mais simple, fait preuve du respect de notre époque envers l'oeuvre de Skanderbeg.

La réalisation de cette idée comprenait deux processus importants, celui de la restauration du monument et celui de l'élévation de la nouvelle construction.

L'idée principale de la restauration était la mise en évidence des traces originales du monument du XVe siècle. Tout d'abord on a effectué des sondages dans de différentes parties du plancher de l'église et en dehors, près de la maçonnerie, puis on a enlevé les nouveaux crépis du monument modifié. D'après les traces découvertes il résulte qu'on a à faire à une église à une nef avec une abside à demi-cercle. La datation de cette construction au XVe siècle, de pair avec les fouilles archéologiques est prouvée par le style roman répandu à cette époque-là dans les régions Nord-Ouest de l'Albanie. Le monument en question, comme nous l'avons déjà souligné, pendant l'occupation ottomane a été transformé en mosquée.

L'analyse complexe de toutes les données historiques, des fouilles archéologiques, des sondages, des éléments conservés démontre qu'il y a eu trois phases principales de transformation. Les ruines des murs, à l'intérieur de la cathédrale, un fragment conservé de l'abside, ainsi qu'une partie de la maçonnerie à fresque se rapportent à la première phase (tab. I, IV). La cathédrale reconstruite au XVe siècle, dont on conserve les murs de périmètre et les éléments de la façade, appartient à la deuxième phase (tab. IV, 2, Tab. II). Pendant la troisième phase, la cathédrale s'est transformée deux fois de suite en mosquée.

A l'heure actuelle, le monument se trouve modifié, mais une série d'éléments architectoniques sont conservés totalement ou partiellement et nous permettent de le transformer à l'état où il se trouvait après l'incendie.

Pendant la restauration on a déblayé l'église des couches et des différentes adaptations avec des éléments islamiques et on l'a complétée par quelques-uns des éléments originaux qu'on avait conservés. On a renforcé aussi la maçonnerie et ses fondations.

A l'intérieur du monument on a mis des oeuvres d'art réalisée en bronze, lesquelles aident à compléter le cadre historique des événements qui se rattachent au héros.

Presque au centre du monument sur une partie du plancher pavé de marbre noir il y a une plaque de pierre blanche au-dessus de laquelle on a mis les copies du casque et de l'épée de Skanderbeg d'après les originaux qui se trouvent à Vienne.

La nouvelle construction est composée d'une colonnade surmontée d'une frise. La composition volumétrique et le traitement architectonique de cette construction ont pour but non seulement la sauvegarde du monument mais aussi sa mise en valeur réalisée par un espace ouvert entre les hautes colonnes et la couverture transparente. Tout en gardant les lignes de l'architecture classique, on a essuyé de créer un volume assez monumental, couvert de marbre, sans beaucoup d'éléments décoratifs, parce que le monument principal c'est le monument même, la nouvelle construction étant à sa fonction.

DO NOT COPY

Nr. 2 1984

monumentet

DO NOT COPY

EMIN RIZA

NJË SHEMBULL I ZHVILLUAR I BANESËS GJIROKASTRITE (BANESA E SKËNDULAJVE)

Banesa gjirokastrite, me një zhvillim të qartë morfologjik, e tipare të spikatura në planin kompozicional, ruhet ende edhe sot, në një mori shembujsh. Megjithëse tipologjia e kësaj banese, e shprehur në numër krahasimisht të madh variantesh dhe nënvariantesh, zhvillohet brenda kufijsh normative mjaft të qartë, mjeshtrat ndërtues, në disa realizime kanë arritur në kufij të lartë vlerash arkitektonike. Përvoja e pasur e arritjeve pararendëse, dhe kristalizimi i krejtë gamës tipologjike, aty nga fillimi i shek. XVIII, krijuan kushtet e duhura që pikërisht në tre dhjetvjeçarët e parë të shek. XIX, në valën e një veprimtarie të gjërë ndërtuese, të ngrihen disa vepra të shquara. Banesa e Kabilatëve (gjasisht e vitit 1816), e Zekateve (1811–12), e Bakirajve (1827), e Resajve (1831) janë disa prej kryeveprave të banesës gjirokastrite, të cilat me vlerat e tyre të dalluara, janë shembuj shprehës të aftësive të gjëra krijuese të mjeshtrave ndërtues. Këta, tashmë me përkujdesjen e dalluar estetike, pa lënë mënjanë kërkesat e tjera që lidheshin kryesisht me funksionin, kanë arritur të japin krijime të vërteta arkitektonike. Kristalizimi i programit dhe i shumë dukurive të tjerë, ndër të cilët kompozimi është kryesori, u ka lejuar krijuesve të këtyre veprave që të ndalen me nge e me dëshirë, për të arritur, nëpërmjet modelimeve të kërkuara, në realizime plastike sa të harmonishme aq edhe të spikatura, duke arrirë kulme të vërteta.

Në vargun e këtyre veprave madhore, një vend të veçantë zë edhe banesa e Skëndulajve, përfunduar, sipas mbishkrimit, në vitin 1823. Kjo vepër e cila vjen deri në ditët tona me ndryshime shumë të vogla, e në gjendje teknike thuajse të pacënuar, është një nga banesat më të mëdha gjirokastrite. Ajo i përket zgjidhjeve më të zhvilluara të variantit të njohur me dy krahë, i cili paraqet arritjen më të lartë në zhvillimin morfologjik të banesës gjirokastrite. Fuqia ekonomike e porositësit, ka mundësuar që mjeshtrat ndërtues t'i kushtojnë përkujdesje të mëdha jo vetëm kompozimit, por edhe trajtimit arkitektoniko-dekorativ të elementeve formues të veprës. Banesa e Skëndulajve është një pikë referimi e saktë për të ndjekur tiparet dhe karakterin e banesës gjirokastrite në periudhën e lulëzimit të saj (1800–1830). Kristalizimi, në këtë periudhë, i programit, kompozimit, teknikës së ndërtimit dhe elementeve arkitektonikë, ka lejuar që në këtë vepër me program maksimal, dhe me investime të bollshme, të arrihet në një realizim plot vlera. Vepra flet qartë për një përvetësim të thellë të tipareve kompozicionale të banesës gjirokastrite nga mjeshtrat ndërtues të cilët, duke gjykuar nga niveli teknik dhe estetik i realizimit të saj, duket qartë se i përkisnin pjesës më të kualifikuar të atyre grupeve të shumta, që ndërtuan Gjirokastrën e shumë vepra në zonën rreth saj. Banesa e Skëndulajve, nuk është një kulm, vetëm brenda kuadrit të banesës gjirokastrite, vlera e saj shtrihet më tej në një rreth më të gjërë, atë të banesës shqiptare e ballkanase bashkëkohore. E lidhur me periudhën e fuqizimit të pashallëkut të Janinës, kur në përgjithësi në trevat e Shqipërisë së Jugut veprimtaria ndërtuese shumohet ndjishëm, ajo dhe mjaft shembuj të tjerë, jo me më pak vlera, përbëjnë realizime madhore në kuadrin e qytetit shqiptar të lidhur me mënyrën feudale të prodhimit. Pikërisht mbas kësaj periudhe tepër të pasur në arritje brenda konceptesh të kristalizuara, nën ndikimin e drejtpërdrejt të lindjes e zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste, e të rritjes e fuqizimit të borgjezisë kombëtare, edhe banesa gjirokastrite shfaq shenjat e rënies. Kë-



Fig. 1

DO NOT COPY

to të fundit bëhen më të qarta nga gjysma e dytë e shek. XIX, megjithë aftësinë e madhe adaptuese që pati ky tip për t'iu përgjigjur kushteve të reja. Por ashtu si çdo dukuri arkitektonike, edhe banesa gjirokastrite ishte pjella e një konteksti të caktuar historiko-shoqëror.

Banesa e Skëndulajve ngrihet në qendër të lagjes «Palorto» një nga më të mëdhatë e qytetit. Mjedisi urbanistik rreth saj karakterizohet nga ndërtime të ngjeshura (fig. 1) të cilat kanë orientim të detyruar, me pamjen kryesore në drejtim të rënies së truallit nga lindja. Në gjendjen e sotme ambienti që përfshihej brenda mureve rrethues të banesës ka pësuar ndryshime, kështu që gjendja origjinale mund të ndiqet nga dëshmitë gojore. Ashtu si shumica e banesave të mëdha gjirokastrite, edhe kjo banesë ka pasur dy oborre. Në oborrin e parë i cili zhvillohej në pjesën veriore, të çonte porta kryesore, e cila delte në një rrugë kryesore, e cila përshkon thuajse horizontalisht lagjen «Palorto». Aty ngrihen dy ambiente ndihmëse, «odajashta», të cilat kanë një kompozim të thjeshtë me kat. Sipas dëshmish gojore, së pari ato kanë qenë koçekë për ruajtjen e produkteve bujqësore, të cilat mblidheshin nga renta çifligare. Më vonë ato janë ritrajtuar duke u kthyer në odajashta tipike, me katin e parë të banuar. Në gjendjen e sotme odajashta e skajit, është transformuar rëndë, ndërsa ajo (fig. 2), pranë banesës ruhet mirë. Oborri i dytë, i cili i shërben vetëm banesës është i vogël. Dera dyflegërshe që të çon në të, ruan trajtimin e njohur. Në këtë oborr, të shtruar me pllaka guri, përballë banesës ngrihet një ambient ndihmës, i cili ka pasur edhe furrë, duke shërbyer ai kryesisht si guzhinë verore. Ngushtësia e truallit ka bërë që banesa të dalë në rrugë me dy faqet e saj, përkatësisht faqia jugore del në «sokakun e të marrëve», ndërsa

ajo perëndimore, në rrugën kryesore të lagjes. Dendësia e ndërtimeve, pjerrësia deri diku jo e madhe e truallit mbi të cilin ngrihet banesa dhe konfiguracioni i sheshit të ndërtimit, bën që volumi dhe aq më tepër pamja kryesore e saj të mos shfaqen plotësisht. Nga pak pika shikimi mund të rroken vetëm katet e sipërme, në dallim nga banesa e Zekateve dhe ajo e Resajve që shfaqen qartazi me tërë madhështinë e tyre.

Siç përmendëm banesa e Skëndulit, ka programin maksimal të variantit më të zhvilluar të banesës gjirokastrite, atij me dy krahë. Megjithë numërin krahasimisht të madh të ambienteve, me funksione të diferencuar mirë, kjo banesë është njëfamiljare. Brenda saj përmblidhen të gjitha funksionet jetësore për kohën, duke lënë jashtë saj vetëm disa funksione të dorës së dytë, të cilat i kryenin odajashtat dhe ahuri.





Fig. 2

Sipas funksionit ambientet e kësaj banese ndahen në kryesorë, ndihmës dhe ndërlidhës. Ambientet kryesorë janë ata ku qëndrohet, merret ushqimi dhe flihet, pra këtu përfshihen odat e zakonshme dhe oda e miqve. Ambientet ndihmës lidhen drejtpërdrejt me funksionet jetësore, si qilari i zahiresë, stera, ambientet e gatimit, ata sanitarë, apo edhe katoi si vend depozitimi i lëndëve djegëse, ndërsa një katua ka shërbyer edhe për mbajtjen e kafshëve të ngarkesës. Grupin e ambienteve ndërlidhës e përbëjnë nëndivani, divani i poshtëm dhe divani i sipërm. Të vetmet ambiente që kanë pësuar ndryshime në këtë banesë janë të dy odat e krahut jugor. Në katin e parë, oda origjinale ka pësuar një zvogëlim, duke u prishur kompleksi «musandër-dhipato» dhe duke u ndërtuar në vend të tij një më i gjërë, në kurriz të hapësirës së dhomës. Ndërsa oda mbi të është ndarë në dy pjesë, dhe është hapur një hyrje e re. Kuptohet se kompleksi musandër-dhipato është prishur, krahas ritrajtimit të ballit të odës. Pra banesa ka pasur 6 oda banimi. Vetëm njera prej tyre është me përmasa të vogla dhe i mungon kompleksi musandër-dhipato, ndërsa të tjerat, me volume të mëdha, përsërisin skemën e njohur kompozicionale të banesës gjirokastrite.[1] Në këtë banesë të zhvilluar gjirokastrite thellimi i diferencimit funksional të ambienteve ka zhdukur praktikisht shtëpinë e zjarrit. Një ambient i vogël banimi në qendër të bllokut fundor të katit të sipërm, t'a kujton disi atë.

Ashtu si në të gjithë variantet e zhvilluara të banesës gjirokastrite edhe në rastin në shqyrtim, ndërmjet kateve ka diferencime të qarta funksionale. Kati përdhe është i pabanuar, kati i parë shërben kryesisht për periudhën e stinëve të ftohta, ndërsa kati i dytë (Tab. I), më i larti, shërben gjatë stinëve të ngrohta.

Odat e dimrit, gjithësej dy, zënë krahët e katit të ndërmjetmë. Oda e krahut kryesor, ruhet mirë në gjendjen origjinale. Ajo dallohet si gjithë të tjerat për kompozimin e theksuar gjatësor, në fundin e të cilit ndërtohet kompleksi musandër-dhipato, me ambientin sanitar brenda tij. Dollapët e muri, kamaret, oxhaku dhe dritaret në pjesën ballore, përbëjnë një konstante në mbarë odat e kësaj banese. Të njëjtën skemë kompozicionale, përsëriste edhe ambienti i krahut tjetër. Në katin e sipërm të katër odat paraqesin veçanti trajtimi, duke ruajtur të njëjtën kompozim. Siç përmendëm përjashtim bën oda në qendër të bllokut fundor, e cila është e thjeshtë, ngaqë ka një volum tepër të vogël. Për t'u vënë në dukje është ndërlidhja e këtij ambienti me një rruginë thuajse të fshehur, me ambientin sanitar, që i shërben dhe odës djathtas

1) E. Riza, «Qytati muze i Gjirokastrës» Tiranë, 1981.

DOKTORATURA



Fig. 3

saj (e djathta e vrojtuesit), si dhe ndërlidhja e drejtpërdrejt me banjën, e cila nga oxhaku i odës, ngroh kazanin e ujit. Qenia e kësaj banje dhe dritaret dyfishe prej allçije të shtyjnë të mendosh se kjo odë nuk ishte një ambient i dorës së dytë. Siç përmendëm, oda e krahut të majtë është e transformuar. Me interes është oda përbri asaj të miqve, ajo merr emrin «oda e musllukut», sepse është e ngritur pikërisht mbi sterën. Në dallim nga ambientet e katit të ndërmjetmë fillimisht pa tavan, kjo odë ka një tavan të thjeshtë, me rozetën karakteristike me copra, tepër të përhapur gjatë shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX, në shumë nga qytetet tona. Për t'u shënuar është dhipatoja e mbyllur, si dhe prishja e oxhakut në faqen ballore, dhe ndërtimi në vend të tij i një dritareje.

Ambienti më paraqitës, e njëherazi nga më të shquarit e banesës gjirokastrite, është oda e miqve (Tab. I), e cila ze krahun e djathtë të katit të sipërm. Volumi i saj formohet nga tre pjesë, qoshkut, vendit të parapëlqyer për qëndrimin në ballë të odës, më të lartë se pjesa tjetër, me tavan të veçantë dhe dritare të shumta të vendosura në dy rradhë në lartësi. Në qendër zhvillohet volumi kryesor i ambientit, me tavan të veçantë, në të cilën shquan oxhaku i dekoruar me motivet e njohura floreale me teknikën «al seco». Në pjesën fundore zhvillohet kompleksi musandër-dhipato (fig. 3), me zhvillimin e thyer në ballin e saj, dhe në pjesën e sipërme të hapur.

Ambientet ndihmëse zënë një vend me rëndësi në banesë, për vetë karakterin e ekonomisë së kohës, e cila kërkonte që brenda familjes, e banesës së saj të siguroheshin rezerva ushqimore e uji, si dhe ambiente për përpunimin e tyre. Jemi akoma në fazën kur ekonomia familjare në shumë drejtime ishte e pavarur nga tregu. Si rast i rrallë, banesa e Skëndulajve ka dy qilare zahireje të vendosur të dy në katin përdhe, në bllokun fushor, trualli i të cilëve është rreth 0.7 m më i ulët, duke siguruar kushte më të mira ruajtjeje. Të dy qilarët qarkohen nga podiume muraturе (Tab. I), ku vendoseshin rezervat ushqimore. Në vazhdim të tyre, është ndërtuar stera me volum të madh ujëmbledhës. Kjo zhvillohet në lartësinë e dy kateve, dhe ka dy vendmarrje uji, njërën nga nëndivani, ndërsa tjetrën nga jashtë, për t'i shërbyer ambienteve ndihmëse në oborrin e parë. Banesa ka dy ambiente gatimi një në secilin kat të banuar. Ai i katit të ndërmjemë është më i thjeshtë, ndërsa ai i katit të sipërm me të njëjtën sipërfaqe ka kompleksin musandër-dhipato, si dhe ambientin sanitar të veçantë. Për t'u theksuar është çvendosja e sqollit në një ambient pranë. Ambientët sanitarë shoqërojnë çdo odë. Ata në ambientet e krahëve përfshihen në volumin e odës, ndërsa në ambientin e bllokut fundor dalin jashtë konturit të planimetrisë me formë dhëmbi. Katoi i krahut të majtë shërbente kryesisht si depozitë për lëndë djegëse, ndërsa në atë të krahut të djathtë, duket se mbaheshin kafshë ngarkese.

Ambientët ndërlidhës, zënë qendrën e kompozimit. Vendosja e bllokut të shkallëve kryesore në pjesën ballore i ka ngushtuar ata. Dyert e shumta që dalin përkatësisht në nëndivan, divanin e poshtëm dhe atë të sipërmin e që presupozojnë rryma të shumtë kalimi, praktikisht nuk lënë, asnjë kënd të qetë në këtë sipërfaqe. Vetëm në katin e sipërm, mbi volumin ndërmjet dy dyerve të katit të ndërmjemë, që të çojnë përkatësisht në një parahyrje dhe në divanin e poshtëm, është sajuar një qoshk (fig. 4) që të kujtojë ata të ndërtuar në tipin e banesës me çardak.

Nga repertori i banesës gjirokastrite banesës së Skëndulajve i mungon vetëm kamarieja. Mungesa e këtij elementi, në variantin e hapur, më tepër me vlera estetike se funksionale, është plotësuar me sistemin kollonë-qemer, që mban rampën e shkallëve për në katin e sipërm, i cili duke u shtrirë në formë të shkallëzuar, pasuron ndjishëm pjesën qendrore të pamjes kryesore. Në një shembull tjetër, dhe pikërisht në banesën e ndërtuar gjithashtu në lagjen «Palorto» rr. M. Bakiri, nr. 1 (fig. 5) pjesa qendrore është konceptuar njëlloj si në rastin e banesës në shqyrtim, por krahas është ndërtuar edhe kamarieja me tre hapësira monumentale. Siç duket mjeshtri, që ka konceptuar veprën në shqyrtim e ka kuptuar se ndërtimi i kameriesë do të largonte planin e ballit të divanit të sipërm, dhe kështu do të dëmtohej njësia e pjesës qendrore, e cila e trajtuar në një plan paraqet pjesën më të arritur (fig. 6) të veprës.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

Banesa e Skëndulajve i përket zgjidhjeve më të zhvilluara të variantit me dy krahë. Skema e kompozimit planimetriko-volumor, ashtu si i mbarë banesave gjirokastrite, formohet nga blloqet e njësuar kompozicionalë, të cilët në rastin e dhënë janë vendosur në formën e shkronjës U. Dy blloqet anësore dhe blloku fundor i formuar nga dy njësi kryesore dhe nga tre ambiente të vegjël, njeri në secilin kat, formojnë banesën. Në qendër të këtij zhvillimi të thyer, janë ndërtuar ambientet ndërlidhës, ndërsa përpara tyre mbi një sistem të shkallëzuar harkade ngrihet rampa e fundit e shkallëve për në katin e sipërm. Formulimi planimetrik (Tab. I) megjithëse dinamik, në krahasim me zgjidhjet e zakonshme është jo tepër i ndërlikuar. Vetëm blloku fundor nga veriu del përtej konturit për të rritur volumin e sterës dhe odës sipër saj. Trualli, deri diku i rrafshët, ka bërë që kompozimi me thyerje volumesh të mos gjejë zbatim në këtë banesë. Vetëm një volum i vogël (Tab. I), në pjesën fundore zhvillohet në dy kate. Skema e

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

thjeshtë kompozicionale shoqërohet me një paralelizëm të qartë të kompozimit të çdo kati, ambientet e të cilëve i kanë hyrjet njera mbi tjetrën. Banesa ka një kompozim simetrik, i cili thyhet vetëm me dy daljet e gjysmës veriore. Blloku i krahut të djathtë (Fig. 17) si zakonisht në shembujt e zhvilluar të variantit me dy krahë, del më përpara, sepse pikërisht në këtë ndërtohet oda e miqve me volumin e bollshëm, që kërkon trajtimi i pasur dekorativ i saj. Ndarja e ambienteve sipas kateve është tepër funksionale, duke ruajtur traditën e njohur të banesës gjirokastrite trekatëshe.

Me interes në këtë banesë është vendosja e shkallëve në kompozim. Qënia e dy hyrjeve njera në katin përdhe dhe tjetra në atë të ndërmjemin, është një zgjidhje deri diku e rrallë në këtë tip banesa, e cila është përgjithësisht me një hyrje. Kjo zgjidhje ka bërë që për në katin e ndërmjemë të ketë dy rampa shkallësh, një e brendshme dhe tjetra e jashtme, ndërsa rampa që të çon në katin e sipërm, mbështetet mbi një harkadë të shkallëzuar. Për të termoizoluar katin e ndërmjemë, në të cilin zakonisht familja kalonte dimrin, është ndërtuar dera (fig. 7) përbri fillimit të rampës që të çon në katin e sipërm, si dhe qepeni që mbyll hapësirën e shkallëve për në katin e mesit. Ky, kompozim i shkallëve, i cili është i lidhur me qënien e dy hyrjeve, bën që praktikisht katet e banuar të kenë hyrje të pavarur nga kati përdhe, me funksione ndihmëse. Pra shkallët e brendshme, që lidhin nëndivanin me divanin, janë praktikisht shkallë shërbimi.

Kompozimi i odave, paraqet karakteristikat e njohura të banesës gjirokastrite, me kompozimin e theksuar gjatësor, i cili arrin në odën e miqve në raportin 1 : 2,6. Në odat e krahëve, balli i të cilave sheh një panoramë të gjërë është i lirë, për t'u ndërtuar vetëm dritaret që lejojnë të soditet panorama. Përkundrazi në odat e bllokut fundor, në ballë ndërtohet oxhaku.

Banesa e Skëndulajve është e ndërtuar me një teknikë të lartë. Për këtë flet gjendja e saj teknike e mirë, megjithëse ndërtimi është përfunduar rreth 160 vjet më parë. Si punimet e gurit, të cilat thuajse zënë krejt volumin e muraturës, ashtu edhe ato të drurit janë zbatuar në nivel, duke përbërë edhe në këtë drejtim një nga shembujt më të arritur të banesës gjirokastrite. Muratura është e ndërtuar me gurë kave shtresor. Ajo është lidhur me llaç gëlqereje dhe përforcuar me breza druri. Muratura ngushtohet në faqen e brendshme nga kati në kat duke luhatur përkatësisht në përmasat 100-90-75 cm. Struktura me skelet druri, është zbatuar vetëm në ballet e odave (fig. 8) të krahëve në katin e dytë, përsarye të hapësirave të mëdha e të shumta të drita-

reve. Mbulimi i hapësirave të ndryshme është realizuar duke përdorur harkun e kombinuar me arkitrarë druri, si në shumicën e dyerve dhe në mjaft dritare, apo thjeshtë me arkitrarë druri. Qemeri është një strukturë e përdorur gjerësisht në këtë banesë, jo vetëm për mbajtjen e rampave të shkallëve, por edhe për mbulimin e ambienteve të tillë si stera, qilari i zahiresë, apo ambienti i gatimit. Tirantat prej druri në nivelin e fillimit të qemereve gjysëm rrethore, janë një dukuri e zakonshme.

Me interes të veçantë në këtë banesë, është struktura e konstruksionit të çatisë (Tab. I), e cila ruhet në gjendje shumë të mirë. Megjithë zhvillimin e ndërlikuar të skemës së çatisë, për shkak të planimetrisë me thyerje të shumta, ajo paraqet një konstruksion racional e kompakt. Edhe në këtë shembull, ndiqen parimet bazë të këtyre strukturave në Gjirokastër, të cilat, së pari dallohen për përdorimin e gjërë të pajantave, të cilat synojnë të mbështeten mbi një mur kryesor, ose kur ai nuk përkon me kulmin pesha e baballëkëve lehtësohet mjaft nga pajantat në fjalë. Shkaku duhet kërkuar në seksionin e vogël të lëndës që varion nga ø 10–12 cm, me përjashtim të tabanëve të ndryshëm që kanë përmasa më të mëdha. Kjo bën që trarët e tavanit të mos mbajnë peshë, ose rrallë një peshë të vogël, ndërsa qeprat të përforcohen dendur me breza, që mbahen nga pajanta të shumta. Strehët janë dy llojesh, të hapura e të mbyllura. Ato të mbyllurat me kornizë guri i gjejmë në faqen e prapme, e cila është më e ulët, dhe njëkohësisht me këtë strukturë të qëndrueshme, është më e sigurt. Faqet e tjera mbulohen nga streha të gjëra që luhatin nga 130–160 cm. Ato janë të hapura dhe mbahen nga testekë të shkurtër, ku mbulojnë mure guri dhe testekë të gjatë kur mbulojnë ballin e divanit, apo të odave të krahëve.

Shtresat janë me rrasa guri, si në katua, në nëndivan, etj, ndërsa ambientet e katit janë shtruar me dysheme druri. Suvatimet veshin të gjithë ambientet e banimit, ata ndërlidhës e të gatimit. Të pasuvatuar janë katojt dhe qilarët e zahiresë. Në pamjen e jashtme faqet jugore dhe perëndimore janë të pasuvatuara, ndërsa faqia veriore është e suvatuar në lartësinë e katit të tretë, ndërsa pamja kryesore në lartësinë e të dy kateve të banuar. Suvatimi, është kryer me teknikën e njohur, duke pasur dorën e parë me llaç balte, ndërsa dorën e dytë me patinaturë gëlqereje.

Banesa e Skëndulajve shquhet edhe për pasurinë e elementeve të ndryshëm arkitektonikë, e veçanërisht të atyre të punuar në dru. Duke ruajtur në përgjithësi skema të njëjta kompozimi, këta elementë ndryshojnë në shkallën e përpunimit në përputhje me vendin e ambientit të dhënë, sipas diferencimit funksional të tyre. Kështu hasim në një numër të madh përpunimesh duke kaluar nga formulimet e thjeshta deri te ato të ndërlikuarat, që ruajnë edhe vlera estetike të shkallëve të ndryshme.

Elementi i parë, që i afrohet vizitorit të banesës dhe ambienteve të saj është porta. Trajtimi i tyre në këtë banesë ka një larmi të madhe formash, të cilat lidhen kryesisht me mbulimin e hapësirës së dritës dhe trajtimin e flegrës së derës. Ashtu si mbarë banesat gjirokastrite, me përjashtim të hyrjes në katin përdhe dhe tre dyerve të tjerë, të cilat si rast shumë i rrallë janë dyflegërshe, dyertë janë njëflegërshe. Të jashtmet sigurohen me shul me lëvizje horizontale. Ambientet e katit përdhe dhe atij të parë i kanë portat me hark, i cili thellohet pak nga faqia e murit. Nga brenda mbulimi bëhet me arkitra druri, për të lejuar lëvizjen e flegrës, që ka formën e katërkëndëshit kënddrejt. Formulimi i flegrave është tepër i thjeshtë, me dërrasa të afruara, që mbërthehen mbi binarë. Në katin e sipërm ku vendosen ambientet me përfaqësues, mbulimi i të gjitha portave bëhet me arkitra. Përpunimi i flegrës është në përputhje me rën-



Fig. 9

DOKOICOPY

dësinë e ambientit të cilit i shërben. Kështu ndërsa portat që të çojnë në tre ambientet e bllokut fundor janë të thjeshtë, dhe kornizohen sipër me një imitim harku, të punuar në dru, dyert e odës së miqve (fig. 9) dhe asaj të krahut tjetër (fig. 10), janë punuar me teknikën e njohur me zemra, që formojnë motivin e svastikës. Oda e miqve, me një punim më të imtë, e përsërit dy herë këtë motiv, ndërsa ajo përkundrejt e punuar jo aq imtë, një herë. Hapësirat e dritareve ashtu si dhe dyertë, mbulohen me hark-arkitra, apo



Fig. 10

vetëm me arkitra. Në katin përdhe dhe të parë, zbatohet varianti i parë, ndërsa në të tretin varianti i dytë, ashtu si për dyert. Në të dy katet e poshtëm dritaret sigurohen me hekura nga jashtë, dhe me kapakë druri nga brenda. Telajot me xhama mungojnë. Këta të fundit i gjejmë në gjendjen e tyre origjinale, si një rast tepër të rrallë, e madje në një nga fillesat e përdorimit të tyre në fillim të shek. XIX në ballin e odës së miqve (fig. 8). Telajoja është një e vetme, dhe lëviz vertikalisht.



Fig. 11

Në ambientet kryesore të banesës, e veçanërisht në ata të katit të sipërm kanë gjetur përdorim të gjërë dritaret fikse prej skeleti allçije me xhama, të cilat



Fig. 12

DO NOT COPY

vendosen mbi dritaret e zakonshme, apo edhe mbi dyerë, kur ndriçojnë ambiente, apo dhipato me dritë indirekte.

Tavani është i përdorur vetëm në ambientet e banimit të katit të sipërm. Për ambientet e katit të ndërmjemë si tavan shërbejnë dërrasat e dyshemesë së katit të sipërm, të cilat vishen me listela në bashkimet e dërrasave. Tavanet e ambienteve të katit të dytë, me përjashtim të atij të odës përbri asaj të miqve, zhvillohen në një plan si ato të divanit, apo në disa plane si ato të odës së miqve (fig. 11). Në të dy rastet rozeta qëndrore formohet nga një rreth mbushur radialisht me motive të gdhendura gjethesh, apo motivesh të tjera, i cili konturohet nga një tetëkëndësh disa brezash, si në odën e miqve, apo me një brez të vetëm në divan. Rozeta e tavanit mbi kafazin e shkallëve konturohet me një brez gjithashtu rrethor. Vetëm rozeta e odës (fig. 12) përbri asaj të miqve përsërit motivin e njohur me copa, në formë katërkëndëshi kënddrejt, që vendosen radialisht. Konturimi me bordura të shumta formon tetëkëndëshin e zakonshëm.

Punime druri me interes janë edhe ato të dollapëve të murit e musandrave. Sipas rëndësisë së ambienteve ato kanë përpunime të ndryshme. Në odën e miqve (fig. 13) është zbatuar gjërësisht motivi i svastikës.

Oxhaqet në përgjithësi i gjejmë në të gjitha ambientet e banimit dhe të gatimit. Tamburet e oxhakëve përgjithësisht formohen nga bashkimi i një gjysme prizmi me një gjysmë koni. Përjashtim bën oxhaku i odës së miqve me një tambur me formë të ndërlikuar, i cili është krejtësisht i pikturuar, duke shënuar një nga shembujt më të vonë të këtij trajtimi, që zakonisht lidhet me pikturimin e brezit mbi sergjenat e odës.

Ajo që të tërheq veçanërisht vëmëndjen në këtë vepër të shënuar arkitektonike, është përkujdesja për trajtimin e ndërtimit jo thjeshtë në planin funksional, por edhe atë estetik. Padyshim në çdo vepër ka kërkesa estetike, por në rastin e dhënë ato janë të shprehura qartazi. Këto përpjekje i gjejmë si në modelimin e veprës, në raportin harmonik të elementeve, formës, ashtu edhe në trajtimin dekorativ të elementeve të ndryshëm arkitektonik, veçanërisht në brendësi të ambienteve dhe më qartazi në odën e miqve, si ambientin më paraqitës të banesës. Edhe në këtë banesë, megjithëse në një formë jo aq të theksuar, shfaqet pabarazia e trajtimit të pamjes së jashtme me atë të brendshmen. Themi jo aq të theksuar, sepse në dallim nga banesa të tjera të të njëjtit variant, te banesa e Skëndulajve shihet qartazi përpjekja për trajtimin e pamjeve të jashtme. Edhe në rastin e dhënë, banesa thuajse punon vetëm në pamjen kryesore, e cila me harmoninë dhe kontrastet e goditura, shkëputet ndijshëm nga pamjet e tjera.

Banesa e Skëndulajve (fig. 14) ka një kompozim që i largohet zhvillimit tipik vertikal të banesës gjirokastrite. Këtu ndikon gjërësia e madhe e bllokut qendror, i cili jo vetëm për madhësinë e tij, por edhe për trajtimin, luan rolin kryesor në konceptimin e pamjes ballore. Trajtimi me harkadën e shkallëzuar, e cila është transparente, dhe balli i gjërë i divanit me harkadën elegante mbi shtyllat e drurit, i japin një frymëmarrje të dalluar pjesës qendrore, e cila qëndron mirë ndërmjet dy blloqeve anësore. Këta të fundit megjithë rritjen karakteristike të përpunimit, duke kaluar nga kati përdhe në të sipërmin, ruajnë monumentalitetin tipik të banesës gjirokastrite. Thyerja e simetrisë së rreptë në pamjen kryesore, për shkak të zhvillimit asimetrik të pjesës qendrore, rrit notën piktoreske të veprës. Në dallim nga monumentaliteti dhe ashpërsia tipike e banesës gjirokastrite në banesën e Skëndulajve, karakteri piktoresk, shfaqet edhe në ekzekutimin e pikturave murale në ballet e odave të krahëve. Aty ruhen gjurmë të temës së njohur me dy luanë anash dhe me panotë karakteristike me kompozime temash floreale. Me interes të veçantë është



Fig. 13

DOKTORATURA

një pano e gjërë, përbri rampësisë së shkallëve që të çon në hyrjen e katit të parë. Ajo paraqet një skenë gjuetie. Një gjahtar me pushkë ka marrë në shenjë një kaproll. Megjithëse jo e vetmja, dhe me një ekzekutim naiv, si për nga tema, ashtu edhe për vendin e saj në pamjen kryesore ajo merr një vlerë të veçantë.

Brendësia e dy kateve të parë, ruan mirë thjeshtësinë dhe lakonizmin e mjeteve shprehëse arkitektonike, në dallim nga kati i sipërm, i cili me hapësirat e mëdha, ndriçimin e bollshëm dhe trajtimin e pasur dekorativ, veçanërisht në ambientet kryesore krijon një atmosferë sa të ngrohtë, aq edhe solemne. Banesa e Skëndulajve, me odën e miqve, në të cilën tavani nuk është i ngjyrosur, ndërsa pjesa mbi sergjenët është pa dekoracionet karakteristike me panotë që përsëriten, si në banesën e Zekatëve.[2] shënon fillimin e shkëputjes nga kjo manierë dekorimi. Oxhaku i odës së miqve me zbukurimet e njohura me teknikën «al seko», me tema floreale, është një provë se pikërisht rreth dhjetvjeçarit të dytë të shek. XIX, duhet kërkuar largimi nga pikturimi i brendësisë, në mbisundimin e daltimeve dhe në përgjithësi të përpunimit të elementeve prej druri.

Siç kemi përmendur, banesa e Skëndulajve i përket një prej realizimeve më të arritura të variantit të zhvilluar të banesës gjirokastrite. Ajo është ndërtuar në një kohë, kur ky tip banese, ishte kristalizuar qartë, nëpërmjet një mori shembujsh. Në raport me banesat e tjera më të arritura, banesa e Skëndulajve shquhet në radhë të parë për programin e saj tepër të gjërë, duke qenë një prej banesave më të bollshme një familjare. Kompozimi racional dhe i qartë, i cili është bërë i tillë veçanërisht me zgjidhjen e shkallëve, gjithashtu paraqet një realizim më pak paralele në Gjirokastër. Me interes është të theksojmë se zgjidhje të tilla kompozicionale të shkallëve ndeshen edhe në banesat me çardak të Beratit. Banesa në rr. S. Bandilli nr. 48 në qytetin-muze të Beratit është një shembull tipik i kësaj zgjidhjeje. Natyrisht në shembullin e kësaj banese me çardak strukturat e harkadës së shkallëzuar janë krejtësisht të hapura, ashtu si i gjithë balli, me gjërësinë e çardakut. Këto paralele dhe të tjera, në elemente të ndryshëm arkitektonikë e konstruktivë, ndërmjet banesës gjirokastrite dhe asaj beratase, kanë vlerë me rëndësi në pikpamje të njësisë së banesës qytetare shqiptare. Megjithatë e njëjta zgjidhje kompozicionale i është nënshtruar trajtimeve të ndry-



Fig. 14

shme, lidhur me veçantitë themelore të të dy tipev përkatësisht banesës së hapur me çardak dhe b nesës së mbyllur gjirokastrite, çardaku i së cilës n e tjetërson dot këtë karakter. Edhe mungesa e kam riesë e afron pjesën qendrore të banesës së Skënd lajve me banesat me çardak. Për nga dekori i pas dhe shkalla e lartë e ekzekutimit të punimeve, kjo b nesë mund të krahasohet më pak shembujve, ndër cilët më kryesori është banesa e Kabilatëve.[3] Me d korin e pasur, arritjet e padyshimta estetike, bren shijeve të kohës, dhe realizimin e përsosur me ma rialet dhe teknikat tradicionale, banesa e Skëndul ve është një shembull përfaqsues i shkallës më lartë që arriti kjo gjini në kuadrin e shoqërisë feud shqiptare.

Banesa e Skëndulajve përsërit në mënyrën më qartë tiparet e banesës gjirokastrite. Ajo i shërbe një familjeje të pasur e cila sipas të dhënave gojo së pari jetonte në një banesë tjetër në lagjen «Te (Rr. M. Heba, nr. 4). Të ardhurat nga pronat tokës përbënin burimin e jetesës së saj. Përmasat dhe tr timi i banesës, tregojnë qartë se këto të ardhura ko qënë të konsiderueshme, pa lënë mënjanë edhe f torin të themi psikologjik, i cili lidhej me dëshirë

2) E. Riza, **«Arkitektura dhe restaurimi i banesës së Zekatëve»** «Monumentet» 3/1977.
3) L. Suli, **«Studim për restaurimin e banesës së Kabilajve në qytetin e Gjirokastrës»**, «Monumentet» 12/1976.

POR ISTI COPY

madhe për të pasur një shtëpi sa më paraqitëse, shpesh përtej mundësive reale të porositësit. Programi i pasur i banesës lidhej me nevojat e jetës së përditshme, atë të grumbullimit të produkteve ushqimore dhe rezervave të ujit, për një kohë deri diku të gjatë, si dhe të përpunimit të tyre, ashtu siç bëhej në këtë kohë, kur tregu ishte faktor i dorës së dytë në ekonominë familjare, thuajse autarqike. Ndarja funksionale sipas kateve shprehet qartazi edhe në këtë banesë, si një karakteristikë tipike e saj. Diferencimi i theksuar i funksioneve të ambienteve, ka bërë që praktikisht shtëpia e zjarrit të humbasë nga repertori i banesës. Odat e banesës, përsërisin tiparet e njohura, me planimetrinë e përzgjatur, e cila ka në ballin e saj vendin e parapëlqyer për qëndrim. Kompleksi musandër-dhipato, ambientet sanitare, oxhaku, sergjenet, dollapët e kamaret, disa prej të cilave në funksionin e mobiljeve të ndërtuara së bashku me veprën, pra pjesë e arkitekturës së brendësisë, përbëjnë një karakteristikë të qëndrueshme.



Fig. 15

Tiparet mbrojtëse edhe në banesën e Skëndulajve janë të shprehura qartë. Megjithëse pjesa qendrore, paraqitet disi më pak e mbrojtur, e me dy hyrje, pikërisht këto të fundit janë bërë objekt i një përkujdesjeje të veçantë vrojtimi e mbrojtjeje eventuale me armë zjarri. Për këtë qëllim janë ndërtuar frengji, të cilat mbulojnë shumë mirë hyrjet. Ato janë vendosur në murin ballor të nëndivanit, në katojtë, ndërsa nga oda dimërore në katin e ndërmjemë një frëngji dyshe (fig. 15) mbron hyrjen për në katin e ndërmjemë. Tipari mbrojtës shfaqet edhe në tregues të tjerë, si qënia e dy oborreve, mungesa e hapësirave ndriçuese në pamjen e prapme pranë rrugës, dyert në parahyrjen për në katin e ndërmjemë etj.

Duke gjykuar nga teknika e ndërtimit, dhe repertori i ornamentikës, kuptohet se mjeshtrit ndërtues kanë qenë ata, që të organizuara në grupe, tradicionalisht kanë punuar për ndërtimin e Gjirokastrës. Të dhënat gojore përsërisin faktin e njohur se punimet e muraturës dhe strukturave të drurit janë punuar nga mjeshtra kolonjarë, ndërsa për punimet e drurit përmenden mjeshtra nga fshati i Konicës.

Banesa e Skëndulajve, vjen me pak ndryshime në kohë. Ndër to kryesori është ai që lidhet me rindërtimin e dy ambienteve të banimit të krahut jugor. Sipas të dhënave gojore, dhe teknikës së punimit të elementeve arkitektonikë, ky rindërtim i këtyre dy ambienteve duhet ti përkasë periudhës ndërmjet dy dhjetvjeçarëve të fundit të shek. XIX. Konkretisht në ambientin e katit të ndërmjemë të krahut të majtë, është prishur kompleksi origjinal musandër-dhipato dhe në vend të tij është ndërtuar një më i gjërë, duke marrë nga sipërfaqia e odës. Ambienti mbi të është ndarë në dy pjesë, me një ndarje të lehtë. Për t'i shërbyer ambientit të ri ballor, është hapur një derë që del në divan. Siç duket me këtë rast është prishur oxhaku dhe tavani origjinal, ndërsa është ritrajtuar balli i odës. Formulimi i ri me tre dritare të mëdha që mbulohen me hark, flet qartë për evolucionin e këtij elementi arkitektonik. Deri më sot nuk kemi mundur të arrijmë në shkaqet që kanë detyruar këtë ndryshim. Arsyet e degradimit mendojmë se përjashtohen, duke pasur parasysh gjendjen teknike të pjesës tjetër të banesës. Edhe në odën përbri asaj të miqve, kemi një ndryshim, i cili nuk vendoset dot në kohë. Është fjala për prishjen e oxhakut në faqen ballore (fig. 16) dhe ndërtimin në një pjesë të volumit që zinte ai të një dritareje. Vendosja e tavanit në ambientin e katit të ndërmjemë, në krahun e djathtë, është gjithashtu e vonë. Ndryshimi i fundit, siç duket i fillimit të këtij shekulli, lidhet me sajimin e dy ambienteve nën dy qemeret e fundit të harkadës që mban rampën e shkallëve për

DO NOT COPY



Fig. 16

në katin e dytë. Për këtë dritaret që ndriçonin divanin e poshtëm janë zgjeruar poshtë, deri në dysheme, duke u kthyer në dyer, ndërsa balli është mbyllur me një skelet druri, duke ndërtuar në të nga një dritare për secilin ambient. Mbi tirantat e qemereve ishin shtruar dërrasat e dyshemesë.

Gjendja teknike e monumentit, në prag të ndërhyrjes restauruese, para qiste këto probleme. Streha e ballit t odës së miqve ishte e prerë. Dis fragmente të strehëve anësore me tes tekë të shkurtër ishin gjithashtu të de graduar, Muri fundor i daljes në pje sën perëndimore ishte mjaft i dëmtuar Përveç këtyre, rënie suvash e dëmti me të tjera më të vogla ndesheshi në ambiente të ndryshme të banesës ndërsa dritaret e sipërme prej skelet allçije thuajse ishin rrënuar, me për jashtim të disa gjurmëve të pjesshme

Punimet e restaurimit (fig. 17) të kry ra në vitet 1966-1967 patën synimet mëposhtme. Lidhur me qëndrimin kar shi fazave të ndërtimit, në përgjithës u përmbajtëm kriterit të ruajtjes së kë tyre fazave kur ato kishin zhdukur thu ajse tërësisht gjurmët origjinale, dhe rikthimi në fazën e parë nuk do të ishte një ndërhyrje e thjeshtë çlirimi por një rindërtim më fort për analo gji, dhe si i tillë i papranueshëm. Duke marrë parasysh vlerën e madhe të kësaj ve pre këto ndryshime natyrisht që e cënojnë njësinë e saj, por koha ka bërë të vetën dhe ato janë bërë pjesë e historisë së saj. Ndoshta mund të jetë der diku i diskutueshëm vetëm rikthimi i ballit të kësa





Fig. 17

DO NOT COPY

ode, e cila me ndryshimin e saj ka cënuar rëndë pamjen kryesore. Ka shumë mundësi që në brendësi të strukturës së sotme të ruhen gjurmë të formulimit origjinal, i cili padyshim ka qënë i njëllojtë me atë të odës së miqve. Kjo ndërhyrje do të rikrijonte formulim origjinal, por nuk do të përputhej me ritrajtimin e brendësisë. Ndërsa për dy ambientet e sajuar në strukturën mbajtëse të shkallëve, u zbatua pa mëdyshje heqja e tyre, e cila praktikisht, me përjashtim të rindërtimit të dy fragmenteve të muraturës, ishte një veprim që nuk tjetërsonte strukturat origjinale. Kështu pamja kryesore fitoi shumë. Punime plotësimi u kryen në strehën e mbi ballin e odës së miqve, dhe në disa pjesë të tjera, të tilla prekën edhe suvatimet, sidomos në nëndivan. Pastrimi i tamburit të oxhakut nga gëlqerja nxorri në dritë piktu-rimin e tij. Muri fundor në rrezik shëmbje u rindërtua, duke ruajtur me besnikëri formulimin dhe trajtimin e strehës origjinale prej guri. Gjatë viteve 1983-1984, janë kryer edhe disa punime mirëmbajtjeje, si dhe është ndërtuar një derë për në oborrin e parë. Ajo u çvendos nga një banesë tjetër e transformuar jashtë zonës-muze. Me këto punime gjendja statike dhe vlerat e monumentit janë të siguruara. Mbetet trajtimi i elementeve të drurit lidhur me dizinfektimin e tyre, dhe natyrisht mirëmbajtja e vazhdueshme si ndërhyrja më efikase për ruajtjen e vlerave autentike të këtij monumenti të rëndësishëm.

DO NOT COPY

DO NOT COPY


KATI PERDHE
A
A
1 2 KATUA
3 4 QILARI I ZAHIRES
5 STERA
6 NENDIVANI


KATI DYTË
A
1 ODE
2 ODE E MIQVE
3 AMBJENT GATIMI
4 ODE
5 ODE
6 DIVANI I SIPERM
7 QOSHK


KATI PARE
A
A
1 2 ODE DIMRI
3 AMBJENT GATIMI
4 QILAR
5 STERA
6 DIVANI I POSHTEM


PRERJA A-A


0 2 4 6 8 м

Emin RIZA

UN EXEMPLE EVOLUE DE L'HABITATION DE GJIROKASTËR (L'HABITATION DES «SKENDULAJ[1]»)

RESUME

L'habitation de Gjirokastër, remarquable par sa nette évolution morphologique et ses traits, sur le plan compositionnel, se conserve encore de nos jours sous nombreux exemples. La typologie de cette habitation s'exprime en un grand nombre de variantes et sous-variantes, dont quelques unes ont atteint de grandes valeurs architectoniques. La riche expérience des réalisations précédantes et la cristalisation de la typologie au début du XVIIIe siècle, ont créé les conditions requises pour la construction d'une série d'oeuvres connues, pendant les trois premières décennies du XIXe siècle. L'habitation des Kabili (1816), des «Zeka» (1811-12), des «Bakir» (1827) des «Reso» (1831) sont quelques-unes des chefs-d'oeuvres de l'habitation de Gjirokastër, lesquelles, par leur valeurs particulières sont devenues des exemples de l'expression de la grande maîtrise créatrice de nos maîtres constructeurs.

Parmi ces grandes constructions l'habitation des «Skënduli» construite, d'après l'inscription, en 1823, occupe une place importante. Cette habitation qui se conserve à l'heure actuelle avec de petites modifications et à un état technique presque intact, constitue une des plus grandes habitations de Gjirokastër. Elle appartient aux solutions les plus évoluées de la variante connue à deux ailes qui représente le plus haut degré de l'évolution morphologique de l'habitation de Gjirokastër. L'habitation des «Skënduli» constitue un point de référence exact pour connaître les traits et le caractère de l'habitation de Gjirokastër au cours de son épanouissement (1800-1830). La cristalisation, en ce temps-là du programme, de la composition, de la technique de construction et des éléments architectoniques, a mené à une réalisation pleine de valeurs. L'habitation reflète nettement une profonde assimilation des traits compositionnels de l'habitation de Gjirokastër par les maîtres constructeurs, qui paraît-il, voyant le niveau technique et esthétique de sa réalisation, appartenaient au groupe le plus qualifié des maîtres constructeurs de la ville de Gjirokastra et de ses alentours. Vue la période de l'affermissement du pachalik de Joanina, au cours de laquelle dans les contrées de l'Albanie du Sud l'activité constructrice se multiplie sensiblement, l'habitation des «Skëndulaj» et beaucoup d'autres exemples, constituent de grandes réalisations dans le cadre de la ville albanaise, liée à la mode féodale de la production.

L'habitation des «Skëndulaj» se dresse au centre de «Palorto», l'un des plus grands quartiers de la ville. L'ambiance tout autour, se caractérise par des constructions serrées d'une orientation forcée, dont la façade donne sur la pente du terrain à l'Est. A l'état actuel, la pièce qui se trouvait dans l'enceinte a subi des modifications, dont pour connaître l'état original il faut se référer aux données orales. Comme dans la plupart des grandes habitations gjirokastrite, nous sommes ici en présence de deux cours. Dans la première cour se situaient deux pièces accessoires, appelées «odajashta» (pièce au dehors) d'une simple composition à rez-de-chaussée. D'après les données orales initiallement elles étaient destinées à l'emmagasinage des produits agricoles. La deuxième cour, qui sert seulement à l'habitation, est très petite. Dans cette cour pavée de dalles, en face de l'habitation, se trouve une pièce accessoire qui a été munie d'un four, remplissant les fonctions d'une cuisine d'été.

L'habitation des «Skëndulaj» représente le programme maximale de la variante la plus évoluée de l'habitation de Gjirokastër, celle à deux ailes. Malgré le grand nombre de pièces à fonctions bien différenciées, cette habitation appartient à une seule famille. Toutes les fonctions vitales de l'époque, se réalisaient à l'intérieur, à part quelques fonctions accessoires qui étaient remplies par les «odajashta» et le pallier.

D'après la fonction, les pièces se repartissent en principales, accessoires et de communication. Les principales sont celles où l'on habite, où l'on prend les repas et l'on se couche, donc les chambres ordinaires et celle des amis. Les pièces accessoires se relient directement aux fonctions vitales, telle la cave, la citerne, les pièces où l'on fait la cuisine, les installations sanitaires, la cave où l'on mettait le bois à chauffer, et une autre cave qui servait d'abri aux animaux de charge. Le groupe des pièces de communication est composé du «sous-divan», du «divan supérieur» et du «divan inférieur».

Comme dans toutes les variantes évoluées de l'habitation de

1 Skëndulaj – nom de la famille habitant la maison.

DO NOT COPY

Gjirokastër, dans le cas en question, il y a de nettes différenciations fonctionnelles entre les étages. Le rez-de-chaussée n'est pas habité, le premier étage est habité pendant l'hiver et le deuxième étage pendant l'été. Les chambres d'hiver, deux en total, occupent les ailes de l'étage intermédiaire. La chambre de l'aile principale se conserve bien à l'état original. Elle se distingue, comme toutes les autres, par sa composition longitudinale bien marquée, au fond de laquelle se trouve le complexe «musander-dhipato» avec les installations sanitaires. Les placards, les niches, les foyers et les fenêtres à la partie frontale forment une constante de toutes les chambres de cette habitation. Le même schéma compositionnel se rencontre à la pièce du côté opposé. Dans l'étage supérieur les quatres chambres représentent des traitements particuliers tout en conservant la même composition.

La pièce la plus représentable et la plus remarquable de l'habitation de Gjirokastër, c'est la chambre des amis, laquelle occupe l'aile droite de l'étage supérieur. Elle est composée de trois parties, «qoshku», une partie plus élevée que les autres se trouve à la partie frontale de la chambre, ayant un plafond à part et deux rangées de fenêtres placées en hauteur. Au centre se situe le volume principal de la pièce, muni d'une cheminée décorée avec des motifs floraux connus, à sec, avec un plafond à part. Au fond se trouve le complexe «musander-dhipato».

Les pièces accessoires occupent une place importante à l'habitation parce que le caractère de l'économie de l'époque obligeait la famille d'assurer des reserves alimentaires ainsi que des pièces pour leur préparation. Nous sommes toujours à l'époque où l'économie familiale dans la plupart des cas est indépendante du marché.

Les pièces de communication occupent le centre de la composition. L'installation du bloc de l'escalier principal à la partie frontale a diminué leur volume. Les nombreuses portes qui percent les murs du «sous-divan», du divan inférieur et celui supérieur, ne laissent pratiquement aucun coin tranquille. Seulement à l'étage supérieur, au-dessus du volume entre les deux portes de l'étage intermédiaire, qui mènent l'une à un avant-entrée et l'autre au divan inférieur, on a créé un «qoshk» qui nous rappelle ceux de l'habitation à «tchardak».

Du répertoire de l'habitation de Gjirokastër, à l'habitation des «Skëndulaj» il manque seulement la niche. Le manque de cet élément, à la variante ouverte, ayant plus de valeurs esthétiques que fonctionnelles, est complété par le système colonne-voûte qui porte l'escalier menant à l'étage supérieur, lequel s'allongeant en forme échelonnée garnit sensiblement le centre de la façade principale.

L'habitation des «Skëndulaj» appartient aux solutions les plus évoluées de la variante à deux ailes. Le schéma de la composition de planimétrie et de volume connu dans toutes les habitations de Gjirokastër est formé par les blocs compositionnels, lesquels dans notre cas se situent à la forme de la lettre U. L'habitation est composée de deux blocs latéraux et du bloc du fond formé par deux unités principales et trois petites pièces une à chaque étage. Au centre de cette construction sur terrain accidenté se trouvent les pièces de communication qui sont devancé par un système échelonné d'arcade, surmonté de la dernière rampe de l'escalier menant à l'étage supérieur. La formulation de planimétrie, bien que dynamique, en comparaison avec les solutions habituelles, ne se présente pas assez compliquée.

L'habitation des «Skëndulaj se distingue par ses nombreux éléments architectoniques, particulièrement ceux travaillés sur bois. Tout en gardant en général le même schéma compositionnel, ces éléments diffèrent par leur traitement selon la pièce ou la fonction. Ainsi on rencontre un grand nombre de traitements passant des formes simples aux formes compliquées qui conservent aussi de différentes valeurs esthétiques.

La composition de l'habitation des «Skëndulaj» s'éloigne de l'évolution typique verticale de l'habitation de Gjirokastër. Cela est dicté par la grandeur et le traitement du bloc central lequel joue le rôle principal à la vue frontale. L'arcade échelonnée transparente et le large front du «divan» avec l'arcade élégante s'appuyant sur des piliers en bois, donnent de l'espace à la partie centrale laquelle s'harmonise bien avec les deux blocs latéraux. Le manque d'une rigoureuse symétrie dans la façade principale à cause d'un développement assymétrique de la partie centrale, augmente la valeur pittoresque de l'édifice. Contrairement au monumentalisme et à la rudesse typique de l'habitation de Gjirokastër, dans l'habitation des «Skëndulaj» le caractère pittoresque se voit à l'execution des peintures murales dans les parties frontales des chambres qui se trouvent dans les ailes de cette habitation.

En face de l'escalier qui mène à l'entrée du premier étage, il y a un large panneau intéressant, représentant une scène de chasse.

L'intérieur des deux premiers étages conserve bien la simplicité et le localisme des moyens d'expression architectoniques se distinguant de l'étage supérieur, lequel crée une atmosphère tant chaleureuse que solennelle, ayant de larges espaces, une bonne illumination et un riche traitement décoratif, surtout dans les pièces principales.

L'habitation des «Skëndulaj» ayant une chambre d'amis à plafond qui n'est pas peint et la partie au-dessus des placard sans la décoration caractéristique des paneaux qui se répètent comme dans l'habitation des «Zeka» marque le début de la rupture avec cette manière de décoration. La cheminée de la chambre des amis avec ses décorations florales à sec, prouve que c'est dans la deuxième décennie du XIXe siècle qu'il faut chercher l'éloignement de la peinture à l'intérieur, à la gravure et en général au traitement sur bois.

Par rapport aux autres habitations mieux réalisées, l'habitation des «Skëndulaj» se fait remarquer tout d'abord par son volume, étant l'une des plus spacieuses, pour une seule famille. La composition nette et rationnelle, surtout par la solution des escaliers, représente une réalisation peu répandue à la ville de Gjirokastra. Il faut souligner que de telles solutions compos

DO NOT COPY

tionnelles des escaliers se rencontrent même dans les habitation à «tchardak» de la ville de Berat.

Les traits défensifs de l'habitation des «Skëndulaj» se mettent nettement en évidence. Bien que la partie centrale soit moins défendue, ayant deux entrées, celles-ci sont devenues l'objet d'un soin particulier d'observation et de défense eventuelle avec des armes à feu.

L'habitation des «Skëndulaj», n'a pas subi beaucoup de modifications dans le temps. On peut mentionner la reconstruction des deux pièces d'habitation de l'aile sud. D'après les données orales et la technique de traitement des éléments architectoniques, cette reconstruction appartient à la période entre les deux dernières décennies du XIXe siècle. Concrètement, à la pièce de la mezzanine gauche, au complexe du placard on a substitué un autre plus largé prenant de la superficie de la chambre. La pièce en dessus est divisée en deux par une légère cloison. Afin de mieux communiquer, on a percé une porte qui donne sur le «divan». Il paraît que dans ce cas on a supprimé la cheminée et le plafond original et on a reconstruit la partie frontale de la chambre. La nouvelle forme, avec trois grandes fenêtres surmontées d'un arc, marque l'évolution de cet élément architectonique. Même dans la chambre, qui se trouve en face de la chambre des amis, il y a une modification, dont on ne peut préciser le temps. Il s'agit de la substitution, d'une fenêtre à la cheminée, dans le paroi frontal. La construction du plafond dans la pièce de la mezzanine, à droite, est aussi ultérieure. La dernière modification, probablement, du début de ce siècle, se rapporte à la construction de deux pièces en dessous des deux dernières voûtes qui tiennent la rampe de l'escalier menant au deuxième étage. Dans ce but on a élargi les fenêtres qui éclairent le divan inférieur en les transformant en portes, on a fermé la partie centrale par une structure en bois en y perçant une fenêtre pour chaque pièce. En 1966-1967 on a entamé des travaux de restauration selon les critères suivants. Quant aux phases de construction, en général on s'en est tenu au principe de leur conservation quand il s'agissait d'un manque total de traces originales. Ayant en vue la grande valeur de cet édifice, ces modifications naturellement altèrent son unité, mais avec le temps, elles s'insèrent à son histoire. Peut-être on peut discuter la restitution de la partie frontale de cette chambre dont la modification nuit gravement la vue principale. Il est fort possible qu'à l'intérieur de la structure actuelle se conservent les traces de la formulation originale, laquelle sans doute a été pareille à celle de la chambre des amis. Cette intervention allait recréer la formulation originale mains ne conviendrait pas au retraitement de l'intérieur. Quant aux deux pièces ajoutées sous les escaliers, on les a supprimées sans hésitation parce que à part la reconstruction des deux fragments de maçonnerie, rien n'altérait la structure originale. Des adjonctions ont été faites à l'avant toit et à la partie frontale de la chambre des amis dans d'autres parties. On a complété aussi la maçonnerie, surtout dans la pièce du sous-divan. Le déblayage du tambour de la cheminée a fait ressortir sa peinture.

Pendant les années 1983-84 on a entamé aussi quelques travaux d'entretien qui garantissent l'état statique et les valeurs du monument.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 2

1984

monumentet

DO NOT COPY

Robert BALLAURI

ARKITEKTURA, RESTAURIMI DHE MJEDISI URBAN I NJË MONUMENTI HISTORIK*

Banesa që do trajtohet, është një ndërtim i gjysmës së dytë të shek. XIX i ndodhur në një nga lagjet më të vjetra të qytetit të Korçës, «lagjen e Kalasë»[1]. Ajo ishte një nga shtëpitë më të bukura të asaj kohe në Korçë në një nga rrugët më të mira të qytetit,[2] që në dekadat e fundit të shekullit të kaluar, së bashku me rrugën që vjen nga Dishnica dhe futet në pazar u ndërtuan në përshtatje me kërkesat urbanistike të kohës[3].

Kjo banesë me dalje në fasadën kryesore paraqet një tip mjaft të përhapur në shumë qytete të vendit. Këtë tip, që në Korçë u përdor shumë në gjysmën e dytë të shek. XIX, E. Riza e ka cilësuar si «tip të ri»[4]. Po të shikohet rruga nëpër të cilën ka evoluar ky lloj ndërtimi, nëpërmjet shumë ekzemplarëve të banesës me erker do të thoshim se kjo banesë është një krijim i viteve 80 të shekullit të kaluar, në qytetin e Korçës (Tab. I).

Arkitektura. Në rastin tonë kemi të bëjmë me një variant, ku dalja në ballë spikat mjaft e theksuar[5], duke krijuar një notë monumentaliteti dhe një harmoni në format dhe përmasat e saj. Këta lloj ndërtimesh janë nga më të mirët e arkitekturës sonë qytetare të gjysmës së dytë të shek. XIX, në shumë qytete, veçanërisht në Korçë.

Pamja qendrore dhe pamjet anësore janë zgjidhur plotësisht simetrike. Nga mbishkrimi që ndodhet mbi derën e hyrjes së katit të parë, mësojmë se banesa u ndërtua në shtator të vitit 1881. (Tab. II). Ana funksionale e banesës është zgjidhur thjesht dhe qartë. Lartësitë e kateve ndryshojnë, kati i dytë është më i lartë se i pari, ndërsa të gjitha dhomat e banesës hapen në dy «çardakë» që gjenden në secilin kat. Në katin e parë gjenden dhomat e shërbimit, guzhina, dhoma e ngrënies së bukës, dhomat me oxhak ku rihej në kohë dimri, dhe në raste të veçantë edhe flihej, si dhe ambiente e dhoma të tjera për të pushuar. Në katin e dytë janë vendosur dhomat e gjumit për njerëzit e familjes dhe për miqtë, «oda e mirë», një vend pushimi që fillimisht ka qenë në pjesën që del në erker, dhe dhoma të tjera. Kjo banesë ka bodrume vetëm në krahun e majtë, ku radhiten tre ambiente njeri pas tjetrit, 1.80 m të lartë dhe të suvatuar. Në qilarin e fundit është një sofat guri që ka

---

*) Monumenti që po shqyrtojmë është restauruar në vitin 1978, në kuadrin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës të Korçës, sipas projektit të autorit të artikullit. Po atë vit ai u kthye në Muze Historik të rrethit të Korçës.

1) N. Naço, **Korça dhe fshatrat për qark,** Sofie 1901, fq. 3, «Gastra» e Kalasë ishte një nga 8 gastrat (lagjet) që ndahej Varoshi i Korçës në atë kohë.

2) Këto të dhëna mbi ndërtimin e shtëpisë janë marrë prej autorit në vitin 1977 nga pronarja, në moshë 80 vjeçare.

3) N. Naço, **Korça dhe fshatrat**....., fq. 4. Kjo rrugë në fund të shek. XIX ngjiste si një bulevard i mbjellë nga të dy anët me shelgje. Sot ajo mban emrin «Bulevardi Lenin».

4) E. Riza, **Banesa shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX deri rreth çerekut të parë të shek. XX,** Monumentet, 20/1980, fq. 95-96,

5) E. Riza, **Arkitektura popullore në qytetet tona gjatë shek. XVIII-XIX** Kultura Popullore 2/1980, fq. 35. **Historia e Arkitekturës Shqiptare,** Maket, Tiranë, 1979, fq. 503.

shërbyer për vendosjen e enëve të zahiresë së dimrit. Bodrumi është shtruar me pllaka guri, ndërsa të dy katet për banim kanë dysheme dërrase. Tavanet dhe muret e brendshme janë suvatuar me llaç gëlqereje. Në bodrum hyhet nga ana e oborrit, ndërsa nga sa tregojnë, dikur komunikohej nga brenda me një shkallë drase që lidhte bodrumin me dhomën lart të katit të parë, ku hapej një qepenë. Të dy katet komunikojnë me një shkallë, që fillon me një rampë dhe mbaron dyrampëshe, në formë spirali (Tab. III).

Konstruksioni i banesës është me mure guri në gjithë katin e parë dhe mur tulle në të dytin, duke patur trashësi muresh jo të barabarta[6]. Muratura e katit të parë është ndërtuar me gurë të papunuar dhe me 3 rreshta tulla (30 x 14 x 4 cm) (Tab. IV) të vendosura në çdo 80 cm. Qoshet e mureve janë formuar me gurë të skalitur, vetëm në katin e parë.

Dyshemeja e katit të parë pushon anash në dhëmbin që ka krijuar diferenca e gjërësisë së mureve të bodrumit me ata të katit të parë. Në mes ajo mbështetet mbi shtylla drase (çdo 1 m), duke e ngritur dyshemenë nga niveli i tokës rreth 90 cm. Ky ambient i mbyllur nën dysheme ka prezencë të madhe lagështie dhe në këtë rast shtyllat prej druri jo vetëm që sigurojnë qëndrueshmëri më të madhe të trarëve të dyshemesë por ndihmojnë edhe në zgjatjen sa më shumë të jetës së tyre.

Pamja kryesore dhe të dy anësoret jo vetëm që ruajnë secila një zgjidhje simetrike të arritur, por që të trija së bashku harmonizohen dhe krijojnë një unitet, arkitektonik. Balli kryesor është kompozuar në një mënyrë të tillë që nxjerr në pah daljen qendrore ose erkerin, bashkë me të edhe shkallët monumentale prej guri, me dy rampa anësore, si dhe kolonat e gurta, të kulmuara me kapitele. Mbi to është vendosur një arkitra masiv, që mban këtë dalje qëndrore. Një kornizë, që e qarkon banesën nga të tre anët ndan katin e parë nga i dyti, ndërsa një tjetër, më lart, ndan katin e dytë nga çatia. Qoshet e mureve marrin formën e kolonave pak të dala në reliev, me kapitele mbi të cilët mbështeten kornizat e mësipërme.

Faqja veriore e banesës ngrihet mbi rrugën kryesore, ku dikur në tre anët e tjera shtrihej një kopsht i madh e i gjërë. Më përpara kopshti nga ana e rrugës kufizohej me një mur të lartë guri, që mbante nj portë të madhe e të rëndë prej druri. Sot ky mur nu ruhet. Ndonëse të pakët, punimet në hekur flasin pë një realizim të mirë. (Tab. V). Punimet në dru, kryesish dyert, dritaret dhe shkallët që lidhin katin e parë m të dytin kanë larmi formash, sidomos në elementët q i kompozojnë. Dritaret ndryshojnë në përmasa dhe n kompozim.

Korça përfshihet në një zonë me sizmisitet të kon sideueshëm, kështu që ka lindur gjithnjë nevoja pë të siguruar qëndrueshmërinë e ndërtimeve.[7] Për ketë në gjatësi të mureve perimetralë, në kuotën e tavani të katit të parë, pikërisht aty ku lidhet muratura gurtë me atë me tulla, janë vendosur tiranta meta like që formojnë një kontur të mbyllur. Në këtë më nyrë është menjanuar në një shkallë të konsideueshme efekti shkatërrimtar i tërmeteve.

Konceptimi drejt i një banese te tillë dhe zbatimi i mire i saj tregojne që porositësit kanë patu kërkesa funksionale të përcaktuara dhe se mjeshtra projektues dhe ndërtues kanë patur gjithnasntu nje nivel të ngritur profesional. Këta porositës i takonin borgjezisë qytetare, që kishte filluar të lidhej ekonomikisht edhe me shtresa të pasura ose firma tregëtare jashtë trevës së Korçës. Ndërtime të tilla janë frut i zhvillimit kapitalist gjatë shek. XIX. Këto ndërtime në Korçë morën perpjestime të mëdha[8]. Banesat simetrike me erker përmbajnë elementë të neoklasiçizmit, njëkohësisht ato kanë edhe një zgjidhje të qartë inxhinjerike. Kështu në ndërtimet qytetare të traditës u fut për herë të parë llogaritja e strukturave dhe interpretimi i tyre.[9]

Pra shtëpi si kjo, me një zgjidhje arkitektonike të mirë dhe racionale krijojnë nje traditë në ndërtimet qytetare shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XIX.

Kestaurimi. Banesa ruan edhe vlera të mirëfillta historike. Në vitin 1916, në kohën e formimit të Republikës Autonome të Korçës, Themistokli Gërmenji nga ballkoni i saj ngriti flamurin kombëtar dhe shpalli pavarësinë e trevës së Korçës[10]. Banesa i shërbeu administratës së Krahinës autonome deri më 1918 dhe më vonë asaj të Qarkut të Korçës deri më 1920. Më 1936 në zyrat esaj u muar në pyetje dhe

---

6) Muret perimetralë prej guri të katit të parë janë 80 cm të trashë dhe muret ndarës 65 cm, muret anësore prej tulle të katit të dytë kanë trashësi 60 cm, dhe muret e mezit 40 cm, kurse muret perimetralë të bodrumit prej gurësh janë të gjërë 90-100 cm.

7) Shih studimin tonë: **«Mbi arkitekturën e një kompleksi banimi brenda zonës-muze të Korçës»,** Monumentet 2/1982, fq. 67.

8) Z. Shkodra, **Esnafët Shqiptarë (shek. XV-XX)** Tiranë, 1973, fq. 340-342.

9) Leonard Bénévolo, **Histoire de l'architecture nouvelle, Tome I,** Paris 1979, fq. 48-49.

10) **Historia e Shqipërisë,** Vëllimi i II, Tiranë 1965, fq. 447-450.

Iconos

u mbajt në gjendje arresti militanti komunist Ali Kelmendi[11] kurse në kohën e Demonstratës së Bukës[12] shumë të rinj punëtorë, antarë të Grupit Komunist të Korçës, u mbyllën në bodrumin e kësaj banese, që ishte kthyer në burg. Mbas një përdorimi prej afro një shekulli, në këtë shtëpi u ndërmor një restaurim i plotë, ndonëse ajo kish pësuar edhe më përpara meremetime të pjesshme, si ay i vitit 1942 kur u rikthye nga ndërtesë administrative në shtëpi banimi. Detyra e restaurimit vinte në plan të parë zbatimin me përparësi të kritereve që gëzojnë monumentet historike, ku ruhet gjendja e banesës e tillë si ishte në momentin e ngjarjes historike[13].

Duke qenë se monumenti paraqitej në gjendje fizike shumë të keqe dhe degradimi i strukturave kishte marrë përpjestime të mëdha, që në fillim u kalua në çveshjen e mureve, sigurisht atje ku kërkohej ndërhyrje restauruese. Po kështu u veprua për dyert e dritaret prej druri, si dhe në gastin e dyshemeve dhe parmakëve të shkallëve, ku gjithë pjesët e degraduara u zëvëndësuan me pjesë të reja. Kurse në shkallët e drunjta u arrit një ndërhyrje e kënaqëshme. Gjatë punimeve të restaurimit u bënë përpjekje dhe u morën suvatime të imta. Ndërhyrjet për zëvëndësimin e disa gurëve në bazamakët e shkallëve, në panelet e parmakëve me hekur të punuar në këto shkallë, si dhe shumë punime të tjera estetike, që mbushin boshllëqet e krijuara me kohë në këtë banesë, u kryen me arritje të mira. (Tab. VI).

Mjedisi urban. Banesa në shqyrtim gjendet breda njërës nga lagjet më të vjetra të qytetit (Tab. VII) dhe si rrjedhim ngrihet në një mjedis urban të banuar qysh në shek. XV. Për më tepër në burimet osmane[14] përmendet se Korça ka patur një kështjellë brenda së cilës jetonin njerëz në 26 shtëpi[15]. Kjo e dhënë ka vlerë, sepse vërtetohet që zona brenda kalasë banohej qysh në shek. XV dhe që atëhere, në gojën e popullit, kjo është thërritur **«lagja e Kalasë»**. Sot shumë banorë mbi 80 vjeçarë që kanë lindur në qytetin e Korçës, kur flasin për këtë zonë, tregojnë se dikur mbi sipërfaqen ngriheshin trakte muresh prej guri, shumë të gjërë.

Një fakt tjetër që hedh dritë mbi qënien e kësaj kështjelle është se në disa vende ku janë bërë ndërtime të reja, gjatë hapjes së themeleve, në thellësi që shkojnë deri 4 m. nga sipërfaqja e terenit, në 6 vende janë gjetur trakte muresh të vjetër prej guri[16] me lartësi 3-4 m. (Tab. VIII). Drejtimi i këtyre mureve shkonte paralel me rrugët anësore dhe me drejtimin e rrjedhjes së lumit të Korçës. Gjatë gërmimeve për ndërtimet e reja doli se nën muret prej guri, në kuotën rreth 4 m. u gjend një brez me drurë lisi dhe dushku, me seksion ø=15 cm dhe afro 2.50 m. të gjatë, mbi të cilët vendosej muratura. Kjo shpjegohet mbasi në këtë teren rezistenca e tokës ka qenë e vogël për shkak të prezencës së lagështisë dhe duke qenë toka moçalishte, masa të tilla janë marrë për të rritur aftësinë mbajtëse të saj. Në pikat 4 dhe 5 (Tab. VIII), brezat e drurëve u gjendën të pacënuar dhe llaçi i bollshëm që lidhte muraturën kishte krijuar me gurët një bllok monolit. Ndërsa në pikën 2 drurët dhe materiali lidhës ishin dekompozuar plotësisht. Kjo tregon

11) **Dokument i Arkivit Qendror Historik të R.P.S.SH.** F. 2. D. 1. Dok. nr.1223, II, ku prefekti i Korçës bën të ditur se Ali Sulejman Kelmendi është marrë nën vërejtje më datë 6/7/1936.

12) Demostrata e popullit të Korçës kundër rregjimit të Zogut, e udhëhequr nga Grupi Komunist i Korçës, Shkurt 1936.

13) E. Riza, **Restaurimi i banesave popullore,** Tiranë 1981, fq. 33.

14) Halil Inalçik, **Defteri i regjistrimit të Vilajetit të Korçës,** në vitin hixhri 835 (1431) (përkthim shqip).

15) Po aty bëhet fjalë për haset në zotërim të subashit të Korçës, duke përfshirë edhe vetë Korçën me të pafetë, që banojnë brenda në kështjellë, gjithsejt shtëpi 26. **Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shek. XVIII-fillimi i shek. XX.** Kodiku i Korçës dhe Selasforit, përgatitur për botim nga Petraq Pepo, Tiranë 1981, fq. 4. Këtu thuhet se familjet e krishterë që bananin në kala ishin përjashtuar nga pagesa e haraçit dhe e taksave të tjera, dhe në këmbim të kësaj ato ishin ngarkuar për të ruajtur kalanë.

16) Mbi gjetjen e këtyre mureve, kemi mbledhur dëshmitë përkatëse nga specialistë të Ndërmarrjes së Ndërtimit në Korçë, të cilët kanë punuar në hapjen e themeleve të këtyre objekteve.

-Më 1967, në ndërtimin e Hotel Ilirisë

Më 1970 në themelet e banesës shumëkatëshe të banjove. Kjo gjetje përmendet edhe në **Historinë e Arkitekturës Shqiptare,** fq. 404, **Në vitet 1981-1982 gjatë ndërtimit të** bllokut «8 Nëntori» të banesave shumëkatëshe karshi Hotel Ilirisë, kur u hapën themelet e banesave 4, 5, dhe 6.

Tregohet se edhe në hapjen e themeleve të ndërtesës ku sot është hotel Gramozi, **në vitin 1928** u gjendën trakte të tillë muresh prej guri.

FOTOKOPY

se në pikën 2 ka patur prezencë shumë më të madhe ujrash nëntoksore se sa në pikat 4 dhe 5. Në pikën 3 gjendja e muraturës dhe e drurëve poshtë saj nuk kish ndonjë specifikë të veçantë, kurse për pikën 1 qëndron vetëm e dhëna që këta mure shkojnë thellë në tokë, pa asnjë njoftim tjetër plotësues. Muret nëntokë të gjetur kanë gjërësi nga 1.30 – 1.50 m.[17] Duke i konsideruar si themele, konturi që përftojmë nga bashkimi i pikave 1,2,3,4 dhe 5 na jep konfiguracionin e pjesshëm që mund të ketë patur muri perimetral i Kalasë së Korçës. Sipas një veprimi të tillë arrimë të marrim një sipërfaqe brenda mureve me përmasa rreth 150 x 200 m. Pra, një pjesë e mirë e 26 banesave që përmenden në Defterin e regjistrimit të Vilajetit të Korçës në shek. XV, u takon të gjendeshin brenda kësaj zone. Për të vënë në dukje se sa rëndësi ka patur Kalaja e Korçës në vitet e para të pushtimit Osman, mjafton të përmendim se po ato burime e radhitin njëlloj si edhe Kalanë e Treskës[18]. Që të dyja kanë qenë kala garnizonesh, ku strehoheshin trupa me qëndrim të përhershëm e me detyrë për të ruajtur rendin dhe për të siguruar rrugët e komunikacionit në drejtim të vjeljes së taksave në viset e thella malore. Burimet e renditin Kalanë e Korçës në fortifikimet e periudhës së parë të pushtimit osman në ven din tonë[19].

Zona e banuar brenda kalasë së Korçës ka një konfiguracion urbanistik të qartë dhe sot përmban ndërtime të bëra që prej fillimit të shekullit të kaluar deri në vitet 80 të shek. XX. Në këtë zonë ndodhet banesa për të cilën bëhet fjalë në këtë shkrim, si edhe tre pika ku janë gjetur muret mesjetare të Kalasë së Korçës. (Tab. IX). Ky mjedis urban përfshihet në një sipërfaqe prej rreth 3 ha, dhe në të janë vendosur 30 ndërtime qytetare të bëra në më shumë se 160 vjet kohë. Këto banesa janë: ndërtime simetrike me erker gjithsej 4 banesa simetrike pa erker dhe ndërtime të tjera të bëra para vitit 1945 gjithësej 23 dhe 3 banesa shumëkatëshe të ndërtuara pas vitit 1960. Të tilla shtëpi shtrihen edhe në zonat dhe lagjet e tjera të qytetit.

Në Korçë ndërtimet simetrike me erker kanë filluar të ngrihen që gjatë gjysmës së parë të shek. XIX[20] dhe vetëm në gjysmën e dytë të atij shekulli u ndërtuan ekzemplarë me vlerë të këtyre banesave. Të datuara, nga këto kanë arritur pak deri në ditët tona, si rrjedhim është vështirë të vendoset për to një rend kronologjik.[21]

Nga të katër banesat me erker që ndodhen brenda mjedisit urban, banesës së trajtuar i takon të jetë e treta në kohë (Tab. XI).

Ndërtimi i parë paraqet një banesë dy katëshe dy familjare për vetë zgjidhjen funksionale, me lartësi të përmbajtura të kateve dhe me erkerin pak të dalë, që na jep një nga format më të hershme të tij Si ndërtim është i dekadave të para të shekullit të kaluar[22]. Muret perimetralë janë prej guri, me të njëjtën gjërësi në të dy katet. Muret e ndërmjetme me gurë në katin përdhe dhe prej qerpiçi në katin e parë. Banesa tjetër është njëfamiljare dhe i takon mezit të shek. XIX. Edhe kjo ngrihet me mure të së njëjtës gjërësi nën të dy katet. Erkeri mbështetet mb katër kolona guri të skalitur dhe kompozohet me hy rje dy rampëshe, me nga tre këmbë shkallë. Ky varian reflekton në mënyrë të qartë fillimet e atij zhvillim ekonomiko-shoqëror të mezit të shekullit të kaluar që përmbante edhe kërkesat në rritje të shtresav tregëtaro-zejtare, sidomos pas reformave të Tanzima tit, kur u dukën elementet e parë të mënyrës kapita liste të prodhimit[23] (Tab. X). Banesa e katërt, ngritur në fund të shek. XIX është dykatëshe një fa miljare dhe dallohet si një ndërtim i veçantë, më arritur se tri banesat e para në trajtimin arkitekto nik dhe zgjidhjen funksionale. Erkeri ka një dalj mjaft të theksuar, mbahet me katër kolona prej gu të punuar dhe merr pjesë në kompozimin e gjithë hy jes. Muret lartësohen me gjërësi të ndryshme, pë bodrumin dhe katet. Në katin e parë ata janë pre

17) Sipas të dhënave të specialistëve të ndërtimit që kanë punuar në ndërtesën shumëkatëshe të banjove, në Hotel Iliria dhe në kullat e Bllokut «8 Nëntori».

18) Halil Inalçik; **Defteri i regjistrimit të Vilajetit të Korçës,** ku përmendet se në Timarin e Jusuf Ogllaniut, fshati Rehovë iu dha si shtesë dizdarit të Kalasë së Treskës. Treska, në shek. XV e më vonë konsiderohej fshat.

19) **Historia e Arkitekturës Shqiptaret,** Maket, fq. 315-319.

20) **Po aty,,** fq. 503, R. Ballauri, **Mbi arkitekturën e një kompleksi banimi, të shek. XIX,** fq. 59.

21) **Historia e Arkitekturës Shqiptare,** fq. 503.

22) Si zgjidhje planimetrike dhe funksionale kjo banesë ndryshon nga ndërtimet e tjera dy familjare të shek. XIX në Korçë shih: E. Riza, **Banesa dyfamiljare në qytet,** Monumentet 2 1981, fq. 115-118.

23) Z. Shkodra, **Esnafët Shqiptarë (shek. XV-XX),** Tiranë, 1973, fq. 338.

DOKTORATURA

guri me rreshta tullash dhe në të dytin prej tulle. (Tab. XI).

Gjithë studimet e deritanishme japin të dhëna që në Korçë ky tip banese gjeti një zhvillim më të madh se sa në qytetet e tjerë të Shqipërisë dhe krijoi shtëpi të arritura, deri tri katëshe, nga të cilat sot ruhet akoma një e tillë, me funksion dyfamiljar[24]. Të gjithë këta ndërtime janë frut i vetë kohës dhe si shprehje arkitektonike i përgjigjen realitetit historik shqiptar të shek. XIX.

Nga sa pamë, ky mjedis urban që përfshihet në «lagjen e Kalasë», banohej qysh në shek. XV. Njoftime të tjera hedhin dritë se këtu jeta u zhvillua edhe gjatë shek. XVIII[25]. Jeta në të vazhdon edhe në ditët tona, kështu arrijmë në bindjen se ky mjedis, që bën pjesë në ish «gastrën e Kalasë së Varoshit të Korçës» paraqet një nga lagjet më të vjetra të qytetit.[26]

Në përfundim vëmë në dukje se:

1. Faktor kryesor në këto ndërtime qytetare ishin kushtet politike dhe ekonomike që u krijuan në gjysmën e dytë të shek. XIX.

2. Mjedisi urban që morëm në studim, me një vazhdimësi jete për më se pesë shekuj, na jep si rrjedhim edhe një vazhdimësi të arkitekturës. Ndonëse këta ndërtime kanë nisur të bëhen që prej fillimit të shekullit të kaluar e më vonë, ndër ta dallohet tradita ndërtimore vendase. Banesat simetrike qytetare të shek. XIX, midis tyre edhe ndërtimet me erker, janë vepra përfaqsuese të arkitekturës të Rilindjes sonë Kombëtare.

3. Teknika e ndërtimeve qytetare në shekullin e kaluar bëri hapa përpara, duke zgjidhur me materiale rrethanore shumë probleme inxhinjerike, kryesisht me përfundime të nxjerra nga praktika. Nëpërmjet kësaj përvoje u formuan mjeshtrat popullorë të ndërtimit në trevën e Korçës, të cilët dhanë një ndihmesë me vlerë në ndërtimet e kohës, jo vetëm brenda truallit tonë, por edhe në vendet fqinje.

DO NOT COPY

24) Është fjala për banesën që ndodhet në Korçë, Rruga Pavllo Katro, nr. 2.

25) **Materiale dokumentare për Shqipërinë juglindore**... I, fq. 17. Atje thuhet se në vitin 1779 me ferman u caktua një vend i ri për varrezat e komunitetit ortodoks të Korçës. Ky vend ndodhej jashtë mureve, në pjesën veriore dhe ndahej nga lagja e Kalasë prej rrugës kryesore që lidhte trevat e Maqedhonisë me qytetet bregdetare të Detit Jon. Vetkuptohet se varrezat janë bërë gjithnjë në periferi të qendrave të banuara. Kështu zonës urbane të Kalasë, që në atë kohë banohej vetëm nga familje të krishtere, iu krijuan kushtet për të patur afër varrezat e veta.

26) **Po aty,** fq. 8. Më 1707 Varoshi i Korçës filloi të ndërtonte kishën katedrale. Dihet se gjatë shek. XVIII rreth kësaj kishe u formua edhe një bërthamë tjetër urbane, ku lindën lagjet Penço dhe Mano.

TAB I



DO NOT COPY

TAB II

PAMJET KRYESORE

PARA DHE PAS RESTAURIMIT

PAMJA VERILINDORE





PAMJA VERIPERENDIMORE





GURI I DATUAR MBI PORTËN E HYRIES TË PAMIES VERIPERËNDIMORE





DO NOT COPY

TAB III

PLANIMETRIA E KATEVE

0 1 2 3 4 5 10 M.

BODRUMI



KATI I PARË



KATI I DYTË





PARA DHE PAS RESTAURIMIT

LARTESIA E KATEVE



DO NOT COPY

TAB IV

DO NOT COPY

STRUKTURA E MUREVE

0 10 20 30 40 50 60 80 100 CM



DETAJ
I MUREVE
PERIMETRALË

DETAL I QOSHEVE





PARA RESTAURIMIT

TAB V

DO NOT COPY

PUNIME NË HEKUR

PARA





DHE PAS RESTAURIMIT



KONSOL BALLKONI

0 20 40 60 80 100 CM.



PARA

DHE PAS RESTAURIMIT



PARMAK
BALLKONI



PARAPET
SHKALLËSH

TAB VI



1 · DERË E BRENDSHME

2 · DERA NË BALLKON

3 · DERA E HYRJES NË KATIN E PARË

PARA





PARA



DHE PAS RESTAURIMIT



DHE PAS RESTAURIMIT

DO NOT COPY

TAB VII



DO NOT COPY

TAB VIII

DO NOT COPY



TAB IX

DO NOT COPY

ZONA NË LAGJEN E KALASË

KU NGRIHET BANESA PËR TË CILËN BËHET FJALË

PLANIMETRI E VITIT 1980



TAB X

DO NOT COPY

NDËRTIME ME ERKER
NË LAGJEN E KALASË

2. BANESË NIËFAMILJARE
RRUGA " MISTO MAME „ NR.3







KATI PËRDHE



KATI I PARË



KATI I PARË

1. BANESË DYFAMILJARE
RRUGA " NDRE MIEDA „ NR. 5 DHE 7



BODRUMI



KATI I DYTË



TAB XI

NDËRTIME ME ERKER
NË LAGJEN E KALASË

0 1 2 3 4 5 10 M.

3. BANESË NJËFAMILIARE
BULEVARDI " LENIN " NR.43





KATI I PARE

4. BANESË NJËFAMILIARE
RRUGA " NDRE MJEDA " NR 9





BODRUMI

KATI I DYTË



KATI I PARË



KATI I DYTË



BODRUMI

DO NOT COPY

Robert BALLAURI

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE, LA RESTAURATION ET LE MILIEU URBAIN D'UN MONUMENT HISTORIQUE

RESUME

L'habitation dont il est question est une construction de la deuxième moitié du dernier siècle, trouvée dans un des plus anciens quartiers de la ville de Korça, au quartier «Citadelle». Cette habitation, à sortie dans la façade principale présente un type assez répandu dans plusieurs villes du pays. Ce type assez fréquent à Korça, pendant la deuxième moitié du XIXème siècle, est qualifié de «type nouveau» par E. Riza.

L'architecture. Il s'agit dans notre cas d'une variante à sortie assez accentuée sur la façade principale. Ces sortes de constructions sont les plus réussies de l'architecture urbaine de la deuxième moitié du XIXème siècle.

L'aspect central est complétement symétrique avec la solution des vues latérales. On apprend d'après l'inscriptiongravée sur le fronton de la porte d'entrée au rez-de-chaussée que l'habitation a été construite en 1881. Le côté fonctionnel de l'habitation a été réalisé par des planimétries simples et claires. Les étages sont de différents hauteurs, le premier étant plus haut que le rez-de-chaussée et toutes les pièces de l'habitation des deux étages s'ouvrent dans de grands espaces dits çardak. Les deux niveaux communiquent au moyen d'un escalier qui commence par une rampe et finit par deux branches en forme de spirale. La construction de l'habitation est en pierres au rez-de-chaussée et en briques à l'étage. La largeur des murs aussi est inégale. Les murs du rez-de-chaussée sont construits en pierres brutes, mais les coins sont formées de pierres taillées.

L'aspect principal avec les deux vues latérales ne présentent pas seulement une solution symétrique réussie mais les trois ensembles s'harmonisent pour créer une seule unité architecturale. Le front principal est composé de façon à mettre en vue la saillie centrale (ou l'encorbellement) le grand escalier en pierre et les colonnes également en pierre couronnées de chapiteaux.

La face septentrionale de l'habitation s'élève sur la rue principale. Tout autour il y avait un grand jardin large. Auparavant, du côté de la rue, le jardin se bornait d'un haut mur de pierre qui portait une lourde et grande porte de bois. Quoique en petit nombre, les façonnements en fer sont bien réussis.

La ville de Korça est comprise dans une zone de sismicité considérable. Pour cette raison on a en toujours besoin d'assurer la solidité des constructions. Pour ce faire il y a le long des murs des bandes de fer formant des contours fermés.

La restauration. L'habitation garde aussi des valeurs historiques proprement dites. En 1916 à l'époque de la fondation de la République Autonome de Korça, Themistokli Gërmenji, a élevé sur son balcon le drapeau national pour proclamer l'Indépendance de la région de Korça. Une totale restauration s'est entreprise après une utilisation d'à peu près un siècle. La restauration avait pour but d'appliquer avec priorité les critères concernant tous les monuments historiques pour conserver l'état de l'habitation tel qu'il a été au moment de l'événement historique.

Le milieu urbain. L'habitation se trouve dans un des plus anciens quartiers de la ville (pl. VII), par conséquent elle s'élève dans un milieu urbain habité depuis le XVème siècle. D'après les sources ottomanes de ce siècle à Korça il y avait une citadelle habitée, avec 26 maisons. C'est une donnée de valeur qui dénote que la citadelle était habitée depuis le XVème siècle et que depuis lors elle est appelée par les gens «le quartier de la Citadelle». Aujourd'hui pas mal d'habitants plus qu'octogénaires et natifs de Korça affirment qu'auparavent des fragments de mur de pierre assez larges s'élevaient sur la surface du sol.

Mais un autre fait affirmant l'existence de cette citadelle, ce sont les vestiges d'anciens murs de pierre d'une hauteur de 3 à 4 m trouvés dans quelques endroits, 6 au total, lors du creusement des fondations des nouvelles constructions à une profondeur de 4 m. de la surface du sol. La direction de ces murs était parallèle aux rues latérales et au cours de la rivière de Korça. Pendant le creusement des fondements des nouvelles construction on a vu qu'au-dessous des murs de pierre, à la côte 4 m. environ, il y avait une bande de bois de chêne sur laquelle était assis le mur. De telles mesures ont dû être prises pour augmenter la capacité portante du sol étant donné que le sol, plutôt marécageux, a été d'une faible résistance à cause de l'humidité. Les bandes de bois sont trouvées intacts et le mortier abondant avait formé un bloc monolithique avec les pierres du mur. Les murs souterrains ont une largeur de 1,30 à

1,50 m. En les considérant comme fondements, leur contour semble nous donner une configuration partielle que les murs de la Citadelle de Korça auraient dû avoir.

La zone habitée dans la Citadelle de Korça est d'une claire et nette configuration urbanistique, ayant des constructions datées depuis le début du siècle dernier jusqu'aux années 80 de notre siècle. Il y a l'habitation qui nous a concerné, ainsi que trois points où l'on a trouvé les vestiges des murs de la Citadelle de Korça. (pl. IX). Ce milieu urbain s'étend dans une superficie de 3 ha, environ, et comprend 30 constructions urbaines effectuées dans plus de 160 ans.

Des quatre habitations symétriques à encorbellement qu'on peut trouver dans cette zone, l'habitation en question chronologiquement occupe la troisième place (Pl. XI). La première construction est une habitation à étage, pour deux familles, quant à la solution fonctionnelle à une hauteur modérée des niveaux ou l'encorbellement peu saillant, comme l'une de ses plus anciennes formes. Elle a été construite pendant les premières décennies du dernier siècle, tandis que la deuxième habitation, pour une seule famille au milieu du XIXème siècle. L'encorbellement s'appuie sur quatre colonnes de pierres taillées et se compose à l'entrée par deux escaliers de trois marches aux côtés. La quatrième habitation se distingue des trois premières en tant qu'une construction plus réussie au point de vue architectural et à une solution fonctionnelle. L'encorbellement est d'une saillie assez accentuée, appuyée sur quatre colonnes de pierres taillées et qui prend part à la composition de l'entrée (Pl. XI).

Toutes les études effectuées jusqu'à présent aboutissent à la conclusion que ce type d'habitation a trouvé à Korça un plus grand développement que dans les autres villes de l'Albanie. Ces constructions sont le résultat de l'époque et en tant qu'expression architecturale, elles répondent à la réalité historique albanaise du XIXème siècle.

DO NOT COPY

Nr. 2

1984

monumentet

DO NOT COPY

Isuf SUKAJ
Hajredin ISUFI

VËSHTRIM MBI ARKITEKTURËN DHE VEÇORITË FUNKSIONALE TË HANEVE NË QYTETET DURRËS DHE KAVAJË

(Shek. XIX — fillimi shek. XX)

Qyteti i lashtë i Durrësit, si port dhe qendër për tregtinë tranzite, nga fundi i shek. XVII dhe veçanërisht në shekujt XVIII e XIX, ka luajtur një rol të rëndësishëm për marrëdhëniet tregtare të brendshme e ndërkombëtare si dhe për ndërlidhjen e krahinave të Ballkanit me botën e perëndimit për shkëmbimin e mallrave.[1]

Transporti i mallrave nga ky port në këtë periudhë e deri në çerekun e parë të shekullit XX[2], kryhej me mjete primitive transporti, kryesisht me karvane kuajsh, që udhëtonin në çdo stinë të vitit nëpër rrugët e vjetra tregtare: Durrës-Kavajë-Elbasan-Strugë-Manastir-Ohër-Shkup-Kavajë-Elbasan-Pogradec-Korçë, Durrës-Kavajë-Lushnjë-Berat-Gjirokastër-Janinë, Durrës-Ura e Zezë-Mamuras-Lezhë-Shkodër etj.

Pushimi i kafshëve dhe i personelit të karvaneve të shumta, bëhej në ndërtesat e haneve, që kanë qenë ndërtuar pothuajse në çdo qytet[3], si dhe gjatë rrugëve në qendra të vogla banimi, aty ku përfundonte etapa ditore e udhëtimit.

Sasia e mallrave që transportonin qiraxhinjtë (pronarët e kafshëve të karvaneve) në portin e Durrësit, ishte e madhe dhe e shumëllojshme dhe me këto mjete transporti ajo përballohej me pjesëmarrjen e shumë karvaneve me qendra në vilajete dhe në sanxhaqe e kaza të ndryshme. Nga këto më të dalluar kanë qenë qiraxhinjtë nga Kavaja, Elbasani, Korça, Berati, Durrësi, Lushnja, Vlora, Lezha, Shkodra, Manastiri, Shkupi, Janina etj, që transportonin nga qytetet e tyre prodhimet e vendit për eksport dhe anasjelltas nga Durrësi ato transportonin mallrat e importit.

Qiraxhinjtë në përgjithësi kishin në pronësinë e tyre nga 3 deri në 12 kuaj, dhe ndaheshin në bashqiraxhinj, të përbërë zakonisht nga dy-tre vëllezër me 10-12 kuaj së bashku, dhe në qiraxhinj të thjeshtë që kishin vetëm nga 2-3 kuaj secili. Udhëtimi bëhej në grupe me pjesëmarrjen e një bashqiraxhiu dhe me dy-tre qiraxhinj të thjeshtë, duke formuar kështu një karvan me 18-20 kuaj madje dhe më shumë që siguronin më mirë të papriturat gjatë rrugëve të gjata, të vështira dhe të rrezikshme.

Nga pamundësia e banimit në Durrës, si pasojë e klimës së keqe moçalore, Kavaja në këtë periudhë, mbasi ishte bërë qendër e rëndësishme ekonomike zejtaro-tregtare e bujqësore[4], zhvillonte edhe një veprimtari aktive në marrëdhënjet tregtare me qytetet kryesore të vendit dhe me krahinat e ndryshme të Ballkanit.[5] Pozita e saj shumë afër portit tranzit të Durrësit,[6] bëri që qeraxhinjtë e shumtë kavajas të përballonin një ngarkesë të madhe transporti dhe duke rrezatuar me udhëtimet e tyre të gjata në të katër anët e vendit, luajtën një rol pozitiv edhe për

---

1) Z. Shkodra, Esnafet Shqptare, Tiranë 1973, fq. 80, 81.
2) I. Fishta — V. Toçi, Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat, Tiranë 1983, fq. 8.
3) E. Çelebi, Shqipnia para dy shekujsh, Tiranë 1930, fq. 102. Sallnonnet e vilajeteve. vilajeti i Shkodrës 1897, etj.
4) I. Sukaj, Vështrim mbi zhvillimin e urbanistikës dhe të arkitekturës së Kavajës, Monumentet 2/1982, fq. 30.
5) J.G. Hahn, Albanesische studien, Wien 1854, vëll. I, fq. 150.
6) E. Barbarich, Albania, Rome 1905, fq. 249.

komunikimin informativ, për zhvillimin kulturor të qytetit dhe për ndërlidhjen me rrethet patriotike të krahinave të ndryshme.

Nëpërmjet të dhënave gojore të të moshuarve, pjesëmarrës në personelin e karvaneve, mësojmë se bashqiraxhinjtë kavajas ishin ndarë në një drejtim të caktuar, duke formuar karvane të veçanta. Kështu p.sh. rrugën Durrës-Kavajë-Manastir-Shkup e bënin disa grupe qiraxhinjsh që udhëtonin vetëm në këtë drejtim, rrugën Durrës-Kavajë-Elbasan, e bënin disa grupe të tjerë e kështu me radhë edhe për rrugët Durrës-Kavajë- Berat, Durrës-Kavajë-Janinë etj.

ndërkombëtare që ndikuan pozitivisht në forcimin e lidhjeve ekonomike ndërmjet tyre.

Të dhëna të sakta mbi fillimin e ndërtimit të haneve në qytetet Durrës dhe Kavajë, sot për sot nuk kemi. Nga dokumentat më të hershme kemi njoftimin e Evlija Çelebiut në gjysmën e dytë të shek. XVII, për ekzistencën e dy haneve në Kavajë. Ndërsa në fund të shek. XIX në Salnamenë e vilajeteve[8] gjejmë të regjistruar 9 hane në prefekturën e Durrësit dhe 12 hane në nënprefekturën e Kavajës. Nëpërmjet gjurmimit të vendeve ku kanë mbetur në këmbë, por të transformuara, nëpërmjet materialeve fotografike të mu-



Fig. 1

Në qytetet Durrës dhe Kavajë, ku përfundonin dhe zenin fill rrugët e qiraxhinjve të krahinave të ndryshme të vendit dhe të Ballkanit, ndërtesat e haneve ishin bërë domosdoshmëri funksionale. Ndërtimi i tyre si objekte, duke i parë qoftë nga ana numerike, ashtu dhe nga vëllimet, cilësia dhe arkitektura e tyre, njohu zhvillimin më të madh në shekullin e XIX dhe në fillim të shek. XX. Kjo përkon me periudhën e rritjes dhe të zhvillimit të dukshëm të tregut në qytetet tona në përgjithësi.[7] dhe me formimin e tregjeve

zeumeve historike të të dy qyteteve, si dhe nga të dhënat gojore të të moshuarve, mundëm të identifikojmë 4 hane në qytetin e Durrësit dhe 16 hane në qytetin e Kavajës. (fig. 1). Nga këto në Durrës dy hane kanë qenë me dy kate dhe dy hane me nga një kat, ndërsa në Kavajë 6 hane kanë qenë ndërtuar me dy kate, të cilat dhomat e fjetjes i kishin në katin e dytë, dhe 10 hane me nga një kat që funksiononin si hane ditore, vetëm për mbajtjen e kafshëve.

Gjatë rrugës Durrës-Kavajë dhe Kavajë-Rrogo-

7) Z. Shkodra, Proçesi i ç'thurjes së feudalizmit... Tiranë 1957, fq. 22.
8) Salnamet e Vilajeteve, Vilajeti i Shkodrës, 1897.

DO NOT COPY

zhinë kanë pasë funksionuar edhe 8 hane të tjera, përkatësisht nga 4 në çdo pjesë rruge, nga të cilat disa kishin edhe dhoma për fjetjen e qiraxhinjve dhe të rrugtarëve, ndërsa të tjerat kishin karakter tranzit, sepse shërbenin kryesisht për pushimin dhe ushqimin e kafshëve.[9] P.sh. në pjesën Durrës-Kavajë, pranë Shkëmbit të Kavajës ka qenë ndërtuar një han me dy kate, që shërbente edhe si restorant, kafe dhe për fjetje. Tre hanet e tjera me nga nji kat, kanë qenë ndërtuar radhazi, njeri në km 9 (nga Durrësi), tjetri aty ku është sot stacioni i trenit në Golem dhe i treti në buzë të detit, pranë Malit të Robit në afërsi të mikrotoponimit «Qisha»[10] (nga vendasit ky han thirrej hani i Qerretit te «Qisha»). Ndërmjet Kavajës dhe Rrogozhinës të katër hanet kanë qenë ndërtuar me nga një kat, dy prej të cilëve përbri rrugës në fshatin Harizaj, njeri në fshatin Gose dhe i fundit në Rrogozhinë. Më tej vazhdonin hanet e Peqinit të Elbasanit.

Me funksionet e këtyre haneve, përveç shërbimeve kryesore për fjetjen e qiraxhinjve dhe të rrugëtarëve, të strehimit dhe të ushqimit të kafshëve, shpesh herë lidheshin edhe shërbime të tjera plotësuese për gjininë e këtyre lloje ndërtimeve, siç janë p.sh. ato të profesioneve të nallbanit, të samarxhiut, të shërbimeve veterinare popullore, të shitje-blerjes së sanës dhe të tagjisë, etj. Këto kërkesa funksionale kanë qenë faktorët kryesorë të kompozimit planimetrik të haneve, të cilët janë bërë faktorë që të përfshihen një seri mjedisesh të ndryshme jetësore, artizanale, shërbimi, vend strehimi për kafshë dhe depot përkatëse.

Nga pikpamja organizative, hanxhinjtë kishin esnafin e tyre, i cili në bashkëpunim me organet shtetërore, kishte për detyrë kryesore rregullimin e tarifave të fjetjes dhe të qëndrimit të kafshëve në hane, caktimin e çmimeve të shitjes së sanës, të tagjisë dhe frenimin e konkurencës, nëpërmjet ndalimit të vendosjes së çmimeve sipas dëshirës etj. Për këto probleme dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura, esnafi zhvillonte mbledhje të rregullta që vazhduan deri në vitin 1913[11]. Nga ana tjetër edhe karvanxhinjtë (qiraxhinjtë) kishin esnafin e tyre, që kishte për detyrë rregullimin e tarifave për bartjen e mallrave sipas rrugëve që bënte karvani[12] etj.

Hanxhinjtë dhe qiraxhinjtë e këtyre dy qyteteve, në fund të shek XIX dhe në dekadën e parë të shek. tonë i kanë dhënë ndihmesën e tyre lëvizjes për pavarësinë tonë kombëtare, duke u bërë vatra të rëndësishme për strehimin e patriotëve të ndryshëm, për grumbullimin dhe shpërndarjen e trakteve të ndryshme kombëtare dhe të librave në gjuhën shqipe – si dhe për lidhjen e komunikimin me rrethet patriotike të krahinave të vendit. Kështu p.sh. qiraxhiu Haxhi Hasan Dimni sillte në Kavajë me karvanin e tij libra në gjuhën shqipe të cilat me anë të hanxhiut Sali Kullolli i dorëzoheshin përhapësit të gjuhës dhe të shkrimit shqip, patriotit Besim Sinella. Në vitet 1910-1911 hani i Must Tiranës në Durrës u bë bazë për grumbullimin dhe shpërndarjen e armëve për kryengritjen e Malësisë së Kurbinit[13]. Ndërsa patrioti kavajas, qiraxhiu Qazim Merhori vuri në dispozicion të Ismail Qemalit dhe shoqëruesve të tij, kuajt e vet dhe i përcolli ata deri në Vlorë.[14]

Nëpërmjet studimit të haneve të ndërtuara në këto dy qytete, vlerësuar nga ana arkitekturore, e numrit të mjediseve e ndarjes funksionale, e komoditetit të zgjidhjeve dhe e materialeve të ndërtimit, dallohen hanet me dy kate, disa nga të cilat merituan përparësinë që nëpërmjet kërkimit të gjurmëve ndërtimore, përveç të tjerave, t'i bëjmë rikonstruksione hipotetike dhe punime grafike mbi bazën e materialeve fotografike arkivale.

NË QYTETIN E KAVAJËS hanet kanë qenë vendosur në zonat pranë shesheve tregtare të pazarit si dhe buzë rrugëve kryesore që të çonin në pazar ose ishin pjesë e tij, në vazhdim të linjës së vargjeve në formë korridori të dyqaneve. Ato nuk ishin ndërtuar në grupe, gjatë një rruge të caktuar, siç kanë qenë grupuar dyqanet e një zeje të vetme në blloqe të veçanta[15], por ishin shpërndarë në të katër anët e pazarit (fig. 1), duke kryer kështu më mirë funksionin e tyre, që lidhet me drejtimin e lëvizjeve të qiraxhinjve dhe të ardhjes me kafshë të fshatarëve për

9) Bisedë e autorëve me hanxhiun Qerim Guma i dat. 1884, Kavajë dhe Maliq Kërtusha i dt. 1900 Durrës.

10) H. Myrto, Mbi disa qendra arkeologjike ndërmjet Kavajës e Durrësit, Monumentet 7-8/1974, fq. 251.

11) M. Kaucky, Mittelalbanische Stad und Wirtschafchilder në rev. «Osterreichische Monatchrift fur den Orient, 1916, Nr. 1-6.

12) Z. Shkodra, **Vep.cit**, fq. 206.

13) P. Pepo, Lufta për çlirimin kombëtar 1878-1912, (Kujtime veteranësh) Tiranë 1962, fq. 421.

14) Koli Xoxe, Ismail Qemali (jeta dhe vepra) Tiranë 1983, fq. 245.

15) I. Sukaj, Urbanistika dhe arkitektura e pazarit mesjetar të Kavajës, Monumentet 1/1981, fq. 37-38.

ZOTËRUAR



Fig. 2

shitjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale në pazar. Këto hane, megjithëse të pakët në numër në krahasim me dyqanet, ndërtuar përbri dhe ngjitur me ato, sipas rregullsisë së linjave të drejta, por jo kuadratike, ndihmuan në larminë arkitekturore të blloqeve të dyqaneve që përbënin elementin kryesor në formulimin e ansamblit të pazarit.

Hani Nr. 1. I ndërtuar rreth vitit 1830 dhe i vendosur në të djathtë të rrugës kur vjen nga Durrësi, nga ana veriore në hyrje të pazarit, aty ku është sot hoteli i qytetit, ky han me vëllimet dhe sipërfaqet e mëdha të tij, ishte një nga ndërtesat më të mëdha dhe më të vjetra të kësaj gjinie në qytetin e Kavajës.

Ndërtuar buzë rrugës së «Madhe» (fig. 2), me pamjen kryesore të orientuar nga ana lindore përgjatë kësaj rruge, hani ishte i kompozuar me skemën kompakte simetrike të mbyllur me formë planimetrike drejtkëndëshi.

Hani kishte dy kate, në hyrjen kryesore në qendër nga ana e rrugës së «Madhe», një portë e madhe e mbuluar me qemer, të fuste në një korridor tërthor për t'u lidhur me mjediset e katit përdhe, me shkallën dhe oborrin e brendshëm.

Në katin përdhe ishte vendosur dhoma e hanxhiut ngjitur me portën e hyrjes, hauret për strehimin e kafshëve të qiraxhinjve, një depo për tagji dhe shkalla, përgjithësisht të mbyllura. Kati i dytë ishte kompozuar, me dy radhë mjedisesh për fjetje, nga të dy anët e koridorit qendror që lidhej drejtpërdrejt me shkallët. Në këtë kat kishte: 12 oda për fjetje me dritare nga ana e rrugës dhe oborrit dhe një nyje sanitare që dilte jashtë bllokut drejtkëndësh të godinës në fund të korridorit Në oborrin e rrethuar me mure me përmasa nga njëra anë sa gjatësia e hanit dhe brinja tjetër rreth 30 m, ishin ndërtuar depot e sanës pusi për furnizimin me ujë të pijshëm dhe vendet për lidhjen e kafshëve me qëndrim ditor.

DO NOT COPY

Të dy katet e hanit janë ndërtuar me mure guri, llaç gëlqere me breza druri me çati me strehë të dala pak, mbuluar me tjegulla vendi.

Trajtimi arkitekturor i godinës ishte i thjeshtë, ajo ka të theksuar pjesën qendrore me portën e hyrjes në kartin përdhe dhe me një ballkon në katin e dytë. Në këtë ballkon, sipas të dhënave që disponon Muzeu historik i qytetit Kavajë, më 27 Nëntor 1912, nga patriotë përparimtarë vendas, u ngrit flamuri kombëtar.[16] (fig. 2).

Kjo ndërtesë ka funksionuar si han deri në vitin 1911, pas këtij viti e deri më 1940, vit në të cilin është djegur, ka qenë përshtatur për ndërtesë administrative për nënprefekturën e qytetit dhe për organet e tjera.

Hani Nr. 2. Ka qenë ndërtuar në pjesën veriore të pazarit ngjitur nga ana jugore me ndërtesën ku është sot Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit (fig. 1). Përbëhej nga dy blloqe ndërtimi të bashkëngjitur, nga të cilët njeri ishte me dy kate ku ndodheshin gjashtë oda për fjetje në katin e dytë dhe një kafene e dhoma e hanxhiut në katin përdhe, ndërsa në bllokun tjetër me një kat me hyrje të veçantë nga ana e rrugës kryesore ishte hauri për mbajtjen e kafshëve. Ka funksionuar si han deri në vitin 1932, pas këtij viti u përshtat vetëm për hotel dhe për kafene deri në vitin 1963.

Hani Nr. 3. Ka qenë ndërtuar në pjesën qendrore të vargut perëndimor të dyqaneve të pazarit në krahun perëndimor të sheshit të qendrës së sotme të qytetit (fig. 3). Me pamjen kryesore të tij të orientuar nga lindja buzë rrugës së «Madhe», merrte pjesë në formulimin arkitekturor të të gjithë këtij blloku të gjatë rreth 120 m. Ka qenë ndërtuar në vitin 1870 dhe ka funksionuar si han deri në vitin 1916 kur pjesa e pamjes kryesore u prek nga ndërtimi i linjës së dekovilit nga ushtritë Austro-Hungareze. Hani i kompozuar me skenën kompakte të mbyllur me formë planimetrike të gërmës «L», përgjatë rrugës së «Madhe» me dy kate ka pasë zgjidhur bllokun e shërbimeve dhe të fjetjes së rrugëtarëve, ndërsa hauri për pushimin dhe ushqimin e kafshëve, me një kat, ishte vendosur nga prapa ngjitur dhe normal bllokut me dy kate. (fig. 3).

Ka qenë ndërtuar me mure guri me llaç gëlqere dhe me çati të mbuluar me tjegulla vendi.

Hyrja kryesore e hanit ishte nga ana e pazarit dhe një portë e madhe me dy kanata, e mbuluar me qemer të shtrirë, të fuste në korridorin tërthor me gjërësi 3.5 m, që bënte lidhjen funksionale në katin përdhe me mjediset e shërbimit, me haurin dhe me shkallën që të çonte në katin e dytë. Në katin përdhe, në të majtë të këtij korridori, ishin zgjidhur mjedisi i hanxhiut dhe kafazi i shkallëve, nga e djathta ishin mjediset për mbathjen dhe shërbimin veterinar të kuajve dhe një depo për ruajtjen e mallrave të karvaneve, ndërsa përballë tij ishte vendosur hauri i kafshëve me gjërësi e gjatësi 12 x 16 m, çatia e të cilit mbështetej mbi shtylla druri të vendosura në katër hapsira (3.5 x 4 m), një nga të cilat shfrytëzohej për depozitimin e sanës dhe të tagjisë (fig. 3). Hauri nga ana perëndimore e tij lidhej me anë të një porte me oborrin e hanit ku ishte hapur pusi për furnizimin me ujë të pijshëm. Ngjitur me dhomën e hanxhiut, në katin përdhe të kësaj ndërtese, me hyrje të veçantë nga ana e pazarit, për punimin dhe riparimin e samarëve shërbenin dy ndarje, zeje që lidhet direkt me funksionin kryesor të haneve.

Ndryshe nga kati përdhe, kompozimi planimetrik i katit të dytë, ka qenë zgjidhur sipas skemës me vendosje të mjediseve vetëm nga njëra anë e korridorit gjatësor me gjërësi 2.8 m, ku ishin vendosur edhe shkallët prej druri për komunikimin vertikal. Ai përmbante pesë oda për fjetje dhe nyjen sanitare që kishin lidhje të mirë funksionale. Mobilimi i odave ishte i thjeshtë, për fjetje shërbenin shtrate të gjërë dhe unike prej dërrase, që ngjiteshin në muret perimetrale dhe ngriheshin nga dyshemeja 40–50 cm, ndërsa për vendosjen e sendeve vetjake dhe të rrobave, shërbenin kamare të hapura në mure dhe varset në lartësinë e arkitrarëve të dritareve dhe të dyerve.

Në trajtimin arkitekturor të pamjeve, përkujdesje të veçantë ka pasur pamja nga ana e pazarit që e dallon veçanërisht theksimi i pjesës qendrore që del përpara 1.8 m në të dy katet, ku janë zgjidhur porta e hyrjes poshtë dhe një ballkon në dhomën e mesit të katit të dytë. Zgjidhja e përpjestuar mirë e lartësive të kateve, e vendosjes së dritareve, e kombinimit dhe e lidhjes së qemereve me mjedisin rrethues dhe e ndarjes llogjike të kateve me funksione të ndryshme nëpërmjet kornizës horizontale me gurë të gdhendur, kanë bërë t'i rriten vlerat estetike dhe të dallohet nga ndërtesat e tjera të pazarit duke lexuar qartë funksionin e tij në tërësi si objekt i kësaj gjinie dhe funksionet e çdo kati në veçanti.

Hanxhiu së bashku me dy djemtë e tij ushtronte edhe profesionin e nallbanit e të shërbimeve veterinare populloré dhe kishte klientë të rregullt kryesisht karvanxhinjtë që vinin nga Elbasani, Manastiri dhe Berati.

Hani Nr. 4. Është ndërtuar në hyrje të rrugës së

16) A.Q.H. i RPSSH, F. 71, D_4; Dok. nr. 723/25.

FOTOKOPJE

HANI Nr. 3 KAVAJE





DO NOT COPY

lagjes Zguraj, nga ana veriore e saj, rreth 100 m nga rruga e «Madhe» në afërsi të pazarit, (fig. 1).

Ndryshe nga hanet e tjerë të ndërtuar në qytetin e Kavajës, që përgjithësisht karakterizohen nga skema kompakte, ky han në kompleksin e tij përbëhet nga tre grupe mjedisesh me blloqe të veçantë me qendër kompozimi oborrin e brendshëm me sipërfaqe rreth 140 m^2 i shtruar me kalldrëm guri. Dallohet blloku kompakt me dy kate i vendosur në ballin verior të oborrit, i cili në katin përdhe kishte haurin për qëndrimin e kafshëve të karvaneve me sip. 60 m^2, depot e sanës e të tagjisë dhe shkallët për komunikimin vertikal, ndërsa në katin e dytë ka pasur gjashtë oda për fjetjen e rrugëtarëve të vendosura nga të dy anët e një korridori tërthor. Nga ana perëndimore e oborrit, në bllokun me një kat, një hajat me gjërësi 4 m dhe gjatësi sa ajo e oborrit, shërbente për strehimin e kafshëve, kryesisht gjatë ditës. Ndërsa mjedisi i hanxhiut, i mbathjes së kuajve dhe i punimit i riparimit të samarëve kanë qenë vendosur në bllokun e tretë, ndërtim ky me një kat, nga ana jugore e oborrit, por me hyrje nga rruga e lagjes Zguraj (fig. 4). Po nga kjo anë ndodhej porta e hyrjes së hanit, e mbuluar me çati gjatë gjithë gjërësisë së mjediseve të këtij blloku. Furnizimi me ujë të pijshëm për kafshët bëhej nga pusi i hapur në skajin veri-perëndimor të oborrit. Blloku me dy kate muret e katit përdhe i ka pasë të ndërtuara me gurë, ndërsa katin e dytë me çatma. Dy blloqet e tjera janë ndërtuar me mure prej qerpiçi me breza druri, të mbuluara me tjegulla vendi.

Vendosja e vëllimit me dy kate brenda, në fund të oborrit qendror, larg nga rruga kryesore, duke lënë në dukje nga kjo anë vetëm vëllimin me një kat, ka bërë që ky han të mos marrë pjesë bukur në formulimin arkitekturor të kësaj rruge, sikurse kemi theksuar për hanet e tjerë me dy kate që ishin ndërtuar buzë rrugëve kryesore të pazarit.

Në krahasim me kompozimin planimetrik të haneve të Korçës[17], ky han ka të përbashkët oborrin qendror, rreth të cilit janë zhvilluar blloqet me mjediset e funksioneve të ndryshme të tij.

Për vitin e ndërtimit të tij nuk ka ndonjë mbishkrim, por sipas të dhënave gojore i përket fundit të shek. XIX. Ka funksionuar si han deri në vitin 1944, sot ai shfrytëzohet si magazinë e N. Komunale, duke mos ruajtur në gjendjen e parë vetëm katin e dytë të bllokut ku ndodheshin odat e fjetjes.

Hani Nr. 5 dhe Nr. 6. Kanë qenë ndërtuar në pjesën jugore të pazarit, në vazhdim të vargut perëndimor të dyqaneve, buzë rrugës së «Madhe» (fig. 1).

Vendosja e tyre në pjesën jugore të pazarit, aty ku fillojnë ndërtesat e banimit të lagjes Sharrë, së bashku me hanet e tjerë, formonin tiparin dallues urbanistik, atë të rrethimit të pazarit nga të gjitha anët e tij me ndërtesa të kësaj gjinie duke kryer kështu më mirë funksionin e tyre për të qënë më afër rrugëve nga bëhej lëvizja e rrugtarëve me kafshë transporti (fig. 1).

Të dy hanet kanë qenë kompozuar me skemën kompakte të mbyllur me formë planimetrike drejtkëndëshi, me dy kate në të cilët odat e fjetjes së rrugëtarëve ishin vendosur në katin e dytë, ndërsa në katin përdhe ishin zgjidhur mjediset e hanxhiut, të shërbimeve dhe depot e sanës e të tagjisë. Hani për pushimin e kafshëve të karvaneve edhe në këto dy objekte ka qenë ndërtuar me një kat i bashkangjitur me bllokun me dy kate.

Sipas të dhënave gojore, objektet përkatësisht kanë pasur nga gjashtë dhe dhjetë oda për fjetje, të kompozuara në planimetri sipas skemës funksionale me vendosje të mjediseve nga të dy anët e korridorit qendror. Muret e katit përdhe kanë qenë ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqere, ndërsa kati i dytë me çatma. Hyrjet dhe pamjet kryesore i kanë pasur nga ana e rrugës kryesore, të cilat kanë pasur trajtim më të përkujdesur arkitekturor; duke u dalluar qartë në mes të ndërtesave të tjera të vargut perëndimor të dyqaneve.

Hanet ditore. Në pazarin e Kavajës, të shtunave të çdo jave bëhej treg i madh ku kryhej shkëmbim i mallrave dhe prodhimeve bujqësore e blegtorale. Fshatarët e shumtë që vinin nga fshatrat përreth qytetit, transportin e mallrave dhe prodhimeve të tyre e bënin me kafshë, dhe për qëndrimin e tyre nuk mjaftonte vetëm kategoria e haneve hotel, që analizuam më lart, por shërbenin edhe një numër i madh hanesh ditorë dhe sheshe e oborre të posaçme të rrethuara për këtë qëllim.

Nga dëshmitë e shumta gojore, arritëm të përcaktojmë dhjetë ndërtesa që kanë funksionuar për hane ditore, të paktën nga fundi i shek. XIX deri në vitin 1944. Sikurse sqarohet në planimetrinë e pazarit (fig. 1), ndërtimi i këtyre haneve vlersuar nga zgjidhja urbanistike, njëlloj si hanet hotel, kanë qenë ndërtuar nga të gjitha anët e pazarit, në formë unaze, duke i shërbyer më afër fshatarëve që vinin me kafshë nga drejtime të ndryshme dhe duke mënjanuar kryqëzimet e lëvizjeve në qëndrën e tregut.

Hanet ditore në përgjithsi kanë qenë ndërtuar me një kat, me skemën e kompozimit kompakt të mbyllur dhe me zgjidhje planimetrike të thjeshtë por

17) P. Thomo, **Vështrim historiko-arkitektonik mbi pazarin e Korçës,** Etnografia Shqiptare 13/1983, fq. 168-176.

DOKTORATURA



DO NOT COPY

Fig. 4

DO NOT COPY

HANE DITORE - KAVAJE



DO NOT COPY

Fig. 5

lagjes Zguraj, nga ana veriore e saj, rreth 100 m nga rruga e «Madhe» në afërsi të pazarit, (fig. 1).

Ndryshe nga hanet e tjerë të ndërtuar në qytetin e Kavajës, që përgjithësisht karakterizohen nga skema kompakte, ky han në kompleksin e tij përbëhet nga tre grupe mjedisesh me blloqe të veçantë me qendër kompozimi oborrin e brendshëm me sipërfaqe rreth 140 m^2 i shtruar me kalldrëm guri. Dallohet blloku kompakt me dy kate i vendosur në ballin verior të oborrit, i cili në katin përdhe kishte haurin për qëndrimin e kafshëve të karvaneve me sip. 60 m^2, depot e sanës e të tagjisë dhe shkallët për komunikimin vertikal, ndërsa në katin e dytë ka pasur gjashtë oda për fjetjen e rrugëtarëve të vendosura nga të dy anët e një korridori tërthor. Nga ana perëndimore e oborrit, në bllokun me një kat, një hajat me gjerësi 4 m dhe gjatësi sa ajo e oborrit, shërbente për strehimin e kafshëve, kryesisht gjatë ditës. Ndërsa mjedisi i hanxhiut, i mbathjes së kuajve dhe i punimit i riparimit të samarëve kanë qenë vendosur në bllokun e tretë, ndërtim ky me një kat, nga ana jugore e oborrit, por me hyrje nga rruga e lagjes Zguraj (fig. 4). Po nga kjo anë ndodhej porta e hyrjes së hanit, e mbuluar me çati gjatë gjithë gjerësisë së mjediseve të këtij blloku. Furnizimi me ujë të pijshëm për kafshët bëhej nga pusi i hapur në skajin veri-perëndimor të oborrit. Blloku me dy kate muret e katit përdhe i ka pasë të ndërtuara me gurë, ndërsa katin e dytë me çatma. Dy blloqet e tjera janë ndërtuar me mure prej qerpiçi me breza druri, të mbuluara me tjegulla vendi.

Vendosja e vëllimit me dy kate brenda, në fund të oborrit qendror, larg nga rruga kryesore, duke lënë në dukje nga kjo anë vetëm vëllimin me një kat, ka bërë që ky han të mos marrë pjesë bukur në formulimin arkitekturor të kësaj rruge, sikurse kemi theksuar për hanet e tjerë me dy kate që ishin ndërtuar buzë rrugëve kryesore të pazarit.

Në krahasim me kompozimin planimetrik të haneve të Korçës[17], ky han ka të përbashkët oborrin qendror, rreth të cilit janë zhvilluar blloqet me mjediset e funksioneve të ndryshme të tij.

Për vitin e ndërtimit të tij nuk ka ndonjë mbishkrim, por sipas të dhënave gojore i përket fundit të shek. XIX. Ka funksionuar si han deri në vitin 1944, sot ai shfrytëzohet si magazinë e N. Komunale, duke mos ruajtur në gjendjen e parë vetëm katin e dytë të bllokut ku ndodheshin odat e fjetjes.

Hani Nr. 5 dhe Nr. 6. Kanë qenë ndërtuar në pjesën jugore të pazarit, në vazhdim të vargut perëndimor të dyqaneve, buzë rrugës së «Madhe» (fig. 1).

Vendosja e tyre në pjesën jugore të pazarit, aty ku fillojnë ndërtesat e banimit të lagjes Sharrë, së bashku me hanet e tjerë, formonin tiparin dallues urbanistik, atë të rrethimit të pazarit nga të gjitha anët e tij me ndërtesa të kësaj gjinie duke kryer kështu më mirë funksionin e tyre për të qënë më afër rrugëve nga bëhej lëvizja e rrugtarëve me kafshë transporti (fig. 1).

Të dy hanet kanë qenë kompozuar me skemën kompakte të mbyllur me formë planimetrike drejtkëndëshi, me dy kate në të cilët odat e fjetjes së rrugëtarëve ishin vendosur në katin e dytë, ndërsa në katin përdhe ishin zgjidhur mjediset e hanxhiut, të shërbimeve dhe depot e sanës e të tagjisë. Hani për pushimin e kafshëve të karvaneve edhe në këto dy objekte ka qenë ndërtuar me një kat i bashkangjitur me bllokun me dy kate.

Sipas të dhënave gojore, objektet përkatësisht kanë pasur nga gjashtë dhe dhjetë oda për fjetje, të kompozuara në planimetri sipas skemës funksionale me vendosje të mjediseve nga të dy anët e korridorit qendror. Muret e katit përdhe kanë qenë ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqere, ndërsa kati i dytë me çatma. Hyrjet dhe pamjet kryesore i kanë pasur nga ana e rrugës kryesore, të cilat kanë pasur trajtim më të përkujdesur arkitekturor; duke u dalluar qartë në mes të ndërtesave të tjera të vargut perëndimor të dyqaneve.

Hanet ditore. Në pazarin e Kavajës, të shtunave të çdo jave bëhej treg i madh ku kryhej shkëmbim i mallrave dhe prodhimeve bujqësore e blegtorale. Fshatarët e shumtë që vinin nga fshatrat përreth qytetit, transportin e mallrave dhe prodhimeve të tyre e bënin me kafshë, dhe për qëndrimin e tyre nuk mjaftonte vetëm kategoria e haneve hotel, që analizuam më lart, por shërbenin edhe një numër i madh hanesh ditorë dhe sheshe e oborre të posaçme të rrethuara për këtë qëllim.

Nga dëshmitë e shumta gojore, arritëm të përcaktojmë dhjetë ndërtesa që kanë funksionuar për hane ditore, të paktën nga fundi i shek. XIX deri në vitin 1944. Sikurse sqarohet në planimetrinë e pazarit (fig. 1), ndërtimi i këtyre haneve vlersuar nga zgjidhja urbanistike, njëlloj si hanet hotel, kanë qenë ndërtuar nga të gjitha anët e pazarit, në formë unaze, duke i shërbyer më afër fshatarëve që vinin me kafshë nga drejtime të ndryshme dhe duke mënjanuar kryqëzimet e lëvizjeve në qëndrën e tregut.

Hanet ditore në përgjithsi kanë qenë ndërtuar me një kat, me skemën e kompozimit kompakt të mbyllur dhe me zgjidhje planimetrike të thjeshtë por

17) P. Thomo, **Vështrim historiko-arkitektonik mbi pazarin e Korçës,** Etnografia Shqiptare 13/1983, fq. 168-176.

PO PHOTOCOPY



DO NOT COPY

Fig. 4

funksionale. Mjediset e këtyre haneve ishin dhoma e hanxhiut dhe stalla. Dhoma e hanxhiut me sip. 16–20 m² gjithmonë ndërtohej në hyrje nga njera anë e hanit, ajo përveç qëndrimit të hanxhiut shërbente njëkohësisht për ruajtjen e mallrave të ngarkesave të fshatarëve dhe në raste të veçanta për fjetjen e tyre që bëhej mbi një shtrat prej dërrasash me gjatësi sa ajo e dhomës dhe i ngritur 15–20 cm nga dyshemeja. Kjo dhomë dritaret gjithmonë i kishte nga rruga kryesore (fig. 5) dhe lidhej drejtpërdrejt me stallën nëpërmjet një porte të brendshme.

Stallat në përgjithësi kanë pasur sipërfaqe ndërtimi 80–100 m², ishin ndërtuar me mure prej qerpiçi, me çati që mbështetej mbi shtylla druri të vendosura çdo 3,5–4 m larg nga njera tjetra dhe ishin mbuluar me tjegulla vendi. Pjesë e kompozimit planimetrik të këtyre haneve ishte edhe oborri i brendshëm me sipërfaqe të bollshme që zakonisht ndodhej prapa ndërtesës së hanit, rrethohej me mure prej qerpiçi, kishte vendet për lidhjen e kafshëve, pusin për furnizimin me ujë dhe komunikonte direkt me stallën nëpërmjet një porte të veçantë.

Hanet ditore në qytetin e Kavajës të vendosur buzë rrugëve të pazarit me pamjet kryesore nga këto rrugë, kanë dhënë kontributin e tyre modest arkitekturor. Ato ishin ndërtesa me lartësi kati të vogël (2,6–3,2 m) dhe hyrja, zakonisht një portë e gjerë dhe e lartë, së bashku me dritaret e mjediseve të tyre të zgjidhura nga ana e pamjes kryesore kishin një trajtim të thjeshtë arkitekturor dhe pa pretendime (fig. 5).

Në qytetin e Durrësit hanet kanë qenë ndërtuar në zonat pranë shesheve tregtare, në afërsi të dyqaneve të tregtarëve ku karvanxhinjtë dorzonin mallrat për eksport që sillnin nga vilajetet dhe kazatë e tyre dhe ngarkonin aty mallrat e importit. Mbështetur në materialin fotografik të paraqitur në këtë studim dhe në të dhënat gojore të moshuarve vendas, hanet në Durrës, megjithse kanë qenë ndërtuar pranë shesheve tregtare, ato nuk bënin pjesë në vazhdimin e vargjeve të dyqaneve të tjerë të qendrës së qytetit, por në shumicën e rasteve ato kanë qenë ndërtuar të veçantë.

Hani Nr. 1. Ka qenë ndërtuar buzë rrugës kryesore, në të majtë të sheshit ku ndodhet sot ndërtesa e Komitetit të Partisë së Rrethit. Ishte nga hanet më të vjetra të qytetit dhe ndërtimi i tij datonte vitin 1865. Hani i kompozuar me formë planimerike drejtkëndëshi, me një kat dhe me hajatin përpara sa e gjithë gjatësia e ndërtesës nga ana e rrugës kryesore (fig. 6) paraqiste një variant të veçantë të hapur, që krijonte lidhje më organike të saj me mjedisin rrethues.

Porta e hyrjes e vendosur në qendër nga ana e hajatit, të fuste në një portë me korridor të gjerë



Fig. 6

në të djathtë të të cilit ndodhej dhoma e hanxhiut që shërbente edhe për fjetjen e rrugëtarëve, përballë tij ishte stalla e kafshëve dhe nga ana e majtë përgjatë hajatit me hyrje të veçantë ishin vendosur dy mjedise për punimin dhe riparimin e samarëve.

Arkitektura e jashtme paraqitej me tiparet e banesës së hapur me hajat dhe nuk lexonte nga jashtë përmbajtjen funksionale të hanit.

Hani Nr. 2. Paraqet një tjetër shembull të ngjashme me hanin Nr. 1 si nga zgjidhja e kompozimit planimetrik dhe nga arkitektura e tij.

Ka qenë ndërtuar në afërsi të shkollës «10 Korriku» prapa sheshit ku ndodhet sot Pallati i Kulturës, ngjitur me hamamin e qytetit dhe me pamjen kryesore të orientuar nga ana jugore. Përpara tij ndodhej një shesh i madh i lirë që shërbente për qëndrimin e kafshëve dhe të karrove e qerreve që ishin mjetet e transportit të kohës. (fig. 7).

Ndërtimi i tij i përkiste mesit të shek. XIX. Njëlloj si hani Nr. 1 ishte ndërtesë me 1 kat, me hajatin përpara nga bëhej hyrja për në një korridor tërthor që të lidhte me dhomën e hanxhiut nga e djathta, me hanin për mbajtjen e kafshëve përballë dhe me depot e sanës nga ana e majtë. Dhoma e hanxhiut ka pasur një shtrat 3,5 x 2,2 m të ngritur nga toka 40–50 cm që quhej «Nafile» dhe shërbente për fjetjen e rrugtarëve.

Konstruksioni mbajtës vertikal ka qenë ndërtuar me mure prej qerpiçi, me çati tip vendi me katër kullime uji, me streha të dala nga 50 cm në të gjitha anët e ndërtesës dhe i mbuluar me tjegulla vendi. Furnizimi me ujë të pijshëm bëhej nga pusi që ishte hapur përpara në oborr 5 m nga ana e hajatit.

Hani Nr. 3. Dëshmitë gojore pohojnë se ky han ka qenë ndërtuar përbri rrugës kryesore, nga ana

BOKOT SOFT

DO NOT COPY



Fig. 7

lindore e sheshit të pazarit të qytetit. Është ndërtuar me dy kate në vitin 1890 në vendin ku më parë ishte një han i vjetër i vogël me një kat.

Forma planimetrike drejtkëndëshe e godinës, kompozimi i mbyllur në të dy katet dhe ndarja funksionale e mjediseve të çdo kati, kishin karakteristika të njëjta me kompozimin e haneve me dy kate të qytetit të Kavajës. Në katin e dytë ai ka pasur 10 oda për fejtje të vendosura nga të dy anët e një korridori qendror gjatësor, ndërsa në katin përdhe ishin dhoma e hanxhiut, hauri i kafshëve, mjedisi i mbathjes së kuajve dhe depot e barit. Prapa ndërtesës së hanit ishte një oborr me sip. rreth 300 m^2 i rrethuar me mure guri që shërbente për qëndrimin ditor të kafshëve, aty ku ndodhej edhe pusi për furnizimin me ujë.

Ky han ka shërbyer si bazë edhe për strehimin e patriotëve të Rilindjes tonë Kombëtare. Në qershor të vitit 1910 hanxhiut Must Tirana iu kontrollua shtëpia dhe hani nga xhandarmëria turke i akuzuar se në hanin e tij grumbullonte dhe shpërndante armë për kryengritjen e Kurbinit.[18] Must Hanxhiu (Tirana) u caktua dhe mori pjesë si delegat i Durrësit në Kuvendin Historik të Vlorës më 28 Nëntor 1912.

Hani Nr. 4. Kompozimi planimetrik dhe vëllimor, ndarja funksionale e kateve dhe materialet e ndërtimit të tij kanë pasur zgjidhje të ngjashme me ato të hanit Nr. 3. Ai ka qenë ndërtuar buzë sheshit të pazarit me hyrjen dhe pamjen kryesore nga perëndimi dhe ishte me dy kate. Ka qenë hani më i madh i Durrësit, në katin e dytë kishte 12 oda për fjetje të zgjidhur me dy rradhë ndaj korridorit gjatësor; ndërsa në katin përdhe ka pasur po ato mjedise si të hanit Nr. 3, por me përmasa më të mëdha. Oborri me sipërfaqe rreth 500 m^2 që ndodhej nga prapa dhe nga pjesa jugore e hanit, komunikonte direkt me rrugën kryesore nga sheshi dhe me haurin. Në oborr bëhej furnizimi me ujë nga një pus i hapur 8 m larg nga dera e haurit, ai ishte i rrethuar nga të gjitha anët me mure rrethues me lartësi 2.2 m.

Nga ky studim i ndërtesave të haneve në qyte-

18) Telegram Nr=228 i Konsullit austro-hungareze, Palavicinit në Stamboll, Tiranë, 1, Korrik 1910; P. Pepo, **vep.cit.,** fq. 422.

tet Durrës dhe Kavajë, duke i krahasuar ato si brenda përbrenda një qyteti, ashtu edhe ndërmjet dy qyteteve, rezulton se kanë mjaft tipare të përbashkëta në zgjidhjet e tyre urbanistike dhe arkitekturore.

Ndërtimi i haneve në këto dy qytete vlerësuar nga zgjidhjet urbanistike është bërë duke i vendosur të shpërndarë përreth pazareve dhe në krye të rrugëve që lidhin qytetin me të gjitha fshatrat dhe me qytetet fqinjë. Kjo vendosje është mjaft funksionale sepse mënjanon kryqëzimet e lëvizjeve të karvaneve dhe të fshatarëve me kafshë që vinin nga drejtime të ndryshme. Këto hane të vendosur buzë rrugëve kryesore ngjitur me vargjet e dyqaneve të pazarit, me arkitekturën e tyre ndihmuan në larminë dhe formulimin e blloqeve të dyqaneve. Nga këto dallohen hanet hotel me dy kate që karakterizohen nga skema të mbyllura të kompozimit dhe nga trajtimi më i përkujdesur arkitekturor i pamjeve me ndarje të qartë funksionale për çdo kat. Kompozimi i përmbajtjes planimetrike të haneve në këto dy qytete, krahas mjediseve për plotësimin e kërkesave funksionale të tyre, karakterizohet me praninë e një seri mjedisesh të tjerë plotësues për nallban, samarxhi, shitës pajisjesh për kafshë e tjerë, që lidheshin drejtpërdrejt me funksionin bazë të haneve. Në hanet hotel dallohet karakteri utilitar që ndikoi në trajtimin e përgjithshëm arkitekturor sidomos në trajtimin e katit të dytë ku janë vendosur mjediset jetësore. Hanet në këta dy qytete sikurse dhe ato të Korçës[19] kanë pasur të përbashkët gjithashtu përputhjen e formës me përmbajtjen funksionale, përdorimin e materialeve rrethanore të ndërtimit, oborrin e hapur të rrethuar me mure dhe pusin për furnizimin me ujë. Në dallim me hanet më të vjetra të Korçës, në qytetet Durrës dhe Kavajë oborri i brendshëm nuk ka qenë qendër kompozimi rreth të cilit të zhvilloheshin mjediset e fjetjes në galerinë e hapur me katin e dytë.

DO NOT COPY

19) P. Thomo, **vep.cit.**, fq. 175.

Isuf SUKAJ
Hajredin ISUFI

DO NOT COPY

APERÇU SUR L'ARCHITECTURE ET LES PARTICULARITES FONCTIONNELLES DES AUBERGES DANS LES VILLES DE DURRËS ET KAVAJE

(fin du XIXe sc. — début du XXe sc.)

RESUME

L'ancienne ville de Durrës, en tant que port et centre du commerce de transit, à la fin du XVIIe siècle et surtout pendant les XVIIIe et XIXe siècles, a joué un rôle important dans les relations commerciales nationales et internationales, ainsi que dans les échanges des marchandises entre les pays des Balkans et le monde occidental.

A cette époque-là, jusqu'au premier quart du XXe siècle, la transportation des marchandises de ce port se réalisait par des moyens de transport assez primitifs, surtout par des caravanes de chevaux, qui voyageaient pendant les quatres saisons de l'année. Les bêtes de somme et les voyageurs se reposaient dans des auberges construites presque dans chaque ville et le long des routes, dans de petites agglomérations, là où s'achevait la première étape du voyage, pour la journée

En ce temps-là, Kavaja, après être devenu un important centre économique, artisanal, commercial et agricole, déployait une large activité dans les relations commerciales avec les principales villes du pays et les diverses régions des Balkans. Vue que Kavaja se situait tout près du port de transit de Durrës, les caravanes de cette ville desservaient de longs trajets allant jusqu'à Shkup, à Manastir (Bitola), Ohër et à Joannina.

Dans les villes de Durrës et Kavaja, là où se croisaient les routes, rayonnant vers les diverses régions du pays et des Balkans, la construction d'auberges était devenue une nécessité fonctionnelle. Voyant le côté numérique, les volumes, leur qualité et leur architecture, leur construction, en tant qu'objets, connait un plus grand essor au XIXe siècle, époque où le marché de nos villes a connu une remarquable évolution, qui a influé positivement sur le renforcement des liens économiques interégionaux ainsi que sur la formation de marchés.

D'après les données écrites de la fin du XIXe sc., il y a eu 9 auberges à la préfecture de Durrës et 12 à la préfecture de Kavaja. Les recherches effectuées aux endroit où se situaient les auberges et sur les auberges modifiées restant encore sur pied, au moyen des musées historiques de ces deux villes, ainsi que des données orales des personnes âgées, ont permi aux auteurs d'identifier 4 auberges dans la ville de Durrës et 16 dans la ville de Kavaja (fig. 1). Dans la ville de Durrës deux auberges étaient à un étage, deux autres à simple rez-de-chaussée, tandis que dans la ville de Kavaja, 6 auberges étaient à un étage, les chambres se situant au premier étage, 10 autres à simple rez-de-chaussée, fonctionnant seulement pendant la journée pour garder les animaux.

De même, le long de la route Durrës-Kavaje et Kavaje-Rrogozhine il y a eu 8 autres auberges quatre dans chaque partie de la route. Elles servaient aux voyageurs à dormir, à garder les animaux et à prendre les repas.

Dans cet aperçu, nous allons représenter graphiquement, en nous basant sur les traces de construction et les matériaux photographiques archivaux, les auberges à un étage, qui se distinguent des autres par leur architecture, le nombre de pièces, les matériaux de construction etc.

Dans la ville de Kavaja, les auberges se situaient à proximité des marchés le long des rues principales, qui conduisaient au bazar, ou ils faisaient partie au bazar, se situant le long de la rangée des boutiques en forme de corridor. Ils n'étaient pas construits en groupe, le long d'une seule rue, mais dispercés dans les quatres coins du bazar (fig. 1) remplissant mieux ainsi leur fonction envers les mouvements des loueurs de chevaux et les paysans qui vendaient les produits agricoles au bazar. Ces auberges, bien que peu nombreux par rapport aux boutiques, construits en face ou à leur côté, selon des lignes droites non quadratiques, ont contribué à la variété architectonique des blocs des boutiques, lesquels constituaient l'élément principal à la formulation de l'ensemble du bazar.

Chaque samedi, au bazar de Kavaja, se faisait un grand échange de marchandises, de produits agricoles et d'élevage. De nombreux paysans, qui venaient des alentours de la ville transportaient leurs marchandises au moyen des bêtes de somme, ils avaient donc besoin non seulement d'auberges-hôtels, mais aussi d'auberges journalières et de cours clôturées à cette fin.

D'après les données orales et les recherches effectuées sur place, on a precisé dix constructions qui ont fonctionné comme auberges journalières au moins de la fin du XIXe sc. jusqu'en 1944. Les auberges journalières étaient en général à

simple rez-de-chaussée, avec un schéma de composition compact, fermé et une simple solution de planimétrie, fonctionnelle. Ces auberges n'avaient que deux pièces, celle de l'aubergiste et l'écurie. La pièce de l'aubergiste, d'une superfici de 16-20 m² se trouvait à l'entrée et servait en même temps à garder les marchandises des paysans et quelquefois à coucher sur un lit en bois de même longueur que la chambre, élevé de 12-20 cm du plancher. Les fenêtres de cette pièce donnaient toujours sur la grand-rue (fig. 5).

Les écuries, d'une superficie de 80-100 m² étaient construites en pierres ou en pisés, couvertes d'un toit, s'appuyant sur des piliers en bois placés de 3,4 à 4 m l'un de l'autre. Une partie de la composition de planimétrie des auberges était occupée par la cour intérieure d'une superficie de 200-500 m², laquelle généralement se trouvait derrière l'auberge ou à côté d'elle entourée de murs en pisé avec les endroits où l'on attachait les chevaux et le puit d'eau.

Dans la ville de Durrës les auberges ont été construites près des marchés et des boutiques des commerçants, auxquels les hommes des caravanes remettaient les marchandises à exporter, qu'ils apportaient de leurs régions et chargeaient les marchandises importées. D'après les matériaux photographiques et les données orales, les auberges de la ville de Durrës, n'ont pas été construites sur le même rang avec les boutiques du centre-ville mais, dans la plupart des cas, à l'écart.

De la comparaison des auberges d'une même ville ainsi que des deux villes, il résulte que dans leur solution architectonique et d'urbanisme, il y a beaucoup de traits communs.

Les auberges de ces deux villes ont été construites tout autours des marchés ou là où commençaient les routes reliant la ville avec tous les villages et les villes voisines. Cette position était très favorable, parce qu'elle évitait le croisement des mouvements des caravanes et des paysans qui venaient de différentes régions. Ces auberges construites au bord des rues principales, tout près des boutiques du bazar, ont contribué à la variété de l'architecture de ces boutiques. On y distingue les auberges-hôtels à un étage, au schéma de composition fermé et d'un traitement soigné de l'architecture des façades principales, ayant de nettes divisions fonctionnelles, pour chaque étage. Dans la composition de la planimétrie des auberges de ces villes, il y a une série de pièces auxiliaires, telle celle du maréchal-ferrant; du marchand de bâts, etc., lesquelles se rapportaient directement au fonctionnement des auberges. Les auberges de ces villes ainsi que celles de la ville de Korça ont eu en commun la conformité de la forme avec le contenu fonctionnel, les matériaux utilisés, la cour ouverte clôturée et le puits. Dans les auberges des villes de Kavaja et Durrës, la cour intérieure ne constituait pas le centre compositionnel autour duquel se développaient les chambres à coucher, dans la galerie ouverte du premier étage, comme dans les auberges de la ville de Korça.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 2 1984

monumentet
(MATERIALE)

DO NOT COPY

Neritan CEKA Moikom ZEQO

KËRKIME NËNUJORE NË VIJËN BREGDETARE DHE UJRAT E BRENDËSHME TË VENDIT TONË

Bregdeti i vendit tonë përbën një zonë me interes për kërkimet nënujore. Gjatë tij ruhen gjurmë të vendbanimeve si dhe të instalimeve të porteve antike e mesjetare. Gjithashtu jo larg vijës bregdetare janë përcaktuar nga gjetjet e rastit pika të mundëshme të mbeturinave të anijeve të mbytura. Edhe ujrat e brendëshme mbulojnë mbetje të vendbanimeve lakustre apo të monumenteve më të vona buzëujore. Të dhëna fillestare për monumentet arkeologjike nënujorë kanë dhënë zhytësit amatorë dhe peshkatarët. Në vitin 1976 me ngritjen e sektorit të kërkimeve nënujore pranë Muzeut arkeologjik të Durrësit u bënë zhytje të organizuara në bashkëpunim me redaksinë shkencore të R.T.V. Shqiptar dhe më vonë me Qendrën e Kërkimeve Arkeologjike. Këto zhytje dhe zbulime u kryen në Gjirin e Durrësit (cektina e Taboltit, Currila, Portëz, Kepi i Rodonit), në Gjirin e Vlorës (kepi i Treportit, Karaburun, Gramata), në liqenin e Ohrit (Buqezë), lumin e Drinasës, në liqenin e Seferajt të Belshit, në bregdetin e Sarandës, Himarë, liqenin e Prespës. Zhytjet janë kryer me akualang në një thellësi deri 30 m.

Pjesa kryesore e gjetjeve arkeologjike nënujë ndodhet në fondin e Muzeut Arkeologjik të Durrësit. Në ekspeditat e organizuara në vitet 1981, 1983, 1984 janë xhiruar filma televizivë të cilët shërbejnë si një dokumentacion i materialit të zbuluar. Përcaktimi i karakterit dhe dokumentimi i tyre është hapi i parë për vënien në mbrojtje dhe përpunimin e metodikës së mbrojtjes dhe ruajtjes së tyre. Kërkimet janë përqëndruar kryesisht në vijën bregdetare për gjurmimin e vendbanimeve antike dhe skelave të tyre.[1)]

Rezultatet e kërkimeve paraqiten me interes dhe ne po i njoftojmë sipas qendrave përkatëse.

1. Bregdeti pranë Durrësit.

Legjenda popullore që flet për mure të mbytura, nga cektina e Taboltit (Batllës) deri në Currila, ishte një shtysë për të vëzhguar bregdetin në këtë zonë[2)]. Nga vrojtimet nën ujë u kontrollua pjesa më veriore e brezit shkëmbor, që ndodhet përballë rrafshit të Currilave. Nuk u vunë re gjurmë ndërtimesh apo punimesh nënujore dhe dy të çara në formë kanalesh që e përshkojnë atë kanë karakter natyror. Vetëm në shkëmbinjt që futen në det pranë vendit ku brezi shkëmbor lidhet me tokën në cepin verior të tij u gjetën në ujë pjesë amforash italike dhe enësh të shek. II p.e.sonë. Ka mundësi që ato të kenë qenë hedhje nga varkat që strehoheshin në gjirin e vogël, të

1) M. Zeqo, **«Durrësi i lashtë e gojëdhëna e përmbytjes së tij»,** «Shkenca dhe Jeta», 1, 1977, faqe 25-28., **«Disa rezultate të para të kërkimeve arkeologjike nën det»,** «Almanaku Durrës», Tiranë; 1983, f. 35-46.

2) L. Heuzey, H. Daumet, **(Mission archeologique de Macédoine,** Paris 1876) qenë të parët që kontrolluan vërtetësinë e kësaj legjende dhe nxorën përfundime se në brezin shkëmbor, nuk kishte gjurmë ndërtimesh, Shih dhe M. Zeqo, **«Nën det në buzëbregun e Durrësit»,** «Shkenca dhe Jeta» 6/1981 faqe 26-28.



Fig. 1

mbrojtur nga erërat e veriut. Mungesa e ndërtimeve u provua edhe nga zhytjet në cepin jugor të brezit shkëmbor, në cektësirën e Taboltit. Me gjithatë, edhe këtu në fundin e detit, në thellësi nga 2-4 m u gjetën mjaft fragmente keramike, që vinin sigurisht nga pastrimet e varkave.

2. Bregdeti i Portëzës.

Rreth 300 m në veri të hidrovorit dhe 40-50 m nga bregu, në thellësi deri 2.5 m u gjurmua një ndërtim me gurë të mëdhenj ranorë, pa lidhje llaçi. Ruhej një krah i ambientit me gjatësi 4 m, ku lidhej një mur ndarës me gjërësi më të vogël. Format e gurëve nuk ishin të rregullta, megjithëse dalloheshin shenja të punimit me daltë. Përmasat e tyre ishin të mëdha e mesatare (1,20 x 0.85 x 0.55; 0.97 x 0.61 x 0.38, 0.79 x x 0.64 x 0.32). Një trakt tjetër me gurë të mëdhenj, që ruhej disa metra më tej, paralel me të parin, dëshmonte për një godinë me përmasa të mëdha. Gurë të tjerë, rreth 20 m më larg, i takonin një godine fqinje të prishur nga dallgët. Rreth ndërtimeve kishte mjaft tjegulla solene dhe kalipterë me vijë kulmore të theksuar tipike për shek. IV-II p.e.sonë, që i takonin çatisë së godinave (Fig. 1). Gjurmë ndërtimesh dhe mbeturina të një shtrese kulturore të shek. IV-II p.e.s. ndiqen gjatë gjithë vijës bregdetare edhe pranë murit të periudhës bizantine në Portëz. Ato dëshmojnë për ekzistencën e një vendbanimi të hapur, që u braktis si rrjedhim i uljes së vijës bregdetare.

Edhe në vijën bregdetare rrëzë kodrës së Portëzës ndeshen brenda nën ujë, deri në largësinë 30 m nga bregu, copa të tëra nga muri i periudhës bizantine. Qënia e tyre në det mund të shpjegohet me faktin se muri zgjatej edhe më shumë drejt perëndimit në një pjesë të ngushticës që u ul më pas nën nivelin e detit. Egziston edhe mundësia që muri të ketë vazhduar me kënd të drejtë duke u ngjitur drejt kurrizit të kodrës dhe të jetë rrëzuar nga gërryerjet e saj prej valëve të detit.

3. Kepi i Rodonit

Lëvizja e vijës bregdetare ka zbuluar themelet e dy kullave të rrumbullakta të kalasë së Skënderbeut në Muzhël. Jo shumë larg kullës jugperëndimore, në thellësi 3 m gjendet një mur me gurë të mëdhenj, të palidhur me llaç. Mbetet që të gjurmohet më tej bregdeti rreth Kepit të Rodonit, që është zonë më e mundëshme për kërkimet e qytetit Denda. Plini (NH III, 23) na jep të kuptojmë se kjo qendër e rëndësishme, e cila në shek. I të e.sonë gëzonte të drejtën romake, gjendej në bregdetin ndërmjet Lisit dhe Dyrrahut. Përderisa në sterenë e kësaj zone, nuk janë gjetur ende rrënoja që mund ti përshtateshin Dendës, kërkimet duhen shtrirë edhe në det, ku qyteti mund të jetë fundosur prej shekujsh [3]

4. Gjiri i Vlorës

a. Treport. Në Gjirin e Vlorës kërkimet u përqendruan në zonën e Treportit, për të sqaruar rolin e murit bregdetar të kësaj qendre, funksioni i të cilit ka mbetur i diskutueshëm.[4] Shqyrtimi i kepit shkëmbor që zgjatet nga Treporti në drejtim të jugperëndimit tregoi se ai vazhdonte në det për rreth 300 m në formën e një barriere natyrore. Ky valëthyes natyror me gjërësi nga 5 deri 30 m në pjesë të veçanta të tij ka qenë lartësuar me një mur prej bllo-

3) Për të kërkuar Dendën në këtë pjesë të bregdetit është shprehur C. Patsch **«Gjendja ekonomike e kulturore e Shqipërisë në kohën e kalueme»** Tiranë, 1925, f. 62, Për gjetjen e mureve nën ujë, M. Zeqo, «Zëri i Popullit» **«Zbulime nën ujë»** 11.12.1981.

4) Përshkrimi i parë tek C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien, Wien** 1904; f. 63 që mendon për një mol. L.M. Ugolini, **Albania Antica,** I, Roma 1927, f. 107 e quan rrugë në det. A. Baçe, **Qendrat e fortifikuara të Gjirit të Vlorës në Antikitet,** «Monumentet» 10, 1975, f. 10-11, e konsideron bankinë.

DO NOT COPY

qesh ranore. Veprimi i vazhdueshëm i dallgëve e ka shkatërruar me kohë këtë mur dhe prej tij ruheshin vetëm masat e rrënimeve prej blloqesh gjysëm të punuar, me forma katërkëndëshe, të shpërndara gjatë pjesës nënujore të barrierës. Rreth 200 m nga bregu, në jug të kësaj barriere u përcaktua vendi i radës së anijeve antike. Këtu në thellësinë 12 m, u gjetën dy amfora të plota të tipit olearia, të shek. I p.e.sonë dhe mjaft copa enësh. Ndër ta më i hershmi ishte një luter korintik, i shek. IV p.e.sonë, ndërsa pjesa më e madhe i takonte shek. III-II p.e.sonë. Pjesë të shumta amforash të mbuluara nga rëra përvijonin aty konturet e një anije të mbytur me konstruksion druri, që mund të lidhet fare mirë me ngarkesën e olearieve.

Megjithëse në thellësi të vogël, edhe muri bregdetar paraqiti interes për kërkimet nënujore (Fig. 2). Në pjesët më të ruajtura nënujë fasada e murit kishte trajtimin karakteristik të mureve rrethuese apo mbajtëse. Rreth blloqeve dallohej qartë buzina tipike prej 3-4 cm si një element dekorativ, që ndeshet në muret e shek. III p.e.sonë, në Apolloni, Irmaj, Zgërdhesh, etj. Vetë muri kishte ndërtimin e zakonshëm të fortifikimeve me gjërësi 3.50 m, prej dy faqesh prej blloqesh të punuar dhe mbushjes me gurë mesatarë e të vegjël. Në gjatësinë e tij vëreheshin dalje që i korespondojnë kullave dhe një ndërprerje, shenjë e një hyrje në drejtim me vendin e radës. Pas murit kishte një depozitim të rregullt shtresash kulturore me materiale tipike për shek. III p.e.sonë. Këto të dhëna do të flisnin për një ndërtim mbrojtës, për një mur rrethues, i cili duke u zgjatur për rreth 700 m paralel me bregun, kthehej në drejtim të VL për tu kapur në fundin e harkut të kodrave të Treportit. Brenda do të përfshihej një sipërfaqe pothuaj e barabartë me atë të Bylisit. Megjithatë kjo sipërfaqe ka vetëm dy zona kryesore banimi. E para kufizohet në pjesën më të lartë të kodrës së Treportit në formën e një akropoli, ndërsa e dyta shtrihet si një brez me gjërësi deri 100 m vetëm përgjatë murit bregdetar. Në të dhënat e deritanishme do të mendonim për një tip të veçantë urbanistik, ku një pjesë e vendbanimit, ajo më e hershmja dhe e fortifikuar gjendej në lartësinë që zotëronte skelën dhe pamjen drejt



Fig. 2

detit. Pjesa kryesore, me karakter ekonomik ishte zhvilluar pranë skelës, buzë detit, por duke u mbrojtur nga valët dhe nga sulmet nga një mur paralel me bregun. Ulja e vijës bregdetare bëri që ky mur të përfshihej nga deti dhe vetë vendbanimi të braktisej.

Kemi pa dyshim një vendbanim të rëndësishëm të karakterit qytetar gjë që vërtetohet edhe nga gjetja e vulave mbi tjegulla me emrat e prytanëve.[5] Kjo ngre edhe çështjen e identifikimit dhe ne do të propozonim për këtë qytetin Daulia, i cili përmendet

5) Për rezultatet e gërmimeve shih. V. Bereti; **Gërmime në Treport,** Iliria VII-VIII, 1977-78, f. 285-292, ku dëshmohet fillesa e një vendbanimi arkaik protourban, që u kthye në qendër qytetare gjatë shek. IV-III p.e.s. Dy vulat mbi tjegulla të botuara nga autori f. 286 dhe tab. III, 3 i takojnë tipeve apolloniate apo dyrrahase, ku emri i prytanit eponym shoqërohet me dy nëpunëse të tjerë (N. Ceka, **Vula antike mbi tjegulla në trevën midis Aosit dhe Genusit**. «Iliria» 1, 1982, f. 38,52). Në njërin rast lexojmë emrin e prytanit Agaklidas dhe të njërit prej nëpunësave Athanias, ndërsa tek e dyta lexohen vetëm emrat e nëpunësave Antileon dhe Simias. Të dy vulat që i takojnë një prodhimi lokal të tjegullave dëshmojnë për një organizim politik të tipit qytetar sipas një modeli të afërt me Apolloninë.

DO NOT COPY

në listën delfike të thearodokëve, në çerekun I të shek. II p.e.sonë, krahas Apolonisë, Bylisit dhe Orikut.[6]

B. **Mermer.** Në gjurmim të trafikut detar për transportin e gurit për ndërtime në Apolloni dhe Dyrrah, gjatë vrojtimit të bregdetit lindor të Karaburunit u zbulua një grup guroresh në vendin e quajtur Mermer, rreth 10 km në veri të Orikut. U gjurmuan katër gurore të mëdha me gjatësi rreth 100 m secila të vendosura buzë detit deri në një lartësi 60 m dhe me faqe vertikale me lartësi 10-30 m (Fig. 3). Teknika e nxjerrjes së blloqeve katërkëndëshe është ajo e njohur në guroret antike të vendit tonë,[7] nëpërmjet hapjes së kanaleve në tre anë të tyre, për të shkëputur pastaj nga poshtë me pyka hekuri. Gjurmët e blloqeve japin përmasa që arrijnë në 1-2 m gjatësi, 0.60-1.5 m gjërësi. Nga kërkimet nën ujë u përcaktua vendi i molit. Thellimet për vendosjen e pilotave prej druri jepnin një gjërësi prej rreth 4 m të tij. U vu re gjithashtu se pjesa e poshtme e gurores gjendej nën sipërfaqen e ujit në një thellësi rreth 1 m. Kjo dëshmonte se kur filloi të shfrytëzohej gurorja, kjo pjesë e bregut ka qenë mbi sipërfaqen e detit, përndryshe do të qe e pamundur nxjerrja e blloqeve në thellësi të ujit. Masa e madhe e blloqeve të marra prej guroreve lidhej me kërkesat e qendrave të mëdha si Apollonia, Dyrrahu, Oriku etj. Aërsia mund ta lidhë pronësinë mbi to me Orikun gjë që do të shpjegonte edhe një mbështetje të ekonomisë së këtij qyteti. Mbi njërën nga faqet e guroreve u vunë re edhe skalitje skematike të dy fytyrave njerzore në fas. Për kohën e shfrytëzimit të tyre nuk u gjetën të dhëna të sakta dhe mund të flitet në përgjithësi për periudhën para erës sonë, kur ndërtohej me blloqe katërkëndësh.

Mbulimi i pjesës së poshtme të gurores lidhet me të njëjtën fenomen që ka nxjerrë jasht përdorimit murin e Triportit dhe që ka lënë gjurmë në qendrat antike që nga kepi i Rodonit deri në Butrint, kur ka ndodhur kjo fundosje. Monumentet nënujore japin si terminus **post quem** shek. II p.e.sonë, kur datohen gjetjet e Rodonit ose fundi i shtresës kulturore buzë murit të Treportit. Në burimet historike kemi vetëm të dhënën e Plutarkut (Cicer) i cili flet për lëvizjen e bregdetit gjatë një tërmeti në vitin 58 p.e.sonë. në Dyrrah.

C. **Oriku.** Pjesën më me interes për kërkimet nënujore e përbënte këtu padyshim porti i brendshëm i qytetit, ku sipas përshkrimit të Çezarit (Bell civ. III, 40) kundërshtarët e tij dogjën një pjesë të anijeve të lidhura në breg. Gjithashtu rreth 200 m nga bregu në drejtim të jugut janë vënë re nga peshkatarët gjurmë ndërtimesh në thellësi të vogël. Gjatë kërkimeve u vu re se relievi nënujor ka ndryshuar shumë që nga koha antike. Pjesa veriperëndimore e lagunës, që komunikonte atëhere me detin dhe kishte thellësi të madhe është mbushur me materjale. Nga ana tjetër laguna është zgjeruar në drejtim të jugut si rrjedhim i ndryshimit të ngritjes së nivelit të ujit, duke mbuluar ndërtimet e lashta në bregun tjetër të lagunës. Dendësia e planktonit në ujin e lagunës nuk lejonte të gjurmoheshin këto ndërtime. U vërtetua se ndërtimet në bregun verior të lagunës, që futen deri rreth 10 m në drejtim të saj nuk i takojnë një moli siç janë spjeguar.[8], por zgjatjes së linjës së murit të antikitetit të vonë në drejtim të portit të brendshëm.

D. **Uji i Ftohtë.** Shkëmbinjtë e çveshur në tërë bregdetin poshtë kampit të pushimit të puntorëve kanë shërbyer në antikitet si gurore. Gjatë bregut ruhen grumbuj blloqesh katërkëndësh të përgati-



Fig. 3

6) Shih, S. Anamali, **«Ilirët dhe qytetet e Ilirisë së Jugut në mbishkrimet e Greqisë»**, «Iliria», 1.1982, f. 9. C. Patsch, **vep.cit,** f. 63 vendos në Treport Aulonën, A. Baçe, **art.cit,** f. 11, ka propozuar për Triportin identifikimin fillestar me Thronin e shkatruar nga apolloniatët dhe më tej me Aulonën.

7) K. Zheku, **«Zbulimi i një gurore antike në shkallë të Konispolit»** B.Sh.Sh. 1.1963, f. 228-232. E njëjta teknikë është zbatuar në Selcë, Bylis, Amantie etj. Ku ruhen gjurmë të qarta të guroreve.

8) Shih: **«Historia e Arkitekturës Shqiptare»** (Maket), Tiranë, 1970.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

tur për transport. Me interes është një grup kollonash të rrumbullakët me punim të rrafshët (Fig. 4) si dhe një trung kollone me diametër rreth 1 m.

5. Karaburun

A. **Grama.** Bregdeti perëndimor i Karaburunit ka pasur emër si vend i rrezikshëm për lundrimin. Anijet e kapura nga moti i keq gjendeshin aty përballë një bregu të thepisur me shkëmbinj të paafrueshëm. Vetëm tre gjire të vegjël i ofronin anijeve një vend-strehim për erërat e jugut apo të veriut: Gjiri i Arushës. «Grama e Vjetër» dhe Grama. Grama është bërë e njohur për herë të parë nga Qiriaku i Ankonës dhe më pas nga Paçi,[9] që njoftuan për mbishkrimet e gdhendura në shkëmb, kushtuar dioskureve nga detarët e strehuar në raste shtërngate.[10].

Gjiri i Gramës është në fakt fundi i një kanioni të një përroi malor, që hapet drejt perëndimit. Në të mund të strehoheshin në rast nevoje rreth pesë anije të mëdha. Sjelljet e përroit kanë krijuar një buzë ranore, të përshtatëshme për zbritjen në breg, ndërsa shkëmbinjtë në të dy anët e gjirit bien thikë në detin e thellë duke lejuar akostimin. (Fig. 5). Më tepër se për strehim, fillimisht Grama është përdorur si gurore, duke shfrytëzuar shkëmbinjtë gëlqerorë në breg të detit. Gurorja e parë, e shfrytëzuar në mënyrë intensive gjendet në breg të detit. Duken qartë gjurmët e nxjerrjes së blloqeve, duke krijuar sipërfaqe të gjëra vertikale si në Mermer. Në drejtim të perëndimit ruhet edhe platforma horizontale e shfrytëzimit, e cila ka qenë kthyer në një banesë. Në dyshemenë e saj janë hapur dy gropa në formë pitosash për ruajtjen e prodhimeve. Dyshemeja gjendet sot në një thellësi 0.50 m nën pasqyrën e detit në rast zbatice. Kjo gjë presupozon që në kohën e punimit deti të ketë qenë në një nivel të paktën 3 m më poshtë, për të lejuar punën, transportimin e blloqeve dhe mosdëmtimin nga dallgët në rast të erërave perëndimore. Prané janë gdhendur dy vaska të vogla rëzë shkëmbit për mbledhjen e ujit të pijshëm që kullonte prej tij.



Fig. 6

9) C. Patsch, **vep.cit**, f. 90-95.

10) M. Zeqo, «**Mbishkrimet dhe vizatimet në shkëmb të Gramatës**», «Zëri i Popullit» 5.3.1982, si dhe **Kartvizita të shekujve**, «Shqipëria e re». 1; 1983.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 9

Gurorja kryesore gjendet në drejtim të përroit, rreth 100 m larg bregut dhe rreth 50 m mbi nivelin e detit. Është gurorja më e madhe në vendin tonë, me një hapsirë prej rreth 200.000 m^3 të shfrytëzuar ndërmjet faqesh vertikale, që arrijnë lartësinë deri 50 m. Teknika e nxjerrjes së blloqeve ka qenë ajo e zakonshme për periudhën antike, me shkëputjen e tyre pas thellimit të kanaleve anësore.

Në faqet e krijuara nga shfrytëzimi i guroreve, që nga shek. III p.e.sonë ka filluar gdhendja e mbishkrimeve që zgjaten gjatë gjithë anës lindore të gjirit. Siç e ka vënë në dukje Paçi mbishkrimet i takojnë kohëve të ndryshme, duke vazhduar edhe në mesjetë. Duke bërë një klasifikim paraprak të tyrin do të dallonim mbishkrime të shkruara drejtpërdrejt në shkëmb dhe të tilla të vendosura brenda një sipërfaqeje katërkëndëshe të thelluar në shkëmb. (Fig. 6-7). Gjithashtu nga mënyra e të shkruarit dallohen mbishkrime të skalitura dhe një grup më i vogël i shkruar me bojë të kuqe.

Përsa i përket kohës vihet re një grupim i mbishkrimeve në dy periudha kryesore. E para, i tako



Fig. 8



Fig. 10

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

shek. III-II p.e.sonë dhe e dyta shek. VI-XI të e.sonë. Të parat janë në gjuhën greke dhe i kushtohen përgjithësisht dioskureve (Fig. 8). Të dytat janë në Gregishten mesjetare dhe dallohen nga formula Κύριε βοήθει e njëllojtë me atë të mbishkrimit të mozaikut në amfiteatrin e Dyrrahut. Mbishkrimet latine janë të pakta (Fig. 9) po kështu edhe ato pas shek. XV (Fig. 10). Një vend të veçantë zënë edhe figurat e gdhendura në shkëmb ku dallohen anije, një skenë me një kasolle dhe një grua pranë saj, amfora, kryqe dhe shenja të tjera (Fig. 11, 12). Përgjithësisht mbishkrimet, që duhet të jenë mbi 500, janë të dëmtuar dhe të mbuluar nga smërçi. Gjithashtu, mbishkrimet që shohim nga perëndimi janë dëmtuar nga kontakti me detin. Për këtë arsye pak mund t'i shtohet asaj që është dhënë nga Paçi. Mundëm të iexonim emrin e detarit ilir Genthios, si dhe një mbishkrim të një grupi ushtarësh të shek. III p.e.sonë. Grupimi kronologjik i mbishkrimeve është i lidhur me dendësimin e lëvizjeve veri-jugë në kohën e lulëzimit të qyteteve ilire në shek. III-II p.e.sonë dhe më tej të lidhjeve ndërmjet qendrave arbërore të Dyrrahut, Lisit, Ulqinit, Kaninës etj. në shek. VI-XI.

Grama paraqet një qendër të rëndësishme arkeologjike për studimin e shfrytëzimit të guroreve dhe të trafikut detar, në dy nga periudhat më të rëndësishme të historisë ilire-arbërore. Vendosja e mbishkrimeve na jep edhe një datë të sigurtë për datimin e shfrytëzimit të gurores para shek. III p.e.sonë, si dhe për ngritjen e nivelit të detit pas kësaj kohe. Sa për vendin ku transportoheshin blloqet e nxjerra nga gurorja, kryesisht duhet të mendojmë për Apollioninë dhe Dyrrahun, por veç tyre më pranë gjendeshin qendrat antike të bregut të përtejmë të Adriatikut.

B. Gjiri i Arushës. Në drejtim me fundin jugor të Gjirit të Vlorës, ku është vendosur Oriku, Karaburuni



Fig. 13



Fig. 14



Fig. 15

ulet në një qafë të gjërë që mban emrin Ravenë. Në anën perëndimore kjo qafë zbret në një gji më të gjërë se të Gramës, por më pak të mbrojtur nga erërat. Rreth gjirit nuk ruhen gjurmë antike, por fundi i detit në thellësi 10–15 m është i mbushur me qeramikë antike kryesisht amfora. Nga kërkimet nënujore u mblodh një numër i madh fragmentesh. Më e hershmja është një buzë amfore korinthike e shek. V p.e. sonë. Ndeshen me shumicë amfora italike të shek. II–I p.e.sonë dhe amfora të Azisë së Vogël të shek. VI të e.sonë. (Fig. 13). Shkarkimi i amforave të thyera dëshmon se ky gji përveçse një vendstrehim për anijet ishte një skelë që i shërbente tregëtisë së Orikut. Në pjesën verilindore të gjirit, pranë shkëmbenjve të bregut, në thellësi rreth 14 m ruhet skeleti i një anije të drunjtë, por mungesa e objekteve nuk dha mundësi të përcaktohej koha e fundosjes së saj.

6. **Shkodër.** Në kërkimet në ujrat e brendshme dhanë përfundime me interes ato të zhvilluara në Shkodër. Në anën e qytetit të poshtëm të zhvilluar në jugë të kodrës së Rozafës ishte vrojtuar me kohë një mur i gjatë bregut të lumit Drin.[11] Kërkimet nënujore vërtetuan se kishim të bëjmë me një pendë me gjatësi rreth 300 m të ndërtuar në disa periudha. Periudha e parë e ruajtur deri në thellësinë 5 m ishte ndërtuar me blloqe të kalasë ilire të ripërdorur me lidhje llaçi. Një periudhë e dytë përfaqsohej nga një numër i derdhur brenda armaturave prej trarësh e dërrasash, pjesë e së cilës ruheshin ende nën ujë. Periudha e tretë përbënte plotësime të veçanta dhe në të ishin ripërdorur elemente arkitektonike të një godine monumentale të shek. II të e.sonë. (Fig. 14). Kjo periudhë lidhej me nivelin e godinave të shek. IV–VI të zbuluara nga gërmimet arkeologjike.[12] Në thellësi të ujit pranë murit u gjetën kollona të lëmuara, kapitel korintik (Fig. 15) friz me dekoracion bimor, kollona lidhëse, pllaka orthostate etj. Ato ishin rënë aty nga muri i periudhës së tretë, ku ishin ripërdorur si material ndërtimi. Ndër spoliet e

11) M. Barleti, «Rrethimi i Shkodrës», Tiranë 1982, f. 40. duke shënuar shtrirjen e Shkodrës rrëzë Rozafës shton se «kur u hodhën themelet e qytetit, rrethi i mureve shtrihej atje poshtë në fushë më tepër se dymijë hapa, në formë katrore. Pjesës së poshtëme të këtij qyteti i binte përmes lumi i Drinit. Th. Ippen, **Skutari und die Nordalbanische Kustenebe** ne, Sarajevo 1907, f. 17,23, na njofton për zbulime monumentale në shpatin e Rozafës që sheh nga Drini, për pilastrat e një ure dhe për dy rrënoja kishash. M. Suflaj, **Stadte und Burgen Albaniens hauptsachlich wahrend des Mittelalters»** Wien 1924, f. 14;15 shënon edhe qënien në bazë të Drinit të «oborrit mbretëror të Balshajve dhe themeleve në shtratin e lumit». Gërmimet arkeologjike në këtë vend nxorën në dritë një banesë të madhe me një kthinë me mozaik që datohet në antikitetin e vonë. Autorët e gërmimit e përcaktojnë murin buzë Drinit si pjesë të fortifikimit të pjesës së poshtme të qytetit.

12) Shih. **Gërmimet arkeologjike të viteve 1978-1979** «Iliria», 1.1981. f. 271. ku S. Anamali dhe H. Spahiu njoftojnë për zbulimin e një godine banimi të antikitetit të vonë. Muri-pendë është vlerësuar aty si mur rrethues i poshtëm i qytetit.

DO NOT COPY



Fig. 16

ruajtura ende në këtë mur gjenden dy pjesë frizi, njëri prej të cilëve i plotë (1.67 x 0.65 x 0.33 cm), ndërsa tjetri i zbukuruar me rozeta.

Në njërën nga pjesët e frizit brenda në ujë dallohesin qartë reljefët e dy delfinëve të kundërvënë në bisht si dhe një cfurku tri dhëmbësh. Në një fragment tjetër ruhej reljefi i një delfini më të madh. Këto atribute dëshmonin se pjesët arkitektonike vinin nga një tempull i ordrit korintik kushtuar Neptunit, ose hyut vendas analog-Redonit.

Në pjesën më perëndimore lumi kishte zbuluar edhe një godinë banimi, muret e së cilës mbështeteshin tek muri pendë-i periudhës III. Shtresa kulturore që lidhej me të i takonte shek. IV-V e.sonë, njëlloj si banesa e zbuluar në gërmimet arkeologjike. Ky horizont banimi dëshmonte se muri pendë i periudhës III i takonte shek. IV të e.sonë, gjë që përforcohej edhe nga ripërdorimi i pjesëve arkitektonike të shek. II të e.sonë.

Muri i periudhës së II mund të lidhet fare mirë me kohën e ndërtimit të tempullit, kur në bregun e lumit u krijua një lloj forumi për qytetin e poshtëm të Shkodrës. Periudha e I e ndërtimit i takonte kohës kur lumi u bë rrezik për qytetin e poshtëm. Në shek. II. p.e.sonë Livi (XLI 31.3) na njofton se Shkodra rrethohej në dy anë prej Klausalit (Kirit) dhe Barbanes (Bunës), që derdheshin të dy në lumin Oriund (Drin). Kjo dëshmon se Drini duhet të ketë rrahur më nga jugperëndimi dhe Kiri kalonte pranë Shkodrës duke mos përbërë rrezik për lagjen e poshtme. Plini, në shek. e I të s.sonë e vendos Shkodrën mbi brigjet e lumit Drin. (NH III, 22). Pra, në këtë kohë Drini ishte kthyer drejt veriut dhe qe bashkuar me Klausalën para derdhjes së tij në Bunë, ashtu siç ndodh edhe sot. Kjo e ndryshoi ekuilibrin e ujrave dhe filloi gërryerja e brigjeve ku ngrihej qyteti i poshtëm. Për ti bërë ballë kësaj u ngrit edhe muri me blloqe të mara nga fortifikimet ilire, të cilat qenë braktisur prej kohësh. Por nuk përjashtohet mundësija që ky mur të ketë qenë ndërtuar që në periudhën ilire (Fig. 16).

Gjatë shekujve ka ndodhur edhe një fenomen tjetër: ngritja e shtratit të lumit. Ruajtja e armaturës prej dërrase në murin e periudhës së II dëshmon se pjesa e poshtme e tij ka qenë edhe atëhere nën nivelin e ujit, por sot nën ujë ndodhen pothuaj 3/4 e lartësisë së murit dhe për më tepër edhe disa banesa të shek. IV-VI të e.sonë, që përfaqsonin një ngritje të kuotës së qytetit gjatë egzistencës shumë shekullore. Duhet menduar se shtrati i lumit Drin është ngritur vazhdimisht si rrjedhim i mbushjes së Bunës nga prurjet e ngurta të tij. Kjo ka shkaktuar edhe ngritjen e vetë nivelit të ujrave të Drinit dhe si pasojë ngritjen e mureve të reja në vijën e pendës.

7. Seferan

Liqeni i Seferanit gjendet rreth 2 km në jp të qytetit ilir të Belshit. (Fig. 17). Gjatë thatësirës së vitit 1982 niveli i këtij liqeni u ul rreth 4 m dhe gjatë bregut të tij, në thellësinë nga 1.5-3 m u gjetën nga nxënësit një numër i madh terrakotash, enësh balte dhe kocka kafshësh. Ato ishin të shpërndara në mënyrë pothuaj të njëllojtë në një largësi të barabartë nga bregu. Nga kjo kuptohej se ato ishin hedhur në ujë gjatë zhvillimit të ceremonive të kultit përgjatë bregut. Terrakotat paraqisnin të tëra Afërdi-

DO NOT COPY

tën në shumë variante. Më të mëdhatë ishin protome të Afërditës Pandemos. Kishte paraqitjen në pozicion të shtrirë, në këmbë, në guaskë, të shoqëruar me Erosin etj. Enët ishin amforiska për mbajtje uji ose vere, enë guzhine dhe enë parfumesh. Kjo sqaronte edhe ritin e veçantë të ushtruar nga banorët e qytetit ilir të Belshit për një hyjneshë ilire të identifikuar në figurën e Afërditës. Tipologjia e objekteve e daton kohën e përdorimit të kësaj faltoreje ilire në natyrë në shek. e III-II p.e.sonë.

8. Liqeni i Pogradecit

Në vendin e quajtur Bllatë, në j të gadishullit të Linit u gjurmuan mbeturinat e një vendbanimi lakustër. Në thellësinë 2-4 m dalloheshin në fundin e liqenit hunjtë e një ndërtimi me drunj të ngulur. Diametri i tyre lëvizte nga 0.10-0.30 m dhe vendosja ishte e çrregullt, por duke mbuluar një sipërfaqe të madhe, mbi të cilën ishte ngulur platforma e vendbanimit. Drunjtë ishin mprehur në majë për tu ngulur. Trashësia e madhe e llumit nuk lejoi të gjurmoheshin gjetjet e mundëshme të depozituara gjatë jetës në këtë vendbanim.[13)]

Kërkimet nënujore megjithëse në fillimet e tyre kanë dhënë një material me vlerë dhe hapin një perspektivë të gjërë për gjurmimin e monumenteve të vendit tonë. Ato janë një metodë, që do të përsoset duke zgjeruar njëkohësisht edhe fushën e kërkimeve nënujore.

Problemi i parë që shtrohet nga këto kërkime është vënia nën mbrojtje e monumenteve të zbuluara dhe përpunimi i një metodike për ruajtjen dhe vlerësimin e tyre. Kjo shtrohet veçanërisht për ato monumente që janë në kufirin midis ujit dhe tokës, si Grama, Treporti, etj.

Një punë e ngutshme që duhet bërë sa më parë është dokumentimi i këtyre monumenteve, duke përdorur në shkallë të gjërë fotogrametrinë si dhe metodat e dokumentacionit nënujor.

Studimi i mëtejshëm i monumenteve buzëujore dhe nënujore do të sjellë të dhëna të reja mbi dinamikën e vijës bregdetare në antikitetet e mesjetës, mbi drejtimet e lundrimit, lëvizjen e materialeve të ndërtimit dhe teknikën e nxjerrjes e transportimit të tyre, mjetet e lundrimit,etj.

FOTOCOPY

13) M. Zeqo, **«Zbulime arkeologjike nën ujë»**, «Zëri i Popullit» 16.10.1980.

Neritan CEKA
Moikom ZEQO

DO NOT COPY

FOUILLES SOUMARINES LE LONG DE LA COTE ET DANS LES EAUX INTERIEURES DE NOTRE PAYS.

RESUME

La côte de notre pays constitue une zone d'intérêt pour les fouilles soumarines. Le long d'elle se conservent des traces de centres habités, ainsi que d'installation des ports antiques et médievaux. Pas loin de la côte, ont été déterminés aussi, à la suite de trouvailles dûes au hasard, des points possibles, où se trouveraient des restes de bateaux naufragés. Les eaux intérieures couvrent de même des vestiges de cités lacustres ou de monuments ultérieurs auprès des eaux. Des expéditions soumarines ont été entreprises ces dernières années, en vue de la découverte de cette espèce particulière de monuments.

Les résultats des recherches présentent de l'intérêt et nous allons les exposer selon les centres relatifs:

1. La côte près de Durrës. *Les observations soumarines ont été effectuées dans la partie nord de la masse rocheuse, se situant en face du plage des Currila. C'est seulement parmi les rochers qui entrent dans la mer près de l'endroit où la masse rocheuse joint la terre, à son extrémité nord, qu'on a trouvé sous l'eau des parties d'amphores italiques et de récipients du IIe siècle av. n. ère. Il est probable qu'elles ont été jetées là par les barques qui s'abritaient dans la petite baie, protégée des vents du nord. Le manque de constructions a été prouvé aussi par les plongées soumarines faites à l'extrémité sud de la masse rocheuse à Talbolt. Toutefois, même là, au fond de la mer, à une profondeur de 2-4 m, on a trouvé plusieurs fragments de céramique, qui ont, sans doute, été jeté des barques.*

2. La côte de Portezë. *A 300 m environ au nord du barrage et à 40-50 m de la côte, dans une profondeur allant jusqu'à 2,5 m on a examiné une construction en grandes pierres sableuses, sans mortier. Un côté du bâtiment, long de 4 m était conservé, la où commençait un mur de séparation de largeur plus petite. D'autres pierres, à 20 m environ de là, appartenaient à un bâtiment voisin démoli par les vagues. Autour des constructions il y avait plusieurs tuiles. Des tracés de constructions et des vestiges d'une couche culturelle des IVe-IIe siècles av. n. ère continuent sur toute la ligne côtière et près du mur de la période byzantine à Portez. Elles témoignent de l'existence d'un centre habité ouvert, qui a été abandonné à la suite d'un abaissement de la ligne côtière.*

3. Le Cap de Rodon. *Le déplacement de la ligne côtière à découvert les fondations de deux tours rondes du château de Scanderbeg à Muzhël. Pas trop loin de la tour sud-ouest, dans une profondeur de 3 m, se trouve un mur en grandes pierres non liées de mortier. Il reste à continuer davantage les recherches le long de la côte autour du cap de Rodon, qui est la zone où l'on pourrait le plus probablement découvrir la ville de Denda. Pline (NH III, 23) nous laisse comprendre que cette cité importante, qui au Ier siècle de n. ère jouissait du droit romain, se situait sur la côte entre Lis et Dyrrah.*

4. Le golfe de Vlorë

a. Treport.

Dans le golfe de Vlore, les fouilles ont été concentrées autour de Treport, et avaient pour but de clarifier le rôle du mur côtier de ce centre, qui reste discutable. L'examen du cap rocheux, qui se rallonge de Treport vers le Sud-Ouest, a démontré qu'il continue dans la mer sur environ 300 m, en forme d'une barrière naturelle, large de 5 à 30 m, et qui, à divers endroits, était haussée d'un mur de blocs sableux. A 200 m environ de la côte, au sud de cette barrière on a déterminé l'endroit d'accostage des navires antiques. Là, à une profondeur de 12 m, on a découvert deux amphores entières du type olearia (fig. 2), datant du Ier siècle av. n. ère, ainsi que bien des vestiges de récipients, parmi lesquels le plus ancien semble être du IVe siècle av. n. ère, tandis que la plus grande partie appartenait aux IIIe-IIe siècles av. n. ère.

De nombreux restes d'amphores couverts de sable y dessinaient les contours d'un navire en bois naufragé, qui pourrait être relié à la charge de l'huile.

Bien qu'à une petite profondeur, le mur côtier aussi a présenté de l'intérêt pour les recherches soumarines. Le mur lui-même était construit selon la technique ordinaire de la construction de fortifications, large de 3,50 m, avec deux faces de blocs taillés, rempli à l'intérieur d'éclats de pierre moyens et petits. Sur sa longueur, on a relevé des saillies, correspondant aux tours et une interruption, signe d'une entrée dans la di-

DO NOT COPY

rection du lieu d'accostage. Derrière le mur, il y avait une déposition régulière de couches culturelles avec des matériaux typiques pour le IIIe siècle av. n. ère. Ces données témoigneraient d'une construction de défense pour le mur d'enceinte, presque égal à celui de Bylis. Toutefois cette surface n'a que deux zones principales d'habitations. La première est limitée à la partie la plus haute de la colline de Treport, et a la forme d'un acropole, alors que la seconde s'étend seulement le long du mur côtier et a une largeur de 100 m. Les données qu'on dispose nous mènent à penser à un type urbanistique particulier, où une partie de la cité celle la plus ancienne et la plus fortifiée, se situait à une hauteur qui dominait le quai et la mer. La partie principale, de caractère économique, était développée près du quai, au bord de la mer et était protégée des vagues et des attaques de pirates par un mur parallèle au bord de la mer. Le glissement de la ligne côtière a causé la disparition du mur dans la mer et l'abandon de la cité.

Cela pose le problème de l'identification et nous proposerions la ville de Daulia, mentionnée dans la liste delfique de theoradoques, dans le premier quart du IIe siècle av. n. ère, à côté d'Apollonie, de Bylis et d'Orik.

B. Mermer

A la recherche du trafic maritime pour la transportation des pierres utilisées dans les constructions d'Apollonie et de Dyrrah, examinant la côte Sud du Karaburun, on a découvert un groupe de carrières, à l'endroit nommé Mermer, à 10 km environ au Nord d'Orikos. On a étudié quatre grandes carrières, de 100 m de long environ chacune, situées au bord de la mer jusqu'à une hauteur de 60 m du niveau de la mer. L'exploitation intensive des carrières a créé des faces verticales d'une hauteur de 10-30 m (fig. 3). La technique d'extraction des blocs rectangles est celle bien connue dans les carrières antiques de notre pays, consistant à creuser un canal sur trois côtés et les détacher, par la suite d'en bas, au moyen de coins de fer. On a constaté également que la partie inférieure de la carrière se trouvait sous l'eau à une profondeur de 1 mètre environ. Cela démontrait que, lors du commencement de l'exploitation de la carrière, cette partie de la côte était au-dessus du niveau de la mer, autrement l'extraction des blocs à cette profondeur serait impossible.

L'inondation de la partie inférieure de la carrière est reliée au même phénomène, à celui qui a neutralisé le mur de Triport et qui a laissé des traces dans les autres centres antiques, depuis le Cap de Rodon jusqu'à Butrint. Quand a eu lieu cette inondation? Les monuments soumarins désignent comme terminus post quem le IIe siècle av. n. ère, duquel datent les découvertes de Rodon, ou bien la fin de la couche culturelle le long du mur de Treport. Dans les sources historiques on n'a que la donnée de Plutarque, qui parle du glissement de la côte et la liaison du marais avec la mer, au cours de la guere civile à Dyrrah.

C. Orikos

Lors des touilles, on a constaté que le relief soumarin a beaucoup changé depuis les temps antiques. La partie nord-ouest de la lagune, qui communiquait alors avec la mer et qui avait une grande profondeur, est remplie toute entière avec le matériel provenu de l'approfondissement du port actuel. D'autre part la lagune s'est élargie dans la direction du Sud, à la suite de la hausse du niveau de l'eau, qui a inondé les constructions anciennes sur l'autre bord de la lagune.

D. Uji i Ftohtë

Les rochers mis sur toute la côte, au-desous de la maison de repos des ouvriers, ont servi de carrières dans l'antiquité. Le long de la côte sont conservés des tas de blocs rectangles préparés pour être transportés. D'intérêt est un groupe de colonnes rondes, ainsi qu'un tronc de colonne d'un diamètre d'un mètre environ (fig. 5).

5. Karaburun

A. Grama

Grama a été mentionnée pour la première fois par Cyriaque d'Ancone et plus tard par C. Patsch, qui ont présenté les inscriptions, gravées sur les rochers, qui étaient dédiées aux dioscures par les marins qui s'y sont abrités en cas d'orage. Mais au début, Grama a été utilisée plutôt comme carrière que comme abri, en exploitant les rochers calcaires monolites. La première carrière exploitée de façon intensive se trouve au bord de la mer. On y voit clairement les traces de l'extraction des blocs, en créant de vastes surfaces verticales comme à Mermer.

La carrière principale se situe dans la direction du torrent, à 100 m environ du bord de la mer et à 50 m environ au-dessus du niveau de la mer. (fig. 7). C'est la plus grande carrière de notre pays, d'un volume d'environ 200 000 m^3 exploités entre des faces verticales, qui atteignent une hauteur de 50 m.

Sur les faces créées par l'exploitation des carrières, depuis le IIIe siècle av. n. ère ont continué les inscriptions qui se rallongent sur tout le côté Est du golfe. En faisant une classification préliminaire de ces inscriptions, on distinguerait celles écrites directements sur le rocher et d'autres gravés sur une surface rectangle creusée sur le rocher (fig. 8). On distingue également des inscriptions gravés et un groupe plus petit d'inscriptions écrites à l'encre rouge.

DO NOT COPY

Les inscriptions appartiennent à deux périodes principales. La première est du IIIe-IIe siècles av. n. ère et la seconde du VIe-XIe siècles de n. ère. Le premier groupe d'inscriptions est en langue grecque et généralement dédié aux dioscures. Celles du second groupe sont écrites en grec médiéval et se distinguent par la formule « Κυριε βοήθει του δουλου σου». Les inscriptions en latin sont peu nombreuses, de même celles d'après le XVe siècle. Une place particulière est occupée par des images gravées sur le rocher, parmi lesquelles on relève des navires, une scène avec une chaumière et une femme à côté, des amphores, des croix et d'autres signes.

Le groupement chronologique des inscriptions est lié à la densité croissante des mouvements Nord-Sud, aux temps de l'épanouissement des cités illyriennes, au IIIe-IIe siècles av. n. ère et à la conservation des liens entre divers centres albanais comme Dyrrah, Lis, Ulqin, Kaninë, Butrint etc., au VIe-XIe siècles.

Les inscriptions sont un témoignage sûr de la datation de l'exploitation de la carrière avant le IIIe siècle av. n. ère, ainsi qu de la hausse du nivéau de la mer après cette époque-là. Quant au lieu où les blocs extraits de cette carrière étaient transportée, on peut penser à Apollonie et à Dyrrah surtout, mais les centres antiques de l'autre côte de la mer Adriatique étaient encore plus près.

B. La Baie d'Arushë

Dans la direction du fond sud du Golfe de Vlore, là où se trouve Orik, le Karaburun a un col large, portant le nom de Ravenë. Autour de la baie on ne trouve pas de traces antiques, mais le fond de la mer, à une profondeur de 10-15 m est plein de céramiques antiques, surtout des amphores. La plus ancienne est la partie supérieure d'une amphore corinthique B du Ve siècle av. n. ère. On y trouve en grande quantité des amphores italiques du IIe-Ier siècles av. n. ère, ainsi que des amphores de l'Asie Mineure du VIe siècle, de n. ère. Ces objets témoignent que cette baie a été non seulement un abri pour les navires, mais aussi un quai qui servait au commerce d'Orik. Dans la partie NE de la baie, près des rochers de la côte, dans une profondeur d'environ 14 m, est conservée l'ossature d'un navire en bois, mais le manque d'objets n'a pas donné la possibilité de déterminer le temps de son naufrage.

6. Shkodër

Dans la partie de la ville s'étendant au sud de la Colline de Rozafa, on avait découvert depuis longtemps un mur le long du bord du fleuve de Drin. Les fouilles sous l'eau ont certifié qu'on avait à faire à un barrage, long de 300 m environ, construit au cours de quelques périodes. La première période conservé dans une profondeur allant jusqu'à 5 m était construite avec des blocs provenant de la forteresse illyrienne, réutilisés et liés avec du mortier. Une seconde période est représentée par des blocs jetés à l'intérieur des maçonneries de poutres et de planches, dont une partie est encore conservée sous l'eau. La troisième période constituait des complétements particuliers, où l'on avait réemployé des éléments architectoniques d'un bâtiment monumental du IIe siècle de n. ère. Cette période correspond au niveau des bâtiments de IVe-VIe siècles. Dans les profondeurs de l'eau, près du mur, on a trouvé des fragments architectoniques tombés du mur de la troisième période. Parmi les spolie, conservés encore de ce mur, on trouve deux parties de frise, dont l'une est décorée de rosettes.

Sur l'une des parties de frise, à l'intérieur de l'eau, on distinguait nettement les reliefs de deux dauphins ainsi que d'une fourche à trois dents. Ces reliefs témoignaient que les parties architectoniques étaient en provenance d'un temple de l'ordre corinthique dédié à Nepthune, ou bien à Redon, dieu autochtone analogue. Par leur mode de traitement elles correspondent avec le style de la période des Antonines.

Dans la partie extrême Nord, le fleuve avait découvert aussi un bâtiment d'habitation, dont les murs étaient appuyés contre le mur-barrage de la IIIe période. La couche culturelle qui lui correspondait appartenait aux IVe-Ve siècles de n. ère tout comme l'habitation découverte par les fouilles archéologiques.

Le mur de la IIe période pourrait très bien correspondre avec l'époque de construction du temple, lorsque sur la rive du fleuve, il était créé un forum pour la ville basse de Shkodër. La Ière période de construction appartenait aux temps où le fleuve a constitué un danger pour la ville basse. Au IIe siècle av. n. ère, Live (XLiV; 31, 3) nous informe que Shkodër était entourée de deux côtés par Clausala (Kir) et Barbane (Bunë), qui se versaient dans le fleuve d'Oriund (Drin).

Ceci témoigne que le Drin a dû passer plus au Sud-Ouest et que le Kir coulait seul près de Shkodër, sans constituer un danger pour le quartier bas. Pline au Ier siècle de n. ère, situe Shkodër sur les rives du fleuve de Drin (NH III, 22). Donc, en ce temps-là, le Drin était retourné vers le Nord et s'était réuni avec le Clausala, avant qu'il ne se versât dans la Bunë, comme de nos jours. Ceci a modifié l'équilibre des eaux, qui ont commencé à creuser les rives où s'élevait la ville basse. C'est pour éliminer cela, qu'a été bâti le mur barrage en blocs en provenance des fortifications illyriennes, qui étaient abandonnées depuis longtemps.

Au cours des siècles est advenu la hausse du lit du fleuve. La conservation de l'armature en planches dans le mur de la IIe période, témoigne que sa partie inférieure était même en ce temps-là, au-dessous du niveau de l'eau, mais de nos jours, sous l'eau se trouvent plus de 3/4 de la hauteur du mur et en plus même quelques habitations des IVe-VIe siècles de

n. ère, qui représentaient la hausse de la quote de la ville pendant son existence multi-séculière.

7. Seferan

Le lac de Seferan se situe à 2 km environ au Sud-Ouest de la cité illyrienne de Belsh. Dans une profondeur de 1,5-3 m, on a trouvé un grand nombre de terres-cuites, de terrines et d'os d'animaux. Ces objets étaient parsemés de façon égale à une distance égale du bord. Ceci nous a laissé entendre qu'ils y avaient été jetés au cours de la célébration des cérémonies de culte. Toutes les terres-cuites représentaient Aphrodite. Cela clarifie aussi le rite particulier pratiqué par les habitants de la cité illyrienne de Belshi pour une déesse illyrienne identifiée avec la figure d'Aphrodite. La typologie des objets date l'utilisation de ce sanctuaire illyrien en nature des IIIe-IIe siècles av. n. ère.

8. Le lac d'Ohrid

A l'endroit appelé Bllatë, au Sud de la presqu'île de Lin, on a trouvé les vestiges d'une habitation lacustre. A une profondeur de 2-4 m, on distinguait au fond du lac, les pilots d'une construction, dont les fondements ont été assis sur un pilotis en bois. Les pilots avaient un diamètre qui allait de 0.10-0.30 m et ils étaient enfoncés de façon irrégulière, mais sur une grande surface. Les pilots étaient taillés en pointe à un bout, en vue de les enfoncer.

DO NOT COPY

Nr. 1 1984

monumentet

Halil MYRTO

DO NOT COPY

TË DHËNA MBI SHTRIRJEN E DYRRAHUT NË PJESËN JUGPERËNDIMORE TË «KËNETËS»

Këneta apo laguna e Durrësit para se të bonifikohej, më 1962, shtrihej në verilindje të qytetit, duke zënë një sipërfaqe prej 2050 ha, prej së cilës 1600 ha plotësisht mbuluar me ujë, ndërsa 450 ha pjesërisht[1]. Në kohë rreshjesh ujërat mbulonin një sipërfaqe edhe më të madhe. Në anën jugore këneta komunikonte me detin me anë të një kanali të gjatë rreth 2.5 km, që arrinte deri tej Spitallës, tek vendi i quajtur Balta e Madhe. Në anën verilindore lidhjen me detin e bënte një kanal tjetër, i quajtur i Brukëve të imta, që hynte deri rreth 2 km në brendësi të tokës, vend i quajtur Balta e Vogël.

Sot pjesa më e madhe e kësaj fushe është nën nivelin e kuotës absolute «0.00» (Tab. I)[2], duke përfshirë brenda edhe zona të vogla deri -0.70 m. Por sistemi i kanaleve kullues të lidhur me hidrovorin e mban nivelin e ujërave në -1.80 m.

Një vështrim mbi gjeografinë historike

Burimet antike e mesjetare paraqiten të kursyera për topografinë e Durrësit. Prandaj mbi gjeografinë historike të kënetës, mund të nxirren vetëm të dhëna indirekte. Autorët më të hershëm, si Thukididi në çerekun e tretë të shek. V p.e.s.[3] dhe Eratosteni në shek. III p.e.s.[4] pozitën gjeografike të këtij qyteti e cilësojnë «gadishull». Nga ky njoftim nuk mund të nxirret përfundim mbi qënien ose mosqënien e kënetës, sepse lidhja e kepit të Durrësit me pastokën mund të kuptohet ose e gjërë si sot, pra pa kënetën, ose e ngushtuar nga shtrirja e saj. «Gadishull» përsërit edhe Straboni në shek. I p.e.s.[5] Por nga mesi i atij shekulli Çezari bën fjalë për «dy gryka të ngushta»[6] të komunikimit me qytetin, për të cilat është shfaqur mendimi se duhen marrë si istmi verior dhe ai jugor i lagunës[7]. Ky supozim gjen mbështetje edhe nga njoftimi i Lukanit se «qyteti do të ishte ishull, pa kodrën e vogël»[8], ndonëse kjo «kodër e vogël» për gjeografinë e sotme fizike të Durrësit është vështirë të identifikohet. Një ndarje ujore e qytetit nga pastoka e tij, madje do të shtonim një ndarje «e kontrolluar», del më qartë nëpërmjet njoftimit të Prokopit të Gazës, autor i fundit të shek. V dhe shek. VI e.s. kur dyrrahasit i quan «njëkohësisht banorë të ishullit dhe të kontinentit»[9].

Në shek. XI Ana Komnena, duke përshkruar rrethimin norman të Durrësit, përmend një kanal që hyn nga deti në tokë në anën jugore[10] dhe le kështu

1) Rilevim topografik para bonifikimit (ruhet në Drejtorinë e ujërave e sistemimeve Durrës). Në vitet e para pas Çlirimit para se të hapej kanali i Jubës, këneta shtrihej edhe më tepër nga VL, duke zënë një sipërfaqe prej 3000 ha (shih. P. Geco, **Gjeografia fizike e Shqipërisë**, Tiranë, 1973, fq. 394-395.
2) Harta me izoipsin «0.00» është marrë nga Instituti i Tokave, Tiranë.
3) Thuc, I, 26.
4) Eratosteni sipas Steph, byz. s.v. Dyrrahion.
5) Strab, VII, 8.
6) Caes, **B.C.**, III, 58.
7) G. Veith, **Der Feldzung von Dyrrachium zwischen caesar und Pompejus**, wien, 1920, fq. 168.
8) Lucanus, **Pharsalia**, VI
9) Procop Gaz, 491-492.
10) A. Comnena, «Alexias», VI, 1.

për të nënkuptuar ekzistencën e një lagune. Sidoqoftë shtrirja e saj ka qenë e kufizuar. Ajo nuk arrinte të mbulonte fushën para mureve të qytetit, ku u ngrit një kamp ushtarak për 30.000 njerëz të pajisur me kavaleri të rëndë e me kulla lëvizëse[11] Autorja shton, nga ana tjetër, se rrethonjësit e ngritën kampin midis rrënojave të Epidamnit antik[12]. Më pas, tërmeti i madh i vitit 1273 thuhet se e mbylli grykën e kanalit dhe shkaktoi rritjen e kënetës.[13]

Në shek. XV jepet për herë të parë një njoftim direkt mbi praninë e kënetës dhe mbi emrin e saj të mirëfilltë: «Balta»[14] Po në këtë shekull dhe pikërisht më 12 prill të vitit 1442, senati i Venedikut urdhëroi të merrej në shqyrtim një propozim i durrsakëve që, me ndihmesën e tyre, të hapej një kanal përmes kënetës, nga veriu në jug, për ta kthyer qytetin në ishull.[15] Një kanal i tillë duket se është hapur, tejmbanë apo jo këtë nuk e dimë, por gryka e tij u mbath shpejt nga rëra e detit[16]. Më 1501, kur turqit sulmojnë dhe pushtojnë Durrësin, mësojmë se në shumë vende këneta ishte tharë.[17]

Me interes është harta e parë e lagunës, që njohim, e përpiluar më 1861 nën drejtimin e L. Hezeit[18]. Aty për pjesën jugore është vënë emri «lagunë», ndërsa për verioren, vetëm «moçal», me fjalë të tjera bëhet e njohur natyra e saj e ndarë në, siç quhen, «lagunë e gjallë» dhe «lagunë e vdekur».

Njoftimet e përmbledhura më sipër na lejojnë, së paku, të pohojmë se jo në të gjitha kohët territori që kemi në studim ka qenë tërësisht i mbuluar me ujë. Për më tepër, nga sa bën fjalë Ana Komnena lind sugjerimi se përtej mureve të Durrësit mesjetar, me sa kuptohet në pjesën JP të kënetës, duhen kërkuar rrënoja të Epidamnit antik.

Përshkrimi i gjetjeve

Objekte antike me prejardhje nga vendi i kriporeve të fillimit të këtij shekulli, të cilat gjendeshin anës JP të kënetës, përmendin për herë të parë Praschniker dhe Shober.[19] Disa dekada më pas, në kohën e punimeve bonifikuese, më 1961–1962, në kënetë u shpëtuan një numër fragmente kolonash mermeri e guri gëlqeror, si dhe objekte të tjera[20]. Midis këtyre përmendim një kokë mermeri të datuar në shek. I e.s. (Fig. 1)[21].

Në vitin 1971 u ndërmorën gërmime shpëtimi, që vijuan pastaj në mënyrë të rregullt në pjesën VL të qytetit të sotëm, vend që dikur arrihej nga zgjerimet e kënetës. Aty u evidentua një varrezë e shekujve të parë të erës sonë.[22] Vitet e fundit kemi dhënë një raport të hollësishëm mbi mbetjet e këmbëve të ujësjellësit antik, që e përshkonte tejmbanë pjesën jugperëndimore të kënetës, në drejtim të Rrashbullit (Tab. I)[23].

Por me një vështrim në sipërfaqe, sidomos në kohën e lëvrimit të tokës, vërehet se mbetjet e ndërtimeve antike brenda kufijve të kënetës së dikurshme nuk kufizohen vetëm me gjurmët e ujësjellësit. Atë kanë shtrirje më të gjerë, si në hapësirë, edhe në kohë. (Tab. I)[24] Duke filluar 600–700 m tej linjës

11) **Po aty,** shih dhe L. Heuzy-H. Daumet, **Mission Archéologique de Macedoine,** Paris, 1876, fq. 349.
12) A. Comnena, **po aty.**
13) M. Shuflaj, **Serbët dhe shqiptarët,** Tiranë, 1926, fq. 13.
14) K. Jireçek, **Die lage und vergangenheit der Stadt Durrazo in Albanien,** në «Illyrisch-Albanische Forschungen», Leipzig, 1916, V, I, fq. 158.
15) **Acta et Diplomata,** II, 481.
16) M. Shuflaj, **vep. cit,** fq. 12.
17) **Po aty,.**
18) L. Heuzey-H. Daumet, **vep. cit,** (Plan H)
19) C. Praschniker-A. Schober, **Archaologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien, 1920, f. 43.
20) Sipas njoftimeve gojore që kemi nga bashkëpunëtori i vjetër shkencor V. Toçi, që përfitojmë nga rasti për ta falenderuar. Materiali ruhet në muzeun arkeologjik të Durrësit, i pabotuar.
21) Fotografia e saj është dhënë në albumin **«Shqipëria arkeologjike»** Tiranë, 1971, nr. 110.
22) F. Tartari, **Rezultate të gërmimeve të vitit 1971 në skajin VL të qytetit të Durrësit,** në «Buletin arkeologjik», Tiranë, 1971.
23) F. Miraj-H. Myrto, **Ujësjellësi i Dyrrahut,** «Iliria», 1982, fq. 131.
24) Të dhënat që do të përshkruhen më poshtë janë përftuar nga autori me anë gjurmimesh në sipërfaqe, ndërhyrjesh shpëtimi dhe të një gërmimi të papërfunduar. Për njoftime të mëparshme, shih H. Myrto, **Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit,** – almanak 1, Tiranë; 1983, f. 57 dhe **Rezultate të kërkimeve arkeologjike në kënetën e Durrësit,** në «Materiale të sesionit shkencor arkeologjik», Durrës, nëntor 1983, fq. 39-47.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

së «rrethojës së tretë» të Dyrrahut, (400-500 m në lindje të stadiumit të sotëm), haset një shumicë material ndërtimi antik i nxjerrë në sipërfaqe nga punimet bujqësore. Kjo pamje, që vërehet edhe në faqet e kanaleve kullues, ndeshet edhe në brendësi të kënetës, deri 2 km nga kufiri i sipërpërmendur e qytetit antik, si dhe në një pikë pranë Bisht-Kamzës në veri. Sipërfaqia e përgjithshme e pjesës JP të kënetës që i shfaq më dendur këto gjurmë arrin në 80 ha.

Përveç blloqeve të mëdhenj gurësh shtufi e konglomerat që shihen të shpërndarë në sipërfaqe, aty-këtu vërehen edhe gurë të tillë në një linjë, që të lënë përshtypjen se përfaqsojnë rrënoja muresh. Në përgjithësi blloqet e gurëve kanë madhësi të vogël e mesatare dhe janë pa forma të rregullta e të palatuar. Por janë hasur edhe blloqe gurësh të latuar. Ndërmjet këtij materiali përmendim edhe tamburë të plotë e fragmente kolonash dorike e jonike.

Qeramika masive e përdorur si material ndërtimi përfaqsohet kryesisht nga solene e kalipterë (Tab. II). Ato janë të tipeve tanimë të njohura, si në Durrës, edhe në qendra të tjera antike të vendit tonë, të shekujve IV-I p.e.s.[25] Por nuk mungojnë edhe tipe që janë karakteristike për periudhën pasardhëse.

Për të formuar një ide më të kjartë mbi domethënien e kësaj dukurie, po përshkruajmë më poshtë rezultatet e një gërmimi ende të papërfunduar, si dhe disa gjurmë të tjera që paraqesin elemente më treguese. Në përshkrimin tonë, si kriter bazë për renditjen e materialit kemi zgjedhur atë gjeografik me drejtimin nga jugu në veri, duke e ndarë sipërfaqen që shfaq gjurmë antike në katër sektorë. (Tab. I).

Sektori A

Rreth 400 m në veri të linjës së ujësjellësit është zbuluar një pjesë e mbeturinave të një banese në një sipërfaqe prej 250 m^2 (Fig. 2). Thellësia e shtresës kulturore nuk shkon më tepër se 0.40-0.60 m. Në pjesën e gërmuar kanë dalë në dukje mbetje themelesh, apo xokolatura muresh, dhe shtroje dyshemesh me gurë, pllloça e material qeramik.

Muret zgjaten deri 8-10 m (4,6,7,8). Gjerësia e tyre shkon nga 0.80-0.90 m (7,8,12). Ka edhe pjesë muresh më të vogla, me trashësi 0.40 m (1,2,3). Lartësia arrin 0.40 m. Janë ndërtuar me gurë ranorë e konglomerat, me madhësi të vogël e mesatare, që arrijnë përmasa maksimale: 0,60 x 0,30 x 0.20 m. Mi-

25) Shih: A. Mano, **Të dhëna mbi qeramikën masive të Apolonisë përdorur si material ndërtimi**, «Studime Historike» 1, 1965, fq. 51-79.



dis tyre ka gurë më të vegjël, të thyer. Lidhja është bërë me baltë.

Brenda mureve vërehen shtroja kalldrëmesh me gurë të vegjël të çrregullt dhe ndërfutje copra tjegullash (A,B). Shtroja në ambientin A arrin deri në nivelin e xokolaturës së mbetur të mureve, kurse në «B» në një nivel 0.20 m më të ulët. Një pjesë dyshemeje (E) është prej fragmente solenesh dhe fragmente të rralla amforash, të shtruara mbi baltë të ngjeshur e përzier me zhurishte.



Fig. 4

Në pjesën veriore të sipërfaqes së zbuluar ka dalë jo tërësisht një xokolaturë (15), me formë katërkëndëshi (7,80 x 2,80 m). Kufizohet anash prej një bordure gurësh të vegjël të lidhur me baltë dhe të puthisur mirë, që përcaktojnë lartësinë e saj 0.15m. Brenda është mbushur me baltë të ngjeshur dhe copra tjegullash e gurësh të vegjël. Ka një ndarje të brendshme, e përcaktuar nga një linjë e hollë muri.

Në skajin e kësaj xokolature u gjet një bllok i madh kuadratik travertin (0.85 x 0.85m) i latuar nga të gjithë anët. Në faqen e sipërme të tij mund të dallohet shenja e një rrethi me diametër të madh, e mbetur ndoshta nga mbivendosja e një kolone. Një bllok identik u gjet pranë (Fig. 3).

Anash mureve 1,4,6, nga jashtë, si dhe në anë të shtrojes «E» u zbuluan mbetje konstruksionesh të lehta prej tjegullash solene, të një forme interesante. Këto janë në trajtë bankinash të vogla[26] të kufizuara anash prej solenesh. Në krah të murit C një «bankinë» e tillë u gjet e mbuluar edhe nga sipër me solene të fragmentuara të vendosura në këmbë. Mbushja ishte prej dheu me ndonjë fragment të rrallë ene me vernik të zi.

Si për gjithë planimetrinë e pjesës së zbuluar të kësaj ndërtese në raport me të tërën, edhe për funksionin e këtyre konstruksioneve të lehta në të, nuk mund të japim ende një gjykim të sigurt. Këto të fundit kanë përngjasim ndoshta me kostruksione të një natyre të afërt që janë vërejtur në shtëpi të shekujve IV-III p.e.s. në Apoloni.[27]

Mbi gjithë sipërfaqen e zbuluar u gjetën një mori fragmente tjegullash solene e kaliptere, si dhe fragmente enësh balte. Solenet janë të tipeve të përmendura më lart (Tab. II, 8, 9, 12, 14). Një pjesë e tyre kanë qenë të lyera në faqe me një lustër violet ose të kuqe të hapët. Në një fragment përmbahet vula monogram siç duket e përbërë nga gërmat Δ dhe A (Tab. II). Kjo vulë është e njohur dhe në tjegulla të tjera solene nga Durrësi.[28] Ky monogram, por me gërmën M poshtë, është gjetur mbi tjegulla solene në Klos[29] dhe është lexuar Δαμοσια shtetërore). Është gjetur dhe në blloqe gurësh të godinave kryesore në Apoloni[30] dhe po ashtu është lexuar «shtetërore». Kalipteret janë të tipit «korintik» (Tab. II, 1).

26) Gjerësia e tyre arrin 0.76 m, thellësia 0.44 m.
27) L. Rey, **Fouilles de la mission française à Apollonie et à Durrazzo** «Albania» 1923-1924, fq. 14.
28) Material i pabotuar në fondet e Muzeumit të Durrësit.
29) L. Papajani, **Gërmimet arkeologjike të vitit 1974 në qytetin ilir të Klosit,** në «Buletin arkeologjik» Tiranë, 1974, f. 39-40.
30) N. Ceka. Apolonia e Ilirisë, Tiranë, 1982, fq. 81.

DO NOT COPY

Bie në sy mungesa e tullave. Kjo na lejon të bëjmë supozimin se muret përmbi xokolaturën e gurtë kanë qenë prej qerpiçi të dobët ose prej materiali të drunjtë e të lyer me baltë, që nuk ka lënë gjurmë të dukshme. Kjo teknikë ndërtimi është e njohur në vendin tonë në banesat e periudhës qytetare ilire[31].

Enët e baltës përfaqsohen nga fragmente pitosash e amforash, si dhe enësh kuzhine e tavoline[32] (Tab. III, 1,2,4,8,9). Ndërmjet këtyre përmendim një pjatë me figura të kuqe, që paraqet dy peshq dhe një sepie (Fig. 4)[33].

Janë gjetur edhe disa objekte të pakta metalike (Tab. III)[34], si dhe 23 monedha bronzi, tepër të brejtura nga oksidimi. Megjithatë tek disa dallohen të dhëna që mund t'i identifikojmë me monedha të Dyrrahut të tipit Herakli /armë, tip që dihet se ka filluar të pritet në këtë qytet që në shek. IV p.e.s.[35]

Në këtë mënyrë, shtëpia që evidentohet deri tani pjesërisht dhe që në të ardhmen shpresojmë të zbulohet e plotë, mendojmë se i përket fundit të shek. IV dhe fillimit të shek. III p.e.s.

Mbetje banesash antike në këtë sektor shihen edhe pak më në veri, në skarpatën e një kanali.

Më evidente është faqja e një muri guri në skarpatën e po këtij kanali por rreth 400 m më në lindje (Fig. 5). Ky përbën këmishën e jashtme të një xokolature (me gjatësi 6.30 m, gjërësi 0.70 m dhe lartësi 0.95m), që vazhdon, e pazbuluar, në drejtim të veriut. Muri është ndërtuar me blloqe të punuar gurësh shtufi e konglomerat me përmasa mesatare që arrijnë deri 0.96 x 0,44 x 0.28 m. Blloqet janë lidhur në të thatë dhe formojnë fugatura horizontale jo fort të drejta. Radha e fundit e gurëve del pak jashtë, duke krijuar një shkallëzim me gjërësi 10-20 cm. Thellësia e bazës së këtij muri nga niveli i sipërfaqes është 1.25 m. Ndërtimi, që siç thamë mbetet ende i pa zbuluar në drejtim të veriut, të jep përshtypjen se ka shërbyer si një bazament për një mbikonstruksion që është zhdukur.[36]



Fig. 5

Rreth 180 m në veriperëndim të kësaj pike, midis një sasie fragmentesh qeramike ngjitur pas plisave argjilorë, kemi gjetur një terrakotë jo të plotë, që tipologjikisht datohet në shek. III-II p.e.s[37]

Po në këtë sektor, në jug të linjës së ujësjellësit antik, duke vërejtur faqet e kanaleve kullues, si dhe gjurmë të dukshme në sipërfaqe, kemi mundur të ndjekim mbetje të një muri me gjatësi rreth 500m (Tab. I). Materiali i përdorur në këtë mur, gjërësinë e të cilit nuk kemi mundur ta përcaktojmë, përfaqsohet nga fragmente tullash (me trashësi 5 dhe 6 cm, por edhe 3-4 cm), si dhe llaç gëlqeror përzier me copra tulle, që formon fugatura horizontale 5-6 cm të trasha. Midis këtij materiali ndërtimor përmendim edhe fragmente detajesh arkitektonike dhe skulpturash, disa syresh prej mermeri.

31) F. Prendi, **Urbanizimi i Ilirisë së Jugut në dritën e të dhënave arkeologjike,** «Kuvendi i Studimeve Ilire» Tiranë, 1974, fq. 117.

32) Këto janë fragmente skyfosash me vernik të zi (Tab. III, 1, 2), fragmente ojnohoje në ngjyrën natyrale të baltës okër-rozë, si dhe një kandil balte me vernik të zi (Tab. III, 3).

33) Pjata peshqish me figura të kuqe të stilit Apul kanë qenë në përdorim të rëndomtë në Apolia, Kampanje dhe Pestum ndërmjet viteve 350-235 p.e.s. (A. Trendall, **Southitalian vase painting,** «The British Museum», 1966, fq. 14).

34) Të tilla si një gjilpërë dyshe në trajtë «omege» (Tab. III), tip i njohur në stolitë ilire, dy gozhdë bronzi, dy gozhdë hekuri (T. III).

35) H. Ceka, **Probleme të numismatikës ilire,** Tiranë, 1965, fq. 38.

36) Duke pastruar faqet e dukshme të murit, kemi mbledhur fragmente solenesh dhe enësh balte, ndër to edhe një fragment vazoje me figura të kuqe.

37) R.A. Higgins, **Greek Terracottas,** London; 1967, fq. 125.

POWOTCOPY

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 8

I murosur në të ka qenë edhe një altar varri me mbishkrim latin (Fig. 6, a, b). Ky u gjet i nxjerrë në sipërfaqe mbi një vazhdë prej gurësh të mëdhenj, fragmente tullash dhe llaçi gëlqeror të përzier me copra të trasha tulle, vazhdë kjo që ndiqet në një gjatësi deri 15m.



Fig. 7

Altari është prej mermeri të bardhë. Lartësinë e ka 1.10m, gjërësinë e mbetur 0.43 dhe trashësinë 0.35 m. Vende-vende ruan gjurmë llaçi gëlqeror, si provë e një ripërdorimi në murosje. Lart ai kulmohet nga një pjesë në formë cilindrike. Në anën e sipërme të brinjës së mbetur ballore të tij del në relief një kokë demi. Brirët e tij janë stolisur me kordele, dy bishta të së cilës zbresin njëri anash faqes ballore dhe tjetri në faqen anësore. Prej brirëve të demit varet në këto dy faqe edhe nga një feston gjethesh lulesh e frutash, që harkohen në anën e poshtme.

Ndërsa në pjesën e sipërme të faqes së mbetur anësore është paraqitur një rozetë në relief, në faqen ballore, brenda një **tabulae ansata,** është gdhendur një mbishkrim latin në gjashtë rreshta, që ruhet jo i plotë në anën e majtë:

(. . . .mforius/ . . .menos/ . . .s-perp/ . . .rhedris/suis/d.p.

Motivi i bukranios na kujton fragmentin e frizit të gjetur në Durrës, që tani ruhet në Luvër[38]. Një fragment altar varri zbukuruar në të njëjtën mënyrë është gjetur në kishën e Petovës të rrethit të Fierit dhe është datuar në shek. II e.s.[39]. Altari ynë men-

38) L. Heuzey–H. Daumet, **Mission...**, fq. 382-384, Tab. XXVII, 4.
39) Ç. Praschniker, **Muzakhia und Malakastra,** Wien, 1920, fq. 183, fig. 10.

dojmë se i takon shekullit të parë të erës sonë dhe është marrë diku afër për t'u ripërdorur si material ndërtimi në një mur të shek. V-VI e.s, i ndërtuar ndoshta në rrethana që kërkonin ngutje.

Me materialin e mësipërm do të shoqëronim edhe një **cippus** (gur varri) me prejardhje nga zona verilindore e qytetit, kufi me fushën e kënetës së dikurshme, ku ngrihen banesa të reja. Është një tip i veçantë (Fig. 7,a,b), i panjohur deri më sot në vendin tonë. Trungu i tij paralelpiped (0.97 x 0.46 x x 0.39 m) kulmohet nga një pjesë piramidale e zbukuruar me motivin e «luspave të peshkut» apo të «tjegullave në çati». Në meset e secilës brinjë të bazës ka kllapa me pjesëza plumbi, të cilat kuptohet se kanë shërbyer për ta lidhur me bazamentin, që mungon.

Motivi zbukuronjës gjen paralelizëm tek një shembull i «cippusit të rrumbullakët liburn» me mbishkrim latin që ruhet në muzeun e Splitit[40]. Në Durrës e kemi vërejtur vetëm në një rast tjetër, në zbukurimin e një krahu të gurtë froni zbuluar në amfiteatër.[41].

Karakteristikë të veçantë, përveç formës, ka edhe përsëritjen e të njëjtit mbishkrim në dy faqe të kundërta:

M(arco) T erentio/Syro Padia Prima/viva fecit) h (oc)m(onumentum) h(eredem) n(on) s(equetur).

Emri Syro i përket një antroponimi të vjetër ilir[42]. I përdorur në këtë rast sipas formulës onomastike romake, në funksionin e **«cognomen»**, përfaqson një shembull të ruajtjes së antropomisë ilire në banorët e Dyrrahut edhe mbas fillimit të përdorimit të emrave romakë. Mendojmë se i takon shek. I e.s.. Paraqitja e të njëjtit mbishkrim në dy faqe të kundërta të monumentit tregon se ka qenë vendosur në anë të një rruge, kryesore, për t'u shikuar nga të dy drejtimet.

Në skajin perëndimor të këtij sektori është gjetur një bllok paralelopiped me bazë katrore, prej guri travertin, me lartësi 0.37m dhe gjërësi 0.16m (Fig. 8, a,b). Paraqitet i lëmuar vetëm në tri anë, i thyer në pjesën e sipërme dhe i prerë jo rrafsh në anën e poshtme. Në njërën faqe të tij, brenda një kornize të cekët, është gdhendur mbishkrimi:

PRIVAT

Në faqen e përkundërt lexojmë katër gërma, prej të cilave e para nuk është e plotë PVBL.

Guri na duket i ripërdorur dhe gërmat të gdhendura jo nga një dorë mjeshtri. Mendojmë se është dhënë në trajtën e shkurtër dhe duhet transkribuar: Privat(us), Publ (icus). Kështu do ta merrnim këtë gur si një shtyllëz sinori **(cippi terminalis)**[43], i vendosur siç ishte zakon në një pikët kufiri midis një toke private dhe pronës publike të qytetit, që në periudhën e më parshme mund të ishte kullotë, pyll etj.[44]

Në afërsi të pikës së mësipërme, duke ndërmarrë një gërmim shpëtimi u zbuluan tre varre 0,5–1 m larg njëri tjetrit. Dy prej tyre, tek të cilët është zbatuar riti me vendosje kufome, ishin mbuluar me tjegulla në formë kulmi çatie. Varri i tretë, tek i cili ishte zbatuar riti me djegie, përbëhej nga një urnë qelqi e futur brenda një amfore të madhe, pasi kjo ishte sharruar për këtë qëllim mespërmesi. (Fig. 9). Në supe të amforës ruhet një vulë mbishkrimore në dy rreshta:



Fig. 9

40) J.J. Wilkes, **Dalmatia**, Cambrigde, Massachusetts, 1969, Tab. 22.
41) Ruhet në fondet e muzeut arkeologjik të Durrësit.
42) H. Krahe, **Lexikon Altillyrischen Personennamen**, Heidelberg, 1923 fq. 105. Për përdorime të tjera, shih dhe L. Heuzey, **Mission....** fq. 152 si dhe C.I.L. III, 611.
43) I. Calabi, **Epigrafia latina**, Milano, 1968, (shih **cippi terminalis**).
44) E. Lepore, **Per una fenomenologia storica del rapporto città-territorio in Magna Grecia**, «La citta ed il suo territorio», Atti del settimo convegno di studi sulla Magna Grecia (Taranta 8-12 ottobre), Napoli, 1968, fq. 32.

ZONOI COPY

T. Palfuri Surae /T. Palfurilar. . . . .Vula me emrin e Surës na kujton një amforë me «prejardhje ilire», e gjetur në Brindisi të Italisë[45]. Në Durrës ky emër njihet edhe nëpërmjet gurësh, mortorë të shek II e.s.[46]).

Nga këto të dhëna dhe në mënyrë të veçantë nga inventari i dy varreve të para, një kupë me figura në reliev (Tab III)[47] dhe një kandil i tipit «korintik» (Tab. III)[48], ky grup varresh datohet në shek. II-III e.s.

SEKTORI B

Është sektori me gjurmë ndërtimesh antike më në brendësi të anës jugore të kënetës së dikurshme, që kemi mundur të evidentojmë. Materiali ndërtimor i fragmentuar këtu shfaqet sidomos në një sipërfaqe rreth 2000 m^2, e shtrirë kjo në dy anët e kanalit të madh kolektor.

Në skarpatën e kanalit si dhe në anët e dy vijave kulluese që derdhen në të shihet se materiali i nxjerrë në sipërfaqe vjen nga një thellësi 1.5 m. Në këtë thellësi, në faqen e skarpatës lindore kemi mbledhur tulla katrore (44 x 44 x 8 cm). Këtu vërehet dhe një brez prej fragmente solenesh, pitosash dhe amforash. Në sipërfaqe janë gjetur funde, gryka e kapakë amforash, po ashtu dhe fragmente enësh tavoline me vernik të zi e kafe (Tab. III, 13,14,15).

Me interes janë edhe disa fragmente solenesh që mbajnë vula të pjesëshme mbishkrimore (Tab. II).

Në këto vula të pjesëshme lexohet i plotë emri i prytanit eponym Kalen dhe nuk vihet në dyshim ai i prytanit eponim Nesyl. Nga të dhënat numismatike njihen prytanë eponymë të Dyrrahut me emrin Kalen dhe Nesyl që i përkasin shek. III p.e.s.[49] Tjegulla solene me emrin e prytanit eponym Nesyl janë gjetur edhe në një shtëpi të shek. III p.e.s. zbuluar në Durrës, në kodrën me lartësi 59 m[50]

Por një pjesë e materialit qeramik paraqet karakteristika kronologjike të mëvonshme. Këtu përfshihen fragmente tjegullash të sheshta me buzë të profiluar, tjegulla me kurriz të harkuar që zbukurohen me vija të bëra me gishta para pjekjes, si dhe fragmente **terrasigillata** e copra flakonesh apo vazosh qelqi. Një fragment tjegulle e sheshtë, me trashësi 1 cm mban një vulë të pjesëshme mbishkrimore: PD (Tab. III). Ndërsa një fragment buze amfore mban vulën e pjesëshme: HER (Tab. III).[51]

Banesa apo banesat, që evidentohen nëpërmjet këtyre mbeturinave duket se kanë pasur një jetëgjatësi që nga shek. III p.e.s. deri në fillimin e shek. I e.s.

SEKTORI C

Shtrihet në veri të sektorit «A» dhe pothuaj i pandarë prej tij. Nga punimet bujqësore për dystimin e një sopi të vogël, në vitin 1974 dolën në dukje tri kthina jo të plota të një shtëpie me mure tullash. Në gjendjen që e gjetëm, muret arrinin lartësinë 0.80 m. Ato qenë ndërtuar me tulla drejtëkëndëshe jo të plota dhe qenë lidhur me baltë të përzier me rërë të hollë. Në to ishin futur edhe fragmente tjegullash e amforash. Vërejtëm fragmente solenesh me buzë të lugët e të mysët, si dhe fragmente të sheshta

45) M.H. Callender, **Roman Amphorae,** Oxford University, Taranto-New-Jersy, 1965, nr. T. 682.

46) V. Toçi, **Mbishkrime e relieve nga nekropoli i Dyrrahut,** «B.SH.SH.» 2. 1962; f. 105, nr. 50, shih dhe L. Heuzey, **vep. cit,** fq. 378.

47) Kupa ka trup cilindrik, me një këmbë të ulët unazore (L. 4,6 cm. diam. i grykës 6.2 cm). Gjithë faqja e saj është zbukuruar me një sërë figurash në reliev dhe e larë nga brenda e jashtë me një lustër të hollë ngjyrë kafe të hapët. Një kupë e ngjashme është zbuluar në Apoloni (shih. A. Mano, **Nekropoli i dystë i Apolonisë,** «Iliria» III, f. 203). Për datimin e këtij tipi nga mesi i shek. II deri në fundin e shek. III e.s., shih H.S. Robinson, **Roman Pottery,** Princeton-New-Jersy, 1959, f. 54).

48) Kandili është i tipit «korintik». Në pjesën qendrore të diskut paraqitet Herakliu në këmbë, lakuriq, me mëzdrakun në dorën e djathtë, të mbështetur në tokë dhe me lëkurën e luanit palosur mbi krahun e majtë, që e ka nxjerrë përpara. Në bazën e rrumbullakët të kandilit ka një vulë mbishkrimore tepër të fshirë: [Κ]αλλισ[τον]
Për datimin e këtij tipi kandilash në shek. II-III e.s., shih Ph. Bruneau, **Lamps Corintnienses,** «B.C.H.» XCV, 1971, fq. 448.

49) H. Ceka, **vep. cit,** f. 45. dhe 141.

50) F. Tartari, **Një ndërtesë e shek. III p.e.s. në Durrës** (dorëshkrim) Përfitoj nga rasti për të falenderuar autorin.

51) Për amfora të shek. I p.e.s me vula mbishkrimore «HERG» dhe «HER» në buzë të enës, shih. M.H. Cahlender, **vep. cit,** nr. 627, fq. 139 dhe nr. 693 fq. 138.

FOTOKOPJE

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11

me buzë pak të profiluar dhe zbukuruar me vija të bëra me gishta. Kalipteret ishin të tipit me kurriz të harkuar.[52]

Në afërsi kemi gjetur tre tamburë kolonash guri gëlqeror me kanelyra jonike (Fig. 10,a) dhe lisho (Fig. 10,b). Përmasat e tyre janë: a) L. 58, ø 0,24m, b) L. 0,44m, ø24m: c) L. 0,41m, ø, 21m. Në qendrën e secilës bazë të tamburëve ka gropëza katrore me tendencë për rrumbullakosje.

Gjetje me interes në afërsi të mbeturinave të kësaj banese, të nxjerra në sipërfaqe nga punimet bujqësore, janë një pllakë me dy figura në reliev dhe një pllakë me mbishkrim latin.

Relievi (Fig. 11) është prej guri gëlqeror dhe ka përmasat: lartësi 0,40m, gjërësi 0,29m dhe trashësi 0,11 m. Janë paraqitur dy figura grash në këmbë. Gruaja në të djathtë ka hedhur mbi kokë një vello që i le zbuluar fytyrën dhe i varet pas shpine. Dorën e djathtë e ka ngritur mbi gjoks, duke mbajtur një send të paqartë, ndoshta frut a lule. Në të majtë të saj qëndron një vajzë. Të ngjashëm me gruan përbri ajo ka mënyrën e hedhjes së vellos mbi kokë. Por këmisha e ngjitur pas trupit deri poshtë belit përbën një karakteristikë të veçantë të veshjes së saj. Dorën e djathtë e ka kaluar pas belit të së parës, ndërsa në dorën e majtë mban një degëzë gruri me gjethe, paksa të ravijëzuara.

Në tërësi relievi është tepër i dëmtuar, sidomos në fytyrat e grave. Pllaka është e thyer në anën e majtë, por që nuk të lë përshtypjen se ka pasur edhe një figurë të tretë. Një reliev i ngjashëm është zbuluar në Ballsh, që paraqet po ashtu dy gra në këmbë, prej të cilave ajo e anës së djathtë mban në dorë një kokërr shegë.[53]).

Çifti në relievin tonë mendojmë se përfaqson Demetrën dhe Koren. Relievi ka karakter votiv dhe siç duket është mbajtur në një shtëpi të lidhur me ekonominë bujqësore.[54]

Pllaka me mbishkrim latin është një pllakë përkujtimore prej mermeri të bardhë, e thyer në të djathtë (Fig. 12). Ka përmasat: L. 0,26m, gjatësi e mbetur 0,36m. Në anën e majtë një brimëz e rrumbullakët e tejshpuar le për të nënkuptuar se ka shërbyer për montim në vendin e destinuar. Brenda është gdhendur mbishkrimi që vijon:



Fig. 12

52) Këtu janë gjetur edhe fragmente pitosash e amforash, vegje dysh amforash me prerje në trajtë 00, fragmente **terrasigillata** si dhe monedha bronxi mjaft të dëmtuara.

53) C. Praschniker, **Muzaknia und...**, f. 162, fig. 78, që e ka cilësuar reliev funerar.

54) Për Demetrën ἐποικιδίη, mbrojtëse e shtëpisë, shih. D. Callipolitis-Flytmans, **Deméter et les Moires,** «B.C.H» XCIV-1970, fq. 46.

Hono [re usus]/p(rincipi)o(ptimo) aed(ili), v(iro) b(ono)Marco/cliens.

Kjo pllakë kaptohet se i kushtohet qytetarit të shquar Marko, që në qytet ka pasur edhe postin e edilit, nga ana e një klienti të tij. Nga karakteri i shkrimit mendojmë se datohet në shek. I e.s.

Në një pikë tjetër rreth 300 m në perëndim të së parës është gjetur një fragment frize prej guri gëlqeror që paraqet një triglif dhe një pjesë metopi. Përbëhet nga një bllok me trashësi 15cm, gjatësi e mbetur 32cm dhe lartësi 30cm. Gjatësia e kanelyrës së triglifti është 17 cm. Në afërsi është gjetur një fragment i vogël kolone guri gëlqeror, lisho me mbishkrim rreth gropës qëndrore të bazës:O∈ω...

Në këtë sektor gjurmë ndërtesash antike shihen edhe më nga veriu, deri përtej rrugës Spitallë-Vrrin. (Shënavlash). Një pikë me interes gjendet pranë Spitallës. Në sipërfaqe mund të mblidhen fragmente lastrash mermeri, si dhe tulla katrore me kanale diagonalë në faqe, që kanë përmasat 29 x 29 x 2,5cm. Aty kemi gjetur dhe një fragment të vogël kolone me kanelyra dorike.

Por objekti më i rëndësishëm i dalë në sipërfaqe në këtë pikë nga punimet bujqësore i përket skulpturës. Është një kokë vajze prej mermeri të bardhë (Fig. 13), me madhësi në natyralen.[55] Ka vrasje të vjetra në hundë e mjekër dhe gërvishje të lehta në ballë e faqe. Ka pësuar gërvishje të reja nga plugu, sidomos në anë të djathtë: faqe, vesh, ballë e qafë. Lartësia e përgjithshme, me gjithë qafën, është 0,33m, vetëm e fytyrës 0,19cm.

Paraqet fytyrën e një vajze me ballë të madh, vetulla të holla, sy në trajtë bajameje me bebëza të theksuara në formë rrethi e me brimëza në qendër, buzë pak të shtrënguara dhe mjekër të rrumbullakët. Në tërësi fytyra duket realiste, me subjekt nga jeta, që shpreh një qëndrim serioz dhe deri diku krenar.

Flokët i ka të mbuluara me një kësulë gati nemisferike, me një palë dyshe, si shall, që e qarkon në anën e poshtme. Kjo i lë zbuluar mbi ballë një pjesë flokësh të ndara me vijë në mes e të shtrira anash; mbrapa flokët i ka të ngritura lart për t'i mbështjellë me kapelen. Poshtë têmthave i varet nga një tufë flokësh, a stoli, në trajtë veshi rrushi.



Fig. 13

Kunji që vijon poshtë qafës tregon se ka qenë vendosur mbi një shtatore, e cila do të ketë shërbyer për zbukurimin e një vile **rustica** të shek. II e.s.

Sektori D

Një pikë tjetër me gjurmë ndërtimesh antike gjendet në pjesën veriore të kënetës, pranë Bisht-Kamzës, rreth 600 m nga bregu i detit. Shtresa kulturore këtu dallohet në faqen e një kanali, në thellësinë 1.5 m. Materiali paraqet ngjashmëri me atë që kemi parë në banesën e zbuluar pjesërisht në sektorin «A» dhe datohet në shek. III p.e.s.[56]

55) Shpëtuar gjatë punimeve bujqësore.

56) Kalipteret janë të tipit me kurriz me këndë si edhe nga to me kurriz të harkuar. Ndër enët e baltës, përmendim një pjatë me vernik të zi që ka në qendër një stampë me pesë gjethe palmetash (Tab. III, 10). si dhe një fund kupe që ka gjithashtu në qendër një stampë, por prej katër palmetash dhe brendashkruar një rrethi kymatesh dorike.

DO NOT COPY

PËRFUNDIME

Në përfundim të këtij vështrimi mbi të dhënat burimore dhe arkeologjike që përmblodhëm më lart, mund të themi se për periudhën e hershme të Dyrrahut si qytet, ekzistenca e kënetës vihet në dyshim ose, së paku, nuk mund të bëhet fjalë për përmasa të tilla të saj sa për ta kthyer atë në «ishull». Ndërtimet e shekujve IV p.e.s. deri përafërsisht shek. II-III e.s. që kanë qenë më të evidentueshme deri tani, sidomos në pjesën JP të saj, këmbët e ujësjellësit të shek. II e.s. dhe grupe varresh të shekujve II-III e.s. nuk do të pajtoheshin as edhe me praninë e një lagune të vërtetë më në veri, pra në shpinë.

Ajo çka rezulton e pakundërshtueshme është që trualli i kënetës gjatë këtyre dy mijë vjetëve të fundit ka pësuar një ulje, ose të ngadaltë, epirogjenetike, ose të menjëhershme, tektonike, dukuri kjo e pranuar gjeologjikisht[57] dhe arkeologjikisht edhe në pika të tjera të Ultësirës Bregdetare.[58]. Për rastin tonë, si dëshmi shërbejnë mbetjet e ndërtimeve antike brenda lagunës, në një thellësi 1-1,5 m nën nivelin e detit. Këtë e përforcon edhe njoftimi për mure me blloqe të mëdhenj kuadratikë dhe mori solenesh e kalipteresh që janë vërejtur brenda në det në gjirin e vogël të «Porto Romanos».[59]

Proçesi i kënetëzimit mund të ketë nisur në fund të epokës së kaluar ose në fillimin e epokës sonë dhe ka vijuar gradualisht me formimin e një moçali në pjesën qendrore-jugore, vend që para se të bonifikohej njihej me emrin «Balta e Madhe». Por mund të shpjegohej mirë edhe si pasojë e një tërmeti të shoqëruar me vithisjen e tokës, që është mbuluar pastaj nga uji. Sidoqoftë, duke filluar nga shek. I e.s ekzistenca e një kënete të parëndësishme mund të pranohej, por që mbahej e ekuilibruar nëpërmjet një kanali të lidhur me detin.

Gjurmët e ndërtimeve antike që vërehen aty, duket që përfaqsojnë kryesisht shtëpi banimi. Për mendimin tonë duket se kemi të bëjmë me një lagje jashtë mureve të qytetit.[60], në horën e tij të ngushtë. Themi «një lagje e jashtme» duke pasur parasysh jo vetëm linjën e njohur të rrethonjës së qytetit, por edhe shtrirjen e nekropoleve të shekujve VI-I p.e.s. dhe të shekujve I-IV e.s. që e qarkojnë atë (Tab.I)[61]. Shembuj të tillë në periferi të qyteteve antike nuk mungojnë[62].

Materiali ndërtimor si guri, tullat e tjegullat, sikurse dhe detaje të tilla arkitektonike siç janë pjesët e kolonave prej guri gëlqeror e mermeri, apo fragmenti i frizit me triglif, dëshmojnë për ndërtime jo të thjeshta, që kryesisht mendojmë se kanë qenë banesa. Mbi përmasat e këtyre ndërtesave dhe pozitën shoqërore të pronarëve të tyre në shekujt e IV-I p.e.s. hedhin dritë madhësia e pjesës së zbuluar të shtëpisë në sektorin «A», sipërfaqia e gjërë që zënë gjurmët e dukshme të ndërtesave në pika të tjera, si dhe qeramika e cilësisë së lartë e monedhat.[63]

Shkaku i ngritjes së banesave në këtë territor mendojmë se nuk shpjegohet vetëm me mungesën e sipërfaqes brenda mureve të qytetit, por në radhë të parë me zhvillimin e bujqësisë në horën e tij të ngushtë. Si prova të lidhjes së këtyre banesave me ekonominë bujqësore, përveç vetë fushës ku janë ngritur, mund të merren edhe fragmentet e shumta të pitosave e të amforave, si enë qilari. Një provë interesante është edhe relievi i Demetrës me Koren, si perëndesha që mbrojnë bujqësinë dhe qetësinë e njerëzve të fushës. Kurse fragmenti i frizit dëshmon ndoshta për ekzistencën e një sanktuari të vogël tej qy-

---

57) N. Luli, S. Boçi, **Studim i lëvizjes bregdetare nga pikpamja topografike,** «B.SH.N» 2, 1966, fq. 123.

58) A. Baçe, **Rrugët shqiptare në mesjetë, shek. VII-XV,** Kumtesë në «Konferencën Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, kulturës dhe gjuhës së tij, Tiranë, korrik 1982, «Monumentet» 1, 1984.

59) M. Zeqo, **Gjurmë ndërtimesh në gjirin e Porto Romanes,** Kumtesë, në «Adriatiku» – almanak, Tiranë, 1982.

60) C. Praschniker–A. Schober **vep. cit,** fq. 39-43 sugjerojnë se tej mureve të rrethonjës bizantine do të duhej kërkuar vendi i ngulimit të kolonistëve të vjetër në Epidamn.

61) Shih. S. Anamali, **Nekropoli helenistik i Epidamnit,** «B.SH.SH.» 1, 1957, V. Toçi, **Relieve e mbishkrime...,** F. Tartari, **Rezultate të gërmimeve;** H. Hidri, **Gërmime të viteve të fundit në nekropolin e Durrësit,** dhe I. Toçi, **Të dhëna nga zbulime të rastit dhe sondazhe në nekropolin e Dyrrahut,** në «Materiale të sesionit shkencor arkeologjik», Durrës, nëntor 1983.

62) E. Conduracni, **Problemi della ΠΟΛΙΣ e della ΧΩΡΑ nelle citta greche del Ponto Sinistro,** në «La città ed il..;» f. 147.

63) Për banesa pronarësh të pasur në afërsi të Apolonisë në shek. V p.e.s., shih Herod, IX, 93.

DOKUMENTY

tetit, që me shumë mundësi do t'i dedikohej Demetrës dhe Kores.[64]

Ndërtimet më të hershme që njohim deri tani (ato të shekujve IV-III p.e.s), përkojnë kronologjikisht me kohën që Dyrrahu bie në kontrollin e mbretërve ilirë[65] dhe përbërësi ilir në qytet shtohet[66]. Për atë periudhë kjo lagje jashtë mureve të qytetit nënkupton, nga ana e vet, kushte normale në marrëdhënie me horën e madhe, që banohej vetëm nga vendasit. Rrethanat e favorshme për ndërtime në këtë territor mund të kenë ndikuar edhe në zhvillimin e fshatrave në harkun kodrinor në lindje të Durrësit, siç është rasti në Vrrin.[67]

Për shekujt I-III e.s. gjurmët e ndërtimeve të dokumentuara sidomos në sektorin «C» mund të merren pa hezitim si mbeturina vilash të pronarëve latifondistë.[68]. Pajisja e tyre me skulptura mermeri dhe veçanërisht pllaka me mbishkrim kushtuar edilit Marko e mbështesin këtë mendim. Por pllaka në fjalë dëshmon gjithashtu edhe për mundësinë që përreth pronave të qytetarëve të rëndësishëm banonin këtu edhe fshatarë, skllevër të liruar e plebej (cliens), të cilët kishin shumë nevojë për mbrojtjen e të parëve. Kurse guri i sinorit dëshmon se kufi pronave private, kishte edhe prona publike që i përkisnin bashkësisë së qytetit. Përmes kësaj lagjeje siç duket kalonte edhe rruga kryesore që dilte nga qyteti; për këtë dëshmon në një farë mënyre **cippusi** me mbishkrim të njëjtë në dy faqe të kundërta.

Për periudhën e vonë antike nuk kemi ndeshur gjurmë banesash. Nga kjo mund të nënkuptohet se në shekujt V-VI këneta kishte arritur përmasa më të mëdha. Por ngritja e mureve të tipit «barrierë» në veri dhe në jug dhe mbajtja në funksionim e kanalit që e lidhte me detin, kanë dhënë mundësi nga njëra anë, që shtrirja e saj tani të jetë shfrytëzuar për qëllimin e mbrojtjes dhe, nga ana tjetër, për të kursyer ende të thatë një pjesë të fushës.

Më pas kuptohet që këneta i ka shpëtuar këtij kontrolli dhe ka arritur kufijtë veriorë dhe lindorë të qytetit, ashtu sikundër ka pasur periudha që është vënë përsëri deri diku nën kontroll me anën e mirëmbajtjes së kanalit. Një kohë kur fusha në VL të qytetit ishte e lirë nga ujërat, është edhe ajo kur Robert Guiskardi ngriti aty kampin e tij luftarak. Në atë kohë mbetjet e ndërtimeve antike që përshkruam, sigurisht do të kenë qenë më të dukshme dhe, prandaj, mendojmë se është pikërisht kjo pamja që e ka shtyrë Ana Komnenën të shkruajë se kampi u ngrit midis rrënojave të Epidamnit antik[69].

Me interes na duken së fundi dhe të dhënat onomastike, siç janë emrat ilirë Nesyl, Syro, Sura, sikurse dhe vetë toponimi i parë që njohim për kënetën, «Balta». Nga studimet gjuhësore rezulton se kjo fjalë i përket leksikut të ilirishtes me kuptimin «kënetë»[70].

64) G. Vallet, në **La cite et son territoire dans les colonies greques d'Occident,** fq. 87, përmend se ndër gjashtë sanktuarë «suburbanë» të **Gelës,** katër i janë dedikuar Demetrës dhe Kores.

65) Diod, XIX, 78, 1; shih: S. Islami, **Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare,** në «Kuvendi i Studimeve ilire», Tiranë, 1974, dhe H. Ceka, **Probleme...** fq. 95-96.

66) S. Anamali, **Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apoloni** që përmend Elianin, «B.SH.SH» 1, 1956; H. Ceka **vep. cit,** fq. 31.

67) H. Myrto, **Një varrezë antike në fshatin Vrrin të Durrësit,** «Iliria» (në shtyp).

68) Këto ndërtime tregojnë se nuk mund të jetë ky vendi i braktisur i Epidamnit antik, për të cilin bën fjalë Pausania në shek. II e.s. (VI, 10, 8) shih; Praschniker-Schober për mendimin e tyre hipotetik në **vep. cit,** fq. 37, 40.

69) Shih sh. nr. 10, më lart.

70) E. Çabej, **Studime etimologjike në fushë të shqipes, II, A-B,** Tiranë, 1976, shih «Baltë», si dhe literaturën që citon. Shih dhe T. Todorov, **On the etymology of Deutum,** «Thracia», Sofja, 1980, fq. 204.

DO NOT COPY

TAB I



DO NOT COPY

TAB II



DO NOT COPY

TAB III



DO NOT COPY

Halil MYRTO

DO NOT COPY

DONNEES SUR L'ETENDUE DE DURRACHIUM DANS LA PARTIE SUD-OCCIDENTALE DU «MARAIS»

RESUME

Avant d'être bonifié en 1962, le Marais de Durrës s'étendait au Nord-Est de la ville occupant une superficie de 2050 ha. Aujourd'hui la plus grande partie de cette étendue est au niveau de la côté 0,00 au-dessus du niveau de la mer (Pl. 1).

Aperçu sur la géographie historique

Des données indirectes dont on suppose l'existence d'un marais qui séparait Dyrrachium des terres et le rendait presque en une île, se mentionnent premièrement sous César au milieu du Ier siècle avant notre ère et sous Lucien au Ier siècle de notre ère. Mais plus clairement c'est dans la communication de Procope de Gaza, auteur de la fin du Vème siècle et du début du VIème siècle de notre ère.

Anne Comnène, au XIème siècle, en décrivant le siège de Durrës par les Normands, laisse sous-entendre l'existence d'une lagune, mais de superficie limitée, en mettant au Nord-Est de la ville une Etendue libre pour l'emplacement d'un camp militaire de 30 000 hommes. L'auteur ajoute que le camp a été installé, sur les mines de l'Epidamne antique. Au XVème siècle le Marais est mentionné premièrement de façon directe et par son propre nom «Balta».

Données archéologiques

Des objets archéologiques provenant du Marais sont signalés depuis 1920. Lors des travaux de bonification en 1961-1962, on a sauvé quelques fragments de colonnes ainsi que d'autres objets. En 1971 un cimetière des premiers siècles de notre ère a été découvert dans la zone nord-orientale de la ville que l'expansion des eaux atteignait autrefois. On a plus tard un rapport détaillé sur les vestiges de l'aqueduc du IIème siècle de notre ère qui traversait de part et d'autre toute la partie sud-occidentale.

Mais les vestiges de construction antiques sur ce territoire ont une étendue plus large dans l'espace et dans le temps. Pendant des recherches à la surface, surtout au temps des labourages, au bien en effectuant quelques fouilles, nous sommes convaincus que les vestiges de constructions antiques dans la partie sud-occidentale de l'ancien Marais occupent une superficie de 80 ha que nous avons divisée en trois secteurs exception faite d'un quatrième secteur au Nord.

Le Secteur A

1) Par des fouilles encore inachevées ont été découverts des fragments de murs construits en pierres façonnées et des parties de planchers couverts de pierres et d'éclats de tuiles. On a découvert une foule d'éclats de tuiles et holipterch ainsi que de terrines, d'objets métalliques et de monnaies en bronze de Dyrrachium. Les briques manquent. On ne pourrait encore porter un jugement de valeur sur la planimétrie totale de cette habitation, mais d'après le matériau archéologique elle peut être très bien datée de la fin du IVème siècle et du début du IIIème siècle avant notre ère.

2) Sur le haut d'un canal d'écoulement des eaux au Nord-Est du points sus-mentionné on voit un pan de mur qui a 6,30 m de long, 0,70 m de large et 0,35 m de haut. La technique de construction et le matériau archéologique le datent des IV-IIIème siècle avant notre ère.

3) Au Sud de la ligue de l'aqueduc antique on remarque la suite d'un mur de matériau de construction caractéristique à la Citadelle de Durrachium, V-VIème siècle.

4) Un autel de tombeau en marbre y a été emmuré avec cette inscription latine: Mforius... menus... s-perp... rhedris... svis dp, daté au Ier siècle de notre ère

5) Un cippe de provenance similaire avec la même inscription latine aux deux côtés contraires.
M(arco) Terentio (Syro) Padia Prima (Viva feclit) h(oc) m(onumentum) h(eredem) n(on) s(equetur).

Il garde le nom illyrien «Syro» employé ici selon la formule onomastique. Il appartient au Ier siècle de notre ère.

6) Un autre cippe, cippus terminolis avec une inscription dans les deux côtés contraires, Privat(us) (P)ubl(icus), a été trouvé à l'extrême occidentale de ce secteur.

DO NOT COPY

7) Un groupe de trois tombes a été découvert à proximité. Les deux premières tombes présentent la sépulture à dépouille mortelle dans une construction de tuiles en forme de sommet de toit, l'autre tombe c'est à crémation avec les cendres dans une urne de verre déposée dans une amphore L'Amphore porte un sceau avec une inscription de deux lignes et l'on pense qu'elle serait produite à Dyrrachium.

Le Secteur B. Dans une superficie de presque 2 000 m^2 on a trouvé les restes d'une ou plusieurs habitations extraits du sol lors des travaux agricoles. Le matériau en céramique, surtout les tuiles à sceaux épigraphiques de Dyrrachium prouvent que les constructions ont eu une durée de vie depuis le IIIème siècle avant notre ère jusqu'au Ier siècle de notre ère.

Le Secteur C s'étend au Nord du secteur A dont il est à peine séparé.

